

Poetry Series

skender iljaz braka
- poems -

Publication Date:

2018

Publisher:

Poemhunter.com - The World's Poetry Archive

skender iljaz braka(15.12.1954)

i martuar me tre femije....banoj ne qytetin tim te lindjes, dureses....

Agimet E Mia

Agimet mendueshëm vështroj që ikin..
Mengjeseve treten si zvarritja e kërmillit.
Shkëputur nga lartë, prej kthetrave të skifterit
papritmas shuhet blegërima e qingjit.

Me filxhanin e kafes turke para duarve
I vetmuar qëndroi, ulur në çardak.
Në heshtje tymos cigaren
dhe diç murmurisë përdhëmbshëm.
Fjolla të holla mjegulle që lëpihen nëpër fshat.
Kujtimin e largët më sjellin të një kohe
Mbërthyer nën lak.

Diku lojthata e plakur krahet shkund ngadalë.
Harabelin e përgjumur maj degëzës,
kërkon të zgjoj prej gjumi.
Pas lopës qan me ngashërim një djal,
që shkollën dhe sot veç I ati e di përse ia humbi.

Një nuse e re, një makinë të rastit pret.
Me boçen pranë këmbëve duke u dridhur.
Për lindje e ngrata nxiton të shkoj në qytet.
Më pas të përgëdhel
fyturën e foshnjës së parë të shumëpritur.

Këto janë rëndomë agimet e mia.
Mëngjezet e thyera si pema e thatë.
Gjunjët më dridhen kur zbres tek avllia
Nesër po një kafe turke do të pi ne çardak.

skender iljaz braka

Ah Ky Brez Rinie

Ah ky brez rinie....

Indiferent e i pashtuar punës ky brez rinie.
Dhe çuditërisht i kënaqur shumë prej vetvetes.
Tmerrohem kur mendoj se ç'dreq fytyre,
dhe çfarë motivi do ti japin këta të nesërmes.
I kam ndjekur tek rrinë në grupe ndan udhëve.
Shulluar diellit gjumëndjellës të përtacis dhe vesit.
Me jetë të çthurrur e të çrregullt ngrysin ditët.

Nën efekte të (që s'mundem ti përmënd,
thjesht prej sedre e vrarë prej stresit.)
Pika të më bjerë që jam më i trishtuar se ata.
Dhe ata që më të trishtuar se unë nesër do të jenë.
Ah moj e bardha dëborë!
E bukur je, por dimrit mbi ty dhe qentë dhjesin.

skender iljaz braka

Ai La Pas Vetëm Jetën E Zjarrtë

Eh ati im i mirë...

Nga puna kthehej me aromën e Ilaçit.

Përhapej gjithandej nëpër dhomë

era e gërqeres, tullës dhe hekurit të betonit.

Shokët më thoshnin se shtëpia jote

mban aromën e muratorit.

Mua shtëpia e varfër më dukej si një pulëbardhë

që lëviz qafën e saj të përsosur, pa u lodhur.

Një ditë era e mpiksur prej botësh të padukshme

kanatave të hapura të ngrehinës tonë fryu.

Shuplakat e ashpëra të atit tim u bënë pulëbardhë,

në ikjen e tij të ngadalshme për në askund.

Kominoshet e vjetëra iu bën qivuri i varrit.

Jetën e tij të muratorit mori me vet atë ditë,

duke na lënë si trashgimi të ditëve të rrënuar,

gjithçka prej jetës së zjarrtë.

skender iljaz braka

Ajo Qendronte Atje

Ajo qëndronte atje....

Ajo qëndronte atje....

Atje ne kufirin midis tokës dhe detit.

Me mallin e mallit të zhytur thellësive të tij.

Me lot-dhimbjen nën këllëf të vështrimit.

Dallga qepallët i thyente me shkëmbin e lotit.

Me stërkalat e akullta mpinte bëzën e saj mavi.

(C' I thonë sytë e fjetur mes ujërave dhe koraleve.

Vallë e pyesin për dhimbjet që shpirtit i pikojnë?

Ka pirë prej atij lum-lotosh si të kenë rrjedhur maleve?

A ndoshta gjiri qumështit ka nisur ti rëndoje.)

Ajo qëndronte atje...

Me dëshirën e themelimit të një tjetër bote.

Përtej zbrazëtirës së ftohtë nën akujt e agimit.

Pa re gjëmuese mbushur me vetëtima vrastare.

Pa klithma çjerrëse dhe dritë-errtën e mërgimit.

(Në cilat perla, dremit a fle vetmia jote e përjetëshme?

Shumë brengë dashurie dhe lot-malli këtu ke lënë.

Tregom të lutem për netët mes yjesh përzier me leshterik.

Dhe sa pika qumështi prej qumështit tënd,

Nimfave u ke dhënë.)

skender iljaz braka

Anija Ime

I këputa cimat e vjetra nga moli.
Me forcën e muskujve shkallmova koracën e ndryshkur.
Sperancën nga thellesit e detit e ngrita me vrik.
Ia ndeza motorrët anijes sime të vjetër.
Pastaj njeherazi thirra:
- He, hej. Lundro anija ime! Lundro!
Thyeja dallgët deteve, oqeanëve!
Prej shtërngatash dhe stuhive mos u frik.

skender iljaz braka

Aroma E Shpërthimit Të Borzilokut Të Parë

Aroma e shpërthimit të borzilokut të parë
varur në kryqin e padukshëm të ditës.
Në tejdukshmërinë e ujërave të perëndimit,
mes valëzimit të qelqtë, rridhnin çastet, minutat.
Heshtja heshtjen përpinte me dhimbjen e moskthimit.
Lamtumira e një zëri të padëgjuar në kicin e tragetit
dhe puthja e gishtërinjëve prej buzëve të përvëluara,
shkundënin pluhurin e lodhjes së humbjes.
Nuk do të ketë më kthim mbi të shtata ngjyrimet e ylberit.
Kthim nuk do të ketë më tek borduri i basenit.
Diçka do ti mungoj shpërthimit të borzilokut në ballkon
dhe takimit të pare tek stacioni i trenit.
Dhe shkumëzimi i valëve në mol, prej ndarjes,
nuk e gjen dot qetesin e tij.
Tej ndihet vaji i hekurt i një këmbane,
si sytë e shndritshëm të një vajze, dikur.
Aroma e shpërthimit të borzilokut të pare...

skender iljaz braka

Asgje Nuk Do Te Humbas Prej Syve Te Tu

Asgje nuk do te humbas prej syve te tu

I thinjuri plak e i hequri gjer në eshtra,
si të tokës tënde të ngrën e grryer prej stuhish.
Sytë e tu përtej kohërave shikimin përcillnin.
Dhe etja për liri prej buzëve të thara të pikonte,
si rrëshira e qelibartë e trungut të pishës së zezë.

Prej zjarrit përcëllues, lindi fjala jote e urtë.
Lindi mushti i ardhur i mendimi tënd të ndritshëm,
që ti gjer tek unë i dërgove përmes klithmës së lirisë.

Si një tufë karafilësh të kuq letrash të

çmueshme,
Më solle me to dhe një kupë me vesë prej Dardanisë.
Vitet e mohuara më solle si dëshmi që kohërat moderne
qëllimshëm me dheun tënd të djegur
Mbështjell e kishin me harresën e mjegullës së rrufjanëve.

Plak i urt.

Zëri yt më sillte aromën ledhatuese të manushaqes.
Mjaltin e e gështenjës së butë të livadheve.
Dhimbjen që me timen takohej si trupëzat qiellore.
Ti shkoje përmes vrundujve të fuqishme të erërave të 81-shit,
që me tërbim udhëve të Prishtinës shkundënin baltën e ngjeshur
reckurinat e grisura, rreckurinat e pisura të përbindëshit.
Ti ishe mes britmave të fuqishme të dallandysheve të tua,
që fluturimin kishin marrë të vetëdijshme për çlirim
Atëherë fjala jote mbi zemrat e tyre binte
si copëzat e perlave mëngjesore.

Urrejtja që portat e njerëzve të munduar thyen,
përmes ëndërrash të squllura të shpërtheu.
Dhe zëri yt kumboi mureve të heshtura të qytetërimeve,
për mizorit e pashëmbullta shnëdrruarr në acide bazike.
Gjithçka jotja e dashur kthyer ish në shkreti djerrinash.
Në gjëmbaç të tharë e trungje të djegura bashtinash.

Me ty gjer në kështjellën e Burbonëve erdhi drithi i bukës.
Për të parën herë ajo njohu legjendën e Mujit dhe lotin e Ajkunës

Pas teje erdhi atje kripa, zjarri i oxhakut, drita dhe vetëtima.
Erdhën me ty muzat dhe mushti i ardhur i fshikëllimës.
Atyre ditëve në dritaren e zemrës tënde hyri fladi
i ngrohtë i erërave të reja që tokës tënde do të frynin.
Hyri zjarri përvëlues i Trepçes dhe flakërima e lumit të Ibrit.

Dikush do të dëshironte të harroheshe plak i urtë.
Dikush do të dëshironte të varroseshe me trandafilat e tu.
Po kush mund ta lëkund lisin që në acare dimërore
prej rrufesh s'u dogj e gjunjësh kurrë s'u përkund?
E si mundet të humbas fara e përzgjedhur e drithërave,
që harlisen lartësive në tokën që kurban u bëhet perëndive?

Si mundet të humbas prej syve të tu makabra e varreve massive.?
Si mundet të humbas syrit tënd miti i pavdekshëm i Adem Jasharit.?
Ti me syrin tënd të djegur në mendimet e Miteve të zhveshura,
eshtrat e të parëve i ngrite prej thellësive të ftohta të varrit.

Ne do të shkojmë së bashku duke kënduar
"Hymnin Kombëtar" me zërin tonë të djegur prej gjëmimeve.
Do të shkojmë atje ku përherë do të çelin zymbylat e lëndinave

skender iljaz braka

At Gjergj Fishtës

E kristaltë si uji gurrë-malit, fjala jote At.
Mes njerëzish të mori udhë muza, frymëzimi.
Dhe për të vdekur me urti mësove bijtë e tu.
Shtigjesh të mprehta të ecin, ku merr udhë guximi.

Shpirtin drejt qiellit ta ngriti, 'Lahut e Malsis'.
Aromë e bjeshkëve dhe trifilit të porsaçelur.
Etja e zemrës për atdheun asnjëherë s'tu fashit.
E mbajte për të syrin, si dritë ylli të pa tretur.

Mbi kod të ndershmerisë mbështe ballin që të digjte,
tek sodisje rrëshqanitjen e kryqeve të varrosur.
Mbi kalbëzime, kur shkelte këmba jote dridhej.
Dhe për harresat qaje me sy të përlotur.

Qaje, për Shqipen dhe shkollimin e breznive.
Për bedenat e kështjellës sonë të fundosur.
Zamadh i mbete kombit si Tirteu i lashtësive.
Homer i tragjedive të një populli të rreckosur.

Klithe at, në çdo skaj e gjithkunjëd klithe,
për vetëdije dhe helmet e pafundë të kësaj bote.
Për kënetat dhe zullumet e gjithë mizorive
dhe gurët e pathërrmueshëm të k'saj toke.
Një mbrëje e kuptova....
Kokën ule e diç murmurite nëpër buzë.
Jetoje me mendimin se unë të tradhëtoja.
Ndër mend se kisha shkuar kurrë e dashur.
Se pa dashurin time më tepër do të doja.

Një mbrëmje kur muzgu befi përmbi det.
I vetëm shkoja përgjat bregut këngëtar.
Pa ty gjithë bota më dukej aq e shkretë.
Dhe vetja më dukej si kërkushi, mëkatar.

Atij çasti e kuptova seç ish në thelb vetmia.
Se humbja të shkaktoka një hon kaq të errët..
Si yjet su shkërrmoqka nëpër duar mërzitia.
Mes dilemash dhe vet jeta tu bëka më e pjerr't.

Se ky breg ku ne u puthëm s'është i kot.
Atje ku vdesin dhe rilindin të gjitha dashurit.
Jetën duke thither përmes etjesh dhe nën lot.
Se u dashka ca vullnet për të thyer marrëzit

skender iljaz braka

At U Bëra Për Atin Tim....

Pesëmijë vjet më i madh se ati im jam sot.
Vëlla i tij flokëthinjur si mjekërra e stërgjyshit,
që më tregonte legjenda kreshnikësh
dhe ndodhira me demon.
Sytë dhe buzët i kam si të tijët,
Mbushur me përngjashmërinë e brazave.
Më i vogëli vëlla i tij kam mbetur,
prej asaj ngrehine të pazhdukshëme të farërave.
Pesëmijë vjetë më shumë se ati im kam rrojtur.
Mbi të jam përkulur, dorën duke i vënë në ball.
Mbi ballin e rrudhur, mbi ballin e varrosur.
At për atin tim u bëra në këto vite.
Njërën pas tjetrës duke hapur të gjitha
dyert e mbyllura të trashëgimive,
ndryshkur prej gjakut ujëholl të fatkeqësive.
Pesëmijë vjetë kam jetuar me
dashurinë e përmallëshme të stërnperve
unë krishti I kryqëzuar me rrasa gurësh nën kokë.

skender iljaz braka

Ata Që Ikin Dhe Ata Që Do Të Vijnë.

Ata që ikin dhe ata që do të vijnë.

Prej fatit të imponuar, nëpër dhëmb coptojnë

rrashtët e tyre prej vdekjes dhe riprodhimit.

Nën tragjedira klithmash mbijetesën kafshojnë.

Helmet e mbledhura ndër vite thëthisin prej

zhgënjimit.

Të goditur egërsisht, rrëzuar

përdhe, të pa jetë.

Me sy të përhumbur, ku pasqyrohetdëshpërimit.

Qetësia përherë rrënqethet prej krismash të thata.

Që drejtim paditur humbasin pa frikën e shpagimit.

Me të pabindëshmen portë të jetës përherë përleshur.

Duke kërkuar pak LIRI nën një qorrollisje të verbër.

Guvave të vdekura të nëntokës si çifutët duke u endur.

Ata që ikin dhe ata që do të vijnë.

Kohës së tyre të shkuar dhe kohës që presin të vij.

Me të pasigurtat hapa nxitojnë e nxitojnë parreshtur.

Si ngjyrimet e bredhave të zyrtë, pyllit të çngjyrosur.

Tmerruar prej këtij llahtari përjetësisht të ndezur.

Veç një zoti i falen në një tempull të pa emër.

Me ëndërra, dëshira dhe shpresa të varrosura.

Ata që ikin dhe ata që do të vijnë.

Mes përpjekjesh të grabitura, me një vendosmëri të ftohtë.

Nga mëkati dhe heshtja vijnë dhe shkojnë.

skender iljaz braka

Atdheu Im

Atdheu im.

Në këtë përvjetor të 100-të
Përpara gjunjëve të tu përulem dhe hesht.
Hesht me heshtjen e luftëtarit plagshumë
shkuar mendueshëm shtegut të thiktë të grykës së varrit.
Me nofulla shtrënguar prej shpirtit gjëmimtar.
unë dorën time eshtake drejt teje zgjas
për të fshirë bulëzat e përgjakura të djersës,
rënë mbi rrudhat e lëmuara të ballit.

Eh, moj shtëpiza ime, e vogëla zë kumbuese.
Shikim egëra me aromën e manushaqes së fjetur.
Dhimbja për ty më shkoi gjer në pikën e fundit të lotit.
Dashuria për gjithçka tënden kaq të shënjtë,
më shkoi gjer në kufirin e fundit të shpirtit tim të djegur.

Zgjas dorën të përgëdhel duke iu frikur lëndimit.
Ulërima të gjakosura dallgësh zgjohen rrudhave të tua.
Marrin hov e brofin ca stuhi të heshtura, të tërbuara,
që prej gjoksit të coptuar të ngrihen me rrapëllima.

Oqean i shndërruar në shkëmb stralli mbete atdheu im.
Asht i thatë mes shqotash e tramundanash të shfrenuara.
Mbete zhuri i ashpër ku lotoi e kokën mbështeti Ajkuna.
Zulma e heronjëve dhe lëngata e plagëve të pashëruara.

Zgjas dorën të përgëdhel buzën tënde të djegur.
Sepse dua të them Gëzuar në këtë të qindin përvjetor.
Unë adhuroj çdo grimcë të dheut tënd të ashpër e të etur.
Copëzën e varfër të bukës, bujkun e vobekët, madhështor.

Atdheu im i këngëve të mbetura udhëkryqeve

Atdheu im i këngëve të mbetura udhëkryqeve.
Degë lisash të moçëm je, ahesh e bredhash rrënjëthellë,
që s'shkulesh prej shakullimave të tmerrshme
të erërave grabitqare.
Kullë e rrënuar dëshpërimi je.

Mal kresht lëmuar vuajtjeje dhe pikëllimi.

Ti je gurmaz i uritur i njerëzve të tu kredhur në mjerim.
Erë e papërmbajtëme për degë të thara pishash.
Ball i zhuritur prej diellit të qëndresës dhe paqes.
Je Syri i përlotur vetëtimash prej lidhje të shkurtëra qarqesh.
Gur i pathërrmueshëm prej tallaze të shfrenuara dallgësh.
Yll i vonuar joshës që terrin e bënë të tejdukshëm.
Pëllumbeshë e zalisur kryqëzuar prej mijëra harqesh

Sa shumë e kisha ëndërruar fatin tënd të ndritur.
Si detyrë e një njeriu prej rrënjëve të tua mbir.
Rritur e ushqyer nëpër venat e zëmrës tënde
prej nga s'do të shkulem kurrë.
Dëshpërimin tim prej birishpirtëror
mbi detin e furishëm e memec dua ta derdh.
Si nevojë e domosdoshme e atij që pak rreshta
mbi rrudhat e buzëve të tua të përthara di të hedh.

O zogu im i humbur shtigjesh të mbuluara,
që ligjëron në misterin e errësirës.
O krifë, e egër për rreziqet e papërcaktueshme.
O shtrëngim, i tmerrshëm i zemrës,
që vetëm porsa të shqiptosh emrin tënd,
rrënoqethesh prej makthit e frikës së padurueshme.

Unë - pinjoll yt Ilirjan i gjakut tënd të kulluar,
puth rrashtin e shkëmbit tënd eshtak prej dallgësh dërrmuar.
Duartë e ashpëra mbledh grusht mbi një mill të kristaltë,
për të shkallmuar parzmoret e fatit tënd të mallkuar.
Mbi plagët e përthara prej kripësis së lotit, buzët mbështes
dhe thith aromën e trandafilave të egër të bjeshkëve,
që flenë si një drenushë mbi detin e dhashurisë së harruar.

Atdheu im i këngëve të mbetura udhëkryqeve.
Një udhëtar i lodhur, i huaj vjen e më pyet:
- Ku janë tempujt e lasht?

skender iljaz braka

Ate Nentor

Atë nëntor,

Atë nëntor,
kur lot i vjeshtës së tretë thyhej
mbi vraga të gjata dhimbjesh.
e mbi llakun e gjelbër të detit,
sterronte nata e përgjakur e akujve.
Nën një brerore drite, i urti plak,
më tepër se një shenjti ngadhnjimitar,
shpalosi gjithë përpjekjet e panumërta të shekujve.

Zemërshqyer prej ankthit për një frymëmarrjeje të lirë.
Nën fashitjen e menjëherëshme të një ëndërre mëkatare.
Majë thikash të përgjakur trupit ngulur, therur.
Dhe i urituri, i zëmëruari, i këputuri dhe i nënshtruari,

dhe druri i kthetrave të honit,
dhe fërfërima e valëve të barit,
atë ditë finale zbritën nën hijen e tij ëndrimtare,
Ish hija, që bënte shpirtërat të rilindënin.
Ish hija e krahve të pathyeshëm,
që shpirtin kishte ndezur përmes zjarreve.

Atë nëntor,
Nën shirat leshragafrruar të shtrëngatave.
Mes përpjekjsh e arritjesh të vetmohuara.
Mes dallgëzime rrëmetesh e lotë kripur prej lëngatave.
Drejtë teje flamuri yn udhetuan,
përjetësisht për të qënë të përkushtuar.

Atë nëntor,
Dhe zërat e maleve
dhe këngët e zjarrit, si drita që të errëtën largon.
U përulën në hijen e dritës tënde vagëlluese.
Përhapur si tymënaja prej erës, nën gjethet e thata.
Jeta e mbetura nën pamëshirshmërinë e dhunimit,
nën flladitjet e kraheve, gjeti vlagën e saj përvëluese

skender iljaz braka

Atje Ku Ti Më Shfaqesh..

S'munda një herë, shpirtin prej teje ta largoj.
Mbërthyer kam mbetur në të ftohtin e ikjes,
i mpirë prej fjalëve që s'munda ti them dot.
Ndjekur prej ethesh të një shprese të fikur,
që sa vjen e më të thellë ma bënë të egzistuarit.
Durimin, në oaze dëshpërimi m'a zgjeron.

S'munda njëherë të vetme prej teje të largohem.
Shtegëtari kryqëzuar mbeta shtigjeve të paçara.
Vemitari që nxiton nga njëri në tjetërin stacion,
përpjekur të mos humb destinacionin e hapave të para.

I verbëri që humbet tuneleve të tua të largimit.
Në pikë loti i kthyer kur më thua lamtumirë.
I pavëmëndshëmi që pas tingujve të humbur
pengohet dhe përgjaket prej rrëzimit.
Djegur prej dashurisë nga vetja duke u larguar.
Psherëtima që nuk mund të psherëtohet.

Duke jetuar si luani nëpër pyllin që digjet.
Ndjekur prej hamëndjesh të një dite të papriturash.
Atje ku ti më shfaqesh dhe sërishmi më largohesh.
Si të lindësh prej hiçit dhe prej hiçit të vdesësh.

skender iljaz braka

Atje Në Atë Buzëdet

Atje në atë buzëdet

Diçka më tërheq buzëdetit,
sa herë që dallgët shkumbardha
prëplasen me tërbim.
Sa herë që të thekëshmet.
Zëra tipike të netëve detare,
ngrihen thellësive me vrik.
per te shkukur spirancen time mbërthyer
në rërën brigje - brigje.

Diku, tej mes dallgeve,
imazhi yt, si nje nimfe e bukur,
me shfaqet si ditën që te kam humbur,
Ketu kam mbetur se nje Eskil
ne pritshmerinë e të pakthyeshmes.

As vete nuk e di perse...
Perseri te dua kaq shume,
dhe pse mendimet m'i ke mpire.
Si hije te tejzgjatura me ndjekin
si dikur hapat dhe zeri yt i trisht.

Si nje eremit e kryqezova per ty dashurine
aty ne ate buzedet,
ku kam mbetur,
pa nje alternative tjetre te dytë.

skender iljaz braka

Bashkeshortes Sime.

E dashur
sonde derën mos e mbyll.
Nëse vonë unë kthehm nga kjo udhë e gjatë.
Mbi endrrat e tua, si foshnjë do mbyll sytë.
Si gjethi, kur të bie e, të prehem në shtrat.
E dashur, të lutem sonde mos me pyet,
se ç'gjë të bukur të solla për dhuratë.
Asgjë nuk kam më tepër se ky zjarr në gji.
S'do të më qetësoj asgjë më shumë
Se shpirti yt këtë natë.
Pra qasu të të puth në ballin e përlodhur.
Pastaj në ëndërrën e gjumit tënd bjer e fli!
Prej meje parajsën e dashur mos e prit.
Më të çmuar ç'mund të jap se kjo dashuri.
Dimrin e shpirtit në gjoksin tënd do t'a ngroh.
Në borxhe do të zhytem për ty tek fuqit.
Që marrezisht nëpër ëndërr të thërras:
E dashur, edhe njëqind vite jeto,
me mua përjetësisht!

skender iljaz braka

Bemu Mikeshe Moj Vale

Ti valë e qetë e detit tim.
Qetë qetë puth bregun si një prrockë.
Nga mali zbres me uturimë.
Me dhimbje therse gjer në kockë.

Ti valë e qetë, frymemarrja ime.
Për mua, më e bukura je në botë.
Dikur me të dy ne ishim miq.
por tash sa kohë ty sytë e kaltër s'ti shoh dot.

Zhurmoj dhe shfry, nuk kam qetesi.
Ndaj vi të prek,
 të ledhatoj,
 të flas me ty.
Mbi shqotat e jetës të më hedhësh
Mikeshë t'më bëhesh prap moj valë.
T'më bëhesh prrush për dashurini.

skender iljaz braka

Besoj Në Kohën E Së Ardhmes.

Kam mësuar shumë pak mbi perënditë

Dhe zotat mëse një herë i kam përcmuar.

Në jetë kam besuar vetëm tek dashurit.

Tek njeriu që mes luftërash ka ecur ballëllart

dhe të vërtetat në udhrrëfime ka shndërruar.

Ndaj mos më kërkoni që verbërisht

t'u bindem të "shkruarave", magjive.

Dhe me gjasa t'i përulem të "mbinatyrshmes".

Shpirtin e zemrës nuk dua kurrë ta kreshpëroj.

Veç në mundësia ta pastroj prej vesit dhe lëbyrjes.

Mos më kërkoni të jetoj nën ligjësit frenuese.

Të padronëve që firmosin kohën shkatrrimtare.

Në vënd të zotave dhe perëndive,

unë i besoj paasgjësueshmërisë së lëvizjes.

I besoj të pashmangshmes kohë të së ardhmes.

Le të bëjmë më të mirën e asaj që duhet bërë.

Duke shkundur plogështin e botës së shpirtit të djegur.

Eshtë koha e ikjes nga topitja e stinëve të mërzitshme.

Me forcën e përditësimit të çbëjmë gjithë ç'duhet çbërë.

Dhe të shkuim lulet e venitura, mbirë fytyrës së të keqes.

skender iljaz braka

Besoni Tek Syte E Një Gruaje.

Besoni tek syte e një gruaje.

Besoni tek syte e një gruaje.

Përshkënditur mes flakëve përvëluese, shkëndijash janë.

Qëndrën e diellit mbajnë përherë pushtuar.

Gravitet i pamohueshem për forca te pa ekuilibruara.

Besojini syve të një gruaje,

kur shfaqen si sytë e qiellit me vetëtima.

Në ta është klithja e një nëne

dhe orgazma humbur nën psherëtima.

Syri i një gruaje është syri i detit,

që kapedanin e mirë kurre s'ka

per t'a tradhëtuar ditëve të rrëmetit..

Sytë e një gruaje, hon për butësinë e pafundëme.

Harrim, për dëshirat e shkurtëra mizore.

Dhimbje dhe rrënim për largimet e pakthyer.

Zjarr varresh për perandori pasionesh të shfrenuara.

Sytë e një gruaje janë pentagrame,

për gjymtyrë dhe puthje të pangopura.

Vullkane në shpërthime pasionesh dashurie.

Luftëtar i orëve të para të nisjes,

të thirrura betejash për rritjen e një fëmije.

Sytë e një gruaje janë etje për shtegëtime.

Jehonë e pahumbur këmbanash

mbetur fluturim hapsirave të qelqëta.

Botë e pafundëme livadhesh të blerta.

Kur flasin mbi krahë të fortë dashurie.

Sytë e një gruaje bëhen më të këndëshëm

se ujët e burimeve malore.

Më pikëllues se netët e trishta hënore.

Besoni syve të një gruaje,

kur në orbita galaktikash enden pafundësish.

Ata tokës së zhuritur zbresin,
për t'i bërë stinët e ftohta, të lulëzuara.
Zërin të gjallë për ta mbajtur përjetësisht.

skender iljaz braka

Bota E Madhe E Artit

Bota e madhe e artit.

Botë e të panjohurave është bota e artit.
mbarsur enigmash e mendimesh të fshehura,
është bota e padukshmes dhe e shenjave,
e tingujve, ngjyrave dhe këngëve të heshtura.

Çerdhe e brishtë ku marrin jetë ëndërrimet.
Askush s' gjeti plakjen në oazin e shëndetit.
Ajo është raft dhe pavione i pambarimt librash.
Është strehëza e ngrohtë, e përjetshme e poetit,

Bota e madhe e artit është oqeani përbotshëm
ku krijuesit parreshtur derdhin shpirtërat e tyre.
Flokëthinjura e miljona vegimeve, imazheve.
Flotilja e galerave për ndodhit e pashmangshme.

skender iljaz braka

Braktisja Vinte Nga Mjerimi

Erdha me frymën e ëngjëllit të mbirë prej fundit të dheut,
kur degët e palmës së vetmuar përplaseshin me rënkime.
Me një frymë drejtë teje vrapova për të qënë i përkushtuar.
Mbushur me polem dashurie ishte shportë e zemrës sime.

E stuhishme binte nata mbi leshrat e tu të mëndafshtë.
Ti më prisje mes shtullungave të muzgut të largëm.
Me thëngjinjë të ndezur prrushi ishin sytë e tu të afshtë.
Na vinte nga deti nata me heshtjen e horizontit të paqtëm.

Asgjë nuk thamë, vetëm diçka lamë në atë breg kaltërosh.
Një mërmërimë të humbur në botën e shpirtrave të etur.
Në ikjen e tyre, vargjet e poezisë një hapsirë aty lan bosh.
Ca fragmente enigmash që shushurinin muzgut të heshtur.

Braktisja nga mjerimi na erdhi e dashur, që kurre më s'u pamë.
Humbur një lumi të turbullt mes grykë- malesh të errëtuara.
Kaq larg i mbetëm kohës si dy shkëmbenjë prej dallgësh coptuar.
Si dy planete, që galaktikës prej së largu i puthen të dashuruara.

skender iljaz braka

Brejtur Ndërgjegjesh...

Brejtur ndërgjegjesh...

E mbytur nën errësirën e asaj nate vjeshte.
Përhumbur zhbiron në një hapsirë boshe pa emër.
Prej dëshpërimit e mbërthyer flet me heshtjen.
Të pandershëmen tradhëti varrosur ke në zemër.

Me buzë të përzhitura nga klithmat dhe e qara.
Një mendim i beftë pragut të vetdënimit të troket.
Në hirin e paftohur të shpirtit rikujton e vetmuar.
Natën kur aty të lash, si një dallëndyshe të shkret.

Me gjymtyrë të kafshuara prej urisë së perëndimit.
E heshtur qëndron mbi supet e netëve të përgjumura.
Fytyra jote shënjtëruar që ndrit në altarin e nderit.
Ngado më përgjak kështjellën e mureve të rrëzuara.

Si fugë vërtitej bota ime e vogël, e egoizmit të pa fre.
Në botën tënde të madhe të ëndërrave të pafundëme.
Fshehur në pëjetësin e përbuzjes, mbetur nën mëshirë.
Si djall humnere jam zvarritur prej hijes së turpëshme.

Dhe një herë i'u riktheva atij kujtimi të largët.
Nën pickamën e akullt të një melodie trishtuese
.Mbi flokë, era frangmente kujtimesh më rrëzon.
Pendesa më ndjek e më djeg me flakë përvëluese.

Rizgjuar prej gjakut që përskuqi të brishtën bardhësi.
Mallkuar them qofsha që të paturpësisht të çnderova!
Në duart e drejtësisë, ku ëngjëlli yt të më gjykoi.
Brejtur ndërgjegjesh, për jetë në hirin tënd dau të rri.

skender iljaz braka

Brigjeve Te Zemres Sime

Brigjeve të zemrës sime..

Brigjeve të pathyeshme të zemrës sime.
Spirancën metalike të shpirtit tënd
një ditë do të ankorosh.
Në butësinë e reve unë do të nge
fuqishëm me krahët e mi.
Rrënjët e mia të dala nga thellësia e deti
do të bëhen mbështetja jote e përjetshme.

Por në ndodht një ditë, në një cast të mbrëmjes.
Ti udhën do të marrësh në një largësi të pafundëme.
Si degë që i thahen vjeshtës do këputem kraht e mi.
E mbi buzët e tua të zhuritura s'do të çelin më lule

Vetëm një ditë me ty...

Vetëm një ditë me ty doja të isha i lumtur.
Me ndryshkun e flokëve të tu të isha çmallur.
Një ditë ti përngjaja barit që buit në livadhe.
Mështeknës së bardhë më lëvozhgën e ringjallur.

Vetëm një ditë doja të ishe rëra e brigjeve të mia.
Me shkëlqimin e saj të ushqeje të dyja dashuritë
Unë qumështi i fiku të detit tënd të isha.
Ti më e forta guacë për t'më mbrojtur nga stuhia.

skender iljaz braka

Bukuroshes Se Durrësit.

Bukuroshes Se Durrësit.

E zhytur më je nën atë mjegull të shndritshme
Qetë qetë më vështron si një pikturë hyjnore.
Ç'kërkon të më thotë shpirti ty i mermertë?
Sytë miqësor të lindur përmes tinguj heshtash,
që ëndërrave të mia përditë hov e baron.

Baron brinjë errësirës së prangosur,
mbi faqet e palexueshme të bedenave.
Duke u shtrënguar pas frymëmarrjes së vdekjes,
Tingull pas tingulli me zë qiellor këndove
për të coptuar prangat e ç'mishëruara të jetës

Oh, bukuroshe e pafjetur e ujit, e qytetit.
Në tre mijë vjetë thellë qënies kam ruajtur
dritë-hijen e syve të tu të vdekur.
Në tremijë vjetë duart e tua të bardha kam puthur.
Kam puthur buzën tënde të djegur,
gjoksin e çapëlyer prej dhëmbëve të ujçërve.
Kam puthur qepallën tënde si alga e gjelbër.

Oh, ti rreze e diellit tonë të vakët,
që këtu s'munde dot e qetë të preheshe.
A se shikon sa egërsisht më theri terri i thepinava?
Mbartur mbi krahtë e hekurt e të përgjakur të zefirit.
Së bashku me mua prej të ftohtit vdiq stina e egër
e kacafytjeve dhe angullimave.
Një natë si për harresë të gjithçkaje,
ngritur prej humnerave të thella të trishtimit.
Si rrëke elodhur pikoj loti yt

Pushtuar prej brengës.
Përvëluar prej dëshirës.
Kithma jote me jehonën e padëgjueshme
të zërit tim shkonte tutje,
ku deti tretet mes kaltërësirave,
përtej mbi profilet e ashpëra të vargmaleve,

nëpër shtigje luginash plot pyje
të përshkuar prej përrenjësh oshëtitës.

Oh, bukuroshe e pafjetur e ujit, e qytetit.
Kënga jote si mjagull u zvarit ngulmuese
Shtegun e martirëve duke ndjekur
së bashku me hirin e shenjtë
muzgjeve kumbuese.....
skender braka

skender iljaz braka

Buzembremje Vjeshte

BUZEMBREMJE VJESHTE

Buzëmbremje vjeshte:

Prej trokëlimës së hapave të mia,
drithërohet e hesht dhe vet heshtja.
Gur i pathyeshëm jam,
që vdes nën hijen e zambakëve.

skender iljaz braka

C'Mbetet Nga Dashuria

C'mbetet nga dashuria

Ajo që në mëndje mbetet përgjithmonë,
është puthja e parë nën një muzgë të pikëlluar.
E panjohura psherëtimë e buzës tonë të pjekur
dhe ajo ëndërr e bukur transparente,
që ne nënshkruam në atë qiell të djegur.

Ajo që dashurisë kurrë nuk i vdesë
është drithërima e beftë kur njëri-tjetrit iu larguam.
Shikimet e kryqëzuara, ajo e qarë me dënesë.
Shpresa që na tërheq për ëndërrat që si shuam.

Ajo që dashurisë do ti kujtohet gjer në vdekje.
Eshtë lëndimi i dhimbshëm shkaktuar
prej një kori zë çjerr dhe një tymnaje të endur.
Janë fjalët që padashur e përdhosin marrëzishtë.
Atë që zemrat kurdoherë do ta cilësojnë:
' Si më të papërsëritshëm në jetë..
Si dashurinë të çmëndur, çmëndurisht'

skender iljaz braka

Dashuri E Përflakur.

Trandafil jetëdhenës je
për shpirtat e plagosur.
Pulëbardhë e bukur,
ulur mbi zëmrat e lënduara.
Perëndimet me lot dhimbjesh ke përgjakur.
Me magjinë tënde – sinfoni,
që shekujsh fuqishëm ka ushtuar.

Dashuri e përflakur,
Për mua je vet jeta,
je drita më e pastër.
je rrezja që më ngroh
dhe zbardhëllon agimin.
Ti je kënga e ditëve të mija.
Je uragani i hovit të pandalur.

Me ty jam ëndërra e së nesëmes.
Bukuria e lules së porsaçelur.
Me ty jam gjelbërimi.
Aroma e mbrëmjes së pranverës.

skender iljaz braka

Dashuria Ime

Dashuria ime

Dashuria ime, melankoli dhe pikëllim.
Shumë më ndryshe sot do të doja të më ishe.
Vargonjë e dhimbjes t'i shkëlqej me rrëmbim
dhe mimozat në një vazo të bukur ti qëndisje.
Të dashuruarit udhëve të pafundëme le të rendin.
Ngritur mbi pirgje trishtimesh të harruara,
Në dy duar gjithë botën le të mbledhin.
Pëgëdhelur prej diellit me rreze të praruara.
Ktheu dhe ndalu ti në zemrat rinore!
E çilter, e paster, me të pranverës bukuri.
Meridianet pushtoi me flatërat e tua
Kaltërsive dërgoi ëndërrat, e bukura dashuri.

skender iljaz braka

Dashuruar Për Të Dy..

Prej ditës që të humba diçka prej vetes me ka ikur.
Në ate boshllëk të pambushur prej asnjë lloj dashurie.
Prej të njëjtës pritje në vetmi çdo ditë duke vdekur.
Mbytur ngasherimesh nën ëndërra çmëndurie.

Mes zjarrit si Kostandini prej varrit jam ngritur.
Përtej të panjohurës mes flakëve t'kam kërkuar.
Atje ku varur në vetedijen time të imagjinatës.
E gjallë ishe ti, si ditës së parë prej meje ledhatuar.

Nishani sa një pikë kallaj mbi buzën e sipërme
dhe i vogëli tatuazh në atë faqe të djathtë.
Nga balli s'isht zhdukur ajo shenjë prej ndryshku.
Veç buzeqeshja në buzë një tjetër trajtë të kish marrë.

Trëmbur prej thërmimit të akullit, kisha frike të të prekja.
Nën të vetëmin mëkat në ndërgjegje duke mëkuar.
Zvenitur gjer në pragun e papërmbajtur të trishtimit.
Ambivalent tërësisht i kthyer në ket'çast të dëshpëruar.

Tradhëtuar prej jetës, amoral brenda një honi i ndjerë.
Gërhamat e shpellës së përjargur me risjellin në jetë.
Pas teje kaq çmëndurisht nuk di përse isha dashuruar.
Dashuruar pas atij që prisnim, për t'a kurorezuar si një mbret.

skender iljaz braka

Detit Tim

Ngahere diçka forcërisht më rrëmben drejt teje.
Dhe magjishëm më thith horizonteve të pafundëme.
Harbon zemra ime, prej valëve, kafshuar nëpër terre.
Mbi paranoja bredharake, hapsirave të zhurmëshme.

Përtej madhështis tënde, që shpirtit m'a gulçon.
Nën netët e mbushura me gjëmime shkepëtimash.
Ti deti im, me çfarë magjije kaq rënd më përvëlon
Dhe mbi dallgët më përplas me zëmërim vetëtimash.?

Dhe unë nuk di, përse klithmat e tua dua t'i dëgjoj.
Të rend pas psherëtimës së fundit të vajit të koraleve.
Atje ku mes heshtjes ulërasin misteret e ngatërruara.
Thellessive kërënuese dua, të çvarros udhët e fateve.

Tempull i hyjnive të mija, prej algash e perlash ndërtuar.
I magjepsur si një femijë, përpara këmbeve të tua falem.
Për të marrë prej teje gjithçka që ditës më ka mungur.
Prej afshit tënd, në udhën e përditëshme të mos ndalem.

Herë në një copë shkëmb më shndërrove mes tallazesh.
Si Anteu më ngrite, prej diellit përbindshëm zëmëruar.
Herë si një zgalem, më mbajte mes dallgëve të ashpëra.
Ti deti im, prej fuqisë së tokës, asnjëhere s'më ke lëshuar.

skender iljaz braka

Dhe Pse Plakemi

Dhe pse plakemi...

Koha n'a i thinji floket,
ballin ne brazda ugaresh n'a e ktheu.
me syte e mendjes shohin si
treden nje nga nje pasionet tona
në hapsira boshe.
kur afshi tokes avullon,
një ere e mjegullt ulerine
në gjokset tona te brishta.
dhe pse plakemi,
prane e ndjejme ritmin qe vjen,
ritmin, qe shkon shtratit te qete.
Ttrishtimi kurre nuk n'a mberthen.
ra me fshesën e saj,
kujtimet tona i mbështjell si një nënë e mirë.
çuditërisht dhe pse nata na kapëllen,
Sytë kurrë nuk e humbasin shikimin
dhe pse tek ne diçka vetvetiu përjashtohet,
humbet ne moskthim
buzët e holla i ndjemë ende të ngrohta
e çuditëshmja natë,
si mysafir i larget, i huaj,
rreket të trokas.
e presim qetësisht.
lodhjen kurrë nuk e ndjejmë.
Supet, vitet tona i mbajnë mbi petale.
me nekrar i përziejnë per t'i pllenuar
në vitet që do vijnë.
freskia e malit n'a hedh mbi flokë
cicërimat e zogjëve dhe melodinë e ujëvarave.
dhe pse plakemi.
me gjishtërinjet eshtak prej dore e kapim agimin,
dhe qetësisht e ulim mbi tryeza
me aromen e trandafilit.
dhe pse plakemi, malli për të shkuarën
gjithmonë n'a rrëmben.
nuk mërzitemi për vitet që iken.
vitet që vijnë mbi duar i peshojmë.

dhe pse plakemi,
gjithmonë kemi diçka për të thënë.....

skender iljaz braka

Dhe Une E Ngrita Shpirtin Tim

Dhe une e ngrita shpirtin tim

Si nje libër i vjetër, mbuluar pluhurit të harrimit,
a ndoshta prej vetëdijes së mohimit,
të gjeta një ditë, Shpirti im.

Përzier në të njëjtin vrer përçmimi,
Vrar prej të njëjtit plumb dënigrimi.

Djegur prej të njëjtit zjarr mallkimi.

Ndjenjash dhjet fish keqtrajtuar.

Zhytur në thellesi muzgu të nënvleftësimit.

Me ndjesinë e ndjenjes së një burri,
mbi krahet e hekurt të hodha.

Me ftohtesinë e mendimit, si nje foshnje të braktisur të pështolla,
për të hapur mes reve një shteg shprese të shuar.

Një agim tjetër për të gjetur të zgjuar.

Mbi rrënoja të vjetëra të ngrita,
kutërbuar ende aromën e shkatërrimi.

Të ngrita mbi idiotësitë poshtëruese të nihilizmit.

Mbi mjegullnajën e zezë të mosarsyetimit.

Te ngrita duke thirrur:

- O njeri!

Ti shpirtin mos e ndrydh kafazesh prej hekuri te mosperfilljes.

Ti shpirtin, mos e shit ne ankandin e

verberise makute.

shpirtin mos e var ne fije te keputeshme.

Ngaherë mbi vetveten ngrihu...ngrihu, ngrihu...ngrihu...

skender iljaz braka

Ti

Dhe Une Vdes Per Ty

Dhe unë vdes për ty.

Moj ç'është kështu me ty,
për besë as vet se di.
Mundohem të mbaj larg,
por pranë ti vjen më rri.
Pa mbaruar me të parën,
e dyta ma bënë me sy.
Harrohem, pas teje çmëndem,
Moj ç'është vall kjo magji?
Gjithë bota është e imja,
e imja më je dhe ti.
S't' mallkoj kur ma merr mëndjen.
As kur më hedh në shtrat.
Malluar them qoftë bota,
kur nga një më duken shatë.
Eh, ilaçi varrit, me ty gjej ç'do shërim.
Ma heq cipën e ballit gjer lart përmbi flokë.
Sa herë që jam me ty, të gjithë bëjë miq e shok.
Në djall xhepat e zbrazur.
Në djall vaft dashuria.
Sa bota do të rroj.
Do rroj edhe rakia.

skender iljaz braka

Dhimbja E Motres....

Dhimbja e Motres....

Diku nën një copë qielli të nderur.
Mes kumbimesh të thekëshme metalike,
të trishtat jehona përcillte errësira.
Në shtëllunga të kobëshme mjegullash,
shkelur mbi pirgje gërmadhasht të zishme,
rrapëllima ogurzezë përplasej në rrëpira.
Nga vdekja në vdekje shkonin stuhit.
Nga lufta në luftë vraponin mizorit
dhe toka e ngrirë prej lotësh të mermertë,
përskuqej prej flakëve të zemërimit,
në gulfa derdhur si një mortje e murrëme
ardhur udhëve të përgjakura të pushtimit.

Mbi plagët e tua të hapura.

Mbi plagët e tua prej dhimbjesh të mpira.

pluhurin e hirtë shkundëte dhimbja.

Mes stuhis së pëmotëshme,

nen tingujt funebër të botes

thellësive të tokës ngrihej thirrja.

“Rasht më rasht bashku shqiptari.”

“Nder e besë kish thirr i pari”.

Rasht më rasht.....

Nder e besë...

Në shtratin e lisit të motshëm,

të nëntat plagë, gjakun të pikonin.

Të ngrohta prej afshit tënd shekullor,

të nënta prej prrushit të jetës zjarrmonin,

kërcënuar prej tërbimit të verbër mortar.

Por dora që plagët e pambyllura t'i lidhte,

ishite mishi yt, që kurrë s'donte të humbiste

dhe shpirti yt që, zërin tënd të zëmëruar e etur e përpinte.

Ishte vet e vdekura, që vdekjen të largonte,

e të ardhëmen e jetës në mes kërkonte të t'a priste.

Ishte drita e syve të tu,

që dritë përmes errësirës të ndrçonte..

Ishte fati, që trupit të saj kish veshur zinë.

Zinë, që ishte më e zezë se vetmija e maleve.

Në tokën e shkrifëruar të shpirtit të saj prej motre.
Ti në varrezë përvuajtjesh u ktheve, sepse ishte dhimbja jote.
U ktheve në kryqin e krahëve të tu, munduar prej lëngimi.
Gjymtyrë e saj të palodhëshme t'u bënë vigu.
Gjoku i etur tu bënë shekujve, për fluturime.
Zëri i shkrirë në pëvuajte, tu bë dhimbshuria, dëshpërimi.
Prëhërit të saj lulëzoje, si piramidat,
që majat zbardhuese fshikin..
Si më parë i vdekur Gjergj Elez Alia.
Si më parë i gjallë prej zjarrit të zëmërimit u ngrite,
kur dhe një herë në pragun tënd të gurt,
lakuriqësia e çnderimit trokiti
me përvijimet e valles së përherëshme satanike.
Ti mes dhimbjesh dhe lotëve të motrës u rrite.

skender iljaz braka

Dialog Me Neruden

Dialog me Nerudën....

Eja sonte miku im.

Ti krishti im i revolucionit dhe i poezisë.

Me kundërmimin e erërave të këndshme të luleve të Kilit.

Në vatrën time eja një kafe të pimë,

të kthejm një gotë raki....

Pablo, eja!

Eja të ngrohemi në zjarrin e përjetësisë,

që ndezur është prej këngëve të tua,

që tek mua erdhën si trandafila të mbirë prej zëmrës së dheut,

mbështjell me petkun e borës së zezë të pyjeve pa emër.

Eja sonte miku im.!

Eja me shpirtin tënd që bënda të mbërthyer

me fije të çelikta mbante këngët e vobekta,

mbante rrebelimin, vrullin e egër të etur për arratisje.

Shumë kohë kami shpenzuar duke u marrë me vetveten.

Duke iu referuar ca ngjarjeve të rëndomta

dhe njerzëve të fshehur në fildishin e pushtetit.

Mbrëm befas në ëndërr mu shfaq një zog i bardhë.

Cicëronte e degëve të një peme hidhej me vrik.

Mbrëmë në ëndërr mu shfaq një druvar....

Klithmat e të vdekurve të Spanjë,

që drithëronin 'gjer në fund të kontinentit të zymtë'.

Mu shfaq lugina e përgjakur e Ebros

dhe një general me emrin Bolivar,

i braktisur si limanet në agimin e brymt.

Eja sonte Pablo!

Zbrit në këto humnera të thella të trishtimit tim.

Sa shumë borxhe u kemi unë e ti njerzve.

Të domosdoshmen kripë,

eja ti hedhim gjellës që zjen në kazanin e madh të popujve.

skender iljaz braka

Diku Ne Buzedete...

Diçka më tërheq buzëdetit,
sa herë që dallgët shkumbardha
prëplasen me terbim.
Sa herë që të thekëshmet
zëra tipike të netëve detare,
ngrihen thellësive me vrik.
per te shkullur spirancen time mbërthyer
në rërën brigje - brigje.
Diku, tej mes dallgeve,
imazhi yt, si nje nimfe e bukur,
me shfaqet si ditën që te kam humbur,
Ketu kam mbetur se nje Eskil
ne pritshmerinë e të pakthyeshmes.
As vete nuk e di perse...
Perseri te dua kaq shume,
dhe pse menedimet m'i ke mpire.
Si hije te tejzgjatura me ndjekin
si dikur hapat dhe zeri yt i trisht.
Si nje eremit e kryqezova per ty dashurine
aty ne ate buzedete,
ku kam mbetur pa nje alternative tjetre te dyte.

skender iljaz braka

Do Të Vish

Do të vish

Tani larg ke ikur...

oh! sa larg nga bota ime e trisht.

Në të ftohtin shtrat, gjumi pse s'më zë?

Më shfaqesh rishtaz ndër vegime.

Të prehem, të dremis,

imazhi yt, jo nuk më lë?

Do vish nje ditë e dashur,

unë e di.

Me një tufë lulesh do të rendësh si e marrë.

Por atëherë në dhomën tone të boshatisur.,

të çirresh,

Do bërtasësh:

- Përse në duar lulet më janë tharë.?

skender iljaz braka

Dokeret E Qytetit Tim

Duke punuar çdo ditë i shoh dokerët
në portin e qytetit tim.
Supeve dhe krahtë ngarkesave të rënda mbërthyer
....gjer në muzgun e zi,
prej erës së gjelbërt të korrikut flladitur.
Bashkë me ulërimën e tyre që djeg e përvëlon.

Padronët, me makina luksoze shkojn për të shëtitur,
Të gjorët dokerë..
djerën e trupit të tyre lëpijën
Si buajt nën diellin që shkon duke zhuritur.

Deti i plakur dergjet i lodhur në mol.
Në degë të thara pishash
dhe majë elektrovixhash
era e trishtuar fle dhe rënkton.
Unë me gjithë fuqitë e shpirtit ulëras:
Dokerë, djersa juaj detit i dha ngjyrën e gjakut! .
Ç'urrejtje dhe ç'britmë më fal
Gjemia që ikën, ikën, ikën.
Ujërat e trazuara me uturimë shurdhuese,
duke lëruar.

Doker të portit të qytetit tim
Ju këtij moli të rrënuar i mbetët
midis jetës dhe vdekjes me trupin krrusur, sflitur.
Krrusur mbi dallë dhe mbi re agimit të mahnitshëm.
Vet vdekjen veshur me petkun e pastorit,
duke përqeshur.

Shëtisin, pushimet verore pronarët tuaj
Kalojnë në Dubai, në Anguilla, Fernando de Noronha
Në Florida shëtisin.
Ju qiejt puthni nën diellin e zhuritur.

skender iljaz braka

Duart Drejt Teje Zgjas...

Atdheu im.

Në këtë përvjetor të 100-të.

Përpara gjunjëve të tu përulem dhe hesht.

Hesht me heshtjen e luftëtarit plagshumë,
shkuar mendueshëm shtegut të thiktë të grykës së varrit.

Me nofulla shtrënguar prej shpirtit gjëmimtar.

unë dorën time eshtake drejt teje zgjas,
për të fshirë bulëzat e përgjakura të djersës,
rënë mbi rrudhat e lëmuara të ballit.

Eh, moj shtëpiza ime, e vogëla zë kumbuese.

Shikim egëra me aromën e manushaqes së fjetur.

Dhimbja për ty më shkoi gjer në pikën e fundit të lotit.

Dashuria për gjithçka tënden kaq të shënjtë,
më shkoi gjer në kufirin e fundit të shpirtit tim të djegur.

Zgjas dorën të përgëdhel duke iu frikur lëndimit.

Ulërima të gjakosura dallgësh zgjohen rrudhave të tua.

Marrin hov e brofin ca stuhi të heshtura, të tërbuara,
që prej gjoksit të coptuar të ngrihen me rrapëllima.

Oqean i shndërruar në shkëmb stralli mbete atdheu im.

Asht i thatë mes shqotash e tramundanash të shfrenuara.

Mbete zhuri i ashpër ku lotoi e kokën mbështeti Ajkuna.

Zulma e heronjëve dhe lëngata e plagëve të pashëruara.

Zgjas dorën të përgëdhel buzën tënde të djegur.

Sepse dua të them Gëzuar në këtë të qindin përvjetor.

Unë adhuroj çdo grimcë të dheut tënd të ashpër e të etur.

Copëzën e varfër të bukës, bujkun e vobekët, madhështor.

skender iljaz braka

Dyrrah - Varri Im I Madh

Qyteti im - bir i Melisës dhe hyut të detit,
në tre mijë vjet me frymën tënde jam rritur,
jam rritur në furinë e vazhdueshme të rrëmetit.
Në tre mijë vjet kam pirë lotët e tu të kripur,
buzë detit duke vështruar sytë e tu të vdekur.

Sa herë prej vendit ke lëvizur, qyteti im,
prej tërmetesh të llahtarshëm i rrënuar.
Po këtu ku më ke lindur, më ke gjetur,
me shpirtin tënd prej Taulantësh të mëkuar.

Mijëra vjet, qyteti im, të kam pyetur.
Ti veç ke heshtur me heshtjen tënde
prej dheu të kripur e bregu të përcëlluar.
Klithmës sime të çmendur s'i je përgjigjur,
por krahët e përgjakur katërsh m'i ke hapur
e supit më ke mbështetur ballin e përhumbur.

Në rrahur prej algash ma shtrove shtratin prej guri.
Shtratin shekullor që Epidami thellësive kish ngulur,
mbi shkumëzimet e shndritshme
e të vetmuara të detit të tërbuar.
Netëve të kthjellta aty kam fjetur,
duke ëndërruar futurimin mbi krahët e trandafiltë,
të jetës tënde të pagjunjësuar.

O varri im i madh!
O varr gjysmë i mbuluar!
Në tre mijë vjet,
gjithë mendinet e mia për ty kam kryqëzuar.

Gjymtyrëve të tua të djegura kam vrapuar i përvëluar,
duke iu frikur përherë fuqisë tënde të zemërimit.
Prej fashitjes së menjëhershme të një ëndërre jam zgjuar,
ty të kam përqaftuar nën tejdukshmërinë e perëndimit.

Një herë e një kohë ka qënë shkëlqimi yt,
më i tejdashëm e më i thellë se flakërimi i dallgëve,

fytyra jote prej mermeri të kuq,
më e freskët se gjoksi i bëshëm e qumështor i një vashe.
Madhështia jote, qytetërime ka lënë të mahnitur.
Gjymtyrët e lëmuara të luanin shpesh me valët
e dielli ngazëllehej me fytyrën tënde
prej perëndeshe të skalitur.

Tani rreth murit, prej zjarrit të rreshjeve gërryer,
bari yt i blertë prej kohe është zverdhur e zhuritur.
Por deti përsëri mes vështrimesh të rënduara,
me baticat dhe zbaticat e tij të buta,
të përkëdhel e të puth si me gjuhë valësh i uritur.
Kujdesshëm të mjekon plagët e pashëruara,
që ti kurrë të mos vdesësh, qyteti im,
por të mbetesh si i gjallë mes të gjallësh.

Dorën një herë të vetme s'ma ke zgjatur.
S'më ke përkëdhelur kurrë si fëmijën tënd të uritur,
dhe kur me zë të lartë, për gurët e tu kam kënduar,
kur kam kënduar për hirin e perëndive pellazgjike.
Kur mbi shkrimet e sargofagëve të mbyllur
sytë më janë verbuar, përsëri po aty janë ripërtëritur.

O varri im i madh!
O varr gjysmë i mbuluar!
Në tre mijë vjet.
Gjithë mendimet e mia për ty kam kryqëzuar.

skender iljaz braka

E Bukura Lule E Tetorit

E bukura lule e tetorit
që gjallon mes krijesash që thahen e vyshken..
Eja sonte tek unë!
Me frymën e shpirtit tim do të shkruaj fjalë të magjishme dashurie, fjalë të
ëmbëla pune,
fjalë të kristalta jete.
Eja, sonte të pikuroj me rënkimin e thellë të malit,
me zëmërimin e detit,
me ngashërimin e lumit dhe të pyllit.
Eja më e bukur se bukuria e hënës
që shkëlqen mbi bardhësinë e shndritëshme të mermerit.
Mbështetu mbi të gjelbërtën e thellë të ekualipsave të lartë.
Lamë me vesën tënde të padukshme e
të ngrrohtë, që më tërbon e çmënd.
Eja si një pasqyrë me reflekse
në të cilën njollat e padukshme të hijeve nuk kanë vënd.
Eja sonte lule e bukur e tetorit..
Eja kështu siç je e freskët,
miturake dhe e thjeshtë gjer në rrënjë.
çliruar prej vargonjëve të shirave vjeshtorë.
Eja në baltën time të pjekur pa maska të pështira,
pa makiazhe pa karta kreditesh e llogarish bankare.
Skajesh të ndriçuara, të ngrohura prej diellit të ngazëllehemi.
Eja në liqenin tim që dremit nën cicërima zogjësh.
Ne, kohës do ti mbeteemi përherë triumfatorë.

skender iljaz braka

E Dashur Sonte Derën Mos E Mbyll

E dashur sonte derën mos e mbyll

E dashur, ti sonte derën mos e mbyll.
Nëse vonë mundet të kthehem
prej kësaj udhe kaq të gjatë.
Mbi ëndrrat e tua si foshnje do mbyll sytë.
Si gjeth i lodhur kur te bie në shtrat.

E dashur, ti sonte mos më pyet
se ç'gjë të bukur të solla për dhuratë.
E ç'mund të sillja më shumë se ky zjarr
që gjoksit për ty ngaherë më përvëlon.
Ç'do të mund të dhuroja më shumë
se ky shpirt si det mbushur me aromë.

Pra qasu të tq puth pak ballin e djersitur.
Pastaj në gjumin tënd e qet shko bjer e fli
Se shpesh prej gjumit e trëmbur ti je ngritur
Se ndodhka dhe kështu në të bukurën dashiri.

E dashur nga unë parajsën mos e prit.
Dimrin e shpirtit do të vi t'a ngroh.
Në mijëra borxhe do zhytem tek fuqit.
Që të thërras marrezisht:
Grua, me mua përjetësisht ti rro!

skender braka

skender iljaz braka

E Imja Toke E Pergjakur

E IMJA TOKE E PERGJAKUR

E imja tokë e përgjakur.....

E stërlashta, e zeza dhe e etura e tretur.

Prej detit, malit dhe mëkatit ke lindur.

Rritur mes kaltërsive të tyre të djegura.

Humnerave të natës ku prehet qetësia pikëlluese.

Mes gjelbërimit dhe të kuqes së zvenitur

dhe klithmave të barit tend të fishkur,

që kurrë klorofilit s'iu bë dritë mikluese.

Me mitet dhe legjendat e moçme,

flen nën gurët e tu të lashtë,

gjymtyrët e përzhitur nëpër zjarre.

Ulërimat e paharruara të fëmijëve,

arratisur prej djepit si zogj shtegëtarë

humbur golleve të nëmura të malve.

Ti je e sërta dhe e ashpëra ime ëmbëlake.

Drita e largët e një komete të padukëshme.

Je rrokullisja e këmbanave të pazëshme.

Gjaku i pampiksur, që rrjedh syve të të vrarit.

Guva e pashtershme e valleve të oxhakut.

Honi i hapur i poetit dhe varri i humbur i ushtarit.

Qiejve të ftohtë të shkurtit çlodhet fryma jote,
shikimi yt i vrarë prej dritës së turbullt,
që mezi zbulon zbehtësinë e vdekur.

Atje, fundit të rrëpirave të tua dërrmuese,
ku befas shkëlqen një vështrim prej të varfëri
dhe një paqe tinzare fytyrë ngërdheshur.

skender iljaz braka

E Imja Dashuri, Titanikja E Akujve Të Pashkrirë.

E thella humnerë dhimbjeje, përzhitur nëpër zjarre.
Kraterit të zbrazët të zemrës sime të ngrirë,
nektarin dehës të netëve qumështore hodhe,
për të thyer vetmin time krenare.
E brisht më linde muzgjeve të përflakur.
O ti, më e pakufishmja kënaqësi e pambarimt,
që vullshëm u ngjite ditëve të mëpastajme
me tërë ëmbësin tënde mishtore të shërimit.
Unë ethshëm të ndoqa rrëpirave të rrëmbyeshme.
I përhumbur shpesh herë horizonteve të djegura.
Përmes fërfërimës së kallzave të pranverës të thërrita.
Gjer ditës që të gjeta mes udhëve të mia të vdekura.
Tu përula gjunjëve si një shpendi i plagosur.
E supet ti mbulova me shtrojet e mia të varfëra.
Pas zjarrit tënd përvëlues i tëri i marrosur.
Mjegulluar prej djersitjes së gjinjëve të bardha.
E imja dashuri, zjarmëtarja e ditëve të lumtura.
Qiejve të mi ndriçoi drita jote prej ylli fergëllues.
Ajërin mbushe me shkulma valësh të përgjakuara
dhe të paprekëshmet errësira të shkretuara mikluese.

skender iljaz braka

E Ngrita Shpirtin Tim.

E ngrita shpirtin tim.

Dhe une e ngrita shpirtin tim
Si nje libër i vjetër, mbuluar pluhurit të harrimit,
a ndoshta prej vetëdijes së mohimit,
të gjeta një ditë, Shpirti im.
Përzier në të njëjtin vre
prej të njëtit plumb dënigrimi.
Djegur prej të njëjtit zjarr mallkimi.
Ndjenjash dhjetë fish keqtrajtuar.
Zhytur në thellesi muzgu të nënvleftësimit.
Me ndjesinë e ndjenjes së një burri,
mbi krahet e hekurt të hodha.
Me ftohtesinë e mendimit,
si nje foshnje të braktisur të pështolla,
reve një shteg shprese të shuar.
Një agim tjetër për të gjetur të zgjuar.
Mbi rrënoja të vjetëra të ngrita,
kutërbuar ende aromën e shkatërrimi.
Të ngrita mbi idiotësitë poshtëruese të nihilizmit.
Mbi mjegullnajën e zezë të mosarsyetimit.
Te ngrita duke thirrur:
- O njeri!
Ti shpirtin mos e ndrydh kafazesh prej hekuri te mosperfilljes.
Ti shpirtin, mos e shit ne ankandin e verberise makute.
Ti shpirtin mos e var ne fije te keputeshme.
Ngaherë mbi vetveten ngrihu...ngrihu, ngrihu...ngrihu...

skender iljaz braka

E Shtrenjta Nëna Ime...

E shtrenjta nëna ime...

Në ninullat e mbremjeve kur djepin më përkundje. Këmbin e jetës
më hidhje mbi fytyrë.

- rritmu biro, si pëllumb i bardhë,

- rritu biri im, bëmu si një yll.

Ungjijët e shpirtit ballit m'i këndoje.

Nën ethet e trishtimit, prej rënkimit mekur.

E shtrenjta nëna ime, veten rënd qortoje,
se s'kishe ç'të më jepje, veç pak bukë të thekur.

Supeve të brishtë, rënduar mijëra halleve.

Veshur me të zeza, buzëqeshja sapo nisur.

Fatet të kryqëzuan, të hapën dhjetëra varre.

Nën lotëte e ngrirë, të rridhte jetë e ngrysur.

Me butesi mendafshi, si një vello hedhur.

Fjala jote ëmbël ditëve më përcillte.

Ngrohtësi e shpirtit tënd porsi llavë derdhur.

Hap pas hapi nënë, trupit seç më digjete.

Në bebëzen e syrit e gjallë ti më je ngrir.

Dhe pse thinjur je, tretur gjer në kockë.

Për mua mbetesh deti, prej dallgësh e përpirë.

Unë një copëz valë, a si e vogëla përroskë.

Në ditët e marsit të trishtë..

skender iljaz braka

Edhe Këtij Viti Që Vjen..

Këtij viti, ca më rëndë do ti mbështetem
shkopit tim prej thane të thatë.
Do ta ndjej ca më tepër të ftohtin e murranit.
Por le të fryje, e shiu me vetëtima le t'më lag.
Unë i tretur kam qën e do të mbetem gjer në kockë.
S'do ti trëmbem gjëmimeve dhe britmave të djallit.

Këtij viti po atë udhë të pambarimt ë gjatë do të ndjek.
Në po ato thepina shtegu do të ngjithem ngadalë -ngadalë.
Si një sy i verbëruar pas gjurmës së padukshëme të shejtanit.
Në vevete duke u tretur si shqiponja e plakur në mal.

Prej peshës së dhimbjeve do të krrusem dhe më pak.
E mbi det do të dëgjoj po ato klithma krillash të përgjakura.
Por fundja, një qyqe mbi degë të blerta pishe
mëngjesit herët prej gjumit do t'më zgjoj.
E buzëmbremjesh me sy trishtueshëm do të ndjek,
po ato anije, që humbasin horizonteve të përflakura.

Paskëtaj erërat e vjeshtës prap do të fryjnë.
Vetmitar do të bie të fle në shtratin tim të ftohtë.
Por derën e shtëpisë që mbaj hapur, sërishmi s'do ta mbyll.
Qoftë dhe një udhëtar i lodhur lehtaz të më gjej
e hallin shpirtdërrmues, si sqota e dimrit të hershëm,
me qetësinë e tij topitëse, t'ma derdh mbi fytyrë.

Edhe këtë vit do të ngrihem herët në mëngjes.
Mbi det përsëri po ajo mjegullë e bardhë do të bjerë.
S'do tkurrem për ti dhënë dikujt një kafe të ngrohtë.
E di se nga unë, ai është shumë herë më i mjerë.
Më i mjerë se një dre i vetmuar, me sy të mbushur me lot.

Dhe ky vit kështu do të shkoj si shumë të tjerë.
Si moçali i mbuluar prej xunkëthit të dëndur.
Oh, natë e bukur, e magjishme, kaltëroshe,
përse më nxin e më bëhesh kaq terr?

skender iljaz braka

Egoizem I Shfrenuar

Ngritur prej varri një " X" po më tregonte
Permes britmash të përcjella udhëve te humbura,
përherë të gremisur përgjatë starteve te konkurimit
K'ta "Idhujt" të ngurosur prej pamundësis se vrapimit,
rrezuar Nxitojn te egersuaren ego, me te
Mbijetesën mberthyer prej kthetërave te poshterimit.
Kalbëzuar ndergjegjesh, prej mendimesh te cunguara.
Nen trysni të çuditëshme, prej neurozes se përfitimit.
Nxitur prej cmires, me shpirtin perbrenda të nxire.
Të bukurën shpërfytyruar prej xhelozisë së marrosur.
Kthyer gjithçka në të vetem të tyren per ta quajtur të përsosur
Here vjellur vrere, pa me te vogelen meshire.
Egoizëm i shfrenuar, qe hapin dot se ndal.
Cdo dite hap varre, per varrime pa funeral.

skender iljaz braka

Eja Dashuri.

Dashamiresja dashuri, me flatra fluturake.
Mbrëmjeve të mija eja plotë me dritë.
Shpalosur agimesh të bukura pranverore.
Mbi ftohtësi të zemrës, qëndrom ti veç një ditë.
Të tuat cicërimat, si zogjtë e bjeshkës ti lëshomi.
Në ultratinguj m'i kthe të mijat fjalë të pathëna.
Me kthe buzeqeshjen time të mohuar.
Rizgjomi dhe ndizëmi më të bukurat ëndërra.
Me shpirt të këndoj atë kengë të pakënduar.
I çmëndur të thërras: - Dashuri ti ku më je!
Mes vezullimeve të dëborës eja të lodrojmë.
Thellë syve të tu, sytë e mi të bëjn fole.
Përhumbur le të bredhim ne netëve dimërore.
Si pëllumba të bardhë të pushtojmë lartësitë.
Përmbi pirqje guresh, a nën rrasa shkëmore.
Të ngrem çatin tonë të dashur përjetësisht

skender iljaz braka

Eja Dashuria Ime.....

Eja sonte e imja dashuri,
o detonatorja, e çmëndurive të papara!
Me veshjen tënde të zakonshme virtuoze eja! .
Siç i vjen shpirtit të lënduar në rizgjim, kënga.

Eja me dridhërimën e melodis së saj,
që zbret e derdhet si ujëvara.
Eja në këtë përvjetor feste të përbotshme,
që s'pati kurrë ditëlindje dhe funerale të përmotshme.
Ti ajri im i rrall me dehjen shekullore!
Ti trandafili i kuq i lëndinave të gjelbërta.
Ti më i ëmbëli mjalt se mjalti i hojeve,

Eja të t'i prek buzët e tua si qershi
dhe të dehem prej verës tënde marramëndëse!
Prej mushtit të tyre i gjallë të mbetem për veten dhe ty.
Etja dhe ankthi im i pafundëm me fuqi të ethshëme.
Bredhomë lëndinave ku të rigojnë plagët e ngrohta!
Thellësive të zjarrit të varrit tënd digjëm.
Atje ku përvëlojnë përmytjet e ftohta.

Kështu siç më shfaqesh të dua përgjithnjë.
Ndaj pas teje ngarend me dhuratën time modeste.
Kuturisur si gërrvima e vjertër e një vegle të varfër,
si jehona pa fillim e fund i një tingulli të pazëshëm,
i një violineje të trishtëme që kërkon t'i shkëputet telave.

Eja ti sonte e dashur, eja!
Si shëmbëllimi në mëngjes i molusqeve gri, eja!
Eja ti që për mua gjer në vdekje do të mbetesh
hallka e pakëputëshme, shkëlqimtarja e përjetshme.

skender iljaz braka

Eja Dhe Një Herë...

Zbehur më zbret si hëna në agim,
me pamjen e trembur dhe të trisht.
Në dhomën e ftohtë mbi libra e letra.
Më përulesh si bregut, vala e brishtë.

Si në orbitën e një ylli të largët në gjithësi,
që qiellit feks me rezatim verbues.
Më ulesh mbi prehër ngadalë, e dliërë.
Me afshin tënd të ëmbël, përvëlues.

Fjala, 'Me puth', si ujvare madhështore.
Prej thellësis së gjoksit, të doli ndezur zjarr
Mjegullimat e shpirtit magjishem m'i hoqi.
Ne shtratin e bute m'i ktheve në një parajsë.

Në dhomë, psherëtimat humbasin e treten.
Si dëbora pranverës që malit i shkrin.
dhe një herë te lutem ti eja në mbrëmje.
Mbi mollët e bardha të derdh unë poezinë.

skender iljaz braka

Eja Kësaj Nate..

Kur era të fryj mbi fletëzat e flashkëta
dhe nata e qetë të rrëshqas mbi kodrinë.
Të lutem më dil tek mështekna e bardhë
me penelata puthjesh ta ngjyejm dashurinë.
Eja të të them se gjithçka do jetë e jotja.
Në frymëmarrjen time do ngij një psherëtim.
Do të lëmë atje disa çaste të ngrohta.
Atje do të gdhëndim më të bukurin kujtim.
Me sytë e zemrës ëndërroj orë e çast.
Ndaj të lutem si drenushë përvindhju ti ngurimit.
Në çmenduri të çojmë natën ne yjet ziliqarë.
Të dehur prej llavës së pasionit dhe gëzimit.
Dhe një herë të lutem, eja magjipolote.
Flokët e lëshuar të t'i krehim me këtë freski.
Gjithë bota kësaj natë do të jetë e jona.
Lërma zjarrin e shpirtit t'a shuaj në qetësi.

skender iljaz braka

Eja Sonte E Dashur...

Eja sonte e dashur.....

Eja sonte e imja dashuri,
o detonatorja, e çmëndurive të papara!
Me veshjen tënde të zakonshme virtuoze eja! .
Siç i vjen shpirtit të lënduar në rizgjim, kënga.

Eja me dridhërimën e melodis së saj,
që zbret e derdhet si ujëvara.
Eja në këtë përvjetor feste të përbotshme,
që s'pati kurrë ditëlindje dhe funerale të përmotshme.
Ti ajri im i rrall me dehjen shekullore!
Ti trandafili i kuq i lëndinave të gjelbërta.
Ti më i ëmbëli mjalt se mjalti i hojeve,

Eja të t'i prek buzët e tua si qershi
dhe të dehem prej verës tënde marramëndëse!
Prej mushtit të tyre i gjallë të mbetem për veten dhe ty.
Etja dhe ankthi im i pafundëm me fuqi të ethshëme.
Bredhomë lëndinave ku të rigojnë plagët e ngrohta!
Thellësive të zjarrit të varrit tënd digjëm.
Atje ku përvëlojnë përmytjet e ftohta.

Kështu siç më shfaqesh të dua përgjithnjë.
Ndaj pas teje ngarend me dhuratën time modeste.
Kuturitur si gërrvima e vjertër e një vegle të varfër,
si jehona pa fillim e fund i një tingulli të pazëshëm,
i një violineje të trishtëme që kërkon t'i shkëputet telave.

Eja ti sonte e dashur, eja!
Si shëmbëllimi në mëngjes i molusqeve gri, eja!
Eja ti që për mua gjer në vdekje do të mbetesh
hallka e pakëputëshme, shkëlqimtarja e përjetshme.

skender iljaz braka

Eja Sonte, Eja!

E vdekur ëndërrës sime të trisht iu shfaqe,
tej një vëndi të çuditshëm mes gjethe mullagash.
Gjysmë e varrosur në rrënjët e një qiparisi të plakur.
Unë erdha dhe shpirt prej shpirtit tim të dhash.
E ti mostra ime mu riktheve e bukur, e ringjallur.

- Eja sonte të thashë.

O e bukura e përrallave të moçëme!
kësaj mbrëmje të vakët vjeshte mistike.
Digjëma prrushin e fundit të këtij zjarri përvëlues.
Në shtatë portat e qiellit të hapur,
zemrën time të përgjëruar për ty, ngjite!

Eja sonte, ti zanë me parfumin e luleve të bjeshkës.
Arratise erën e rëndë të dashuris sime të vdekur.
Uljonja ime e adhuruar, Shëmbëllimiim i përgjumur.
Shpirtin mizor çpoma, me duartë e tua si trandafilët e egër.

Eja, të ngatërrohem flokëve të tu të mëndafshtë.
Gjithë harresat ti thith në honin e buzëve të shkrumbuara.
Me lëmimin e trupin vritëma mjerimin tim të dhimbshëm.
Dhe me forcën e magnetizimit të epshit,
në një të vetëme bashkoi zemrat tona të binjakëzuara.

skender iljaz braka

Eja, Merrëm Det.

Kaq vite kam mbetur me një bisht cigari në buzë
Dhe me vjershat e mija shpesh here i zëmëruar
Përse nuk deshe të më bëje dhe mua, ti shok.
Por brigjeve të tua më lë kështu të vetmuar.

Ngaherë shpërfillës me dallgën tënde, që gjëmon.
I'a merr ti një kënge të herëshme prej piratësh
O det i honeve të jetës sime, përse ti më tundon.
Mbi dallgët e tu fluturim, s'më merr të më përplasësh.
Në këtë copë shkëmb një ditë dhe ti do të ngurosesh
Me të rëndin petkë të kaltër hedhur përmbi krah.
Fatet e këtij shkëmbi, ku së bashku rrënjët kemi mpleskur.
Eja të t'i lajmë ne o det, me shkulma dallgësh të mëdha.
Trazuar prej një ndjenje të natyrëshme njerëzore.
Me psherëtime të argasim pulëbardhat lartë në qiell.
Eja, të ecim deti im nëpër shi e mjegull, a gurore.
Veç të brishtat mure t'i ngrohim me pak diell.

skender iljaz braka

Emigrimi

Emigrimi

Nuk jemi më shumë se një grusht,
që presim për tu nisur.
Një grusht i hallakatur njerëzish.
A thua se drejt asgjës do të nisemi.
Dhe udha nga prej kemi ardhur
ka kaluar nga hiçi.
Pë nisjen e shumpritur presim,
pa e ditur se do të mbërrim një ditë.

Eshtë frika në fytyrë, gjithë ç'na ka mbetur.
Eshtë një psherëtim e fikur buzeve që ka ngrirë.
Vetëm ca pika djerse mbulojnë ballin e gjërë.
Dhe një vështrim i trëmbur, si vetëtimë.

Të gjithë presim orën e nisjes...
si atleti startimin në pistën e tij.
Nisja jonë paska qënë një infinit...

skender iljaz braka

Endërr

Një magji të paimagjinueshme
më imponoi mbrëm nata.
Veten të zhbëja shpejt e shpejt.
Me njërën dorë të vidhisja universin.
Me tjetrën një satelit të rrëmbeja
prej të madhit Jupiter.
Dikush më imponoj të harroja identitetin,
nderin, gjakun dhe besën.
Gjithçka njerëzore që kam,
të cilën si Noja në një varkë do ti merrja,
për ti shpëtuar kaosit të planetit të zhbër.

skender iljaz braka

Enderra E Nje Vajze.

Endërra e një vajze

Të vështroja tek shkoje me ecjen e ngadaltë të muzgut.
Përmes lajthishtes së xhveshur humbisje verbërisht.
Si një velë e coptuar prej erës, flokët e tu të shpupuritur.
Prej syve më largoheshin, më zhdukeshin pafundësisht.

Përmes shtegut të së shkuarës të thërrmoheshin kujtimet.
E nëpërkëmbura jetë padrejtësisht të ndiqte nëpër ikje.
Me etjen e aromës së shpresës duke zhpërfillur zhgënjimet.
Ti shikimin tresje horizontit me të vetmen kahje nxitjeje.

Mall-djegur i rrëmbeje të parën freski blerimit të lëndinës.
Në turravrapin çmëndurak si lingth i një kali të harbuar.
Për një buzëqeshje fëmije, mbetur e zhuritur prej dëshirës.
Mbi zjarret e tua, imazh i tij si një planet duke fluturuar.

Endërruar të parën lidhje traktati midis nënës dhe fëmijës.
Si çdo vajzë që jetës kërkon t'ia rrëmej me çkusht shpagimin.
Mbi barkun e ndezur prej psherëtimës së fundit të vetmisë.
Të ujitur prej syve të përlotur, të derdhur si dallgë pikëllimi.

I luteshe ti qiellit, me të veç një ditë për të shkuar mbi yjësit.
Disa çaste të qëndroje pranë dritës dhe shpërthimeve të veriut.
Të ngrohtin gjak mbi tënden krijesë duke shpërbër vazhdimisht.
Gjersa të arrije në të largëtën strehëz të padukëshme të shiut.

skender iljaz braka

Erërat Që Fryjnë.....

Fryjnë...fryjnë...fryjnë... fryjnë
Dhe përsëri gjithkund fryjnë erërat e rizgjimit.
Mes ulërimash të thekëshme vullshëm shfryjnë.
Mbi globin e rrudhur prej mplakjes së mendimit.

Në ndarje hapsirash, mes boshllëqesh të ngrira.
Në të pafundëmet vakuume prej zjarrit përvëlur.
Të stuhishmet erëra meridianeve përdridhen.
Planetit i përqeshin qorrollisjen e tij të verbuar.

I ndjej dhe unë, tyneli i errësirës, i dritës së largët.
Lëvozhgën e ashpër në ngjyrën e errët të ndryshkut.
E ndjej dhe shoh nën tkurrjen e tij të vazhdueshme.
Pandalshmërin e thërrmimit të likenve dhe myshkut.

Fryjnë përpara fytyrës së shëmtuar të braktisjes.
Përmes rrjedhave të thella të ujit të tejdukshëm.
Të rejat erëra thyejn makthet e gjata të pritjes.
Mbi brigje lotësh ngrihen e bien mallkueshëm.

Fryjnë, rrugëve të fundosura mes të gjallëve, të vdekura.
Ardhur prej udhësh në të përjetëshmen strehëz ëngjëllore.
Fryjnë mbi të tjerat diktatura, me fyrëra të maskuara.
Ku zëri i urisë klithmën se ndal hapsirave qiellore.

skender iljaz braka

Eshte E Trishte

Eshtë e trisht...

Drithëruese dhe e trisht është të mendosh.
Se egziston një kupolë që dikton mbi gjithçka.
Si një anije e plakur piratësh humbur detit.
Me vela të shqyera që u bien direkëve të kalbur.
E trishtë është që mes pyllnajës së përflakur.
Të shohësh një lis pa gjeth e pa një syth.
Ku çdo ditë degë të thata prej trungut të tij.
I bien si re të zeza tokës së vlagur.
Eshtë e trisht të mendosh se ka edhe një moçal.
Me fole mushkonjash që thithin çdo ditë gjak.
Se mes malesh ka për bishat dhe një strofull.
Ku fshihen lakenjtë, që rriten rreth e qark.
E trishte është, shumë e trisht.....

skender iljaz braka

Falem Nje Minute

Falëm një minute..

Në rrugicë m'u shfaqe, një mbrëmje krejt papritur.
Të florinjat flokë hedhur përmbi supe.
'Ndal ti moj vajze, falëm një minute."
Por Ti seç më fshiheshe, tretur nëpër muzg.

Me rrezen e syrit, të ndoqa deri larg.
M'u shkërmoqen fjalët, shikimi seç m'u tret.
Mjeri une, i mjeri, mbi deborë seç mbeta.
Si nje dru i thatë , si nje zog i shkretë.

Befas nje dallgë fati, të ngre nga thellësia.
Si nje nimfë deti, vjen m'a bën me dorë.
Rreth e qarke veshtroj me shikim të vrarë.
Era e marrosur minutat m'i bën orë.

Mbi të heshturën rruge, debora fle e qetë.
Tej një lot i keputur, përmbi buzë te bie.
Era nëpër muzgje, këngët i shtyn lehtë.
Deborë e kristaltë, mbi qepalla të shkrihet.

skender iljaz braka

Fillimi I Marrëzimit Nuk Është Veç Fundi I Vetshkatërrimit.

Fillimi i marrëzimit nuk është veç fundi i vetshkatërrimit.

Ajzbergu sytë e skeplosur nxorri pas procesit të votimit.
Fatalisht i përplasur mbeti vetmitar, brigjeve të disfatës.
Mbeti si një anije e fundosur prej mungesës së farit.
Me kënaqësitë e pagëzuara prej përgëdhelive të uratës.

Pluhuri i diskriminimit mbuloi misteri e fajsisë së të pafajshëmit.
Dhe e njëjta plagë u la përsëri prej të njëjtësh lot zëmërimi.
Të rrënqethura përvëluese shkaktuan dhe një herë ironit e fatit.
Mbledhur prej rryfeve të groteskut dhe komizmit të përgmimit.

Në përjetim të momentit banal, bushtrat ngren vellot e kuisjeve.
Dhe shthutje e gjygjësorit, e përgjakur plandoset para zgjimit.
Para syrit të botës digjet procesverbal i padeshifruar i kulisave.
Këputen e bien me rropëllimë të kalbëzyerat hallka të zinxhirit.

Ky s'është veçse një hon ku është rrokullisur njerëzimi.
As një qorrollepse rastësore, inkurajuar prej mashtrimit.
Retushim i plot i reve të qiellit me një tjetër penel krimi.
Fillimi i marrëzimit nuk është veç fundi i vetshkatërrimit.

skender iljaz braka

Gjenocid Familjar.

Rëndom kur papritmas biem në fatkeqësi fatale.
Nën një heshtje të zezë varri ndrydhemi, e tkurremi.
Kështu nisin të parat plasaritje të jetës familjare.
Dhe pse nuk duam ta pranojmë, papritmas vethelmohemi.
E prej vrerit të një sedreje të lënduar, rrënqethemi,

Mes angullimash të vazhdueshme, netëve të vetmuar.
Vetëveten, vetëm për një çast arrijmë të imagjinojmë,
nën hidhërime, të mbytur mes lotësh para portave të ferrit.
Atje të imponuar shpesh prej një gjykimi paradoksal.
Një pakt pajtueshmërie duam të nënshkruajm
mes diskriminimit demonial.

Diçka eprore na torturon ndërgjegjen prindërore.
Më kot jashtë vetes e kërkojmë burimin e së keqes.
(Ashtu si më kot perlat fundit të detit kemi kërkuar)
Gjithçka para syve gjallon si këmbanë e së nesërmes.
Habitshëm pyesim nën heshtje: ku vallë kemi gabuar?
Dhe si ëngjëj të ngrirë prej dhimbjes së përjetshëme,
buzëdridhur murmurisim dhe netëve rrim zgjuar.

Prej prapësive të vazhdueshme të një fëmije të praptë,
që ndershmërinë familjare rëndë na ka provokuar.
Si ikonë lakuriqësie, vazhdojmë të pasqyrojmë mëshirën.
Dhe pse e shëmtuara në më të bukurën na është dhuruar,
sytë me mjegullsinë e art të shpresës ndjejm të na vishen.
Përtej egërsimit të varrosur mundohemi përdhëmbshëm.
Veten t'mos e ndjejm prej pjellës sonë të diskriminuar.
Që pas tingujve të jetës marrëzisht fluturimthi të rendim.
Sërish e serish, një rreze drite kërkojmë të nxjerrim,
prej zemrës sonë të lënduar.

skender iljaz braka

Gjumnazistes

Gjumnazistes..

Ti shkoje vetmitare udhës për në shkollë.
E heshtur si pikëza e vesës qëndruar mbi petale.
Një çamtë librash parakrahëve rrotulloje.
Si të vërtisje ca ëndërra të bukura ngjyrë alle.
(Oh çamta jote prej meshini të zi)

S'mi hidhje sytë e bukur kur pranë të kaloja.
E ndrojtur ishe, a frikë prej meje kishe, nuk e di.
Vetëm një herë do të doja të më shihje.
Se shikimi mbart thellë shumë pyetje pa përgjigje.
Prej shikimit dikur lind një pemë që lulëzon,
por dhe një përrua që dhe dimrit
mund t'i thahet shtratit të tij.

Të afrohesha me ankthin që më ngjitej damarëve.
S'guxoja të të flisja, prej ndrojtjes
që më shpërthente mbi lëkurë.
Mëse një herë me mëngjeset unë u zura.
Dhe gjak u bëra me pyetjet drejtuar reve.

Ah, veç një herë të fshika lehtaz si padashje.
Atëherë kur t'a vodha vështrimin përmes hijeve.

skender iljaz braka

Gjithçka Nga Vetja Do Të Jepja...

Pa ty, në këtë ngrehinë të vjetër ku jetoj.
Koncepti i kohës prej vitesh më është bjerrur.
Kufijët e njëmëndjes më janë fshirë përgjithmonë.
Jeta shndërruar më është
në një labyrinthe kujtimesh të çtjerrur.
Fjalët që s'munda të t'i them
dhe ca puthje që dot, s'dita si t'i marrë.
Mbi fosile këngësh të pa kënduara më kanë mbirë
e buzëve të djegura prej dashurisë, më janë tharë.
Por sakaq që në vetvete jam duke u kthyer.
Mbledhur thellë shpirtit gjithë dhimbjet,
prej humbjes shkaktuar.
Gjithçka nga vetja ime përsëri do të jepja.
Mjaft për të gjetur tek ty,
atë që ndër vite kam pritur, kam ëndërruar.
I heshtur qëndroj përpara imazhit tënd të brishtë.
Sytë e tu miqësor, ngultas duke ndjer të më vështrojnë.
Brënda shpirtit më rindizet drita e shumëpritur.
Prej ndarjes dhe largësis askush në jetë nuk doli i fituar.
I vetmuar, askush s'i dha jetës bukuri.
Prej lotësh dhe ngashërimesh askush s'ka përfituar
Dhe frymëzim një trupi të ngurosuar, si dha asnjëri.
Më thonë se dhe likenet lart në pyllnajë.
Mes lëvozhgash n'errësirë kërkojnë pakëz dritë.
Ndaj të vdes mos e lini përjetësisht pa ngrohtësi.
Të vdes mos e lini, një zemër dhe një shpirt pa dashuri

skender iljaz braka

Gjithmon Do Të Kujtoj

Gjithë muret e heshtjes i theva një nga një,
Kur papritmas kësaj nate me erdhe si vegim.
Përmallshëm të kujtoj tani që s'të kam më.
Pendimin duke derdhur mbi veten si mallkim.
Harlisej kurmi ty nën puthjet e mia prej erës.
Përvëlur zjarrit pa mundur të lëshoja.
Në çark i mbaja ngritur unë ditët e shpresës.
Humbur vetmis time, marrëzisht të dashuroja.
Unë isha i yti e dashur, nga maja e këmbëve
gjer në rrënjën e imtë të flokut tim të thatë,
ndërsa ti për mua u bëre det i dallgëzuar,
ku ujërave të tua mbytesha përnatë.
Me lulet e urthit, që ball i bëjnë vjeshtës.
Qarkuar të kam patur si me grumbuj stërkalash,
për të mos i humbur kurrë dashurisë tënde të vlagët,
që me diell më mbështilte dhe mesit të natës.
Të kujtoj dhe dridhem si degëza prej stuhisë.
Si fik deti lotoj nën peshën e dhimbjes.
Të paharruarat çaste do më ndjekin deri larg.
Kur supeve t'më rëndoje e rënda peshë e pleqëris.

skender iljaz braka

Gjithmone Do Te Kujtoj

Gjithmon do të kujtoj...

Gjithë muret e heshtjes i theva një nga një,
Kur papritmas kësaj nate me erdhe si vegim.
Përmallshëm të kujtoj tani që s'të kam më.
Pendimin duke derdhur mbi veten si mallkim.
Harlisej kurmi ty nën puthjet e mia prej erës.
Përvëlur zjarrit pa mundur të lëshoja.
Në çark i mbaja ngritur unë ditët e shpresës.
Humbur vetmis time, marrëzisht të dashuroja.
Unë isha i yti e dashur, nga maja e këmbëve
gjer në rrënjën e imtë të flokut tim të thatë,
ndërsa ti për mua u bërë det i dallgëzuar,
ku ujërave të tua mbytesha përnatë.
Me lulet e urthit, që ball i bëjnë vjeshtës.
Qarkuar të kam patur si me grumbuj stërkalash,
për të mos i humbur kurrë dashurisë tënde të vlagët,
që me diell më mbështilte dhe mesit të natës.
Të kujtoj dhe dridhem si degëza prej stuhisë.
Si fik deti lotoj nën peshën e dhimbjes.
Të paharruarat çaste do më ndjekin deri larg.
Kur supeve t'më rëndoje e rënda peshë e pleqëris.

skender iljaz braka

Hapma Udhen

HAPMA UDHEN !

Hapma udhen ti bishe e terbuar!
Shtegun hapma! Dritën lërë t'më ndriçoj.
S'më trëmbim sapak të tuat ulërима.
Të përgjakurat dhëmbë vdekjeje,
s'me termbin aspak.□
Hapma udhën! Lërme te shkoj!
Piketave të gjakut tim, që çurg ka rrjedhur.
Diellin me këto duar dua fort ta shtërngoј.
Dhe yjet në një grusht për t'i mbledhur..

skender iljaz braka

Herët Ose Vonë

Shikimin përqëndroj tej ca skajeve të kristalt.
Shtangur përpara një porte të heshtur, të blinduar.
Atje ku kam pritur prej shekujsh të trokas.
Prej varrit i ngritur i përbaltur, i dërrmuar.

Nuk di sa do më duhet të grindem me vetveten.
I papërmbajtur fuqishëm të këlthas, të rrebelohem.
Nuk di sa do t'më duhet të pres tek ky prag.
Përmes pluhurit i zhgënjyer, lirisë t'i përbetohem.

Herët ose vonë, një furtunë malore
do t'ma tres përgjumjen dimërore.
Për t'më çuar atje, ku flakët e urrejtjes duhen shuar.
Atje ku frymë e paqes, një pishtar lirie do të ndez.
Mbi damkime të shëmtuara hakmarrja do të bjerë.
Si një shpatë shpagimtare, e hekurt, e pa deformuar.

Herët ose vonë,
kur vet përbindëshi ta kuptoj se s'është triumfator.
Dhe djalli të mos përbetohet më si ëngjëll në altar.
Atëherë një frymim dashurie do të rigoj mbi univers.
Trungu i that i mjerimit me injorancën do të digjet
përmes flakësh të ndezura në llahtar.

Herët ose vonë...
Një vogëlush s'do të endet udhëve me sy të vrarë.
Hendeqeve kufoma të humbura prostitutash s'do të ket.
Askush s'do të guxoj që mbi popuj të diktoj si një Çezar.
Veç ligji për të gjithë i barabart, të thërras: Unë jam mbret!

Herët ose vonë...

skender iljaz braka

Heshtja E Lumit

Heshtja e lumit

Heshtja e lumit, si zëri i humbur i shkeretëtirës,
më ngjalli kureshtjen e kuptimit tënd.

Iimazhin e floknajës tënde dredharake.

Dhe lumi dhe flokët e ty e dinin se unë isha aty,
duke pasqyruar hënën në fytyrën time të ngrirë
pingul i ngritur mbi një tokë të çarë,
mbi një qivur hekuri të ndryshkur.

skender iljaz braka

Heshtja E Lumit

HESHTJA E LUMIT

Heshtja e lumit,
si zëri i humbur i shkeretëtirës,
më ngjalli kureshtjen e kuptimit tënd.
Iimazhin e floknajës dredharake,
Që supesh të binte e lagur.
Dhe lumi dhe flokët e tu
e dinin se unë isha aty,
duke pasqyruar hënën në fytyrën time të ngrirë
pingul i ngritur mbi një tokë të çarë,
mbi një qivur hekuri të ndryshkur,
duke të pritur gjatë
Dhe ngadalë duke vdekur
si dreri i kaltër
që asaj bote i iku vetëm me një murmurimë.

skender iljaz braka

Hiena Të Korruptuara Shpellash

Hiena të etura për kërmë
nëpër hapsira të errëta morore duken dhe zhduken.
Tokës së vdekur i gëlojnë
si brumi më i thartë e i athët i jetës.
Hiena me fytyra të dhjamura,
të ndyra që poshtërsi dhe mashtrim gjenerojnë.
Hiena me frymëmbytjen e gëlbasës së pështirë
që njerëzimi i sëmurë çliron ditëve të tendossura.
Su frikem.
Durimin e shenjtit kam për tu përballur me to.
I shoh dhe i ndjek me sytë që më vetëtijnë,
kur nëntokën e djegur nën drithërima të ashpëra
me turinjë dhe duar urithërish rrëmijnë.
Më të këqija e më të rrezikshme se këto
është lloji tjetër që korrupsionin e tyre mbron.
Përpara këmbëve më shkojnë
Hiena të babëzitura, hiena zëshurdhëta,
prej ndjenjash njerëzore krejtësisht të xhveshura.
Hiena të nxira shpellash,
kthyer në trupa të çmishëruar pa formë,
si të ringritura prej baltërash të pështira.
Një jetë tej e tej e shpërdoruar,
përkthyer në horror.
Viktima të së njëjtës këngë të vjetër
dirigjuar prej ligjit më të ndyrë korruptor.
Hiena të etura për kërmë
që asgjë nuk arrijnë të dallojnë prej verbimit,
si kryqe të përmbysuar varresh
kërkojnë udhët dhe kolonat e ferrit
Me duart e tyre tërë panik, vdekjen tjerrin.
Kaltërsinë ëngjëllore nuk mundën tia preknin
kurrën e kurrës diellit.

skender iljaz braka

Hije Hipokrizie...

Hije hipokrizie...

Hije, që zgjaten përtej të pamundures.
Kacafytur mundimshem mbi malet e premtimit.
Hije të përvjedhura kodeve të moralit.
Arratisur nën hipnozë sugjestionues.
Fshehur nën krahtë e brishtë të ëgjëllit.
Simotër binjake të pafyrshmëris dhe djallit.
Ecur përgjatë udhëve mëkatore, të errësirës së shpirtit,
gjithkund të përndjekin, të lodhura e të rrudhura,
mes britmash të heshtura, nën klithmat e mallkimit.
Mes lutjesh përulur, përpara kopeturash të koptuara.
Të shmangur prej trysnis dhe rrezes së ndriçimit.
Zotat predikojnë, tek zotat pa besuar për të gjetur errësirës,
shtegun e Poshtërim i fshehur nën lëkurë të parfumosur,
nën jaka spic dhe kollaresh ngrehrosur.
Këto shënitime imazhesh fytyrë shpërfytyruar,
lindur prej shëmtimit të vesit prej vesit, tej thellesive të shkatërrimit,
dita - dites i afrojnë kohës, mundësinë e degradimit.
Ngritur mbi harqe të përthyerë predikimesh, ides së krijimit,
gjithë duke i hijet hipokrite neperkembur gulcojnë,
mes dallgeve të disfatës, në kulm të dëshpërimit.
Prej të njëjtës arsye, përtej çdo limiti, shpesh here e ndjej veten,
së tepërmi dëshpëruar, të vlarë thell shpirtit,
prej çdo shprese të shuar.
Në këtë ves ligështues, të mbetur të përçart,
njerëzimi ende vazhdon të vegjetoj, pa kuptuar sa vet,
se vetveten padashur është duke vlarë.

skender iljaz braka

Hyu Im Ilir

HYU IM ILIR ...

I mbarë paskësh qenë, Hyu im Ilir,
kur mbi dy rrahe trupin e shtriu gjërë e gjatë.
Nimfat e detit këndonin këngët e përjetësisë,
mirëseardhjen bekonin tok me korifejtë e lashtë.

Dhe lindja ime rastësi s'paskësh qenë.
I ardhur nuk jam nga ishulli sirenave,
ku vdekja vdekjes i nanuriste nat' për natë,
Poseidoni, i zemëruar, detit i ngrinte dallgë.

Lindur jam unë prej brinjve pellazgjike.
Nga deti i përgjakur, i dhimbjes së tij
që dallgët Epidamusit ia futi thellë në shtat,
dhe gjaku i ngrohtë shpejt iu bë rrasht.

Me lotët e diellit tharë nëpër trupin e copëtuar,
me Hyun Ilir, shekujt me mund kam sjellë gjer këtu.
Sot, nuk di përse, Hyut tim i rëndon një qepallë,
dhe trupit ndien të mardhur, shndërruar në një dru.

Unë dhe Hyu për ty, Dyrrah, jemi krenar,
dhe pse na dhimbsesh, kur të shohim kështu.

skender iljaz braka

I Lash Në Kapërcyell Të Ditëve..

I lash në kapërcyell të ditëve..

Ne kapërcyell te diteve vara:
te shumeperfoluren buje snobe,
te merziteshmet koferenca shtypi,
kotesit e emisioneve shterperuese
dhe faqosjet e te perditeshmeve gënjeshtare.
Ne ate kapërcyell i lash te gjitha.
Me ajrein tim ndertova nje shtepi,
qe mban ende arome gerqere,
Nje kopeshtin qe rrethova me yje
lash nje dere per te hyre te gjithë.
Cdo dite fshij pluhurin dhe merrem
me punet e mija te shtepise.
Tani ajo rrezaton me shume drite....

skender iljaz braka

I Gjall Kam Mbetur

I gjall kam mbetur....

Me shtatë palë gjuhë më përgojuat,
me të mprehtat gjuhë të thikëta.
Me shtatë pash hekura më shrënguat,
me të rëndat, hekura tuaja të çelikta.
Në shtatë ton gjaku seç më mbytët,
Në shtatë ball det thellë seç më zhytët.
Kur më pat që mbeta gjall,
si i gjalli mbi të gjallët,
me shtatë lumenjë seç më përmbytët,
por shpirtin dot në varr s'ma kallët.

skender iljaz braka

I Kthyer Ne Nje Statuje Te Mermert

Si dhembet e bishes qe prehun kafshojen
koha trupit me copton dalngadale
perpelitem dhimbshem hapsirave boshe
sirenat e alarmit ne brendesi te vetvetes
kam kohe qe nuk i degjoj
i shurdher nuk jam
kthyer ne nje statuj te mermerte
pse i shurdhet qendroj? .
diçka duhet te beje.....
diçka dua te them.....
diçka dua te marre.....
gjithe te papriturat e mundeshme
mbledhur jane tek une,
si miksha te paftuara.
dikush me therret.....
dikush me kerkon.....
dikush me pret.....
koha trupin me bren,
me bren çdo sekonde.
Ne thelb te enderres se argjend
- Nje dore e meshireshme me shtrihet perpara
terur neper nje mjegull te kobeshme.
Mbi krye me sillen papushim miljona duar te tilla
si avujt e ngrohete qe tokes i ikin mbasditeve
dhe rreshqasin siperfaqeve te valezuara te detit....
- Ku jam? Ne askund?
Ndoshta i fundit jam ne cmendurin time te bute.
Jo nuk jam nje somnambul....

skender iljaz braka

I Përjetshëmi Mëkatar..

E thekshme ngjitet hingëllimë e kalit të bardhë.
Në thellësi të qiellit të hapur vetëtinë vikamë e tij.
Hapsirërave kalëron pas farërave të dashurisë.
Me nofullat shtrënguar prej shpirtit gjëmimtar.
Oh, ti kali im i mirë!
Oh, ti kal i bardhë!

Përse mbete përjetësisht i përjetshëmi mëkatar?
I vrapimit madhështori.
I betejës luftëtar.
Prej ç'zemre del kjo klithëma jote?
Kjo piskamë e mprehtë, prej cilit varrë?

Ndër hekuj kalërove që prej Epit tonë të lashtë.
Si shtëllungë vezulluese që i shtyhet pambarimit.
Shikimin gjithmonë zhytur thellësisë së vrazhdë.
Duke ngjizur e blatur pavdekshmërinë e shpirtit.
Të përpjetat e mundimshme përdhëmbësh i ke çar.
Përmes honesh të thepisur e pyjesh plot llahtarë.
Gjithkund mblodhe shpirtëra njerëzish besimhumbur.
Sfilitur prej mendimesh, gjer majë qimes i përvuajtur.
Shpesh keqas i përdorur për ngarkesa e plugime.
Qafës prej zinxhirësh lidhur, i tërhequr zvarrë.
Oh, ti kali bukur!
Oh, ti kali bardhë!

Eh, çmë gjason dhe ti poet me k'të kal të bardhë.
Që majë tufanesh ngjitet e qesh mes shakullinash.
Ngrihesh mbi përqeshjet, puthesh mes dëshirash.
Si një murg i urtë në tempuj perëndirash.

Prej ç'zemre kjo klithëma jote del?
Kjo piskamë e mprehtë,

.....prej cilit varrë?
Oh, ti kali im i mire!
Oh, ti kal i bardhë.!

skender iljaz braka

I Zhytur Në Hallet E Mia Barbare

I zhytur në hallet e mia barbare

Ngaherë i irrituar ndihem prej fodullëkut të orakujve,
që zgjasin përtej këmbëve të mia hije të çngjyrosura.
Rrebeluar mes klithmash, vet mendimi im më tmerron.
Kur paturpësia dhe një herë varros nenet e çvarrosura.

Së tepërmi më dëshpëron besnikëria e idhtarit të verbër.
I shfernauri zell i të paaftit që rreket për para e pushtet.
Në kulm më acaron asfaltimi i një rruge të shtrëmbër.
Formalizëmi alogjik mbi një trup të sakatuar e të pajetë.

Më çmënd bribery që më duhet të paguaj për një faturë.
E shikimn drejt qiellit nguros, mes lakuriqësh errësuar.
Kur leksione demokracie më jep një bakalaro i pafytyrë.
Plot vrer i urrej qëlizat e kësaj sëmundje të pashëruar.

Tejmbushur janë sytë e mi me terr jashtë çdo kufiri.
Shpesh dhe lirine bënda qënies e ndjej të kërcënuar.
Ethshëm nën klithma prej këmbësh më tërheq zinxhiri.
Ajo që më shumë më dekurajon është sedra e lënduar.

Para syve të mi një ditë parimet ball për ball do qëndrojnë.
Engjëlli dhe djalli fytas do të ngërthehen buzë humnerave.
Unë një pijanec i dalldisur ëndërrash tokës s'dua ti rëndo.
Mendueshëm duke ecur mbi palcën e mesnatës së të mjerëve

Tok me krikëllimat e korbave, pas shpine do ta lë pikëllimin.
Në çast ti largohem mugëtirës së kësaj dehjeje të frikshme.
Zhytur në hallet e mia barbare tutje do të hedh trishtimin.
Vullneti përherë më provokon papërkulshmërin e dobishme.

skender iljaz braka

Ike Me Muzgun

Ike me muzgun...

Me muzgun më ike asaj buzëbrëmje vjeshte.
Më ike me gjethet, që pamëshirshë
era tutje i hodhi
mbi dheun e përzhitur.
Mbi degë të zhveshura pemësh,
zogjëve majë sqepit u mbeti,
iu dridhërua cicërima.
Bari iu zverdh kopshtit tim të bukur
dhe petalet ulën pikëllueshëm lulet e gjerbërta...

Cdo mbrëmje qielli do të jetë si një det i trazuar.
Jashtë çikriku i pusit prej heshtjes do të thyhet.
Veç unë në dhomën time të errët do rri zgjuar.
Mbyllur në botën e padukshme që mezi shtyhet.

Mbi djerrina do të bredh shpirti im i parmallur.
Duke të kërkuar ty shteg më shteg
do të mbetem si lakuriqi i natës i pa vatër.
Do të mbës pa atë cicërimë zogu,
pa atë pemë të gjelbër,
pa atë qiell të qetë e të kaltër.

skender iljaz braka

Ikja E Manekinave...

Ikja e manekinave...

U thyen në botikët e rrugicës sonë
në mbrëmje ca xhama vitrine.

Manekinat s'di se për ku,
muarrën arratin.

prej dyqanit të këpucëve,
një e qeshur kristaline shnëdriste.

Manekinat iknin, turravrap,
si kapuçionët e zinjë,
pas duke lene një buzëqeshje meskine.

Mbrëmja e akullt një natë varreze thërriste.

U kthyen në mëngjes manekinat,
pa atë shkëlqimin e vitrinës,
kur mbi ne me finese,
binin të qeta reflekset e dritës....

skender iljaz braka

Im Zot Më Jep Pastertinë E Brëndëshme Të Shpirtit

Sokratit

Palltua jote e rëndomtë, si fluturimi prrallor
i Feniksit prej tokës së gjelbërt fluturoi,
Nëpër rrugën me një emër të lasht Athinase,
ku vështrimin përpara teje ngrosnin të rinjtë.

Prej dorës së brishtë të humbi jese mini i verbër.
Peshë e urrejtjes që zemrën plumb të rëndoi,
mbi gur të palatuar krisi dhe u thërrmua.

Kumbimi i dymbëdhjetë këmbanave të kobshme,
tellësive të detit u tret me ngarkesën e petaleve
të trandafilave të vyshkur dhe erërimit tënd të
pashtershëm.
Tutje shkuan në një botë të pafundëme,
të fshehtë, të përligjur ku shfaqen shënjat e ënjëjve.

Rrathët e padukshëm orbital tu vunë si kurorë.
Mbi të përhumburën e padukshëme të kohës
pikë, pikojnë ca pika loti njerëzor....

Hareja e një zoti të padukshëm për ty Sokrat,
në të tjer qiej rilindi në formën e vetë jese minit.
Mendimi yt i pashkruar u bë pesha specifike,
gravitacioni i etikës së mbarë njerëzimit

Nën një dhimbje të fortë trupore, perënditë
e tua që udhët na rrëfenin, të heshtura shkuan.
Shkuan të përgjunjura prej frikës së ekzekutimit,
si muzgu që fsheh iluzionet e fundit të lisit.
'Im zot më jep pastertinë e brëndëshme të shpirtit'

skender iljaz braka

Imazhet E Vëndë Lindjes...

Imazhet e vëndë lindjes më kthejnë
tek të hershëmet vite të fëmijërisë.
Atëherë kur të tejdukshëm na dukeshin;
deti, kënetë e mbushur me lejleq e pelikanë
dhe perëndimet që përtej Porto Romanos ndizeshin.

S'do të mund të kthehem kurrë tek ajo kënga e parë,
që shpërthente përmes pluhurit të fushës dhe harresës.
Kthim pas s'do të kenë më tingujt e çangës së lodhur,
që lajmëronte fillimin, pushimin dhe mbarimin e punës,
ferri i së cilës, qiellin gërvishtëte si përmbi supe engjëjsh.

Prej lotit të dhimbjes, askush nuk e arriti përqëndrimin.
Nga trishtimi i ndarjes kërkush nuk e gjeti ngushëllimin.
Në mol në tingujt e këmbanës qante një vajzë
duke tundur shaminë e qëndisur,
si të tundëte zëmrën e saj të shkukur.

Imazhet e vëndë lindjes më kthejnë tek nxitimi për në shkollë.
Tek përparsja e zezë dhe kordelja e bardhë punuar me grep.
Më kthejn tek "Ne jemi shqiponja..." që luanim në oborr.
Tek ca çapkëllëqe fëminore që prej mëndjes dot si heq.

skender iljaz braka

Indiferentizem Ekstrem

Indiferentizem ekstrem....

Ngadalë shkojnë makinat me emblemën "kfor".
Makina të gjelbërta me ushtarë të gjelbër,
që armët e frikëshme shtrëngojnë në duar.
Prej fytyrave tona indiferente,
të habitur ndihen çuditërisht,
Në mimikat e tyre lexoj ngatërrimi
me një destinacion tjetër.
Vetëm një dridhje qerpiku flet me mua miqësisht
si përgënjeshtër i harruar, i fjetur
dhe ditët e njollosura me gjak, pas kanë mbetur
nën duartrokitjen e një llozheje të vetmuar.
Nën qetësinë e ditës vështroj një ushtar,
Fëmija përpara ushtarit bënë veç 'pau, pau'
pa e prishur prej syrit të vogël shikimin.
Në rrugë ngadalë shkojnë makinat me emblemën "kfor".
Në rrugë shkojnë ngadalë,
sikur të vinin prej ndonjë planeti tjetër.

skender iljaz braka

Ish E Bukur Puthja E Parë

Nuk di nëse ta vodha asaj mbrëmje
të parën puthje nën shelgun vajtues,
apo ti m'a rrëmbeve me buzët shegëplasur.
Në sfon, syri i detit tinëz na vështronte.
Trupi yt i papeshë u bë kënga e tij e pafundëme.
E freskëta erë e natës,
nuk mundëte ti ftohte trupat tanë.
S'kish dallgë deti,
që zjarrin t'ni i shuante.
Prej nesh iknin, fluturonin tutje pulëbardhat.
Nën pushtetin e puthjes sonë të parë,
inatçore hynte xhelozia e valës.
Atje buzë detit, nën shelgun qaraman,
shigjeta për harkun e së ardhëmes,
farkëtoi ajo, puthje jonë e parë.

skender iljaz braka

Ishim Shok Dikur

Dhe kur të mërzhitur prej skamjes kemi qënë
dhe kur të trishtuar prej ditëve të sqlluar
pa nerv dhe monotone kemi qënë.
të frikur prej pasigurisë së të ardhëmes,
plagosur e të vrrarë prej të vërtetash të hidhura.
Si vëllezër kurdoherë i kemi qëndruar
njëri tjetrit pranë e pranë, duke i ndrydhur
dhe përtypur çastet e vështira, të koklavitura

Ç'kuptim do të kishte ndryshe për ne jeta,
shoku im.?

Ne që bukën nën sjetull merrnim
me një vezë të skuqur, e na dukej
sikur ia kishim rrëmbyer banketin mbretit.

Ne shkonim përmes mjegullës dhe grurit,
Përmes ngjyrimeve të ndezura të trandafilave.
Flakët e detit, pishave, të shkëmbit
dhe erës së vrullshme.
Rridhnin brënda nesh kur uleshim bordurave.

Tani të thinjur jemi shoku im,
por tepër të largët,
Të largët ...
Si dy drur të tharë që ndajnë kilometrat
Dhe humbasim, humbasim...
si grimcat e rërës nëpër shkretëtirë.

skender iljaz braka

Jasteku I Gjumit

Jastëku i gjumit

Për ditë e më shumë jastik i gjumit petohet.

Kur kokën unë e ti mbështesim çdo natë.

I ëmbëli bardhosh si një

kone llastohet.

Kur bien mbi të puthjet dhe psherëtima e thatë.

Prej punës kur kthehem në dhomën e ftohtë.

I buzëqeshim një çast unë e ti hënës ziliqare.

Më pas tek jastiku kokën

mbështes si perandor.

Embëlake

ti buzët mi afron qetësisht si një manare.

Në pyllin e ëndrrave lahemi e s'dim të dalim dot.

Hepohet jastëku prej përkundjesh çmëndurake.

Xheloz nuk bëhet as për

çarçfët e ngrohtë.

Por zë e përdridhet në hijet tona fluturake.

Jastik i gjumit tim sa herë më ke qetuar.

Prej bardhësis tënde do plakem një ditë.

Në kaq vite bashk asnjëherë

s'më je ankuar.

Ndaj do t'përgëdhel gjer çastit që t'mbyll sytë.

skender iljaz braka

Jehonë Këmbanoresh.....

Jehonë këmbanoresh.....

Për atë që më shumë se çdo gjë në jetë kam ushqyer.
Pa u lodhur kam udhëtuar për në temullin e faljes.
Ndonse shpesh herë thellë shpirtit jam ndjer i zhgënjyer.
Falja ngushëllim më ka dhënë,
kur të skalitur e kam gjetur në librin themeltar të parajsës.

Shikimin që mbaja drejtë qiellit, përdhe e kam rrëzuar.
E mbi gjithë kryqet, tek më i vjetëri pa droje jam afruar.
Në pluhurin e të vërtetave ish një sacrificë e padeshifruar.
Dhe jetës sime të dytë i gjeta një dëshmi të pa celebruar.

Verbimin ndjeva thellësive të misterta ku nxin errësira.
Mashtrimin në të zezë ngjyrosur përpara kryqëzimit.
Në zjarrin e ferrit pash vrastarë të përvetësonin shënjtërimin
Ehe ata qe në emër të vet jetës përpësi i dhanë përvetësimin.

Jehojnë këmbanoret nën thirrjet e pandërprera të vdekjes.
I helmuar humbas nën rrezen e diellit që mbi mua ndriçojnë.
Nën varferine e përvuajtur dhe sytë e përbotur të shpresës.
Hija e trishtimit tim zgjatet pertej endërrimeve që lëngojnë.

skender iljaz braka

Jeta...

S'na buzëqeshi ne jeta, s'na buzëqeshi kurrë.
Mes fatkeqësish pafund ne shkuan nëpër breza.
Dhe vdiqëm të thjeshtë pa bujë e zhurmë.

Ngaherë na u duk e mbushur me gënjeshtër.
Por dhe e bukur si nuse mëngjazit na u duk.
Gjithçka që lulëzonte dhe e rriste pranvera.
Papritmas na i rrëmbete dimëri murg.

Shpesh para kohej jetës iu burruam.
Por dhe fëmijë më shumë nga çduhej iu bëmë.
Mbase dhe dashuruam atëherë kur nuk duhej
dhe u ndam kur dohet të shuheshim më shumë.

Iu gëzuam dhe gënjeshtërës si fëmijë të bindur
Mënçurinë akumulua për brezat që do vijnë.
E largët na dukej, e një tjetër bote vdekja.
Ne mbi vdekjen u ngritëm duke sfiduar perëndinë.

S'na përjashtuan dot humbjet, pikëllimet e ditëve.
Të rrahur prej erërash s'u lutëm për mëshirë.
Ne zëmërimin e ndrydhëm thellë në vetvete.
Patkonjë i mbathëm si kuaj të bindur, si kuaj të mirë

Ne të lindurit vdekëtar,
kësaj jete i erdhem për të luftuar,
që nesër e përgjithmonë.....
të mbesim të pavdekshëm.

skender iljaz braka

Ka Dhe Nje Pajtim...

Ka dhe nje pajtim....

Thith ajërin e buzëmbremjes së vjeshtës së ftohtë.
Buzë një udhe të pashkelur, i vetmi kalimtar.
Endur në kërkim të shpirtit të përdhosur.
Peng i një rrebelimi prej një haku të pamarrë.
Pa më të vogëlin shteg për të gjetur pak qetësi.
Baktisur prej të gjithëve, ndihem i vetmuar.
Kjo plage e vjetër, e shkuar gjer në marrëzi.
Cuditërisht më ka mpirë mes një zemre të coptuar.
Degëzimet e trungut të shqarrit të egër.
Më fshikëllojnë fytyrën e diç më mërmërisin.
Prej kullës së ngujimit një jehonë thërrmohet.
Tutje oshëtimat e pyllit. kohët në dysh i grisin.
Britma e një përgjegjësie më buçet nën gjëmim.
Mbi kanune më bënë të ngrihem marrëzisht.
Shpirti s'më lë të rend nga krimi në tjetër krim.
Shpirti më thotë se në jetë, ka dhe një pajtim.

skender iljaz braka

Kam Mbetur Shqiptar

Për at'qiell jam betuar me ndjesin e burrit.
Tokën kam përgjakur për atë copë qiell.
Të egrin shpirt kam ndezur flakëve të gurit.
Me etjen për liri kam puthur pakëz diell.

Kam dhanë besën për një fjalë që se tund guri.
Kam thy gurin, kur pas shpine më ka ngrën pabesia.
Gjakut ngjyrën i kam dhënë mbi valë të thikta.
Tehun e syrit nëpër erëra ma kaliti trimëria.

Kështu më bëri koha, binjak me historinë.
Me shkulma dallgësh më përplasi breg më breg.
Mbi dhimbje plagësh më farkëtoi dashurinë.
Emrin ma frymoi në çdo shkrep e në çdo shteg.

Thanë, do të mbetesh pa një gjuhë e pa një varr.
Thanë s'do kisha histori, që t'më ndiqte nëpër shekuj.
Por brez pas brezi gjer në thua unë mbeta shqipëtar.
Mbeta lisi motshëm vetmitar, degë xhveshur e trup djegur.

skender iljaz braka

Karrocë E Ëndërrave Të Mia.

Karrocë e ëndërrave të mia.

Mos mu ndal ti karrocë e ëndërrave të mia.
Të thella lëri vragat shtratit
të tokës sime të uritur.
Derdhe dhimbjen si vilare uji të përgjakura.
Që prej zëmrës pikojnë
mes kohërash kaq të zymta,
kaq të plakura,
kaq të thinjura.

Përmes blana udhëvdekjesh rrugëto!
Rend mes shenjzimesh të panumërta
të jetës përvëluese.
Mundimshëm tërhiq mes plagësh gjakrrjedhur.
Shtegun e martirëve të tu ndiq.
Dheut të tejngjeshur prej barbarësh mizorë nxito,
duke shpërndar hirin e shenjtë të muzgjeve.
Për të mbrritur tek ky prag gjysmë i rrënuar.
Për të shpërthyer embrionin e ngurosur
të akullit, zjarrit e të trungjeve.

Nxito karrocë e kuajve të harlisur.
Kalëro mbi hirin përvëlues të luftërave.
Kufijëve të qiejve të zbrazet shkund
shpirtin tënd të pangopshëm,
duke i paraprirë tejdukshmërisë
së paqes së perëndimit.
skender braka

skender iljaz braka

Kësaj Nate Dimri

Mi thau sot thëllimi buzët e përvëluara.
Dhe duartë më dridhen lehtaz si fëmijë.
Në një cep ruge si shqarthe rri e gjuaj.
Si xixë t'i shfaqesh kësaj mbrëmjeje gri.

Në u kthefsha pa ty, turivarur si një cja.
Mos nguro, trokit e hyr, prej gjumit zgjom.
Varur kam në mur një shpirt si pentagram.
Gjer në ag këndo, me zërin tënd mbulom.

Nëse gjum i vdekjes rëndë do më ketë zënë.
E ndrojtur mos qëndro, me litar flokësh rrihmë.
E nese duart prej të ftohtit do të më dridhen,
Ngrohmi me firomën tënde prej zjarri të përhimt.

Me lilka dashurie ti zemrën ma ngjyros.
Dhe ndizmi yjet-flakë mbi gjoksin tim të vvarë.
Larg të marrim fluturimin, si cincujt në korie.
Buzë lumit le të zgjohemi kur të bjer ag i bardh.

skender iljaz braka

Kështu Ikin Poetët...

Kështu ikin poetët...

Mes një deti të pashtruar vitesh të trazuara.
Në shkapërdredhje dallgësh të përbindshme
Ikin të përpirë dhe të tretur shpirtëra poetësh.

Me të vetmen kënaqësi të mohuara të vdekjes,
Ikin të shndërruar në adhuruesit
më të zellshëm të egërsisë së jetës.

Kështu ikin ata, një nga një të vetmuar,
me bukurinë e pashmangshme të Afërditës.

Ikin me copëza këngësh udhësh të kënduara,
Me fragmente vargjesh të shkruajtura diku.
Veten duke ushqyer me iluzione të pafundme krijimesh.
Përmes muzgut dhe natës duke ëndërruar
fytyrën përdëlllyese të jetës,
gjer në pikëzimin e mëngjezit zë shuar.

Kështu ikin ata, me pamundësinë e ribërjes,
padrejtësisht të kryqëzuar,
nën një dhimbje të papërfytyrueshme kreshtrash.
Heshturisht, prej vet natyrës dhe kohës të mashtruar.
Mendimtar të ulur këmbëkryq mbi plagët e njerëzimit,
si anija direkthyer ndan një limani të shkret ancoruar.

Kështu ikin poetët..
Në të njëjtin varr prehen me urinë e pashuar të vdekjes.

skender iljaz braka

Kështu U Ndanë Udhët Tona

Kështu u ndanë udhët tona.....

Shqetësuar nuk jam ndjer prej ngacmimeve të tua.
As prej shikimit lozanjar që më hidhje hera herës.
Dhe kur trotuarit e ndjekur prej hapave të vetmuara.
Ca dridhje zemra më kan ardhur te largeta si prej erës.

Ngacmuar nuk jam ndjer kur më rrije nën ballkon.
Dhe cigaret me radhë ndizje -fikje i shqetësuar.
Provuar kam patur atë ndjenjë, që djeg e përvëlon.
Kur prej fërshellimës tënd mendimet m'u trazuan.

Ndaj shumë të kam dashur e përsëri do të dua.
Paçka se jeta, përgjithmonë udhët tona i ndau.
Unë si dallëndyshe dherave të huaja shtegëtova.
Ti detërave s'di ku humbe, si i anijes pa marinar, kapedan.

Në këtë ndrrim viti mendoj veç për gjëra të trishta.
Se në një natë si kjo, mbi krah do të doja të mbaja gjithsesi.
Nën qiellin e ndezur prej fishekziarreve fortë të përqafoja.
Rrënoqethur prej pasionesh, si ty trupa të kaltër qiellor në largësi.

skender iljaz braka

Këtu Më Bëni Një Vend

Këtu më bëni një vend

Zhaurima e erës
si përherë më fshikëllon.
Më muros në kufirin mes tokës dhe detit.
Këtu më bëni një vënd të qëndroj.!
Me ndryshkun e plakur të viteve.
Mbrëmjeve pa skaje një vale ti këndoj
Pastaj të qaj me lotët e mi prej fëmije.
Këtu më bëni një vënd të qëndroj.!
Pranë këtij muzgu të trisht,
pa ngjyrë e pa aromë.
Kësaj bote të çnderuar vallë,
Ç' tingull krenarie i kanë mbetur,
veç një tjetër trajte fuqie të heshtjes.
gjusmë të vdekur.?
Një plim pulëbardhash dua të vështroj
Kur mbi horizontet pa dritë të lëshojnë
athtësirën e limonëve të papjekur.

skender iljaz braka

Ketu Pres

Pas trungut të djegur nën lëkurë të lisit,
vështroj sesi përdridhet dhe fshihet kulpëra.
Në heshtjen e tij shekullore, mujllibardha pret të qënrojnë
tingujt e ndaluar të botës së ngjyrave dhe të shpirtrave.
Të qëndrojnë si rrimetë nën fundakët e rrjebullës
plogështimet e botëve të vogëla të meskinëve.

E di që pas pak, këmbana e lodhur e Buzukut
ka për të zbardhur një tjetër ditë të sotme rraskapitëse
dhe se një tufë rrezesh, largë ka për ta degëdisur natën e zezë.

Këtu pres gjithë ata që shkuan dhe që kurrë su kthyen.
Në këto shtigje të gjelbërta ku gjallon lëvizja.

skender iljaz braka

Ketu Thone:

Këtu thonë: më mirë të jesh i vdekur..

Prej një gjysmë hëne të ngrënë jam rrëzuar, jam vvarë.
a ndoshta prej një tjetër sateliti të djegur nëpër galaktikë.
Pllakosur prej fatkeqësish të panumërta tërhequr jam zvarrë.
Buzë një pellgu ku më të gjalla se vet gjallesat, janë ndyrësit.
E çmundem të bëjë në një vënd, ku këtu të gjithë thonë;
më mirë të jesh i vdekur, sesa i pakallur e erëqelbur, kufomë.

Të humburit zotër të botës, duartë fërkojnë paturpësisht.
Që prej së shkuarës e tëhu s'ia njohën fytyrën fukarallëkut.
Për ta më shumë se gjithçka në botë vlen paraja e përdalur.
Vlen inkriminimi i pushtetit që lulëzon në oazin e pislëkut.

Pa prehje përpëlitim, pa më të vogëlën shpresë shpëtimi.
Përherë i tradhëtuar e i prangosur, përçarë prej dinakërisë.
Pa iu ankuar askujt veç duke mëruar vrerin e këtij bataçilliku.
Qetësinë time kërkoj, shmangur njollave të ërrëta të flamësisë.

U jam hakërryer sahanlëpirësve dhe perënditë i kam mallkuar.
Mbi të pistat para kam pështyrë dhe qiejt kam thyer i tërbuar.
Këtu është më mirë të vdesësh, i braktisur nën mjerim
Sesa të zvarritesh pas poltronesh, ndeshkuar nën kurvërim.
Se kurvat ngaherë, helmin e krvërimin kërkojnë të injektojnë
në ngrehinën e madhe të shpirtërave të pa infektuar....

skender iljaz braka

Këtu Thonë: Më Mirë Të Jesh I Vdekur..

Këtu thonë: më mirë të jesh i vdekur..

Prej një gjysmë hëne të ngrënë jam rrëzuar, jam vvarë.
a ndoshta prej një tjetër sateliti të djegur nëpër galaktikë.
Pllakosur prej fatkeqësish të panumërta tërhequr jam zvarrë.
Buzë një pellgu ku më të gjalla se vet gjallesat, janë ndyrësit.
E çmundem të bëjë në një vënd, ku këtu të gjithë thonë;
më mirë të jesh i vdekur, sesa i pakallur e erëqelbur, kufomë.

Të humburit zotër të botës, duartë fërkojnë paturpësisht.
Që prej së shkuarës e tëhu s'ia njohën fytyrën fukarallëkut.
Për ta më shumë se gjithçka në botë vlen paraja e përdalur.
Vlen inkriminimi i pushtetit që lulëzon në oazin e pislëkut.

Pa prehje përpëlitem, pa më të vogëlën shpresë shpëtimi.
Përherë i tradhëtuar e i prangosur, përçarë prej dinakërisë.
Pa iu ankuar askujt veç duke mësuar vrerin e këtij bataqçilliku.
Qetësinë time kërkoj, shmangur njollave të ërrëta të flamësisë.

U jam hakërryer sahanlëpirësve dhe perënditë i kam mallkuar.
Mbi të pistat para kam pështyrë dhe qiejt kam thyer i tërbuar.
Këtu është më mirë të vdesësh, i braktisur nën mjerim
Sesa të zvarritesh pas poltronesh, ndeshkuar nën kurvërim.
Se kurvat ngaherë, helmin e krvërimit kërkojnë të injektojnë
në ngrehinën e madhe të shpirtërave të pa infektuar....

skender iljaz braka

Kish Vetem Jete

Kish vetëm JETE..

Ditët i jetoj me të vetmen punë të ndershme.
Në frontin e saj ngaherë gjëndem duke luftuar.
Qëkurse isha fëmijë kështu më patën thënë:
Se kristali i djarsës është burim i mirësive.
Është i vetmi klorofil i jetës së gjelbëruar.

Nën ritmin e vazhdueshëm të punës e kuptova
sesa e largët është vdekja për atë që dashuron.
Ndaj ngaherë ndez qirinjë për gjithë ata që ranë.
Dhe lutem me lot të zjarrtë, gjer natën vonë.

Për tërë ata që shkuan e jkurrë më s'u kthyen.
Për atë që në emër të jetës mbeti si hero.
Le t'më kërcënoj me duartë e përgjakura vdekja.
Qirinjtë e poemave të mia, për ta do ndez ngado.

Një herë ajo dhëmbët më shtrëngoi kërcënueshëm.
Nuk donte të më linte që pas erës të vrapoja,
si i marrë të endesha rrëpirrash, nëpër fushë.
Prej nga çelin, rriten dhe vyshken grunajat.
Prej nga kthyer janë varret në zjarre dhe prrush.

Atëherë e kuptova se vërtetë s'kish vdekje.
Se për njeriun e punës përtej vdekjes,
kish vetëm pavdekësi dhe vetëm JETE kish.
Se koha ngaherë lë pas gërmadhat....

skender iljaz braka

Kish Vetëm Jete..

Ditët i jetoj me të vetmen punë të ndershme.
Në frontin e saj ngaherë gjëndem duke luftuar.
Qëkurse isha fëmijë kështu më patën thënë:
Se kristali i djarsës është burim i mirësive.
Eshtë i vetmi klorofil i jetës së gjelbëruar.

Nën ritmin e vazhdueshëm të punës e kuptova
sesa e largët është vdekja për atë që dashuron.
Ndaj ngaherë ndez qirinjë për gjithë ata që ranë.
Dhe lutem me lot të zjarrtë, gjer natën vonë.

Për tërë ata që shkuan e jkurrë më s'u kthyen.
Për atë që në emër të jetës mbeti si hero.
Le t'më kërcënoj me duartë e përgjakura vdekja.
Qirinjtë e poemave të mia, për ta do ndez ngado.

Një herë ajo dhëmbët më shtrëngoi kërcënueshëm.
Nuk donte të më linte që pas erës të vrapoja,
si i marrë të endesha rrëpirrash, nëpër fushë.
Prej nga çelin, rriten dhe vyshken grunajat.
Prej nga kthyer janë varret në zjarre dhe prrush.

Atëherë e kuptova se vërtetë s'kish vdekje.
Se për njeriun e punës përtej vdekjes,
kish vetëm pavdekësi dhe vetëm JETE kish.
Se koha ngaherë lë pas gërmadhat....

skender iljaz braka

Kjo Kurorë E Praruar E Bukurie.

Kjo kurorë e praruar e bukurie.

Vdekja, kurorë e praruar e bukurisë.
Nëna e nënave që lind e rrit fëmijët e erës.
Me nurin e saj të hijshëm pikon përmes nesh,
duke ardhur e ikur e ftohtë dhe lëndonjëse.
Ligjërim i ëmbël i ëngjëjve përpara fluturimit,
që kupolën e errët të shtëpisë së përjetshme
kërkojnë të ngren mbi mëmërimat e lëngimit.

Dallga pa shkmë që rreh e grryen bregun.
Frut i pjekur i pemës që këputet prej degës,
duke na lënë pas shihej e hidhur të bërthamës.
Valle e ndërkyer ujërash të heshtur,
Që hukat me kumbimin e trisht të këmbanës.

Vdekja, kjo kurorë e praruar e bukurisë
Na tregon se është një tjetër kopësht
që sfidon stinët e gje dhe noton përmes qiejve,
Që përmes reve tretet e humbet si shkëmbi i mjegullët.
Rrjedhin prej andej si ujërat e maleve mallet,
Valë pas vale deri tek pragu i bukur i dritës,
Që dita ditës i shpëton kryeneçësisë së drapërit
Pa mundur të zënë një vënd në ndjesinë e zërit,
që kërkon të flas që nga poltroni i gjarpërit.

Hajati i shtruar ku falen dhe luten shpirtërat.,
që mallkojnë rrëmujën e zhurmëshme të borës.
Ndaj le të vijë me përthinjen e saj!
Nuk i frikem se prej shikimit të një ënërrimtari
Merr rrugë dhe pandalshëm hov frymëzimin im
Dhe ndërsa ajo shkon apo kthehet
dhuratë më sjell traktatin e paqes së pajshme
që bëhet pelerine ime e bardhë për qiellin e zjarhtë,
Vdekja, kjo nënë e lodhur e vjeshtës së artë.
E pafrymë hesht nën qiellin e mesnatës.

skender iljaz braka

Kohë Satanike Me Njerëz Të Shpërfytyruar....

Kohë satanike me njerëz të shpërfytyruar....

Ka qënë një kohë shtrigash.
Një kohë e mbetur si letërat e zhubrosura.
Kohë me ëndërra të përgjakura e me dëshira të burgosura.
Ka qënë një kohë ferri mes trubullimash nën horror.
Që prej pagëzimit e drejtë vdekjes si kope ne shkonim.
Përngjashëm me urithët, kanalit të tyre nëntokësor.
Të akulltat domethënie të disfatave, na u bënë emblema e ditës.
Ikonë satanike e trikëndëshit të egzekutimit.
Varr i pambuluar nën hënën e ngrirë të poshtërimit.

Ka qënë një kohë rrëqethjesh, koha jonë e mohuar.
Mbase edhe unë, njeriu i gabuar, i asaj kohe të gabuar kam qënë.
Por jo një profet rebel, dënuar prej inkuizicionit famkeq.
Nuk kam qënë ëngjëlli i plagosur prej qiellit rrëzuar.
As djall i ngritur mes flakëve të ferrit,
fytyrë shënjtëruar, nuk kam qënë...

Ka qënë një kohë terri, koha e shanceve të humbura.
Ku dhe vet ata që e ngritën i trëmbeshin atij ferri.
Të njomur nën shi, kurdoherë nën vuajte të panumërta.
Dhimbjet të imponuar shtrëngonim nën thirrje të egëra.

Si lulja e tharë mbi gur.
Me zemër të coptuar vështroja se si zvenitej
ngado sinqeriteti i jetës.
Si deformoheshin filizat e njomë
prej ujërave të ndotur të kënetës.
Se si orteqe dogmash tymosnin kthelltësin e qiell të shikimit
e mbi kufoma të vdekurish ngrihej perandoria e vetshkatërrimit.
Po, një lule petele përkulur i kam qëndruar lëndinës
së mbetur pa klorofilin e gjelbërimit.

Mbi yje të vdekur shpesh kam rrugëtuar.
Një nga një duke këputur të gjitha cimat e shpresës.
Më tmerronte shfaqja si i menderosur përpara syve të botës.
Fodullëku i kurorëzuar me diademën e një perandori të fetishizuar
dhe grushtgjoks përplasja me kumbinin e këmbanave të vdekjes.

Më shkelte ngaherë këmba mbi baltën e përgjakur.
Me gjysëm trup të kafshuar prej një ideali të marrosur
e me gjysmën tjetër prej llahtarit thellë varrit i varrosur.
Një popull i përndjekur, qorrsoqësh plot viktima.
Ndrydhur energjish çdo ditë nën mërmërima.

Prej diskriminimit përvuajtur më tepër se
prej kafshimit të urisë.
Në pranga të çelikut mbërthyer në barakën time prej pupuliti.
Në çdo hap të hedhur, i suverjuar prej hijesh të sigurimit.
Netët pa gjum i shtyja, pa iu gëzuar rrezën së agimit.
Kohë satanike ish, me njerëz të shpërfytyruar.
Ish koha kur gjer në qelizë të gjithë të indroktinuar.
Dhe nëse në kopështin qiellor kish diell e na thuhej..hënë..
edhe kjo apriori duhej pranuar.
Në hapsirën tonë të vogël dhjetë fish të zvogëluar.
Ngurtësuar mendimesh, përndjekur, internuar.
Në këmbë tokë e djegur prej qiejsh gjëmonte.
Si një zemër që ndjen thellë, thikën e përgjakur.
Të paramenduarat dënime me dhimbje përjetuar.

E plakura rinia ime, e mundimshmëja e fjetur.
Nën dhunimin e lumturisë zvarritej tej dëshirës,
si kashta e kumërit që gërvisht netëve qiellin,
si i lodhuri vetmitar që i vetdorzohet rrëpirës.
Cdo të nesërme voziste mbi lumin e turbulluar të gënjeshtrove.
Mbi vdekjen e të vërtetave përpirë prej humnerës së tatëpjetave.

Më kanë përgjakur dilemat e shumta.
Pyetjet pa përgjigje më kanë helmouar.
Edhe sot mëndja më buçet prej shqetësimesh të panumërta.
Për tjetrsimin tim të urreyer kohës i jam rrebeluar.

Ish kohë satanike ajo kohë...
.....me njerëz të shpërfytyruar.

skender iljaz braka

Kokën Kthej Pas

Domosdoshmërisht e ndjej të kthyerit e kokës pas.
Të qëndroj një çast e vështrimin të hedh larg,
skutave të vjetra, ku flen e zgjohen kujtime të humbura,
ku dremisin ngjarje të trishta, të dhimbshëme,
pse jo, ngaherë edhe të bukura.

Shpesh, heshtja e vetmisë më ngacmon kujtesën.
Këngët mi shkul si yllin e mëngjezit prej dheut të egër.
E befas ndjej të më vij një ditë me erën e një fëmije.
E dal si prej guvës së heshtura, një klithëm e mekur.

Vegime të largëta, më zvendësojn njëra tjetrën.
Më rikthejnë fëmijërinë dhe një nostalgji të vjetër.
Puthjen që buzëmbremjes një vajze ia kam vjedhur.
Lotin e kristalt, që më pas, gurëve të sokakut
për të, kaq ditë netë kam derdhur, kam pykëzuar.

Ku shkuan vallë, si degraduan ato vënde të virgjëra,
ku kam qarë, kam qeshur e me shpirt kam kënduar?
C'u bë ajo vajzë çapkëne që kam dashur si i marrë?
Ku humbën si zogjtë e braktisur të qyqes ata shokë,
që udhët e mistershme s'lamë skutë pa i kërkuar?

Diçka më thërret prej asaj kohe të shkuar.
Më porosit; brengat ethshëm ti djeg brënda shpirtit.
Lënduar prej barrës së rënd të kohës së mohuar.
Forcërisht të ngrihesh mbi botën e vogël të ëndrrimit.

skender iljaz braka

Kthim I Mërgimtarit

KTHIM I MËRGIMTARIT

Në një çantë të hedhur i mblodha eshtrat e mia.
Eshtrat e holluara, të çikërrisura punëve të zeza.
Tokës iu ktheva për t'i rrëmber një grusht dheu,
nga dheun i varrit tim ku përjetësisht do të prehem.

Në kokrrizat e tij ngjitur janë gjurmët e tiranëve,
të dishepujve të degraduar me shpirtin e grykësisë,
gjurmët që shkelin mbi gjakun e mijëra martirëve,
gjurmë manjakërishtë që pagëzojnë demonët e mizorisë.

Në gijotinën e djallit kam parë gjymtyrët e mia të prera,
dëshmimtar i një tjetër torture në udhët me kufoma.
Shpirtin bakallinave e humba si qiramarrës i vetëvlarë,
me po të njëjtin stërmundim biblik ditë-netët i përcolla.

I vetëdënuar, gremisur honeve të asaj çmendurie të marrë,
të njëjtën artisje kam ndier, të fundosur nën përpjekjen,
i përgjakur shtegtova në funeralin e kohërave të zymta.
Unë engjëlli, që në djepin e dhimbjes përkunda vdekjen.

Braktisa ujqërit e mëdhenj, të kthehem përgjithmonë,
në tempullin tim të përzishëm, shtypur nën gërmadha.
Kokën të mbështes në shtratin e gërryer të një lumi,
portretin e ditëve të ardhme për ta thurur me kallëza.

Nën cicërima zogjsh dua të bëjë gjumin tim të vrazhdë,
me shokët e mi në një bar të dehem veç një herë me raki.
Prej malti gjer në palcë jam përvëlur për gurët e sokakëve,
se shpirti i zhuritur më ka mbetur për të bukurën dashuri.

skender iljaz braka

Ku Fshitet Vallë Rizgjimi?

Ku fshitet vallë rizgjimi?

Një i vdekur kam mbetur mes të vdekurve të pakallur.
Udhkryqeve nga endem humbas, si bish e trullosur.
Përpëlitjet e shpirtit ndjej, që më kafshojnë kujtesën.
Me shikim të ngrir thyej kupën, ku nata ka pllakosur.

I gjakosur nën pranga, në kulm të mëshirimit.
Gjer në palcë përvëlur prej zërit tim të ngjirur.
Për ëndërrat e pajetuara ndihem i burgosur.
Që kurrë s'ma panë dritën e shtegut të kalimit.

Nën helmime gjarpërinjësh ku flijohet njerëzimi.
Urija e vdekjes prehet në të njëtin varr me timin.
Varur në çengela shpresat për hapat e matura të lirisë.
Ndjellin kënaqësit e jetës, të mohuara nën tërbimin.

Valë gjaku më përvëlojnë damarët e mbledhur.
Dhe mbi altar të vdekjes më përpëlitet zemërimi.
Prej përbindëshit, që jetojnë mbi krime makabër.
I tmerruar ulëras, bërtas: "Ku fshihet vallë rizgjimi"?

skender iljaz braka

Ku Mund Ta Gjej Demonin E Arsyes?

Ku mund ta gjej demonin e arsyes?

Si e zeza heshtjegjatë e shpellave të lagështa.
E egra vdejke rrëzuar mbi bulevardin e gurt.
Pranvera e trëmbur prej dridhjes së qepallave.
Përsëri e frikur, si hije shtyhet e shtyhet nëpër muzg.

Aty do të mbeten tre gjakëra -mpiksur, të pathara.
Si përбетim i një toke që s'mundet të jap bukë.
Si një rënkim i thekshëm i çmëndurive të marra.
Prej marrëzisë së një klani të vdekur në kolltuk.

Pasigurisë së hidhur seç më trëmben të furishmet ëndërra.
Dhe djalli me ëngjëllin që flen brëndësis së godinës sime.
M'i vrasin e m'i përgjakin mendimet e kthellta.
Më tmerrësisht se vendimet e ashpëra të një giotine.

Ku mundem të ta gjej demomonin e kthjellët te arsyes?
Ku mundem të ta gjej përthyeshmërin e rrebelimit tim makabër?
Mbi dallgë deti kam mbire si nje lulkuqe e përgjakur shtërngatash.
Dhe i tillë dua të vdes mbi dallgëzimet e detit tim të kaltër.

skender iljaz braka

Ku Po Shkojm! ? ...

Prej lindjes gjer në vdekje..

Majë akullnajash të papushtueshme.

Hon i pafundëm errësire të pa zhbirueshme.

Melodi e mbytur për vesh të shurdhër është jeta.

Tabllora luftërash, krimesh, vrasjesh makabër,
grabitjesh e përdhunimesh.

Të gjithë gënjehemi sikur luajm në një teatër.

Drejtë së ardhmes ne shkojmë me frymën e urrejtjes.

Ditët tona nuk dim veç barbarisht të çnderojmë.

Nga njëri altar thërrasim në emrin e së vërtetës.

Nga tjetëri pa të keq injorojmë tiparet e vetvetes.

Ideollog të zellshëm predikojnë lirinë e planetit.

Horra e hajdutë drejtojnë timonin pa busull të shtetit.

I urti zë shuar struket në guackën e brishtë.

I marrosuri si kaposhi mbi plehë kërcënon me gisht.

Nën ritme muzike nderohet braktisa e prindërve.

Mes kafshimit të kohës zvogëlohet rritja e fëmijëve.

Të revoltuar dëgjojmë të njëjtat britëma kafshërimi.

Trupa të pa jetë humbasin pa asnjë vënd varrimi.

Me sy të agulluar ku venitet parakohe dritë e perëndimit.

Lumenjë të tërë mëkatesh vërshojnë mbi izobaret e zhvillimit.

I ndershmi përlyhet me vesin e lashtë të kurvërimit.

Vet kurvëria shënjtërohet si fitore e madhe njerëzimit.

Krenari e zhgënjyer përpëlitet nën kujen e përdhosur.

Ndërgjegjja digjet prej etjes në koma ballcamosur.

Pakica fluturon si në përrallat me qylimat hapsinore.

Të tjerë mbijetojnë në kushtet e varfërisë çnjerëzore.

Ngado ngjyrimet e ditës prej errësirës janë pushtuar.

Mosmirënjohës ndaj jetës, përherë në mungesë.

Të besdiisur prej punës, pa më të vogëlën shpresë.

Si foshnje përgëdhelur, prej hijes tonë të deformuar

Me plazma gjaku vetëm hakmarrjen kemi lartësuar.

Një vëlla në tregun e prostitucionit motrën shet.

Një palo burrë padrejtësisht gruan pret e vret.

Një qeveritar nën hijen e pushtetit terrorizon.

Vetëm një nënë në rrugë hedhur si një leckë e vjetër,

s'ka zemër dhe shpirt, pjellën bastare se mallkon.

Vetveten mashtrojmë me egon se kemi pushtuar gjithësin.

Nuk di nëse jemi ne të çmëndur,

apo koha prej nesh mori çmëndurin?
Ku po shkojmë me këtë turravrap të çfrenuar?
Engjëllin dhe djallin brënda shpirtit tonë kemi gatuar.

skender iljaz braka

Kujtome Nje Çast

Tani larg kam shkuar në një botë pa diell.
Endacak i lodhur me pak fjalë memece.
Një vetëtimë e beftë më vrau,
verbuar më hodhi në një rrjetë shumëfijëshe.
Në mijëra copëza të padukshëme ma thërrmoi
këtë jetë grindavece.

E di, dhe ti shumë ke vuajtur pas kësaj.
Dhe shpresa e pashuar të ka mbajtur gjallë.
E di, që një fjalë mallkimi
për mua kurrë se ke lëshuar.
Se ti vuajtjen e ke shtypur
si mishërat e athët nën dhëmballë.

Të falur të kërkoj me të vetmin lot në sy.
Që dielli se e ndriçoi e guri dot se theu.
C'ka mbeti prej meje në shpirtin tënd është thyer.
Siç thyeht prej belit një plisë i rëndë dheu.

Harrom e dashur si ëndërra e një mëngjesi.
Por një çast kujtomë me sytë e tu ëmbëlak.
Të lutem mos ngurro një ditë dimërit vonë.
Derën t'ia hapësh të përthinjurit plak.

Kujtomë dhe kur përjetësisht
natë e akullt t'më ketë rënë.
E nëse qiellit ngjitem si më i shuari yll.
E di se për ty një burrë i padenjë kam qënë.
Një copë kamë e pabindur kam qënë,
që s'di të futet në myll.

skender iljaz braka

Kur Kthehemi Nga Varret..

Mbi varre vëm lule.

Derdhim lot pikëllimi.

Ne që vijmë nga përbuzjet,
nga urrejtja,
zëmërimi.

Më pas mendueshëm kthehemi.

Kokëulur, si male të shtypur
prej peshës së hidhërimit.

Dhe nën heshtje themi:

- Çudi, si s' muarëm pak nga varret,
që njëri pas tjetërit rrinë ngjeshur

skender iljaz braka

Kur Me The Te Dua

Kur me the të dua

Atë buzëbrëmje kur me the " te dua."
Pa frymë dhe pa peshë mbeta një çast.
Në pentagramin e madh të hapsirës.
Valsin e Lumturisë, luaja si i marrë.

E mblodha botën të tërën në një grusht,
pështjell me aromën e dashurisë sime.
Atje mori trajtën e hapsirës së pafund
dhe ngjyrimet vezulluese të miliona yjësive.

skender iljaz braka

Kur Te Kendoja Serenata

Kur të këndoja serenata..

Nuk di në të kujtohet ajo natë embëlake.
Kur skutave të mia ti u fshehe me magji.
Në prrushin e buzëve të tua u dogjën të imat.
Nën psherëtima të mbytura e tëra humbe ti.

C'lakmonin zemrat tona atyre ditëve të majit.
Kur si dy binjak ne ngjasonim nën qiejt mavi.
Të kishim veç e dashur ca minuta më tepër.
Ca sekonda më tepër për të shtrydhur dashuri.

Unë isha i urti ushtar, ti mbretëresha ime ishe.
Në vënde të fshehura njëri tjetrin shtrëngonim.
Më shumë sesa toka me rrënjën ishim të lidhur.
E mbi flatra ëngjëllorësh hapsirave fluturonim.

Nuk mundem ti harroj ato netë të argjënda.
Kur serenata të këndoja, ty safire të mbinin në sy.
Në ato kohëra zgjimesh botën kisha brënda.
Mes miljarda yjesh, unë ylli më i bukur isha për ty.

skender iljaz braka

Kur Te Kthehesh Nje Dite

Kur të kthehesh një ditë..

Tani larg ke ikur....

Shumë larg nga bota ime.

Në të ftohtin shtrat, gjumi pse s'me zë?

Ti rishtaz më shfaqesh ndër vegime.

Të prehem, të dremis, përse s'më lë?

Nje ditë do kthehesh, unë e di.

Me një tufë mimozash do rendësh si e marrë.

Mbi shtratin tim, kur lehtaz të përkulesh,

çuditerisht do çirresh, do thërrasësh:

- Përse në duar, mimozat më janë tharë?

skender iljaz braka

Kur Të Kujtova Ty

Mbi dallgën e kaltër e ngriva shikimin,
prej klithmës sime një re bardhoshe u thërrmua.
Në mijëra copa coptova vetmin time.
E drithëruar heshtjegjata duarve më ngriu.

Me mall kujtimesh,
boçet e mbarsura të pishës plakë
rërës së thatë i rrëzova.
Gjatë prita me zjarrin e Olimpfit.
Stikat e pjekura të tyre,
në fjalë të pathëna mu kthyen.

Mbi buzë nisi t'më luhatej e para puthje.
Prej syrit, një sumbull loti mu këput.
Ra e u ngërtësua mbi faqen e ashpër
të një molusku.
Thellë zemrës mu derdh malli vjetër
dhe një copë qielli gri nër trup mu ngatërrua.

Kur të kujtova ty e dashur
Gjithë bota përparaa syve mu eklipsua.

skender iljaz braka

Kur Theva Nje Enderr

Kur theva një ëndërr.

Në një udhë të pafundëme çapiste hapi yt.
Ndjekur psherëtimash të gurta, të acarta.
Shikimi të tretej përhumbshëm në askund.
Buzëve të dridheshin veç ca fjalë të athëta.

Një pikëz loti të rrëshqiste ngadalë nën sy.
Në vesh të lëkundej vath i hënës së argjënd.
Dritë-hijet e shpirtit shfaqur vazhdimisht.
Si bulëza vese fluskonin tokës erë rëndë.

S'e kisha besuar kurrë ikjen tënde të pakthim.
Atij çasti e kuptova sa shumë të kisha dashur.
E nesëmja pa ty m'u duk e pakuptimt.
Si një direk thyer, mbetur bregut i përplasur.

Me iriqet e detit më ngjasonte mërzitia.
Thërrmohej lumturia perëndimit me re.
Atëherë e ndjeva, sa e rënd ish vetëmia.
Kur mes pikëllimit, në ikjen tënde më le.

I ngriva kujtimet e ditëve të shkuara.
Si koleksione bizhush i mbylla thellë në shpirt.
Me njëmijë klithma buzëdetit veten e qortova.
Jetës për t'ju kthyer me gjithë ëndërrat sërisht.

skender iljaz braka

Kur Thyhej Vjeshta....

Kur thyhej vjeshta....

Kur thyhej vjeshta,
nën një përzierje vaji dhe tingujsh,
mes pikëzave të fundit të shiut humbiste portreti yt.

Lot të dhimbshëm i pikonin qiellit zëmërak.

Si një pupëlz imcake mes dëborës së parë,
që kishte nisur të binte mi përvldheshe syve,
mes pyjeve gjetherënë duke shkuar larg e më larg.

Në dhomën time heshtjekallur,
një çirmë e dobët ngatërrohej mes librave.
Ngatërrohej mes rreshtave.
Ngatërrohej mes fletëve gjysmë të shkruara të poezive,
ashtu siç hynin e dilnim prej qënies sime,
tingujt e trishtuar e të zverdhur të vjeshtave.

Rrethuar prej unazash korale të diellit.
Tehut të mbrëmjes i vërtitej hija jote e bardhë.
Me ngurrime rresh të varura mbi pishnajë më ngjaje.
Më ngjaje me puhizën e gjelbër rrugëve të rrëgjjuara.
Më ngjaje me fytyrën time që përpara vegimit tën u ringjall.

Në sfoundin e diçkaje të papërcaktuar
kridheshin sytë e mi dhe kërkonin të gjenin.
Vallë ku ishe e ku fshiheshe ti?
Ende nuk mund të kuptoj se si heshtja pandalshëm
lëviz drejtë këtyre grykëvarreve të errëta.
Se ç'raport enigmatik ka me jetën, vdekja.
Di vetëm të them e dashur se për aq kohë,
ti ishe për mua madhështia dhe vet jeta

S'di pse të kujtova tani që po thyehet vjeshta.....

skender iljaz braka

Kurbatka

Kurbatka

Për tridhetë qindarka,
gjithe endrrat e mija ne nje lokal nate i shite.
Ne nje botik u qurrepse per nje copez bluze.
Buze nje trotuari minifundin grise,
per te joshur dike tjeter.
Ti Kurbatkë e lig,
pjellë e atij zakoni të vjetër.
Për tridhjet qindarka,
Me pluhurin e turpit mbulove qoeanet.
I zhduke qiejt dhe yllin polar.
Gjirizet e errëta bëre strehë.
Kurbatkë, kurbatkë e lig,
sa tepër më ke vrarë.

skender iljaz braka

Kurorë E Djegur Përmallimi.

Kurorë e djegur përmallimi.

Kurorë e djegur përmallimi më ke mbetur.
E humbur nëpër mjegull si një mantel i trandafilt.
Një jehonë e mpiksur në një degë peme të xhveshur.
Cucërima e pazëshme e i një zogu të brishtë

Në heshtje i mërmëris imazhit tënd të trishtuar.
Nën kujtime prej mallit përvëlues i mbërthyer.
Si përpara një ikone të mardhur qëndroj i gozhduar.
Pa e ditur se kaq shumë kisha për të vuajtur.
Pa pyetur se prej thonjesh të dashurisë,
shpirtin do ta ndjeja përjetësisht të robëruar.

Oh më e bukura kurorë e përflakur përmallimi!
S'dua ta besoj se prej teje jam ringjallur dhe kam vdekur.
Se një mëngjes pa diell i mbive zemrës sime
si petale shumëngjyrëshe trandafili.
Shpirtin dhe mëndjen çast pas çasti ma helmova
me nurin tënd të hirt e të paprekur.

Një kurorë e djegur përmallimi më ke mbetur.
Syri gënjeshtar i një hijeje të përndjekur

skender iljaz braka

Ky Djall Makthi

Nëpër grykat e thepisëshme të jetës ku shkoj.
Ndjej një shtrëngim të tmerrshëm të mendimit.
Një kular i ndryshkur rreth qafës sime të holluar
më bënë shpesh të rrënqethem prej një ankthi.
Me bindjen se s'do të marrë përgjigje veten pyes:
Përball cilit rrezik të papërcaktuar gjëndem?
Përse më kapëllon të tërin kjo frikë e ethshme?

Ky djall makthi nëpër një shteg të verbër më fut.
Në djall ky shteg i verbër ku s'mundem të dal dot.

Jetoj mes trupash të shqyer pa identitet.
Mes shikimesh përjetësisht të shuara.
Mes gojërash që përvaishëm ulërasin jetoj
dhe gjymtyrësh që shkazmës rrëshqasin.
Jetoj mes një deti konfliktesh si të jenë miljona
grimca rëre përfshirë në vorbullën e një uragani.
(Mes vorbullave të tij edhe unë gjithkund vërtitem)
Mes silueta vdekjesh çdo ditë jetoj,
braktisur si i vdekur prej kusarësh.

Ky djall makthi nëpër një shteg të verbër më fut.
Në djall ky shteg i verbër ku s'mundem të dal dot.

I përndjekur nga këto fantazma të frikëshme.
Ringjallem për të shkpëtuar prej tyre jetën time.
Jetën e shkelur prej hapash të njollosura,
që shkojnë mbi mua duke mërmëritur përçartur.
Mbi këto pirgje kalbëzimesh nga përgjumja ringjallem.
Diellin dua të shoh të më marrë në krahë.
Vetëm ai le të luaj me jetën time të nëpërkëmbur.

I lodhur nga prania e anktheve të 'kota'
Në dritaren time një grumbull pemësh shoh
nga era të valëviten në dritën e vetëtimave të forta

Ky djall makthi nëpër një shteg të verbër më fut.
Në djall ky shteg i verbër ku s'mundem të dal dot

skender iljaz braka

Lagja Ime E Vjeter

LAGJJA IME E VJETËR

Lagjja ku banoj, është ndër më të varfërat e qytetit.
Dikur mbuluar ish prej ujërave të kripura kënetore.
Këmbëzbathur varfëria përshkonte ngado ftohtësinë
dhe skamja, tërë babëzitje, gojët e uritura kafshonte.

Nën rrëbeshe shtrëngatash digjej botë e vogël e lagjes.
Koha interesin humiste prej shpresash zhgënjyer.
E mashtruara dritë nxitonte pas errësirës së natës.
Muzgjet na zinin dhe na linin mbi rrogos të shqyer.

Në zemër të kufomave më së miri njohëm dhimbjen,
nën sakrifica të përjetshme fatet e vdekura përcillnim,
nën lotët e gjakut fuqishëm na rrëzohej e ngrihej jeta.
Rrugëve të pafundme humbisnin shpresat e tretura.

Dhe pse çdo ditë rrënimin e trupit parreshtur kemi ndier,
kurrë s'e vuajtëm mospërfilljen dhe nemitjen e kujtesës.
Në lagjen tonë të varfër kish dashuri të pastër, kurdoherë.
Një frymë mirëkuptimi kish, me aromën e luleve të verës.

skender iljaz braka

Larguar Si Djali Prangprishes

Larguar hidhnueshem prej se njetes arsye.
Braktisjen zvendesuar teresisht me dhimbje.
Kacavarur dhe me sy lotuar si plangprishes.
Nje dite marsi te lash dhe une, ty vendi im.
Ne dremitje asaj dite lash te fjeturit e natyres.
Valet e detit te mbetura pa freski pranverore.
Lash rruginat e shtrenjat te lagjes ku jam rritur
Dhe te pangrohurat, shtroje te strehzes aterore.
Me vetedijen e ashper si ngricat e janarit.
Prej ethesh përveluar s'i mbyllja dot syte.
Shtrengata e ikjes ne gjoks perveluar.
Banor i mehalleve te botes me zgjoi nje dite.
Mbase e njejta plage mbeti ne trupin tend.
Nder vibrime muskujsh zeshem s'me mallkove.
Vdekjen prej bukurise lindur, qe joshjen s'ma kurseu.
Shembelltyren e enderres sime te trembur m'a shnedrove.
Humbur parajsa ne galeri te pafundeme kozmetike.
Ftohur prej tylit te nates ze shurdhuar.
Ne cdo pikezlotti ku mbinte nje renkim trishtimi.
Ty, vendi im me mall te kam kujtuar.

skender iljaz braka

Larte Ne Pyllnaje

Lart në pyllnajë

Prej flladit të pranverës dridhet lule kumbullës.
Nëpër muzg vështroj një shapkë që larg fluturon..
Mbi të thatat kreshtat kapërcen rrëpirë pas rrëpire.
Fluturimi i saj të kristaltin qiell prrushëzon.

Me nerving e gjakut tw burgosur zemra mw haron
Prej rrahjes së flatrave fryma buzëve seç më mpihet,
Ikën, ikën shapka e përhumur mal.
E mali mbi qerpikët e mi, hesht e zw e dridhet.

Ah, ç'mu ktheve në një bujtinë të verbër hidhërimi!
Në Nimfë gjethnajash me fërgëllimën e argjëndërimeve.
Një herë të vetme s'më fole me gjestet e tua të harrimit.
Bregores së lotëve s'i mbolle kalemata e tu tw ëndërrimeve.?

Më kot unë pres të më kthehesh përsëri.
Livadhit të të shoh si anija ankoruar tutje nw liman.
Me shfryrjet e tua të kobshëme të largësisë të më vish..
Me kalërimin e marrosur të qiparisave të fshikëlluara.

Sa kohë që s'të kam pare, e s'di nwse do tw shoh njw ditw
Sa vite sytë m'i qullën k'to përfytyrime zëmërake.
O beniaminia ime e bukur, O ti urejtja ime e ëmbëlake....

skender iljaz braka

Le Të Gënjejmë Veteen Me Dashuri

Le të gënjejm veten me dashuri

Iknin të gjithë asaj dite të trishtuar marsi.
Përmes të shtënash improvizuese iknin
Iknin, iknin, iknin me këngë braktisjeje,
si kënga që thatësirës së shkretëtirës humbet
nëpër duna e zeza sterrë të rërës.
Këngë e egër pa dimensione dhimbjeje,
pa përmasa të matëshme tragjedi.

Iknin të gjithë asaj dite të trishtuar marsi
me shkëlqimin e ndezur të shpresës në tehun e syve.
Tërhequr prej paqes me një fuqi të papërballueshme
Bregut nuk lanë sa edhe një hije vetmie.
Hypur mbi anijet fantazme që shkonin
mbi detin më të bukur të detërave.

Brava të vjetra dyerësh të rrënuara mbylleshin
Rrubineta çezmash të thara.
Pemë me sythe të pashpërthyer.
Rrugica dhe stacione urbanesh
villnin pikëllimin e viteve të përmbysura.

Iknin të gjithë me një braktisje fatale
Me vete duke marrë shijen e hidhur të kohëve të mohuara.
Veç unë me gruan time të dashur mbetëm këtu
si përfaqësuesit më autentik të ndërgjegjes
dhe shpirtit të një kombi mbështjell I tëri në të zi.
Ne që jetonim brigjeve të detit mbetëm.
Mbetëm si simbol i venitur i shpirtit të ftohtë e të përjetshëm.
Mbetëm si rojtarë të varreve të harruar.
S'gjejm këtu më asgjë me të cilën të flasim,
apo të gënjejm vetveten me dashuri...
Le të gënjejm veten me dashuri..
Le ta gënjejmë..
Le ta gë njejmë

skender iljaz braka

Lengu I Limonit

Lëngu i limonit...

Pikë, pikë pikon lëngu i limonit.
Në rrethin tim të dhimbjes hap rrathë valësh.
Si një kohë e ngurtësuar në një gur të stërmadh.

Mes rrathësh, bisqe të harlisur karafilësh priten.
Bien si zërat e vrazhët, që përgjigjen kërkajnë.
Bien në të njëjtët rrath ku asgjë s'pipëtinë.

Syri i honit dridhet prej tmerrit të lëngut të gjelbër.
Si në një dimër të mardhur,
gjithçka para syve të mi shkon përtej imagjinates,
ku veç lëngu i limonit kurrë nuk shteron

Në atë të pakët përhimtësi, që mbrëmja më dhuron.
Unë frymë e fundit të shpresës mbaj mbi brigje lotësh.

Dhe njëherë mundimshëm risillem nëpër Këto rrathë flakësh.

Dhe një herë në majë të gishtërinjëve
do të kridhem në këtë det të gjelbër.
Pa arritur të kuptoj pavërtetësitë e jetës.
Pa mundur të shpreh atë ç'ka kam dashur të them,
si vullkan shpërthyer prej thellësive të zemres.

Pikë, pikë pikon lëngu i limonit
në rrethin tim të dhimbjes.
Në rrethin tim të dhimbjes pikon, pikon.
Pikë.....Pikë pikon.....

skender iljaz braka

Lërma Zemrën Të Fluturoj

Lërma zemrën të fluturoj

Lërma të fluturoj kjo zemra ime.
Ashtu siç di të fluturoj një fajkua.
Hapsirave dhe ti do të ripërtërihesh.
Si ujërat e pyllnajës që gurgullojn në krua.

Puthëmi këto buzët e zhuritura e dashur.
Dhe në frumëmarrjen tënde gjatë më ruaj.
Mbi krahë më merr i vdekur të mos bie
viktimë e pafajshme përpara syve që dua.

Gjithë erërat e globit për ty unë i thitha
Dhe shiut vjeshtak i vura flakët e zjarrit.
Së largu duke të vështruar qaja me ulërima.
Si duke shqiptuar emrin tënd buzë varrit.

Në shtegun e paçar ku ti do të ngjitesh.
Domos do të gjesh një zemrë të thërmuar.
Atje do të jem unë vezulluar përms yjeve.
Mes dritës gjelbëroshe të hënës së praruar.

skender iljaz braka

Letër Tim Biri.

Kënaqu rrezes së diellit biri im.
Kënaqu pikëzës së shiut,
fërshëllimës së athët të erës.
Kënaqu valës së bukur të detit
dhe aromës së blirit.
Pranoje në ball bulëzën e bukur të djersës.
Dhe etjen e buzës prej zhegut pranoje.
Vetëm njerëzit...
njerëzit kurrë mos mendo ti përbuzësh.
Dhe atij që vrëngër nëse i ndodh të të vështroj,
zgjati dorën e ndershme të mirësjelljes..
Kënaqu bir prej prurjeve të bukura tw jetës...

.....

skender iljaz braka

Leter Mikes Sime

E dashur mikja ime

Sot më erdhi me postë libri juaj i fundit. Nuk më kishe thënë dhe as më kishe shkruajtur. Ty gjithmonë të kanë pëqyer surprizat dhe kjo ishte një surprizë e këndshme dhe tepër befasuese. Gjithmonë kam provuar një kënaqësi të veçant kur merrja libra prej miqëve të mi. Rëndom, në kësi rastesh njeriu përjeton ndjesi dhe kënaqësira të tilla, që rrallëherë i qëllon ti provojë në jetë. Kur më thanë se duhet të firmosja në një letër, ende nuk më besohej se ju më kishit dërguar diçka. Firmosa pa hezitar, mora në duar pakon, falenderova dhe pasi u zbytha disa hapa pas, e hapa pakon ku ti kishte mbështjellë librin tënd. (që ishte libri i katërt që ju kishit botuar dhe unë kisha qënë pjesmarrës në të katër promovimet e tyre) dhe pasi i hodha një sy, e lëshova ngadalë mbi tavolinën time të punës mes qindra fletëve dhe librave me të cilët unë punoj përditë. Jam ca i rrëmujshtëm, por dreqi ta hajë, kështu qënka gatuar ky soji yn që merret me shkrime. E lëshova aq ngadalë si të ishte një gotë kristali, të cilës i frikësja se mos e thyjeja. Të falenderova në heshtje mikja ime për respektin, kujdesin dhe vëmëndjen që tergove edhe në këtë rast dhe më pas, mbase i shtyrë edhe prej një ndjenje shfajsimi, pendese, apo më tepër, si për t'u çliruar prej një brengje, të cilën e kam mbajtur përbrenda që prej ditës që ti botove librin tënd të parë, u ula për të shkruajtur këto dy-tri rradhë. Të lutem, bëhuni e duruar dhe lexojeni deri në fjalën e fundit këtë letër! Natyrisht, e di se që në krye kjo letër do të duket e pabesueshme dhe, gjithçka që do të lexosh më poshtë ka për të të ngjarë si një krismë rrufeje në një qiell të pastër.

Mbase do të duket edhe e habitshme. Mbase, ku ta di..... Ka do kohë që letrat kanë dal disi jashtë mode, por mua si krijues dhe juve ca më shumë si një e tillë, e dimë dhe e ndjejmë se asgjë më shumë se një shkrim në letër nuk ta zvëndëson kënaqësinë dhe të përjetuerit të emocioneve që të jep një e tillë. Kësisoj kam bindjen dhe besimin se keni për t'i kushtuar vëmëndjen dhe interesin e duhur. Dua të them që ndodhka në jetë që njeriu për ç'arsye të pa justifikueshme arrin të përbuzë dhe të urrjej edhe njerëz me të cilët prej një kohe të gjatë e kanë lidhur qëllime dhe ideale të njëjta. E them këtë se edhe ne, prej kaq shumë vitesh njohje kemi qënë dhe vazhdojmë të jemi miq të mirë dhe ty, që kurrë ndonjëherë nuk e ke paragjykuar qëndrimin dhe sjelljen time, do të duket krejt e habitshme, madje pse jo, edhe si ndonjë lajthitje imja e çastit. Por besomë, unë po të shkruaj gjithçka që ndjej, gjithçka që më ka munduar dhe që vazhdon të më të shkruaj, sepse nuk po mundem më të përballoj ndjenjën e fajësisë, që po më grryen përbrënda më tepër seç më ka brejtur dhe grryer ajo ndjenjë xhelozie ndaj krijimtarisë tënde.

Kur unë nisa të publikoja krijimet e mia në njërin prej rreteve sociale, ti ishe ndër të parat që më nxisje dhe më inkurajoje të mos i shkëputesha kësaj rruge të

bukur dhe më motivoje të isha përherë e më shumë në kërkim të vetvetes. Fal disa aftësive të mia, unë kisha arritur të gjeja një mënyrë timen për t'iu imponuar miqëve që të më komentonin. Çuditërisht talentin tim kisha nisur ta masja jo me cilësinë e shkrimit më tepër se sa me numërin artificial të klikimeve e, kësaj nga ky shkak, pak nga pak si pa kuptuar po niste të më pëlqente vetja prej përgëdhelive të miqëve. Mbushesha me një ndjenjë vekënaqësie dhe euforie aq sa ngandonjëherë më dukej sikur unë isha shkrimtari më i mirë në botë. Pas çdo skice, portreti apo tregimi që ti më lexoje, gjeje kohë dhe më shkruaje se unë i njihja mirë kërkesat e prozës dhe se gjeja tema interesante krejt të zakonshme dhe i shndërroja me fuqinë e artit në të jashtëzakonshme. Ti as që e merrje me mend se sa krahë më jepnin këto fjalë dhe m'a përforconin bindjen se në një ditë jo të largët, gazetatat do të mbushnin faqet me shkrimet për mua dhe se ekranet e televizioneve do të çaheshin prej portretit tim në studiot e tyre. Për ditë e më shumë më dukej sikur po shkëlqente ylli im, i cili përveç kënaqësisë së madhe shpirtërore, ishte edhe një lloj sfide për gjithë ata që më kishin sulmuar, ose më keq, kishin shfaqur nihilizmin e tyre ndaj krijimeve të mia.

Deri ditën që ti nuk e kishe botuar librin tënd të parë dhe, unë të lexoja me kënaqësi dhe ëndje nëpër faqet e internetit, ti ishe për mua jo vetëm një krijuese e mirë, por edhe një mikeshë, një njeri që dije të falje kurdoherë mirësi dhe dashamirësi. Ishe një grua fisnike, që për një pjesë të madhe lexuesish dhe dashamirësish, u ktheve në një pikë referimi, në një burim frymëzimi, një shënjtore e pa shënjtëruar. Singërisht, deri asaj dite, as që më kishte shkuar nëpër mend se do të ndodhte kështu me mua. Dhe pse asaj dite kur ti porsa kishte nxjerr nga shtypi librin dhe kishe hedhur nëpër faqet e rrjeteve sociale kopertinë, atë kopertinë, e cila më dukej sikur ajo m'a kishte të gjithë fajin, unë të shkuajta dy fjalë përgëzimi. Po, po, më kujtohet si sot. Të shkruajta vetëm dy fjalë dhe më në fund pas tyre...Urime, përsëri seç ndjeva thellë vetes. Ty mbase nuk ta vrau syrin komenti im i ftohtë dhe i thatë. Ndoshta vërtetë kishe dashur që unë të shkruaja diçka më shumë, diçka që më shumë se sa një përgëdhelje sedre, diçka që të kishte formën dhe brendin e një reçence të shkurtë. Fakti që ti nuk më the as edhe një fjalë dhe nuk më krijove mundësinë që unë të hamëndësoja të kundërtën, më bëri të mendoja se ti kishe ditur me atë mënyrën tënde ta anashkaloje pa më rënë fare në sy. Por vetëm tani po u'a them; nuk më bënte dora të shkruaj gjatë, ashtu sikurse të kisha shkruajtur në ato dhjetra e qindra krijime. Nuk më bëhej të shkruaja më në krijimet e tua komente, në të cilat ti nuk nguroje të më vlerësoje, jo vetëm për singërtetin, por edhe për profesionalizmin tim. Pas ca kohe e ndjeja se nuk e kisha më guximin të vështroja më fotot e tua. Ashtu, ditë pas dite vëreja me keqardhje se po më humbiste dëshira për të lexuar qoftë edhe një rresht të vetëm nga krijimet që ti publikoje.

Ngandonjëherë më erreshin keqazi sytë, kur shihja të rritej maksimalisht trendi i fansave të tu, të cilët të ndiqnin dhe të komentonin me fjalë shumë të bukura, aq

sat ë krijonin përrshtypjen se ti ishe me të vërtetë në zenithin e krijimtarisë tënde, ndërsa mua më dukej sikur gjithë krijimtaria ime po përjetonte atë muzgun e vonë, që vetëm një zot pret dhe shpreson se diku do të shfaqet një rreze e ftohte diellit.

Nuk mund të qëndroja dot në një vënd, madje as të thërrisja prej hidhërimit të madh që më kishte pllakosur. Ndofta as vet ti nuk ke për t'i besuar këto që do të shkruaj, por besomë kjo është një e vërtetë që mua më ka rënduar prej kaq kohe. Rëndomë mundohesha ta zotëroja veten, por nuk arrija vetëm sa të shfaqja përpara teje vetë maskën time, dhe atë pak pjesë të padukshme fytyre, pasi gjithë pjesën tjetër të fytyrës së vërtetë, sepse e ndjeja sikur nuk ishte më i imja, por e tjetërkujt. E ndërsa ditët shkonin dhe unë vëreja se ty po të vinin tashmë urime nga mediet e ndryshme dhe prej një numëri gjithnjë edhe më i madh krijuesish nga të gjitha anët, nuk doja ta besoja atë që fytyra jote po më dukej krejt e huaj, një fytyrë që merrte përherë e më shumë një shkëlqim mahnitës. Po hyja gjinjë e më thellë në krijimet e tua për të gjetur atë që ty të bënte të lexueshme, që ndërkohë mua më mungonte. Ndihesha i fyer që ti ishe kthyer në pushtuesen më të madhe të faqes tonë në fb. Kisha nisur të urreja prej xhelozisë, e cila sa vinte dhe me bëhej gjithnjë edhe më e madhe ndaj teje. Nuk doja t'ia pranoja vetes që ti shkruaje më mirë se mua dhe se kishe botuar një libër, një libër fizik, jo një libër virtual. Dhe pse nuk fole asnjë fjale për veten tënde, përsëri mua më dukej sikur ti më sfidoje çdo ditë e më shumë me krijimet e tua. Ti nuk e kuptoje se ç'mllëf më ndizej pas çdo sukse si tëndit. Ti nuk e kuptove as asaj dite kur ne u takuam dhe ulëm në bar për të pirë një kafe, se sa i tensionuar që ndihesha, se sa të ngadalta m'i bënte minutat prania jote, megjithëse çuditërisht kisha një dëshirë të ethshme të qëndroje sa më gjatë pranë meje, sepse ti kishe vërtetë diçka tënden në mënyrën e të komunikuarit, ku pas çdo tingulli të zërit, mbetej një çiltërsia e një fytyre e një krijuese fisnike. Ditë më pas me mendimin për të sfiduar vendosa të bëja diçka më ndryshe. Në ndonjë rast u mundova të të imitoja, por edhe vete e kuptoja se nuk ia kisha arritur atij qëllimi të dëshiruar. Pastaj i nxitur prej kushedi se çfarë ambicije apo egoizmi cinik, tentova të të kopjoja, por as në këtë ndërmarrje nuk pata sukses. Kësisoj, ndërsa ti ngjisje shkallët e suksesit tënd, çuditërisht po vazhdoje tu errësoheshe gjithnjë edhe më shumë syve të mi. Një mend mendova se suksesin tim do ta gjeja tek poetët e huaj, tek ata që nuk jetonin më dhe nxitova të gërmoja nëpër faqet e internetit. U mundova të bëja diçka, por edhe nëpërmjetë kësaj rruge nuk arrita të ngrihesha mbi nivelin e krijimeve të tua. Rëndomë, pendohesha që e shëmtoja aq keqas fytyrën time, por isha i pafuqishëm për të bërë ndryshe përpara pa aftësis sime krijuese. Më vinte të haja veten me dhëmbë nga nervozizmi dhe më keq akoma më vinte turp ta pranoja dështimin. Hera herës i bija tavolinës me grusht dhe dilja nxitimthi në kopështin me lule për tu shlodhur apo qoftë edhe për të larguar ty nga mëndja. Nuk doja të ishe më pjesë e mëndimeve të mia, sepse më dukej sikur padashur ti ishe kthyer në një

pengesë serioze e rrugëtimit tim, sikur krijimet e tua po më eklipsonin përditë e më shumë.

Oh sa e vështirë qënka të besosh e mandej të pranosh sukseset e mikut tënd. Nuk paska gjë më të tmerrshme se kjo për një njeri që merret me letra. Kurrë nuk m'a kishte marrë mëndja se tek mua do të ngrinte krye dhe të të shpërthente një egoizëm i tij i shfrenuar ndaj kolegëve të mi e aq më shumë ndaj jush. Kur pas ca kohësh ti dole me romanin tënd të bujshëm, kjo më irritoj edhe më shumë. M'a nxiti edhe më shumë urrejtjen ndaj teje. Nuk më zinte vëndi vënd. M'a bëri xhelozinë ndaj teje më të papranueshme edhe më të papërmbajtshëme. Më dukej sikur ti më kishte marrë muzën dhe më kishte hedhur si me magji farën e shterpërimit. I irrituar prej ecurisë dhe sukseseve tuaja të vazhdueshme, vendosa të të harroja, të të mbaja larg miqëve të mi. Kërkoja që ata të mbeteshin të fokusuar në lavdin time të dikurshme dhe pse po e kuptoja që kësisoj po shteroja çdo ditë e më shumë, se po i bëja Copy Passe vetvetes....Po çmëndesha në një farë mënyre...besom.. nuk kisha ndjer kurrë në jetën time gjë më torturuese se kjo xhelozia, që edhe netëve më kridhte në një lloj zbrazëtie të pafundëme torturuese. Nuk më ngushëllonte më asgjë, madje as edhe ato fjalë të ngrohta që më tha një mikeshë ime gazetare, se kjo është një dukuri që shfaqet tek të gjithë brënda llojit. Tani po t'i shkruaj këto radhë, sepse dua të mbetem i singert jo vetëm përpara teje, por edhe përpara gjithë miqëve të mi...Nuk dua që askush të më paragjykoj. Ju uroj sinqerisht suksese në rrugën tuaj dhe, duke ju kërkuar edhe një herë ndjesë.

skender iljaz braka

Leter Tim Biri

Letër tim biri.

Kënaqu rrezes së diellit biri im.
Kënaqu pikëzës së shiut,
fërshëllimës së athët të erës.
Kënaqu valës së bukur të detit
dhe aromës së blirit.
Pranoje në ball bulëzën e bukur të djersës.
Dhe etjen e buzës prej zhegut pranoje.
Vetëm njerëzit...
njerëzit kurrë mos mendo ti përbuzësh.
Dhe atij që vrëngër nëse i ndodh të të vështroj,
zgjati dorën e ndershme të mirësjelljes..
Kënaqu bir prej prurjeve të bukura tw jetës...

.....

Qershor 1998

skender iljaz braka

Lipotemi Shtazore...

Përmes ajërit të ndotur,
grabitqarë të ethshëm,
të rritur nën intriga,
të coptuarat mushkri të mijat mësyjnë.
I brejnë.
Pamëshirshëm i kafshojnë.
Gjakun tim të mpiksur,
nën kënaqësit mizore thithin dhe pështyjnë.
Unë ashtët e mi, për të përballuar mbijetesën,
si në natë pa hënë, pak e nga pak,
nën nofulla të mpira prej dhimbjesh thërrmoj.
Lirinë e përndjekur thërras,
të humburat shpresa shkretëtirave të djegura të vobektësis.
Në grushte helmin vdekjeprurës të jetës mbledh,
Siç mbledh lypsari rrezën e pashuar të dritës,
luginave të akullta të lumturiisë.
Oh, tragjedi e trazuar ulërimash!
Ti që transparencën e dritës pret me shpirt të tronditur.
Ecja nën dhunim asnjëherë nuk mundet të buzëqesh.
Veç një lutje e dëshpëruar lartësohet
qiejve të pafundëme të sakrifikimit.
Lipotemi shtazore, egërsisht e goditur.
Në mëndje më mbetesh një kujtesë e vazhdueshme
që buçet e tronditur.

skender iljaz braka

Loja E Dashurise

Loja e dashurisë

E bukur ishte loja jonë e dashurisë.
Më e bukur se loja e fëmijëve koka-mshefta.
Cuditërisht ti dilje përherë e fituara
unë humbësi, që të ndiqja ngaherë,
asnjëherë nuk të gjeja. kudo ku fshiheshe,
kudo ku ti ngrije prita të mëshefta.
Ndodhi një ditë, përmes shiut të vjeshtës më humbe.
Erë dhe litarët e shiut i mblodha në një grusht.
I dagja retë e ngashërueshëm nisa të të qaja.
Udhë pa pa udhë ulërita me emrin tënd në buzë.
Kërkund nuk të gjeta.
Fytyrën e butë me gishtërinjë më kurrë se preka.
Dhe pse u dogja i tëri në zjarrin që ndeza.
Rëndomë unë zgjohem me shikimin nga dera.
Me mendimin se ti pas saj qëndron përgjithmonë.
Nën një pritje të akullt zemrën time mbajta hapur.
Ndjesi se kjo lojë vazhdokërka kaq gjatë sa dhe jeta
dhe përtej saj kur shpirtërat tanë të flenë në amshim.
Unë me ty unë përsëri do të nis të luaj kuka- mfshefta.....
Ah, e dashur! Ti një ëndërr më mbete në mend përgjithmonë,
Si ledhatimi dhe puthja e parë nën një muzg të përhimtë.
Si një ëndërr transparente, shkruar mbi një copë letër,
që vet zemra ime e quajti atë të çmëndur.
Lojën tone nuk të harroj dhe përtej përjetësisë.
Nuk do ta harrojë këtë që ti vet e quajte një ëndërr.
Nuk do ta harroj... nuk.. nuk...
dhe kur të mendoj se ti po fle me po këtë lojë në zemër.

skender iljaz braka

Loti I Engjellit Dhe Loti I Djallit

Loti i engjellit dhe loti i djallit.
Nje dite dimerore ne qiellin gri,
frikshem u perplasen.
Vetetima, si flaket e Zeusit
mbi toke u leshua,
per te humbur ne shtratin e boshatisur te saj
Si zogj te goditur lotet u shkeputen
dhe rane mbi pircje balte te thate,
aty ku dikur bozhuret kishin lulezuar.
Dikush i shtypi mesnates se çmendurise
time imagjinate shkaterruar.
Dikush i ngjeshi ne thellesi
per te mbetur perjetesisht te harruar.
Trembur tmerrit te nates se ftohte.
zgjuar ne gjumin tim te thelle
dicka davaritej mbi ate shtrat te boshatisur.
Hamendesuar ne miljona versione
nuk di perse te ndiqja harbuar,
o ikone, e xhveshur, pothuajse e tjetersuar.
Lotet valle perse nuk i shoh te tretur?
Me erdhi mire qe nje dite te pash atje
me nje tufe karafilash ne duar
ndersa une ne udhen time i vetem
bozhuret e a,
shtratit te shkaterruar.
Loti i engjellit dhe loti i djallit,
rrenjet kane thelle shpirti te trishtuar

skender iljaz braka

Loti I Kurbatkës

Loti i Kurbatkës

.....dhe ajo më pyeti:

- A ta zuri syri ndokund kurbatin tim zeshkan?
Si lisat e gjatë të Shelegurit ish i ngrati.
Mustaqet i nxinin gjer maj Vojskovarit.

Karvani i tij thonë se përtej Danubit humbi.
Ku si valë dritash të zbehta bien e lëpihen kreshtat.
Më thanë se mbeti shkrepave të hirt të Kaukazit.
Andej nga ku brodhi me vetmin e tij të frikshme.
Si skifteri mugëtirës pa diell, shtigjeve të verbërta.
Lullën prej shqope duke mbajtur buzëve të çara
E bashk me të dhe këngën e tij të fuqishme.

.....dhe më tha ngadalë:

-Si sot më kujtohet puthja e tij e parë.
Me gjethe fieri ngritëm shtrat buzë Devollit.
Prej natës, me dritën e kuqërremtë të yjeve u mbuluam.
Ja atje...Atje më vërviti dhe më shqeu,
siç shqyen luaneshën e tij, luani i zi i savanës.
Për hërë të parë ndjeva se ç' do të thotë prekje.
Prekje më të nxehtë se metali në prrushin e farkës.

Përmes ngazëllimit të tokës e të lumit më iku.
Kur dielli qepallën e rënduar shkundëte mbi muzg.
Iku me betimin për besnikëri gjer në varr.
Tek përpiqesha t'ia fshihja lotin syve të tij të gurt.
Fryma, fytit tim të ngjirur, m'u tha dhe e m'u këput.

Magjia e tij shekull pas shekulli nga pas më ndoqi.
Duke më lënë të pangopur si shkretëtira për ujin.
Mbrëmjeve barkun ndjeja t' më rritej dalëngadalë.
Dhe trishtimin e përhumbur që të tërën më dogji.

.....dhe ajo më pyeti:

- A ta zuri syri ndokund kurbatin tim zeshkan?
Si lisat e gjatë të Shelegurit ish i ngrati.

Mustaqet i nxinin gjer maj Vojskovarit.

Karvani i tij thonë se përtej Danubit humbi.
Ku si valë dritash të zbehta bien e lëpihen kreshtat.
Më thanë se mbeti shkrepave të hirt të Kaukazit.
Andej nga ku brodhi me vetmin e tij të frikshme.
Si skifteri mugëtirës pa diell, shtigjeve të verbërta.
Lullën prej shqope duke mbajtur buzëve të çara
E bashk me të dhe këngën e tij të fuqishme.

.....dhe më tha ngadalë:

-Si sot më kujtohet puthja e tij e parë.
Me gjethe fieri ngritëm shtrat buzë Devollit.
Prej natës, me dritën e kuqërremtë të yjeve u mbuluam.
Ja atje...Atje më vërviti dhe më shqeu,
siç shqyen luaneshën e tij, luani i zi i savanës.
Për hërë të parë ndjeva se ç'do të thotë prekje.
Prekje më të nxehtë se metali në prrushin e farkës.

Përmes ngazëllimit të tokës e të lumit më iku.
Kur dielli qepallën e rënduar shkundëte mbi muzg.
Iku me betimin për besnikëri gjer në varr.
Tek përpiqesha t'ia fshihja lotin syve të tij të gurt.
Fryma, fytit tim të ngjirur, m'u tha dhe e m'u këput.

Magjia e tij shekull pas shekulli nga pas më ndoqi.
Duke më lënë të pangopur si shkretëtira për ujin.
Mbrëmjeve barkun ndjeja t' më rritej dalëngadalë.
Dhe trishtimin e përhumur që të tërën më dogji.
skender braka

skender iljaz braka

Lugina E Lotëve Të Mi...

Lugina e lotëve të mi...

Nxituar verbërisht pas të njëjtës hije,
që ëndërrat m'i trazoi një buzëmbremje vere.
Teksa dielli përflakej tutje perëndimit.
Hedhur ndjesite fluide si pa te keq mbi duna rëre.
Cdo ditë i mbyllur përbrënda në vetmi.
Mërmëris të pashprehurat fjalë, tkurrur prej trishtimit.
Qëndroj atje ku s'më sheh e s'më flet njeri.
Dridhur si purtekë nën monolorun e flladit të agimit.
Lugina e lotëve të mi mjegullueshëm mbuluar.
Prej ikjes tënde i mbytur dëshpërimit.
Ti lagothem atij stresi s'kam mundur kurrësesi.
Kurrësesi s'kam mundur t'i shpëtoj lëndimit.
Jetën gjer në prag varri për ty kam dërguar.
Mbërthyer kthetrash dhëmb shpirti im.
Braktisja, si i përskuquri hekur më ka shoqëruar.
Zhgënjyese ka mbetur ënderr e rikthimit.
Lugina e lotëve të mi që s'patën të shteruar.
Lënguar ndër vite si ulkonja brinjësh thyer.
Mes britmash të ashpëra të dimrit të trazuar.
Dhimbjen kam përcjell mes dënesash fuqi grryer.
Te rilindurat shpresat më përgjërime i ngroha.
Mohuar s'të kam patur kurrë në të vërtetë.
Dhe pse zemrën si kripa në zjarre m'a ke plasur.
Shpirtit i kam thënë - gjithmonë shpreso, në k'të jetë.!

skender iljaz braka

Mall Per Detin

Buze detit kam qendruar.

Mermer i bardhe, vetmitar.

Me nje vale shpesh meditoj.

Une biri yt

mergimtar.

Tash larg te kam e dot s'te prek.

Krelat s'mund t'i ledhatoj.

Me mungon aroma jote.

E bukura vash qe dashuroj.

Me mungon blegerima,

zog i

bukur maje lisit.

Uji i kroit lart ne

shpate.

Me mungon dhe vlage e plisit.

skender iljaz braka

Mallkuar Per Jete...

Të mallkuar për jetë të jetëve!

Oh ti frikë befasuese e ethëshme, ngréçmbërthyesë.

Përse më kapëllon me

llahtarinë tënde të mistershme?

O ti frikë e së nesërme që s'dita kurrë të të josh!

Largohe prej ditëve të mia fytyrë tënde të papërgjegjshme! Këmbanat e kobsh
ëme përsëri lëshuan thirrjen e vdekjes.

Sot një tjetër viktim prej krimit makabër u viktimizua.

Toka përsëri u përskuq e prej gjelbërimit të pemës

sot një tjetër gjeth para

vjeshtës së moçme u rrëzua.

Pejsazh i shtangët me dhimbje therëse na mbështolli,

Si me tantellën të zezë të një

fantazëme të përbindshëme.

Koha një qivuri të paprekshëm dhe një herë i përngjau.

Gravurë horrorësh pikturuar sfondeve të saj të përzishme. Një kokën lart e sytë
e mi kapriçioz ngulis drejt qiellit.

Shqetësimin riformuloj se si mund të shkohet tek besimi.

Sepse këtu

të vitesh e të pritësh s'përbën ndonjë tragjedi.

Se këtu qirinjtë e

varreve s'do të shuhen kurrë nga lëngimi.

Krimi gllabëruese që godet me flakë të pamëshir

shme.

Hije

që hijen pas këmbe ndjekin e tutje përngazëllohet.

Të mallkuar për jetë të jetëve qofshi ju

që i shënjtëroni!

Që trupin e shoqërisë si mola drupalburin e lini të brehet.

Se ngaherë prej të korruptuarish vrasësit përgëzohen.

Në emër të vet jetës e zotit i

japin përjetësi barbarizmit.

Dhe një herë në jetë të jetëve ju të mallkuar qofshi!

Ju që krimin dhe

kriminelët vini në altarin e shënjtërimit.

skender iljaz braka

Mangesi Tolerance

Mangesi tolerance....

Kohe e perveluar per transformime.
Coptuar madhesish pambarimisht te vogela.
Prej fatalitetit te mangesis se tolerances,
segmenteve te paemertuara te gjallojne ndasit.
Lemshenje zjarresh levizin traversave te deformatuara,
ndonse per te tjera ndryshime syri yt perlotet.
Therrmuar zemra prej lindjesh hibride.
Kecqtrajtuar prej dhunes drita jote mekotet.
Ferri serish i rrenqethur prej ulerima vdekjesh.
Mbetur zeri yt i mekur prej te tjerave ndeshkime.
E shurdhuar prej zhurmes ne podiume vemjesh.
Toleranca në sy te te gjithëve tretet ne miljona krime.
Pafajsi e djegur mes flakesh perveluese.
Jeten zvarrit ne te njejtin lengim.
Heshtja perpelitur nen mijera kembe te zbathura,
prej honeve te erret ngrihet me te vetemin mallkim.
Mangesi e tolerances, qe kesaj kohe i shfaqesh.
nen zyrtesine e luhurosur te degradimit.
akullnaje e mbijeteses shkrirë prej mangesise tende.
Diteve te shkallmuara, mendimin mbyt prej deshperimit.
Pjell e te tmerrshmes mani e persekucionit total.
Gjakderdhjen trashëguar ne shekuj, shtyn e vendosur.
Vraga thellon nen pameshirshmerine e arrogances.
Besimin rrezon, me forcën e eres se marrosur.
Mes flakeve te mundimit dhe nje here do te ngrihem.
Udheve te humbura me nje lutje te pangushelluar.
Prej mungeses se tolerances, qe shteron energjite,
Nuk dua perjetesisht te mbetem i denuar...

skender iljaz braka

Marsi I Trisht

Si ndodhi fillimisht s'e mbaj mënd,
Kujtoj një det të trazuar njerëzish
në një mot të trisht.
Në një mot pa mot, humbur përjetësisë.
Kalatat përpinin me zhurmime akualiptike
dhe moli i plakur digjte vegimet e pafundësisë.
Dridheshin gjymtyrëve të mija gjithë djajtë e marrosur.
Mbi ca dragonjë të mëdhenjë këndoheshin këngë magjike.
Mes ulërimash shkonin, nën mërmërimat e kodit
të urdhërave të përnatëshme.
Vidhisur kohërave të herëshme biblike.
Mes atij deti njerëzish lundroja dhe unë.
Shashtisur prej një nxehtësi joshëse të ferrit,
pa përfillur fatkeqesitë e tmerrshme.
Mes një reje pluhuri imagjinoja parajsën e kozmosit
dhe udhë të shtruara me shkëlqim të mermerit.
Pastaj një Karaka direkthyer,
me cima të copëtura prej marrëzis së largimit.
Zhytur thellë detit të trazuar me një stuhi rënkimesh,
duke notuar ne ajerin e stuhise,
i mbytyr në pusin e thellë të braktisjes.
Larg, vetëm një dritë pulsonte.
Si i veti dëshmimtar i ditëve të rrëmetit.
Ishte fari ngritur mbi kodrën mjerane të qytetit.

skender iljaz braka

Martirizimi I Prometheut

Martirizimi i Prometeut.

Kryqëzuar majë shkëmbit të bardhë,
ti mes dhimbjesh rriteshe,
ndizeshe flakadan.
Drithmat e trupit, të përgjakurat gjymtyrë
tokës së lagësht ia përcjellin...
Mbi qepallat e pagjumëta vallen e vdekjes hidhte era.
Vetëm flokët e tu të gjatë, si klithma mes vetëtimash,
putheshin me rrufetë që ndiznin detërat.

C'brenjë shpirtin ta brente Promete!
Prej ç'krenarie, zjarri shpirtin ta dogji
dhe zogu i mbretëris së qiellit, zemrën ta coptoi?
Cila flakë përvëluese shikimin ta ndriçoi
dhe padurimin ta treti, me pandehmën
se zjarrin i pandershmi ta vodhi?

Deri në vdekjen tënde të ngadaltë,
i kryqëzuar mbete Promete.
Rrebeluar prej padrejtësish.
Sulmuar dhe grryer prej hajnish.

skender iljaz braka

Mbase Nuk E Dinte...

Mbase nuk e dinte se unë nuk doja
të bëja tregti me shpirtin e saj.
Ngatërruar me errësirem iku.
Nuk e di ku shkoi...
Mes një pylli ëndrrash më humbi,
duke më lënë vetëm me magjepsjen
dhe pakuptueshmrin e një hidhrimi shqetsues.
Nimfën e kalëtr që prej valëve më vinte e fuqishme
si ulërima e singertë e dëshpërimit.
Kurrë se pata prekur e takuar më parë.
Prë mua ishte pjesa më e madh e jtës.
E panjohura dhe forca fatale
dhe unë pjesa tjetër që nuk dita kurrë buzë t'ia freskoj.
Askush si ajo gjuhën time të heshtjes nuk e ka kuptuar.
Ngaherë më shfaqet turbullt nëpër ëndërr mirazhi saj, .
Leshrat e verdha me aromën e lules së kumbullës.
Nuk e di nga më iku e ku shkoi.
Nën ç'rrjedha lumenjësh u shua zjarri i shikimit
të palëvizshm të atyre syve prej statuqe mermeri?
Nuk di ku i humbi tingllimi i zërit,
ku jehoi pikllimi i lotit të patharë.
Mbaj mend se e bukur ish
si gërbullë e pikturuar nga Floberi

skender iljaz braka

Mbi Gjethe Të Kalbura Shkel

Mbi gjethe të kalbura shkel,
udhëve të fshatit tim të murrmë.
Prej dore mbaj një fëmijën të vogël,
fëmijën e mijëra shekujve të vdekur.
Trupi i tij lakuriq shkëlqen midis gjetheve
dhe shtëpive të gurta që shëmben.
Eshtë era e hapsirave të largëta,
që kridhet në një rrjedhë uji të tejdukshëm,
atje ku jeta e botës nuk arrin dot.
Ndezur prej një shkrepje të beftë,
retë hedhin hijet e tyre vraparake.
Unë me fëmijën përdore shkel.
Shkel mbi gjethe të kalbura,
teksa mu kujtua pëllitja e një lope.

skender iljaz braka

Me Kujtimin Tënde...

Me kujtimin tënde...

Kujtimet, si më të bukurat smeralde,
në një copëz letër i mblodha.
Me mallin e zemrës i pështolla
dhe me yjet e qiellit doja te shkruaja veç një fjalë.
Atë që nuk munda të të them,
atëherë kur të kisha aq pranë.
Dritë-hija jote tmerrësisht më mundonte.
Më bëntë që me lot të ngrohtë
të njomëja jastëkët e bardhë.
Ikja jote, hapsirë e pafundeme
mbeti thellë shpirtit tim.
Më i thelli hon, që s'pranonte kapërcim.
Hije e pakapëshme,
si një vello e purput mjegulline në agim.
M'a grishin mallin për ty dy iniciale,
që gdhëndëm në pemën tonë.
Atje ku shkoj shpesh dhe shoh
ëndërrat e mia të përpeliten,
si te goditura prej një dore dimërore.
Atje ku era mbi mua prëplaset si e marrë.
Veten pyes çdo mbremje.
A do te kthehesh një ditë tek mua ti vallë?

skender iljaz braka

Më E Çmuar Se Vet Jeta..

Më e çmuar se vet jeta..

Më të çmuar se vet jetën të kam patur.
Shpirtin detyruar shpesh kam bërë të hesht.
Në një pjesë të së panjohures tënde kam jetuar.
Pa e ditur as vet nëse jetoja në të vërtetë.

Në një mesazh dërguar prej erës më thoshte.
Se ti si e marrë ngado më ke kërkuar.
Ndaj sot të kam ardhur me nxitimin e shiut.
Që beharit humbet tokës së përvëlur.

Braktisur prej vetes ku jetuar ty të kisha lënë.
Ncrringur tek sofati i shtëpisë së rrënuar të gjeta.
E ngrysur qënia jote si një vjeshtë e tretë.
Aty ku frymë njeriu s'më përshëndeti "tunjatjeta".

Një llampë vajguri digjëte flakë të mekura.
Përhumbur qetësia jote mbi një libër të zhubrosur.
Pahnike kishe mbetur siç të lash dikur.
Të shkuarën në tri hapa përjetësisht varrosur.

Një tufë pëllumbash flatëruan prej një dhome
Prej kaq vitesh me ta kishe bërë dashuri
Ngallitur pas tyre, asnjë çast pa më harruar.
Si shenjti besuar perëndisë së tij.

skender iljaz braka

Me Fytyrën E Pranverës

Me fytyrën e pranverës rilindem dhe vdes,
kur valët buzë detit sodis
dhe gjethet e porsaçelura të kumbullës përshëndes.

Gjoksit më lëshohen krahtë e tu,
si e bardha mjegull që shtrihet mbi oaze.
Prej flladimit të mëndafshtë
thith ravijëzimet e meteorit blu.
Vdekjes pak më shumë jetë i kërkoj,
veç për sytë e tu që digjen porsì zjarre.

Me zërin përgëdheltar të natës.
Me zërin tingëllues të gjetheve.
Me zërin e tokës së shëndetshëme.
Nxitoj me ty pas oshëtimës së pandërprerë të valëve.
Të dy mësyjëm lagëmeve të nëndheshme.

Me fytyrën e pranverës kam vrapuar
për një kohë të gjatë pas valëve.
Pa arritur të ndjej pikëllimin therës të humnerës,
që gjer tek mua vjen me zërin e ngjirur të skëterrës.

Cili është zëri i detit, rrahur përjetësisht prej valësh?
Me fytyrën e pranverës u bëra bir i qiellit,
që më dhuroi skeptrin e diellit,
që më kurorëzoi perandor të universit.

Njeriu me fytyrën e pranverës mbeta gjer në vdekje,
se për ty bënda shpirtit rrita dalëngadalë
lulet aromëmbëla të mëngjesit.

skender iljaz braka

Më Jep Një Grusht Vjeshtë

Më jep një grusht vjeshtë

Më jep një grusht vjeshtë e dashur.
Prej vjeshtës që se puthi kurrë njeri.
Të mos shkoj ashtu pa bujë e zhurmërim,
si një çunak i uritur, humbur në arrati.

Më kot e paskam ndrydhur veten time.
Paska dhe vjeshta brigje ku ulërin shkëlqimi.
Ndaj ngrem prej humnerë së thellë të ditëve!
Thyema kulajkën që udhë të marrë frymëzimi.

Më jep një grusht vjeshte e dashur.
Mbase ma largon këtë breng, kush e di.
Me leshërat e tua të floringta më mbështill.
Dehur prej aromës së tyre, vjeshtës ti bëj zili.
skender braka

skender iljaz braka

Me Koken Time Te Prere

Me kokën time të prerë...

Në duar kam marrë kokën time të prerë.
Nxitoj i përgjakur të gjej gurin e pendimit.
Nuk jam nimf, por si dikur një Promethe.
Që vij pranë këtij varri gjysmë të hapur të t'a sjell.
Ndezur i tëri prej zjarrit të tërbimit.
Nën përvijime imazhesh të kobshe i pështjell,

I imponuar heshtjes nën shikime të egërsuara.
Për një tjetër Edip, sfidues të Sfigës së përbindshëme.
Me kokën time të prerë, të mallkoj ty, ish mbret,
që sundove mbretërin sit ë ishe një Makbeth.
Dhe ngrhinën të shkallmuar themelesh ma le.
Ma le të veshur me të njëjtar rrobe të përzishme,

skender iljaz braka

Me Muzgun Më Ike...

Me muzgun më ike...

Me muzgun më ike asaj buzëbrëmje vjeshte.
Më ike me gjethet, që era tutje i hodhi
mbi dheun e përzhitur.
Mbi degë të zhveshura pemësh,
zogjëve majë sqepit u mbeti cicërima.
Bari iu zverdh kopshtit tim të bukur
dhe petalet ulën pikëllueshëm lulet e gjerbërta...

Cdo mbrëmje qielli do të jetë si një det i trazuar.
Jashtë çikriku i pusit prej heshtjes do të thyhet.
Veç unë në dhomën time të errët do rri zgjuar.
Mbyllur në botën e padukshme që mezi shtyhet.

Mbi djerrina do të bredh shpirti im i parmallur.
Duke të kërkuar ty shteg më shteg
do të mbetem si lakuriqi i natës i pa vatër.
Do të mbës pa atë cicërimë zogu,
pa atë pemë të gjelbër,
pa atë qiell të qetë e të kaltër.

skender iljaz braka

Me Pëlqejne Dashurite E Thjeshta

Më pëlqejnë dashuritë e thjeshta...

Oh, s'më hy në sy asnjë zonjush me kordele.
Zemrën s'ma dridhërojnë sandalet takëholla.
Unë vij nga pyjet e pakapërcyeshme të Tomorrit.
Dhe më pëlqejnë dashuritë e thjeshta e pa ojna.

Mbi krahtë e mi të hekurt do të përplas.
Si dallga që shkëmbit i lëshohet me vrik.
Ti vajzë e rritur mes grunajash sonte eja!
Për tonën dashuri të bukur, mos ki frikë.

Ah kjo borë e bardhë, që majat zbardhëllon.
C'mi trëmb e i rrënqeth zonjushat nazeqare.
I mëngjezit thëllim ty dimrit faqet t'i kuqon.
E pranvera gjoksit të hedh polem manxuraje.

S'dua ta di fare për juve që mbaheni mbretëresha.
Unë përmes errësirës ulëras e këndoj me kitare.
Prej thonjëve të vetë djallit në gji do të mbështjell.
Se ti m'i largon dimrat, me shënd më sjell behar.

skender iljaz braka

Më Pëlqejnë Dashuritë E Thjeshta...

Më pëlqejnë dashuritë e thjeshta...

Oh, s'më hy në sy asnjë zonjush me kordele.
Zemrën s'ma dridhërojnë sandalet takëholla.
Unë vij nga pyjet e pakapërcyeshme të Tomorrit.
Dhe më pëlqejnë dashuritë e thjeshta e pa ojna.

Mbi krahtë e mi të hekurt do të përplas.
Si dallga që shkëmbit i lëshohet me vrik.
Ti vajzë e rritur mes grunajash sonte eja!
Për tonën dashuri të bukur, mos ki frikë.

Ah kjo borë e bardhë, që majat zbardhëllon.
C'mi trëmb e i rrënqeth zonjushat nazeqare.
I mëngjezit thëllim ty dimrit faqet t'i kuqon.
E pranvera gjoksit të hedh polem manxuraje.

S'dua ta di fare për juve që mbaheni mbretëresha.
Unë përmes errësirës ulëras e këndoj me kitare.
Prej thonjëve të vetë djallit në gji do të mbështjell.
Se ti m'i largon dimrat, me shënd më sjell behar.

skender iljaz braka

Më Prit Se Do Të Vij...

Do të vij në gjumin tënd të vonë.
Me heshtjen time në ëndërr lehtaz do të flas.
Prej shkëlqimit të syve kahera t'i kam kuptuar
gjithë ç'ke dashur me pak fjalë të me thuash,
gjithçka që thellësive të shpirtit të ka munduar.

Veç vdekja do të lëvizë nëpër ato shtigje
ku bashkë përjetësisht kemi për të shkuar.
Nëpër thepisje shkrepash
do të varim ata tinguj të brish
pas së cilëve ne paprimas u harruam.
Pas shkëmbinjëve të fortë do të përplasim kalbësitë...

Do të vij e dashur...
Dil e më preit në botën e ëndërrave të gjalla.
Aty ku kurmi yt do të ndrij i pari
si kristali i hënsës, në gjerdanin e yjeve të rralla.
Do të vij, por ti qeshu e vishi me të bardha....

Nwse njw ditw do shkoj I pikwlluar

skender iljaz braka

Me Shprese Ne Rikthimin Tend

Me shpresë ne rikthimin tende

Gjthçka do të jepja per nje rikthim perjetesor.
Pranë imazhit tend me vite të rri zgjuar.
Ulur mbi zemren, qe per mua s'ka me vend
Rrembyer kujtimesh dhe dhimbjesh perjetuar.

Ne kohe dhe hapsire udhetoj papushim.
Te qendroj perseri mbi krahte fluturak.
Enderren perjetesisht tek ty me deshire
T'a le te dashuruar, te paperlyer pa shkak.

Ne ëndërrimet e mia ti përherë fluturon.
Më eshte mpiksuar hidherimi mbi syrin e vrare.
Nuk di si t'a thyej k'te heshtje mortore.
Nuk di se cilen rruge per tek ty te marre.

E zjarrta kuror malli, kaq shume kam vuajtur.
Nuk mundem ta besoj se nje tjeteri i perket.
Po dhe ne qofte keshtu, e dashur te uroje.
Shumezuar gezimesh te kesh ne k'te jete.

Ngerthyer hakurash te met bluaj
Udhesh kryqezuar seç më mban nje shprese
Riktheheu per tu pershendetur qofte dhe nje here.
Me pas ne vetmin time lerem qe te vdes.

skender iljaz braka

Më Të Çmuar Se Vet Jeta..

Më të çmuar se vet jeta..
Më të çmuar se vet jetën të kam patur.
Shpirtin detyruar shpesh kam bërë të hesht.
Në një pjesë të së panjohures tënde kam jetuar.
Pa e ditur as vet nëse jetoja në të vërtetë.

Në një mesazh dërguar prej erës më thoshte.
Se ti si e marrë ngado më ke kërkuar.
Ndaj sot të kam ardhur me nxitimin e shiut.
Që beharit humbet tokës së përvëluar.

Braktisur prej vetes ku jetuar ty të kisha lënë.
Ncrringur tek sofati i shtëpisë së rrënuar të gjeta.
E ngrysur qënia jote si një vjeshtë e tretë.
Aty ku frymë njeriu s'më përshëndeti "tunjatjeta".

Një llampë vajguri digjëte flakë të mekura.
Përhumbur qetësia jote mbi një libër të zhubrosur.
Pahnike kishe mbetur siç të lash dikur.
Të shkuarën në tri hapa përjetësisht varrosur.

Një tufë pëllumbash flatëruan prej një dhome
Prej kaç vitesh me ta kishe bërë dashuri
Ngallitur pas tyre, asnjë çast pa më harruar.
Si shenjti besuar perëndisë së tij.

skender iljaz braka

Më The...

Më the...

Më the se ma kishe lexuar dritën e mëgjezit
Dhe më kishe përcaktuar shkëlqimin e ditës.
Hijen e muzgut të mbrëmjes më kishe deshifruar
Dhe se më kishe llogaritur largësinë e errësirës.
Më kishë matur gjatësinë e javës, muajit, vitit
Dhe më the se yjet pas meje do të lëviznin.
Veç një gjë tek unë kurrë nuk ke për ta zhbiruar.
Me ç'forcë shpirti në jetë ty të kam dashuruar.

skender iljaz braka

Më Thërrasin Shokët

Më thërrasin shokët

E bardha dritë mbi shtrat vjen e më zbret.
Qyteti i zhurmshëm shtrojet m'i ngacmon.
Derdhur janë shokët në sheshin e madh si rremet.
Ngado, si shpërthim vullkani thirrje tyre gjëmon.
Diku, tej mbi taracat e plasaritura të pallateve
Shtratit të agonisë, vdekja si qyqe e zezë përpëlitet.
Skutash të errëta dihat e përdhëmbshë çirret.
Unë pas shokëve nxitoj të shkoj diku larg.
Atje ku buçet thirrja, e verteta.
" E duam! E duam! Si gjithë Evropa!

skender iljaz braka

Më Treti Ky Muzg I Kaltër

Mu arratis dhe kjo mbrëmje prej shpirtit.
Në një tjetër botë të padukshme më humbi.
Mu shëmb në ca vidhama të errëta.
Kërkush s'na pa kur puthja na përgjumi,
ndërsa i kaltërti muzg binte
mbi vëndet tona të buta e të fshehta.

Si prej një mëngjezi të artë,
duarve të mia u përndez kjo copëz qielli,
kur shpirti im i dhimbshëm të kujtoj,
nën një heshtje dhe trishtim të vazhdueshëm.

Ashtu kam mbetur siç më pate njohur ti dikur.
Një univers i gjallë klithmash dashurie.
I përhumbur nën të vetmen arsye të palëkundur.
Në të vetmet bindje të fshehura fjalëkryqeve.

Përse vallë vegimi yt më shfaqet diku,
mes të panjohurish, për gjëra të kota duke folur?
Ku më fshihesh ti kësaj kohe, ku? ...
Mes ç'njerëzish ti këndoje këngë ikanakësh?
Cfarë të fshehtash vallë u tregoje?

Vargjet që mbrëmjeve nis të shkruaj më shkërrmoqen.
Prej duarve që më dridhen më bije dhe ky stilolaps.
Bota para syve të mi rrotullohet porsa ti më shfaqesh,
e po aq paritmas si hije e pluhurosur më largohesh.

Sa shumë më ka tretur ky muzg i kaltër.
Ky muzg që veç di të bredh pas tej i lënduar.

skender iljaz braka

Me Ty...

Me ty, veten kurrë se kam ndjer të vdekur.
Se kam ndjer të plogësht, të hutuar.
Prej ëndërrash të friksuara s'jam trëmbur.
Udhën ku kam shkelur e kam parë më të ndriçuar.
Me ty përjetësisht gjithë të vërtetat kërkoj të ringjall.
Në tënden dashuri që më ke dhënë,
shpirtin kam mbajtur të kryqëzuar.

skender iljaz braka

Mesueses

Mësueses...

Një ditë u larguam..
fluturuam si zogj në shtegëtime të largëta.
Puthje dhe lotë si gurrat e malit,
shpërthye prej syve tanë asaj dite.
Nga shpirti gjithçka të bukur nxuarëm.
U nisem.
Konturet e së ardhemes tonë për të përvijuar.
Arterieve të atdheut, t'u shtonim gjak,
prej gjakut tone të grimuar.
U larguam saj dite qershori.
Me vete ne muarëm vetëm
buzëqeshjen tënde të ngrohtë
dhe ca copëza kujtimesh,
që ditareve të vegjë shkruam.
Do të vijm një ditë.
Sërishmi do të ulemi në k'to banga
ku gjithçka kemi lënë.
Ku të parat dashuri i lidhem me vargonjë
dhe atëherë të heshtur do të pyesim:
- Mësuesen e dikurshëme ku mund ta takojmë?

skender iljaz braka

Mikeshes Sime

Mikeshes sime ...

Të përshendes me mall miksha ime.
Me syrin e përlotur nga dhimbja
të përshendes mikesh e largët.
Nuk di ku i fshehe ti ditët e bukura.
Nuk di ku i degedise ti fjalët.

Ke qeshur shumë asaj dite me mua.
Ke luajtur duke rendur deri në marrëzi.
Ti jese min e tulipan të kuq mbolle
në hektarët zemrës sime të vlaguruar.
Miljona jargavan te bukur mbolle ti.

Por befash një ditë mu largove aq papritur.
Si ere e tokës që tretet nëpër muzg.
Si nje zog të mardhur me le të drobitur.
Në kafazin tim tela mberthyer, si në burg

skender iljaz braka

Mirëmëngjes Qyteti Im!

Mirëmëngjes qyteti im!

U zgjova sot me mendimin e mirë të përshëndes.

Të uroj një vit të mbarë

e bashkë të nisim një tjetër udhë,

mbase edhe më të vështirë.

Me këngën time që prej trupit të coptuar më ngrihet

dhe një herë duke më zhvatur,

do të këndoj për ty nën dritën e detit të hapur.

Nën erën përgëdheltare të përendimit të zbrazët,

Do të këndoj, duke ëndërruar jetën e fëmijëve të tu,

që prej eshtrave të etërve thëthisin çdo ditë

lëngun e kyçeve të dhimbshëm.

Do të këndojë për ditët që presim të na vijjë

Një peisazh të shndritshëm rrugësh duke përfytyruar.

Dhe një ëndërr tjetër tek vdekja e padëshiruar..

Shpirti im i ardhur nga larg nëpër natë.

dp të këndoj tretur mes frymëmarrjes së detit,

me butësinë time të ngrohtë si shekuj më parë.

Mirëmëngjes qyteti im!

Mbi fosile algash dhe drurët e tu të blertë.

Bredh ngjyrimi i mugët i rrugicave të tua,

dallgët dhe valët e errëta dhe kënga ime

që tretet me dashuri e nëpër qiell ngjitet

si trandafil i kuq që digjet. prej zjarrit të tij.

Mirëmëngjes qyteti im!

Në jetët tona janë tretur frika, heshtja e përjetshme.

Në bukurinë tënde të parrudhosur ngjethja ka ngrirë.

Faqeve të kodrinës mbjell me beton rrëshqet shpresa

Që shpejtë nëpër ajërin e prushtë zë humbet.

skender iljaz braka

Mos E Kërkoni Përtej...

Veç një qiell shoh tutje këtij horizonti.

Ku tjetër do të mundem të vështroj sytë e bukur e të sertë?

Sytë, që dallgët mizore të detit përgëdhelin e përlotin.

Sytë që urtësojnë ulërimën e frikshme të përtej honit

dhe vrazhdësinë e një përbindëshi kanosës

me gjak të shprishur, që i rrjedh e i rrjedh nëpër dej

Ku do mund ta pikas atë ujvarë dritash,

që prej gojës së qiellit të hapur më përplaset mbi gjoks?

Ah, dhe një herë në i preksha ato duar të buta!

Ato duar që tërheqin e majë gishtash rrotullojnë këtë botë.

Mbi këtë det sysh që të ashprën heshtje derdhin,

që shpirtin ma thërrmojnë ranishtes papushim.

Si një relief memec, prej dherash do më hedhin,

atje ku asgjëkundi s'do të prehet e do shihet shpirti im.

Jo, mos e kërkoni më kot përtej këtij qielli.

Kurmin e saj lakuriq në ca shkëndija dritash për tu ndezur.

Unë përherë e shikoj tek dihat brigjeve të pack të një deti

kur prej rraskapitjesh rilindem dhe ngatërrohem

si shelgu lotues me kurmin e saj të hirtë.

skender iljaz braka

Mos Ma Fyeni Tim Vëlla

Im vëlla më duket i përhumbur,
si pemë e vetmuar
në një muzg të përhimt.
Dhe toka, vendi nga ai vjen e shkon
më duket e rënduar,
prej djersës dhe gjakut
që i bien si të jet pleh
i ardhur dhe i mirë.

Im vëlla më duket më i plakur.
Llis i lasht, djegur prej rrufesh
Fytyrë e tij, prej vuajtjesh e gërvishtur,
që jermion e rënkon hidhur,
gjer në rrasht njomur,
si lisi nën rrebesh.

Më ngjan im vëlla
me një rrobë të arnuar.
Me një det të tërbuar më ngjan im vëlla.
Fshikëllima e ditëve të pamëshëme
në të rrënjët thellë,
thellë i ka ngulitur.

Im vëlla është i tëri një
dhimbje e mbytur.

Veç sytë i qeshin tim vëllai,
Dhe shpirti i tij harliset
si miljonat miliona lule
në një kopësht prej tyre i qëndisur.

Jo, mos ma fyeni tim vëlla!
Mos ma lëndoni ju mutër të shtrenjtë.
Do të vijë dhe për ju koha e varrimit.
E bardha e veshjes tuaj do çngjyroset,
errësohet gjer në rrënjë,
nga klithma e pajajësisë së zemërimit.
Mos ma fyeni tim vëlla!
Mos ma fyeni!

skender iljaz braka

Mos Më Lini Që Të Vdes

Mos mw lini qw tw vdes.

Prej degës së thatë të bredhit, atje lart,
një hidhërim i pakuptueshëm u shkund,
nën shtigje të errëta ra.

U vra.

Unë iu qasa jo pa droje,1)
se më lidh me të një dashuri e fortë, e përmtshëme.
Kur vibrimet e akullta të ajërit i ndau në dysh
krisma e thatë, që mbështjell agimet e mjegullta
me rënkimet e përbotshme.

Më lënduan sytë e pajetë të këtij dreri vetmitar.
Sytë e qelqët prej mermeri
që më vështrojnë të palëvizshëm.
Kur zënë e shuhen qetësisht dalëngadalë.
tingujt e atij zëri aq të mekur, nën lëkurë i rrëshqasin.
Unë i tëri zë e dridhem prej një hidhërimi të përgjithshëm.

Gjithë rënkimet që kanë shkuar përtej varresh zë dëgjoj.
Ndërsa ti më vjen mbi krye
Plagën zë më lan me lotët e tu të pikëlluar.
Tej, shteg i gurt u përmbys,
e përroi ca ndryshe zu të rrjedh ngadalë,
valë - valë buzë përvëlur.
Curril e gjakut gjarpëron nëpër pore
Më humbet nën lëkurën e coptuar.
-Jooooooooooooooooo, - ulëras, sa mali trëmbet,
zë e dridhet.
-Joooo. Nuk dua të vdes këtyre rrugëve të përbaltura,
mbetur si urithi labirinte, duke rëmitur.
Shekuj varur të kam mbajtur brënda shpirtit.
Si peng i përjëtshëm i këtij dheu kaq të hidhur.

-Jo, mos më lini që të vdes me një shpirt të poshtëruar.
Prej zhurmash jete kaq të ndyra, rraskapitur.
e ca më keq si një shtegëtar vetmitar, kaq i ngrysur

skender iljaz braka

Mos Shkoni Larg.....Më Thotë Dikush.

Duke qëndruar jam në një hapsirë boshe..
Mbështetur në një pikën kulmore, të kujtoj.
Tek ty dua të gjej një fjalë të ngrohtë.
Atë që vite më ka munguar, që më joshte.

Në një stacion të boshatisur jam,
duke të pritur deri vonë,
Aty kur trenat njëri pas tjetrit ndrrohen,
nxitojnë për në destinacion..
Përse u dashka i vetëm këtu të qëndroj
Njomur prej një ankthi trup thërrmuar.
Mbytur brenda zemrës time të helmuar përgjithmonë.

Vallë përse kështu duhet të digjem?
Pak çaste duke ndjerë aromën e tymit të përflakur.
Trembur prej vetvetes,
Mallëngjyer prej një zëri i tulatur.

Mos shkoni larg, dikush më thotë.
Mos shkoni larg!
Atë që doni, diku.... këtu pranë keni për ta takuar.

Por unë rend si marathonomaku, për të gjetur
Atje ku ti nesër kushedi ku mund të jesh.
S'më ndal ashpërsia e kësaj nate.
dhe ky shteg i përgjakur që duket
sikur më vërtit nëpër spirale.
Mbase një pakujdesi e paqortuar
pusi do të më ketë bërë tek ndonjë shpat.
Dhe dikush aty pranë do të më sulmoj me gjykime paradoksale.

Mos shko larg, një zë i thekshëm më qorton.
Mos shkon!
Ah që s'mundem sirenave dot tu bëjë ball.
Një ditë kështu vetmitarë më duke shumë e gjatë.
Oh, kurrë nuk mundet ta humbas siluetën e saj nëpër gjumë.
Unë do të enden në çdo metër të tokës,
Mbi lërët e duarve të mia për të ngritur
e më pas për të të rënë në gjunjë..

skender iljaz braka

Mos U Frikso..

Mos u frikso..

Dëgjoi, o njeri, këto fjalë prej një të marrosuri.
Në të qëlloft si asnjëherë i vështirë fundi kësaj jete.
Si më i braktisuri që vitet shtyn në pleqërinë e thellë.
Mos iu frikso mendimit pse dheut të ftohtë do ti zbresësh.
Por asaj çfarë i ke dhënë e ç'vlerë në kaq vite i dhe jetës.

Mos u trishto nëse nëpër të, hapat do të devijojnë në errësi.
Kam përjetuar dhe unë më parë të tilla situata të ngjashme.
Në këmbë, i mbytur prej dëshpërimit kam qëndruar si i ngrirë.
duke pritur belbëzimin e një fjale të ngrohtë ngushëllimi.
dhe shpresuar për zgjatjen e një dore të sigurtë e të mirë.

Si më i egri shpërfytyrim i ringjallur i një kohe të vdekur.
Gjirizeve të flliqur ku hasmin s'do të doje të groposësh.
Do të shfaqet imazhi i tiranisë me grahamë e saj të qelbur.
Ti mos iu trëmb, ëdërrave të vdekura jepu një shpjegim.
Diku mes shpirtërash të humbur vetveten ke për të gjetur.

Pavdekësinë tënde rrënjose atje mes trupash të vdekur.
Prej plogështisë së harresës, nxirre e shkunde burrërinë.
Se edhe unë më parë jam grindur e rebelues kam djegur.
Aty ku kam shkelur, pamëshirshëm kam goditur gjithë ata
që për qëllime të këqija kultivuan urrejtjen dhe mizorinë.

Ata që në heshtje pranuan të nënshkruanin humbjen.
Dhe jetës nën vetëdije i bënë më të keqin shërbim.
Britmën tënde të fortë do ta ndjejnë dhe kufijëve të përtejëm.
Të frikur do të dridhen nëpër terrin e gjithë viteve në vijim.

skender iljaz braka

Motra Jone

Motra jonë...

E gjallë dhe e vdekur erdhi..
mes një lëndine bari të thellë
mbi akuj dëbore duke shkelur.
Zambak uji vuri mbi katër gota vere
dhe iku skajeve të ftohtë të ajrit
me hijen e një libri të porsa promovuar.
Heshtjes dhe një herë i buzëqeshi.
Dhe një herë përgëdheli mbrëmjen e vjeshtës,
që yjet kish ulur mbi lulet e mermerit.
Mbi katër gota kristali,
skalitur mbeti shikimin i saj i qeshur.
Përsëri na iku motra jonë e vdekur.....

skender iljaz braka

Na Hidhëroi Kjo Stinë Përvëlimate.

Na hidhëroi kjo stinë përvëlimate.
Ky korrik, si një i huaj i ardhur nga larg,
këmbanën e zisë poetike kumboi.
Mesnatës dhe agsholit u drithërua shkëmbi i kuq.
Një gjeth papritmas u tha, dheut iu këput,
si venitja e heshtur e luleve vjeshtore.

Ngushëllim! Vetëm ngushëllim, popull!
Ti që linde mbi një pìrg vegimesh të shprishura,
gur i rreshkët dhimbjesh u rrite.
Në mal të shpirtit, çdo pikë loti i Kosovës
u kthye tek ti në ortek.

Oshtimë e largët ngërthyer në dhëmbë graniti.
Lumi i pandalshëm i muzës tënde u bë det.
Zëri yt shpërthyes, si lulakët e parë të pranverës,
mbiu muzgut të dheut të ftohtë,
mbi shtresëzimin e ngurtësuar të brymës së harresës.
Ishte zëri i ujërave mes pyllnajash gurgulluar,
që pritjen e përjetonte mes dhimbjesh dhe dënesës.

Kur Prishtina gjëmonte,
ti udhëve të saj dilje me flokët e njomësht.
Në sytë e nemitur kishte vetëm gjak
dhe shkopinj të hekurt të shqaut barbar.
Veten s'e ndieje të gjallë, por s'e ndieje as të vdekur.
Me zemrën e dritës vështroje heshtjen duke qarë.

Mbi rrafshin tënd të dashur sot bien psherëtima të prera,
bien tinguj të ngërthyer
prej gjetheve të bulbit të tharë.
Së shpejti do të gëlojë një bulë e kristaltë jete,
tokën tënde të djegur për të ushqyer.
Ti linde si zambak i bardhë
që ngjallet prej tokës së tretur.

Ndaj na ike kështu ...
një një poet i madh ...
një burrë i heshtur ...

Ngushëllim! Vetëm ngushëllim, popull,
për njeriun që kurrë s'ka për të vdekur!

skender iljaz braka

Ndarje Mes Miqesh Te Vjeter.

Ndarje mes miqesh te vjeter.

Vale te kaltera perendimit,
mureve te rrenuara perplasen.
Renkim i bankinave si puthje te vrara
te yjeve te detit fluturuar drejte qiellit.
Diku ne hyrje te sheshit te trageteve,
rrethuar hekurash burgu te blinduar,
nen vezhgimin e qindra syve policesh,
doganieresh dhe mashtruesish te korrptuar,
na duhet te ndahemi si miq te vjeter.
Ne degezime udhesh pa krye,
mijera kilometra mbi gjethe te thata vjeshte.
Mbi gjethe te ngrira dimerore,
si nje re grirore pluskon mendimi,
tretur mbi ujera te trazuara,
te nje deti te trazuar.
O ndarje fuqiprerese.
O ndarje lotrrjedhese,
qe veç dhimbje vershoni brenda nesh.
Ne muzg i tretem psheretim mbytese.
Ne nje perlotje syri, qe mallin thith
si foshnja gjirin e brisht te nje nene.
Vetem krijimet tona ne nje faqe te fb
mbeten perjetesisht prane njera tjeteres
deshimtare te nje'....lule Shqiperie',
Cuditerisht te vetemet qe nuk grinden
me heshtjen e tyre.
Cuditerisht duke i thene njera tjeteres
miresisht miljona fjale dashurie.

skender iljaz braka

Ndërgjegje E Ngacmuar...

Përmes rrebeshe shirash në ditët e zhgënjimit.
Rënkuar mbi gjurmët e stërshkelura të pritëshmërisë.
Mes të paimagjinuarave absurde ku rrjedh jetë e lëndimit.
I përbetuar nxitoj udhëve me ndjenjën e papërkulshmërisë.

Me të pamatëshmin mllef, që thellë shpirtit më përvëlon.
Një shteg shpëtimi kërkoj, të dal prej kësaj ngushtësie.
Rëndim i përvuajtshëm, që supet e popujve rrënon.
Me zgjedhën e pamëshirshëme e frymë papërgjegjshmërie.

Ngurosur më ka mbetur shikimi mbi këto udhëkryqe dhe fate.
Të popujve që pafundësisht vuajnë nën ndjenjën e harrimit
Të papërgjegjshëmët pushtet agimet larg e më larg spostojnë.
Imponuar e mbërthyer prej darës së egër të Unit dhe përfitimit.

S' jam Hyjni rrebele, rebelimi thellë shpirtit më ka lindur.
Kur shoh miljonat që përmes vuajtjesh sigurojnë mbijetesën.
Mes fytyrave të trishta si vet imazhi i kësaj jete të tejzbehur.
Kur s'shoh tek koha, që të simbolizoj mirëqniën dhe qëndresën.

Prej së njëtës ndjenjë vetiu shtyhem drejtë sakrifikimit.
Tek shoh një emigrant të drobitur, tmerresisht të keqtrajtuar.
Tek shoh një të përhumur prej lodhjes dhe ndëshkimit.
Tek shoh një mori njerëzish, prej flakëve percëlluar.

Të nëpërkëmburat dinjitete lëndojnë e vrasin ndjesin time.
Nën vështrim të poshterimit të ngritur mbi fron të kurorëzimit
Përlotur ëngjelli i besueshmërisë mes plagëve përpëlitur.
Ngacmuar ndërgjegjëja, prej pafuqishmërisë dhe dëshpërimit.

skender iljaz braka

Ndofta Per Te Fundit Here

Ndoshta per te fundit here....

Në të pambyllurat plagë, shkaktuar
prej nje milion poshterimesh të marra
në arenen e nje lufte absurde klasore.
Zhuritur permes zjarresh totalitare,
perhere nje dhimbje therese kam ndjere.
Ne perpjekje per mosbindje pikpamjesh,
etjen per te pamunduren kam shuar,
duke kerkuar falje prej Ferrit.
I mberthyer kam qene ne kurthin e dogmave.
Ngaherë me eshte dashur per te njejten arsye,
mbijeteses, ti jem perulur
me perdhosjen e dinjitetit
perapra imazhesh te shemtuar..
I dekurajuar prej zellit te dishepujve proverbial,
prej Zylosh, Krisht mohuar.
Trembur prej britmave te mekura korbash,
qiellin kam pare perhere errersuar.
Papergjegjshmeria e orakullit euforik
shpesh me ka irrituar me cinizmin miklues
dhe atehere veten e kam ndjere me te mjere se kurre.
Rendome, braktisur prej shokesh,
ne vetemine time jam gjendur perball heshatsh kryqezuar.
Atehere kur mendova se gjithcka m'u pertha.
Ne pritjen e gjate te ndezjes se nje pishtari lirie,
qe ne ditet e para te rikthimit,
pas shtate lekuresh perveluar,
nen monstruozetin e ketij evenimenti,
njemije ton poshterimesh perseri mbi mua rane.
Mbi majat e kujteses se perdhosur,
pertej imagjinates se humbur.
turtura ime, ngrihet ne mbrojtje te fuqise se realitetit,
I kredhur perseri ne njemije ton poshterimesh kam mbetur.
Kam mbetur po ai skllav i perpjekjeve te deshtuara,
thekshem duke renkuar.
Ne shikimin e perhumur te syve te mi,
vetveten ende pergenjeshetroj per
tretjen e pafundesise mizore.

Ndoshta per te fundit here
thonjet mbijeteses i'a kam ngulur.

skender iljaz braka

Ndoshta Më Parë

Ndoshta më parë, më vonë, a tani....
Atij trupi prej mallit të djegur,
përsëri po ajo plagë i ka mbetur.....

Sa herë rikthehem, gjithnjë e më i thinjur.
Si kopja e një hijeje të frikshme,
Ndjekur prej një hapi të shpenguar.
Të tjera mendime më rizgjiohen
përpara asaj ikoneje të xhveshur.
Të tjera premtime të harruara,
si dëshmi, mbaj duarve shtrënguar.

Prej asaj fytyre ku veç thirrjes së egër,
pika e fundit e gjakut ka mbetur në lëndim.
Matjen e atij perimetri të përflakur do rinis.
Puthjen e vdekjes me vete do të marr.
Gjithçka do t'ia rrëmbej asaj fytyre të vrerosur
që ende vazhdon të dëshmoj padjallëzinë.

Ndoshta më parë...
brënda vetvetes kam patur të fshehur,
djallin, engjëllin dhe magjinë....

skender iljaz braka

Në Sytë E Tu

Në jetën time ti hyre kaq papritur.
E ditët në dysh i ndava veç për ty.
Një njërën vura verën me vap të zhuritur.
Në tjerën vjeshtën e zverdhur në sy.

Unë, zemrën tënde me poezi përgëdhela.
Të djeshmet i mbylla sunduqeve të mykur.
I flaka mëkatet si gjethet, që tutje hedh era.
Përbuzëshëm siç hedhim një send të ndryshlur.

Më the, mbi gjithçka do të dua më shumë.
Në hambar të shpirtit më hyre në thellësi.
Prej tij rrëmbeve çdo të shenjtë që kisha unë.
Dhe qerpikëve të tu të fjetur u'a bëre stoli.

Në sytë e tu çdo ditë shuaj mallin.
Ti aromën e vuajtjeve, në heshtje rri tret.
Nuk di pse koha na ndau, si rrufeja malin.
Si muzgu i egër, që buzëmbremjen godet.

I qeshëm lojes sonë për vite me radhë.
Larguam mallkimin, që shpirtin e vret.
Të dashurova marrëzisht si engjëlli pa faj.
Ashtu siç di të dashuroj vetëm një poet.

skender iljaz braka

Ne Udhet E Mija....

Ne udhet e mija....

Nen te zbehtat drita te qytetit tim.
Pergjate rrugeve ku flokesh jam perthinjur.
ndej befas t'me perplaset ne fytyre.
Si dallge e ashper deti, nje kujtim i hidhur.
Kredhur ne mendime, serish vazhdoj te endem.
cdo cast. cdo ore, nder muaj papushim.
nder vite mbetur, mekatar i deshperuar.
Nje varke e mbytur, qe detit s'gjen shpetim.
Nje gote kristali si te Gralit mbaj ne duar.
Gjithe helmet e jetes sime ne te dua te pi.
Ne llumbetirat e qytetit tim me qellon te zhytem
Si nje lypes i mallkuar, pa shprese ne perendi
Ne udhet e mija shpesh here jam rrezuar.
Lodhur syte e mi rrugeve te ngaterrura.
Mes rrebeshit te shiut mbetur i pastreh.
Si nje shtatore heshtur nen qiell te zemeruar.
Mengjeseve te mpira nen vuajtje perveluar.
Si bisha jam perleshur per pak drite e mbijetese.
Prej shuplakes se jetes mijerahere i ndeshkuar.
Mes plageve te rihapura kam qare me denese.

skender iljaz braka

Në Botën E Të Vdekurve

Ngadalë shkoj me një tufë lulesh të vyshkura në duar.
Përmes lotësh i avitem qytetit madhor të nëndheshëm.
Nën terrin e frikshëm të natës prek mermerët e ftohtë.
Sot askush nuk mundet të dëgjoj zërin tim të thekshëm.

Mijëra kokalla, nën ndriçimin e yjeve që terrin pagëzojnë.
Duartë e mia prekin, duar e vrara, duart e mia të thara.
Si zgjatime vertebrash zgjaten dhe padurueshëm presin.
T'u tregoj për të vërtetat e djegura shpellave të mardhura.

Tu tregoj për tokat gjakderdhur pushtuar prej barbarësh.
Për të thinjurin det - nëmur që dallgët nën dorë ia shitën.
Tu tregoj për një parlamet ku zihen e buçasin vetëm kusar.
Për sythe pemësh e zëra zogjësh, që bastardët i grabitën.

O ti rrezendritura e hënës, të lutem terrin sot ndriçom!
I trishtuar të vështroj diku tek një copë vënd i shëmbur.
Në botën e pafundëme ku shkruar është emri i tim eti.
Pak çaste i heshtur të qëndroj në vetmin time të çmëndur.

Egersohen diku tej rrebeshe shirash të rrëmbyeshëm
Thërrmohet e grryhet dheu i botës së të vdekurve.
Në botën e të gjallëve batakçillëku kudo i pranishëm.
Bren e shton ndryshkun e hekurit të pastër të shekujve.

skender iljaz braka

Ne Detin E Ngrire Te Meendimeve Te Mia

Në detin e ngrirë të mendimeve të mia.

Në detin e ngrirë të mendimeve të mia.

Prej vitesh vazhdon t'më endet hija e trishtimit.
Shpirtit më mblidhen si një grumbull hedhurinash.
Të panumërtat dilema, të çorientuara ekuilibrit.
Nën përgjërime e lutje nënash humbas i helmuar.
Si trumbcaku i grunajës, i pashmangur fluturimit.
Në hapsira vuajtjesh përgjithmonë duke medituar.
Mbeta më i binduri ushtar i skalionit të pare të sakrifilimit.
Cdo ditë duke jetuar anormalitetin brënda anormales.
U bëra përçues i ideve, që varrosen e përçmohen.
Me bindjen për të arritur atje ku asnjëher nuk arrihet.
Por që vetëm padrejtësisht prej padrejtësë ndëshkohen.
Mes kërcënimesh kam vrapuar si dallgë shpërthyes.
Shkretëtirës së vizionit pa iu përulur nënshtrimit.
Si lis i djegur kam mbetur mbi ca rreshta poezie.
Më i palodhuri luftërar i luftës për lirinë e mendimit.

skender iljaz braka

Ne Dhe Hena Xheloze

Ne dhe hëna xheloze.....

E dija që më prisje.....

Dhe unë të erdha turravrap.
Mbështetur të gjeta në murin
e mbushur me myshqe e likene,
të mbretërisë së mëkatit.

Ti ishe xixëllonja përmes errësirës.

Ti ishe vlaga e zemrës së tokës.

Tejdukshmeria e kristalte e hapsirës.
Brumi i ardhur i ripërteritjes së botës.

Nga dritarja e hapur, syri tinzar i nates,
përgjonte çastet tona të çmëndurimit.
Prej epshit digjej ekstaza mjegullore
Dhe hëna e magjepsur hetonte ledhatimet
nën përgëdhelite e duarve të pakontrolluara,
që dridheshin si prej zefirit.

O e heshtura natë.....

Merre këtë copë jete dhe hidhe
mbi krahët e tu të rrëfimit!
Lëri të rënkojnë në përtokje çarçafët e përgjakur!
Rrezato dhe një herë dritën maramëndëse të agimit!

E dija që më prisje...

Ndaj erdha me turravrapin tim,
nën xhelozinë shekullore të hënës,
për të mbetur aty si pasardhes i krishterimit.

skender iljaz braka

Ne Ditarin E Vjeter

Në ditarin e vjetër...

Në ditarin e vjetër prej kohe të paprekur.
Prej vitesh të ngurosur qëndrojnë
të shkruarat fletët gri të jetës sime.
Më rikthen tek to veç një zë i mekur
dhe një tingull i ëmbël, vocërrak dashurie.

Në atë ditar i ringjallur jam unë nën torturë.

Si nën savanin e tejdukshëm e

të ftohtë të a akullit.

Prej lotëve të lutjes i lagur nën pendes i ngërdheshur.
Të paimagjinueshmen imagjinoj dhe pse pa një emër,
rreth së cilit do të vërtitesha si një ikonë e xhveshur.

□

Një pjesë zemre kam lënë në atë ditar të vjetër.
I vrarë përgjithmonë prej së njëjtës plagë.
Gjthçka më davaritet rreth mendimesh të brengosura.
Më mjegullohen gjithë ndjenjat e keqtrajtuara.
Dhe zgjimet e pazgjuara, që kanë mbetur të plandosura.

skender iljaz braka

Ne Diten E Marteses

Në ditën e martesës...

S'kish zanë më të bukur kur dole në valle.
Pikë e lotit të ngriu mbi fustanin e bardhë.
Buzën ta përshkoi një dridhje gënjeshtare.
Nën tingujt kumbues të tretur nëpër sallë.

Si gulçim uj-kthjellët mbi gurët e lumit.
Të erdha. Ja tek jam! Dorën të ta marrë.
Bareshë sypafjetur eja të shkojm larg.
Ku ndrit mbi gjelbërimin vesa si kristal.

Si një fill i hollë pikëllimi nis e thyhet.
Mbi vahe të dritshëm të lumit gjarpëror.
S'të ikin këmbët prej rrugicës ku u rrite.
Prej brumit të ngrohë e peshtafit atëror.

Dëshirë e mbarsur me largësi të pafundëme.
Rend shtegut të papërkthyer të kreshtave kohore.
Tek do t'më zhytësh e gjitha ti mua brënda trupit.
Gjëzat e dëshirave do zbërthejm harqeve hënore.

skender iljaz braka

Në Ditën E Martesës..

Në ditën e martesës...

S'kish zanë më të bukur kur dole në valle.
Pikë e lotit të ngriu mbi fustanin e bardhë.
Buzën ta përshkoi një dridhje gënjeshtare.
Nën tingujt kumbues të tretur nëpër sallë.

Si gulçim uj-kthjellët mbi gurët e lumit.
Të erdha. Ja tek jam! Dorën të ta marrë.
Bareshë sypafjetur eja të shkojm larg.
Ku ndrit mbi gjelbërimin vesa si kristal.

Si një fill i hollë pikëllimi nis e thyhet.
Mbi vahe të dritshëm të lumit gjarpëror.
S'të ikin këmbët prej rrugicës ku u rrite.
Prej brumit të ngrohë e peshtafit atëror.

Dëshirë e mbarsur me largësi të pafundëme.
Rend shtegut të papërkthyer të kreshtave kohore.
Tek do t'më zhytesh e gjitha ti mua brënda trupit.
Gjëzat e dëshirave do zbërthejm harqeve hënore.

skender iljaz braka

Ne Ditët Me Te Errëta Te Jetes Sime

Në ditët më të errëta te jetes sime...

I ndrydhur ne vetvete prej një goditjeje fatale.
Padrejtësisht i denuar prej një ndërgjegjeje brutale.
Mbërthyer mes zërash përçmues të një degradimi.
I flakur mes ndotjesh, lënë pa një shpresë ngushëllimi.
Mes të gjithëve më i heshturi, me heshtjen e mermerit.
Thell shpirtit i perveluar prej flakëve te ferrit.
Zbehur ndjenjash, pa pike më të vogël të dëshirës.
Përhumbur shikimi mbi buzët e përgjakura të errësirës.
Vrerosur si qielli i përpir prej tërbimit të reve të nxira.
Ne ditët e fundit, ne oret e mbetura, ndër me të vështirat.
Ndjekur prej te ftohtin të paravdekjes, jetën pa parëçmuar.
Varrosur mes yjesh dritëshuar dhe vdekjes së afruar.
Mbuluar nën terrin e natës mes dhimbjesh duke renkuar.
Duart zgjata përtej kufijeve te horizonteve te ngrira.
Dhe pse mbetur te pangushelluara gjithë lutjet e mija.
Hetoja rrokullisjen e diellit me nxitimin e renies se lire.
Në kufijte e te pamudëshmes, djegur prej flakëve të mundimit.
Mes sakrificave dërrmuese dhe ëndrrave te zgjimit.
Shpresat tërhiqja, mbi te pashkelurat udhë të rrëzimit.
S'mund te qendroja nën trusnin e natës së pandriçuar.
Mes qindëra plagëve, që veç prej meje duheshin shëruar.
I bëra zë hovit, në apel thirra gjithë fuqitë e shteruara.
Në emër te jetës, kontratë me mbijetesën firmosa.
Mbi përbaltjen të ngrihem, pa derdhur lot ngashërimit.
Si në luftë në armë i thirrur, pa një gërhamë trishtimi.
Me gjithë ç'më kish mbetur, betejat për të filluar.
Si kapedan i furtunave mbi te ligën për të triumfuar

skender iljaz braka

Në Emër Të Drejtësisë

Dalngadalë ndaj gjithçkaje njerëzore njeriu po e shuan besimin e tij.
I thelli dëshpërim arratisur prej demonësh, ku dhe ferri paragjykohet.
Ditë, muaj, vite, përpara syve si një kalendar i çngjyrosur i shkojnë.
Si një eklips dielli, fytyra e kohës dhe mendimi i shplar, i ravijëzohet.

Shpesh u kam thënë, se unë vet jam shëmbëlltyra e të marrit.
Ca më shume se një gjykatës i zhgarrafitur në fasada muri periferish.
Robi i marrë peng prej krimit, që dhe mbi mua vendos masën e dënimit.
Se jam shpirti rebel i dishepullit të degjeneruar prej vesit të babëzisë.

S'më intereson fakti, e vërteta që dikush e quan të pamohueshme.
Në sallën boshe, ulërasin kufoma të padekompozuar në emër të drejtësisë.
Por ligji jam unë mëkatar! Ura mes jetës dhe vdekjes, e pashkëputëshme.
U kam thënë se jam faroni, që jetoj vetëm mbi pushtetin ëmëlak të pasurisë.

Ju kam thënë se jam çmënduria e përditshëme që kohën tmeroj.
Giotina e gjithkujt që rrugëton si gjarpëri udhës së mundimshëme.
Jam nata e kafshëruar, që damarët e jetës në miljona copëza coptoj.
I magjepsuri i tiranisë, që jetën errësirës ia fsheh në mënyrë të përbindëshme.

Kohë e mpiksuar në brendësi të shpirtrave dhe mëndjeve të helmuara.
Më imponon vazhdimisht të thëthis helmin vdekjeprurës të shkatërrimit.
I vetëdijshëm se asnjë mëndje e nënshtruar kurrë s'ka për të më besuar.
Mbi qytetërime të zhdukur kërkoj të ngre frymën e mirëkuptimit.

skender iljaz braka

Në Eshtra Të Rrugëve

Në eshtra të pakalbura varresh jemi kthyer
ne të përditshmit,
të përmuajshmit,
të përvitshmit
e këtyre rrugëve të ndotura, të këtij qyteti të egër.

Kokallo të shpërndara bregut të detit.
Kaldrëmit padashur lëm gjurmën e dokerit
dhe hijen e fytyrës sonë të humbur
nëpër pluhurin e lagësht të dherit.

Rrugëve të qytetit, si në shkretëtirën e trandafilave
Një violinë e braktisur vazhdon të nxjerr tinguj të mbytur
si zëri I ngjirur I Judës, humbur deteve të ferrit.

Të tjera eshtra presin ti rilindin këtyre rrugëveve.
Të tjera kokallo me emra Ilirësh, keltësh, orientesh.
Në kopshtet e vdekur me kryqe të gjelbërt.
Veç dy sy fëmije presin lulëzimin e brishtë të mëngjezit.
Dy sy që ecin duke gdhëndur mbi rruhë
Vetëm inicialet e emrit.

skender iljaz braka

Në Kumbim Të Vargjeve

Në kumbim të vargjeve
Nën kumbimin e vargjeve
të mia poetike do të vdes një ditë.
Do të vdes në një shtëpi fare të thjesht.
Një shok fëmijërie pa tjetër tek koka do ta kem.
Mëpas gjithë të dashurit që nën dhe do t'më shtjen.

Dhe përsëri në jetë do të pihet dhe rakia.
Të tjera buzë do dridhen prej dashurisë së parë.
Pikëllimi mbi qerpikë prap do të zbres.
Këmbana e largët një tjetër do kërkoj për varr.

Por unë i kyher në një zog.
Do endem rrugëve, shteg më shteg.
E përsëri vargje prej të mijave do të këndoj.
Të paktën, shpirtërave të gjallë tu jap pak jetë

skender iljaz braka

Në Limanin E Syve Të Mi.

Si pulebardhë u ule limanit të syve të mi.
Me ngjyrën e oqeaninit m'ï ndrite atë çast.
Në hapsirën time brigje - brigje mbete ti.
...Një anije e bukur, e brishtë, velëbardhë.

Ngaherë tingellues më mbeti zëri yt.
Detit tim të errët i ndeze zjarr të ri.
Si prrush i pashuar notuar përmbi valë.
Flakërim e kaltër, i brëndëshmi vezullim i tij.

Rrethit të jetës sime nuk më le të vërtitem.
Nga ferri më ngrite si më të fortin burrë.
U bëre për mua ikon e shënjtëruar.
Bozhur e bukur çelur përmbi gur.

Mesazh i ç'dashurie më të fuqishme ishe ti?
Nga ç'orbitë e shkëputur, si një yll i rrall
Të tërin më pushtove me tënden magji.
Jetës më shndërrove në më të fortin strall

skender iljaz braka

Në Luftë Me Vetveten...

Në luftë me vetveten...

Ka dhe luftëra të tilla pa zhurmë dhe pa bujë.
Kur njeriu lufton heshturazi përherë me vetveten.
Kur thellë shpirtit i gëlojnë ndjesi krejtësisht të kundërta.
Përmes prishje ekuilibrash dhe harmonish për të drejtën.

I ndodhur mes ngërçit dhe dilemash të pafundëme.
Dritën e udhës së tij njeriu, mundimshëm kërkon të gjej.
Drejtë së përsosurës, të vërtetën duke kërkuar pafundësisht.
Mes shpresash të shuara, jetën e kërcënuar kërkon të ushqej.

Në vazhdimësi për të hapur shtigjet e rrugëdaljes.
Shmangur prej humbjes dhe disfatash, përplasur ashpërsisht.
Rrëzuar e ngritur mes dhimbjes dhe përbaltjes.
Sfidant i kësaj lufte për të mbetur përjetësisht.

Nën heshtje të tejzgjatur, vargani i mendimeve tunduese.
Përtej çdo pendimi mes shkaqesh dhe pasojash.
Ngritur mes trishtimit dhe brengave përvëluese.
Të ardhëmen ndërtuar mes ngrehinash dhe rrënojash.

Në këtë betejë të hapur, të lindur përgjatë shekujve.
Përmes konfliktesh të përditëshme përherë duke u ndeshur.
Në përgjakje të vazhdueshme mes rilindjeve dhe vdekjeve.
Demon i arsyes, patundshmërisht ndër qëndrime mbetur.

Pa këtë luftë askush nuk mundet të korigjoj vetveten.
Lehtësisht dinamikën e jetë në sjetull për t'a marrë.
Pasi asnjë jetë më mbrapa nuk mund të rikthehet.
Dhe askush pa këtë luftë, s' mund të zbres
me një medaljonin të bukur në varr.

skender iljaz braka

Ne Luften Per Te Mbijetuar..

Ne luften per te mbijetuar..

Në atë ikje rraskapitëse për në tokën e premtuar.
Larguar shpirtit prej territ të natës.
I putha duke qare nënen e përlotur,
kangjellat e portës dhe rrugicën e dashur.
Putha cimat e ndryshkura të anijes fantazemë,
ankoruar në molin e vjetër mjekërrbardhë.
Putha bregun e lagur dhe baltën e tretur të tokës,
të djegur prej zjarreve të largimit gënjeshtar.

Mbi blunë e detit mbolla mijera lot,
për të vaditur koralet dhe algat e mërgimit.
Udheve të vetemuara pa kaje kthimi.
Mbolla gjithë brengat shkaktuar prej trishtimit.

M'i shqeu marsi egër portat e keshtjellës
se zemres sime me pamje mesjetare.
Hovshëm me ngriti mbi udhekryqet e jetës,
humnerave te mashtrimit për të njohur veteveten.

Shpatullat dhe ballin i mbeshteta mbijeteses.
Si nje pikez vese u hodha mbi ditet gerqerore.
Dhembet i'a shtrengova damareve te jetes.
Me krenarine e trasheguar burrerore.

skender iljaz braka

Në Natën E Fundit.....

Në natën e fundit.....

Eh, ç'mu shfaqë paritmas kësaj nate tek jam në ikje!
C'më erdhe me atë kujtim të largët në kryq mbërthyer.
E fshikur më shfaqesh me një dhimbshuri të amshuar.
Kredhur në magjinë e butë, molisëse të natës së përthyer.

Me fërshëllimën e një shigjete të vrazhdë më vërsulesh.
Prej vdekjes më zgjon me oshëtimën e dallgës së tërbuar.
Si një fërgëllimë pranverore që degët e veshura ç' ngjeth.
Ti shtratit tim të vjetër mu derdhe si dikur duke gulçuar.

E braktisur, vite më ke ndjekur si livadhet në perëndim.
Kryeneçe dhe e verbër si mushkë e vjeshtës së moçme.
Atëherë fluturimin kishe marrë me ngathtësinë e yjeve.
Nëpër turbullirën shkumëzuese plagosur prej të ftohtit.

I platitur kisha mbetur si më i pa fati armëtar.
Thyer prej stuhis së potershme nën lotët trishtimi.
Shurdhuar prej muzikës së madhe të botës së vvarë.
Nuk dita të dalloja ngjyrimet e puthjeve të ethshëme.

Por prap dhimbjen se nxorra kurrë prej buzëve të mpira.
Megjithse dhimbja frymëmarrjen dhe gjoksin ma thërmoi.
Humnerave përherë rrokullisesha prej djegiesh të nxira.
Gjer ditës që vidhisja ujërave të çmëndura më dërgoi.

Oh, ti vepër kuli kthyer në dritë të qartë vetëtime!
Oh, oqean pikëllimi, që çastit të ftohtë s'ju dorzove.
Prej varrit me hov më ngrite me ndjenjën më sublime.
Që një ditë me dashurinë tënde përtej varrit të më çoje.

skender iljaz braka

Në Një Re Bardhoshe.

Në një re bardhoshe.

Fiksuar në qiell si një re bardhoshe.
Nën lastarët e pishës çdo ditë ngre një rën dorë.
'Monoliza ime' mbi atë re që purpuron,
shoh sytë e tu të ëmbël, të bukur, qiellor.

Profili yt i brishtë me vezullime rubini.
Me atë zjarr të magjishëm, prej rrezesh praruar.
Më tërheq në atë cop qiell, që mbetet i imi.
Në dritë-hijen tënde të fshehur, të pashuar.

Një ditë një erë marroke, renë m'a davariti.
Por tej atje në qiell, ti mbete e pafshirë.
Nën pishën e butë, të vështroj i përmallur.
Nazemadhja ime, si një engjëllore e dliir.

Mbi detin e pafund të ndjenjave m'u hidh.
Rrëmbama ti shpirtin me ndjenjat flurore.
Spirancat tek kjo pishë, për ty unë do ta lidh.
Me shtërngojësat e hoveve të mija rinore.

skender iljaz braka

Në Pesë Kontinentet Kam Dashuruar

Në pesë kontinentet kam dashuruar.
Kam dashuruar gra të verdha, mulate, të zeza.
Në sejcilën prej tyre kam gjetur të veçantën e munguar.
Të përbashkëtin shpirt njerëzor njëlloj kudo të njehsuar,
por dhe kam lënë shpirtin tim prej poeti të rebeluar.

Tani në kokë më ka hypur, një poemë të gjatë të këndoj
për tokën dhe detin e me shpirt të këlthas për diellin.

Këmbyer kam patur me to veç fjalë të ëmbëla.
Fjalë llozhash, muzgjesh.
Fjalë të thëna netëve ngadhënjimtare nën hije mështeknash.
Kemi këmbyer përfytyrime të puthurash,
afshe të shuara prej perëndish të lashta,
margaritare ëndërrimesh dhe tinguj melodik zemrash.

Në të pesë kontinentet kam dashuruar.
Tash që kaq kohë i vetëm kam mbetur,
i hidhëruar prej skamjes dhe varfërisë
kam nisur të rrugëtoj përsëri udhëve të vjetëra.

Zogjëve të bardhë u fërshëllej,
ca nxitjeve të çuditshëme që më vijnë prej kohëve të harruara,
atyre mëngjeseve të bardha, në shpirtëra këngësh të shndërruara.

Në të pesë kontinentet kam dashuruar....
ngjyrat në lëvizje, ngado më kanë bërë miqësi..

skender iljaz braka

Në Pritjen Time

Buzëdetit janë mbledhur me mijëra alga...
Një mori guackash me syrin blu më vështrojnë.
E habitëshme nuhatja e tyre.
Si vallë e din që unë thellë dashurisë
së tyre dua të qëndroj?

Të qetat val, pas pak, do puthin bregun.
Do të mbidhen aty të dashuruarit.
Dashurin time për ta marrë si etalon.

skender iljaz braka

Në Rrethin E Hënës.

Mbi harkun e pathyeshëm të dashurisë më ngjite.
Mbi një lis të motshëm mbir shkëmbit të plakur.
Aty ku çertifikuam të parin takim të përjetshëm.
Dëshmimtare na u bë e bukura mbrëmja e përflakur.

Na u bë ky gur dhe ky shkëmb i pathërrmuar.
Ca lule jargavani, që bleronin mbanë lëndinës.
Rrjedha gjarpëroshe e lumit valë shkumëzuar.
Cicërima e një zogu që dridhej majë dëllinjës.

Nën syrin tënd të djegur prej zjarresh përvëluar.
Mes avujve të nxehtë i humbisja larg eterit.
Brënda meje ti digjje zjarrin tënd të pashuar.
Parajsa jonë ish honi I zvarranikëve të ferrit.

Gjithçka që prej asaj periudhe sot është harruar.
Prej ca rrufeshë që papritmas qiellit gjarpëruan.
Në rrethin e hënës së dashurisë sime të vdekur.
Të bardhin trandafil sërish po shoh të gjelberuar.

E humbura parajsë do të shëmbëllej me një grirorë.
Kur të rikthehesh pas vitesh me zemrën tënde në dorë.
Në rrethin e unazës ku të ndriçuar lam agimet hënore.
Me hirin e ledhatimeve mbuluam këngët e përjetshme.

skender iljaz braka

Në Rrethin E Unazës

Është e gjatë një ditë,
një javë, një muaj...
Dhe një vit është i rëndë në pritje.
Ju shkoni larg, në udhën pa krye të tempullit hije.
Me një tufë flamujësh të grisur shkoni duke rënkuar.
Unë heshtja e gjallë me bukuri të virgjër,
shëmbëlltyra e ëngjëllit dhe djallit të mesnatës,
dëbuar e përndjekur prej jush gjer në varr,
rrekem t'ua ndjek si një mallkim perëndie,
Si një këmbanë e largët, zë shuar, shpirt vrarë.
Ju ikni, ikni, ikni!
Intenerare përherë duke ëndërruar,
ndërsa unë këtu në pritje dergjëm me vite.
Me shekuj dergjem,
përhumbshëm duke ndjekur ikjen tuaj.
Si një mëkatar, harruar në limanin e vetmuar.
Tashmë në radë, pak anije
nga anijet e një kohe të vidhisur kanë mbetur.
Pak. Fare pak rrinë e presin,
Kështu si unë me zemër të helmuar.
Rrethi i unazës së hekurt larg më ka mbetur.
Si një domosdoshmëri flurore,
pa llumëtirën dhe dritën e së cilës,
përherë do të ndihem gjysmë i gjallë,
pse jo; dhe gjysmë i vdekur.
Në rrethin e unazës kërkoj të futem
kështu siç jam.
Me tallaganen e grisur
dhe xhubletën e hekurt.

skender iljaz braka

Ne Shtegëtuam Shkretëtirave Të Varfërisë.

C'dreqin të kam bërë Jetë, që prangosur e lidhur
më mban prej zinxhirësh të tejndryshkur?
Që prej ditës së lindjes marrëzisht të kam dashur.
(Se asgjë në këtë botë nuk është më e çmuar se ty.)
Mbrapsh përse më kthenë emblemën e gënjeshtërt
me fytyrën e një luleje të vyshkur?
Prej ç'mëkati si të dënuarin e galerave më kë përplasur?
Në shpirt përditë e më shumë unë vuaj dhe heq.
Vuaj si i ndëshkuari errësirës nën vrazhdësinë e burgimit.
Nën dhëmbët tërë egërsi një lutje të pazëshme nxjerr.
Zotit Qiell me dëshpërim i lartësohet e përgjëruar.
E prej syve më vrullon të pashpërthyerit e zëmërimit.
Mi morri sot erë e marrosur të gjitha lotët e dhimbjes.
Kufomë pas kufome mi hodhi në të vetmin shtegdalje.
Grryer mendimesh hap librin tragjik të njerëzimit.
dhe përsëri shoh kohën kokëforte, mospërfillëse, mjerane,
Kohën që ne viktimat e saj pamëshirshëm
na çon nxitimthi drejtë përplasjesh të tjera fatale.
Nën rrebeshet e luftës zëshëm vajtoj për gjithë të harruarit.
Në baltën e përgjakur grryej eshtërat e vëllezërve të mi.
Hyjnitë e zjarreve kam thirrur për të djegur të mallkuarit.
Gjithë të zhyturit nëpër mjegullën e zezë të përçmimit.
Oh, por unë isha si ju, të dekompozuarit prej Jetës padrejtësisht,
që në sy shikonim po atë arrugancë të dikurshme.
Nuk isha si të tjerë që nxitimthi shkonin udhës pa krye
duke u kredhurtë gjithnjë e më thellë humnerave të mashtrimit.
Ne nëpër shkretëtirat e varfërisë gjithë jetën shtegëtuam,
me një krrabë në dorë e një thes hedhur supit të rënduar.
Zabeleve të akullta të lumturisë një ditë të vetme s'ju afruam.
Tingujt e këngëve të mbijetesës si zotat lartësive na ngritës
e po ata na vërvitën mbi flakët e zjarreve të pashuar.

skender iljaz braka

Ne Token E Lutjeve Te Mia

Në tokën e lutjeve të mia.

Bjerrur prej zjarrit të zëmrrimit.
Në tokën e lutjeve të mia,
ku agimet e argjënda pas shpatmaleve lindin.
Atje ku fill zë një legjendë, e Mujit dhe Halilit.
Atje ku historia ngjizi gurthemelin e shkrimit,
më pështillen ndër mënd përpjekjet e një ati.
Ngritur mbi vlerat dhe vlerësimin e lutjeve,
që pas portikut të famullisë,
dorën eshtake mbi Mesharin e tij,
si drejtë shekujve zgjati.
- Këtu gërma të arta ndaluni! -thirri.

Vitet që ikën dhe vitet që vijnë,
në të ardhëmen e largët shohim
të projektohen pambarim.
E tashmja kuptimin e saj do ta kish humbur
pa flakërimën e papërmbajtëshme të atij fillimi.
Ndaj, të falem, ty at Buzuk!
Të falem ty ati im!

Shpesh e paarritshemja i pervidhet horizontit.
Ajo që për ne duhet të jetë e nesërmja
e kopështit të trandafilave,
është fatkeqësisht e sotmja e
zbehur prej varferise se mendimit.
larguar prej botës së pasur të ndjenjave humane,
vidhisur prej plogështis së paepur të shpirtit.

Gurë të palëvizshëm, që asnjëherë
nuk mundëm dot ti thërrmonim.
Shtigje nëpër të cilin kurrë nuk kaluam.
Lartësi të bardha, që kurrë si pushtuam
Porta të pahapura, që për vet shkakun tonë,
kurrë pas tyre nuk depertuam.
Shkak të cilin asnjëherë se mësuam.

Në vitet që kanë shkuar dhe në vitet që do vijnë,

ndergjgjja jone po e coptuar ka per te kaluar.

Unë të falem Ty, at Buzuk!

Të falem Ty ati im, që në tokën e lutjeve të mia

Rrugën me gërmat e magjishme ke shtruar.

skender iljaz braka

Ne Zemer Te Netevee Te Tua

Qyteti im i madhërishëm,
nokturn i endërrave të mia gjymtyrë prera,
pa detin asnjëherë s'të kam kuptuar.
S'të kam kuptuar pa amfiteatrin antik
dhe muret e tu prej guri të latuar....

Ditët e tua të mundimëshme
kur me valët mërmërisje ledhatuar,
u bënë klithmat e para të poezisë sime,
që me shpirtin e zemrës t'a kam kënduar.

Varrosur nën gërmadhaat e tua,
mbetur janë psheretimat e mia,
prej dhimbjesh lënguar.
Mbi llerë si foshnje mbajtur të kam patur,
sa herë që trupin tënd kanë lënduar.

Nën bedenat e Torrës Ilire,
përgjumur flenë me heshtjen e shpatave
dhe këngët e dashurive të mohuara.
Ti kurrë nuk do të vdesësh qyteti im.
Në zemër të netëve të tua kam ndezur poezinë
dhe mallin tend të pashuar.

skender iljaz braka

Nën Ngashërim Të Shpirtit Do T.Më Gjesh

Nën ngashërim të shpirtit do t'më gjesh.

Ngado, me një tufë ëndërrash në sy, të kërkova.
I njoma ditë-netët me njolla lotësh.
Me shkopin e lypsarit pas kreshtash të ndoqa.
Vaheve lumenjësh ku parfumojnë ujërat e briskëta.

Më tundonte vështrim i largët i së ardhmes
Dridhej nëpër flakë si të ish një re e dëndur.
S'di ç'më ndante, tek vetvetja ç'më bashkonte.
Të ndiqja pa u lodhur, si të isha rob i çmëndur.

Kurrë se shova për ty shpresën.
Atë, që thellë shpirtit më gjëmonte.
Dheu s'do më treste pa të puthur.
S'ndihesha as i gjallë e as i vdekur

Mbase flije luadhit të shpirtërave të përjetshëm.
Me flakë të padukshme duke më djegur.
Thirrur prej kujtimesh, butësisht më vije pranë.
E po aty, si shënjtore, me një brerore drite ikje vjedhur.

Nuk dua t'më besosh se nëpër botëra të panjohura.
I lodhur, i uritur, nën qiell të hapur unë kam fjetur.
Fatin me k'ta thonjë kam gërrvishtur, kam çjerrur.
Me zemrën e përgjakur duarsh, arratisur, i përndjekur.

Pa zjarr më mbeti shpirti, pa një grusht hi.
E prap kam besuar se shkëmbin loti thyen.
Se tek ty do të vyshket porsi gjethi zëmërimi.
Nën ngashërim do t'më gjesh e mekur, e zhgënjyer.

skender iljaz braka

Nën Ngashërim Të Shpirtit Do T'Më Gjesh.

Nën ngashërim të shpirtit do t'më gjesh.

Ngado, me një tufë ëndërrash në sy, të kërkova.
I njoma ditë-netët me njolla lotësh.
Me shkopin e lypsarit pas kreshtash të ndoqa.
Vaheve lumenjësh ku parfumojnë ujërat e briskëta.

Më tundonte vështrim i largët i së ardhmes
Dridhej nëpër flakë si të ish një re e dëndur.
S'di ç'më ndante, tek vetvetja ç'më bashkonte.
Të ndiqja pa u lodhur, si të isha rob i çmëndur.

Kurrë se shova për ty shpresën.
Atw, që thellë shpirtit më gjëmonte.
Dheu s'do më treste pa të puthur.
S'ndihesha as i gjallë e as i vdekur

Mbase flije luadhit tw shpirtërave tw përjetshëm.
Me flakë të padukshme duke më djegur.
Thirrur prej kujtimesh, butësisht më vije pranë.
E po aty, si shënjtore, me njw brerore drite ikje vjedhur.

Nuk dua t'më besosh se nëpër botëra të panjohura.
I lodhur, i uritur, nën qiell të hapur unë kam fjetur.
Fatin me k'ta thonjë kam gërrvishtur, kam çjerrur.
Me zemrën e përgjakur duarsh, arratisur, i përndjekur.

Pa zjarr më mbeti shpirti, pa një grusht hi.
E prap kam besuar se shkëmbin loti thyen.
Se tek ty do të vyshket porsi gjethi zëmërimi.
Nën ngashërim do t'më gjesh e mekur, e zhgënjyer

skender iljaz braka

Nën Shënjëzimet E Mia Të Dënimit.

Nën shënjëzimet e mia të dënimit.

Ikrrusur nën shënjëzimet e mija të dënimit.
Unë shpirtin dhe një here dërgoj përtej varrit.
Shqetësuar sërish prej një mëndjeje të çartur.
Ndjej rikthimin e vuajtjeve, që dikur kam patur.

Nuk bëzaj. Si mali ndihem nën peshën e akullt.
Verbuar si astrologu, prej apokalipsit të marrë.
Mbi kokën time, yjet formojnë kurorën e plakur.
Me të vdekurat legjenda, përvëlur nëpër zjarr.

Ndër pranga i lidhur, nën lekurën time i tretur.
Ku damarët e plogështuar tmerrësisht më therin.
Mbush grushtet me flokët e mi të përthinjur.
Dhe lotit të helmuar ia thëthis gjithë vrerin.

Të erdha mes shkulmash të përgjakura sythesh.
Drejtë teje udhëtova për të qënë i përkushtuar.
Zë klithmash të nxjerr dhe ti coptoj me gishterinjë.
Mbi të krisurat dallgë të vetëdijes të gjej qetësinë.

Mbi shënjëzimet e mia të dënimit dua të ngrihem.
I ngashëryer dua të përmbys minaret, t'i thyej.
Antenat majë taracash t'i shkul, t'i coptoj.
Dekoret në sheshet e nemitura me një dorë t'i shqyej.

Udhën dua t'i hap një burri, veshur me rroben e agonisë.
Të kalojnë me radhë qytete me shikim të trishtur.
Ara të vdekura me gjithfarë shkurresh .
Një pranverë e urtë, që vjen me buzë të plasaritur.

Me dorën time dua të prek trandafilin e urrejtjes.
Që lulëzon mbi ngrehehinën time të përçudnuar.
Ku përmes një rrjete merimangash të pa çthurrura.
Përditë lind dhe vdes një kusar i vetmuar.

skender iljaz braka

Nënës

Në ninullat e mbrëmjeve,
kur djepit më perkundje.
Kodin e jetës më hidhje mbi fytyrë.
- ritmu biro si pëllumb i bardhë, , -më thoshe.
- si një yll i rrall, ritmu biri im

Me ungjillëzime e fjalë magjike më këndoje
për kohën e perëndive të mohuara
dhe veten nënëzo në heshtje e mallkoje,
që një rrobë më tepër s'kishe
të ftohtin prej trupit t'ma largoje.
Që një copëz bukë më shumë se kishe
të egërën uri preej barkut të më shuaje.

E shtrenjta nenezo mendimet m'i perkedhele.
Me butesi mëndafshi, si një vello hedhur.
Fjala jote ëmbël rridhte si ujërat nëpër lugje.
Si buzqeshje maji me aromë lulëkuqe.

Në bebëzën e syrit e gjallë më je ngrir.
Nëna ime dashur, nëna ime mirë.
Dhe pse thinjur je, tretur gjer në kockë.
Më e bukur më dukesh se një xhevair.

skender iljaz braka

Nëse Ti Më Do Me Të Vërtetë.

Nëse ti më do me të vërtetë.

Nëse ti më do me të vërtetë.

Një çast s'do të mundesh të rrish pa më kujtuar.
E nëse gjumi rëndë s'të kthehet në rrëmet
Mos më thuaj se ditët pa mua ke jetuar.

Përpara ca gjërash të ndryshkura mbylli sytë
Minutat mbrapsh nis e numëro e tensionuar.
Përpara syve mba imazhin tim të vrenjtur.
E mërmëriti në heshtje kujtimit tim të paharruar.

Nëse ti më do me të vërtetë.

Mijërat e kilometrave në qofsh larg.
Në centimetra do të mundesh të t'i kthesh.
Nën një qetësi rrënqethse mos më rri e trishtuar.
Syve të tejmbushur me dashuri pritshmërin do të shpërthesh
Se shirtin prej vdekjes s'do të mundesh ta mbash të robëruar.

Nëse ti më do me të vërtetë.

Veten përjetësisht s'mund t'a mbash
Pas hekurash të burgosur, nën torturë.
Në vetminë tënde pikturo një copëz det
Sillma dhe fol me mua që kam vdekur mbi një gur.

skender iljaz braka

Netëve Në Lirishte

Më grishte çapkëllëku yt prej vajze lozanjare.
Ndaj frymëthërrmuar ngado të ndiqja çmëndurisht.
Prej diegies përvëlur, për të patur gjithmonë pranë.
Si pupël e çngjyrosur i vërtitesha ajërit vazhdimisht.

Kështu nisi meduza ime, o tirania e vogël përvlimtare.
Një ditë viktimë i mbeta shikim tënd të heshur, djallëzor.
Si rob iu dorzova thëthitjes së syve të tu prej nazemadheje.
Sa më të bukurin tingull të quajta, midis tingujve qiellor.

Në lirishtën e qetë ku veç hëna na vështronte.
Të dy fillikat, si ëngjëj të pashkës së trandafiltë.
Përmes lutjesh të pëjetëshme të burimeve ujore.
Nën një zjarr ngrice, ne shkrinim e tresnim dashurit.

Ndodhi që mes flokëve të lëshuar krahve përmarrishëm.
Gjer tek gjinjët e ndulkët unë të humbisja i përhumbur.
Veç nesh në lirishtë s'kish gjë tjetër atij çasti të magjishëm.
Dhe kërcëllimës së lehtë të degëve gjethe shkundur.

Në mënyrën tënde të fshehtë e të parrokëshme.
Kur fytyrat në një të vetëme treteshin më thëthisje.
Ne ndiheshim të etur e grishur prej të njëjtës dashuri.
Gjersa nata gjithçka tonën shndërronte në tmerrisje.

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - ++35 Korifenjë

++35 korifenjë.

Me pikëllimin e heshtjes
ata hyjnë nga një deriçkë,
të bindur mbajnë vesh e dëgjojnë.
Nuk çuditen prej mjaullimës së menteshës,
as prej njollave të ndryshkut,
që kanë spërkatur ngado fytyrën e vjeshtës.
Nuk çuditen nga luginat e përlotura të natës,
as prej rrugicave ku humbasin drejtimin fjalët.
Sa herë i kanë shuajtur zjarret nëpër natë
dhe me ëndërra të hidhura
fytyrë ia kanë lagur kohës dhe qiellit.
Me kënaqësinë e vuajtjeve kanë zbritur ngadalë,
nëpër ca udhë të vdekura kanë shkuar drejtë ferrit.
Atje ku dhe mehja e gjakut ka njollat e diellit.
Gjer tek mua mbrrijnë jehonët e këmbanave
dhe cipëzat epshërore të lugëve të kuzhinës.
35 fretër janë pak a shumë 35 nxënës,
që të revoltuar tentojnë të demonstrojnë një dekorë.
si të jenë një trup i vetëm,
kur kokat u bien e u përplasen mbi dërrasë,
ku prej urisë dhe lodhjes s'i ndjenë më muskujt e tyre të vdekur.
Ky është më i vjetëri ritual që s'mund të ndalet.
++35 të prangosur që nga 35 deriçka hyjnë në një klasë,
me vrunduj të pandalshëm ëndërrash,
a nuk janë një trup i vetëm,
që hynë në një klasë të vetme
me vetminë e natës së mistershme?
Janë 35 -së që koridoreve të shkollës ulërasin,
si 35 pëllumba që nën një çati të rrënuar guasin.
++35 martirjanë nuk janë 35 jeniçer.
Ata janë ++35 revolucionar.
Janë ++35 korifenjë që kohën me grushte këngësh godasin.
C'kisha ndër mend të thosha vallë?
Ah, ç'më humbi kuptimi i saj.
Koridori dhe deriçka e vjetër ku hyjnë e dalin njerëz.
Dhe ky i vjetëri ritual...

Ku ne kërkohet të lindim e të vdesim Njerëz.

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Ah Ti Uri

Ah, ti Uri!

Nën psherëtima të mbytura, të pazëshme ngrin.
Dhe në gur shkëmbor më kthehet, i hidhëshmi lot.
Me një zog pa flatra ngjaj, me shpresën time miturake
që këta akujt dimëror s' mundem t'i thyej, ti çaj dot.

Me ankth e nën rënkime të mekura pres pranverën.
Përmbi hapat e mia të ngurtësuar të buzëqesh.
Mes dhimbjesh, në çdo kohë ta vras skëterrën.
I pangrohur në çati një ditë të vetme të mos mbes,

Ah, ti Uri! Ti ndjenjë e ethëshme, e papërmbajtur.
E burgosura e përthinjur mes lotëve e përflakur.
Mes hekurave të tu të akullt, shoh çdo ditë robërimin.
Dhe ndje ulërimën e një ujku mbi dëborën e përgjakur.

Ti je dora që zgjatet përtej errësirës.
Mpirja e dhëmbëve je mbi venat e rraskapitjes.
Je ulërima në heshtje e mëkatit dhe mëshirës.
E pandjeshmja puthje e vdekjes dhe përpëlitjes.

Ah ti Uri! Ëngjëlli i vdekjes me krahë të coptuar.
Prej teje në heshtje i zvarritem oqeanëve të zinj.
Mbi gjakun tim dhe ujërat e kripura të shuaj etjen,
Siç shuhet guri gërqeror nën përvëlim.

Nën thatësira mjegullnajash kam për të mbijetuar.
Asnjëherë pa harruar së paku emrin tim, Njeri.
Se veç me frymën e tij në jetë jam dashuruar.
Dhe vdekjen prej një përbetimi e pres me qetësi.

Ah ti Uri. Ti zot i paemërtuar që shpirtërat ke tharë.

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Aleksandër Moisiut

Herë më humbet
me hijen e mërgimtarit të natës.
Herë më shfaqesh
me hapin e endacakut të palodhur.
Qytetit të përhumbur i ringjallesh si Promethe.
Kur vjen në duar, jo me kokën e përgjakur të Makbethit,
por me përkrenaren e mbretit tënd Skënderbe.
Kur interpretoje Moisi veshur me lulet e atdheut.
Kur qeshje dhe kur qaje
si lis i thatë, rrahur prej erës.
Atje, ku ti bëje të rrënqetheshin arteriet.
Ku bëje të kërcisnin miljona dhëmbë të bardhë.
Unë vdekjen gjeniu im atje e doja,
në skenën tënde, madhështore të Vjenës.
Prej gojës tënde ku lindënin magjishëm tingujt.
Gjer tek unë vinte dallgëzimi i ëmbël e joshës i detit.
Mbi ngricat e kohës ngrihej buzëqeshja jote ëmbël
dhe qerpikëve të ulej dallëndyshja e vogël e gjebër.
Ti vije me shpirtin e plagosur të Hamletit.
Me Figaron që bëri të çndet pas tej regjizori Reinhard.
Ti vije Moisi me një buqetë trandafilash dhuruar skenash.
Ti vije me shprehjen e magjishme të syve të tu të kristalt
Atëherë vrullshëm gjallote tek ftyra jote e zbehtë.
Lëviznin ujërat e praruara të lumenjve
të përhimëtat mjegulla pështjelluar me tis.
Ti më sillje Moisi tok me një rrolet e tu të pavdekshëm,
klithjen dhe dhimbjen e madhe që ndjeje,
për brigjet e Shqipërisë.

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Opti I Vargjeve Të Mia

Frymën ndjej të më merret në këtë varfëri morale.
Një tjetër goditje marr prej kësi anomali antivlerash.
Shpirtëra të helmuar prej temjanit të përgëdhelive.
Si prej hambarëve të sëmundjeve të përzishme dalin,
E papushim zukasin mbi pirgje të kalbëzyera plehrash.

Prej plagës së gjall më kullon gjaku i purpurt.
Rraskapitur i zvarritem kësaj udhe poshtëruese.
Të plasariturat buzë prej thirrjesh dhe rënkimesh.
Në kreshta dredhore dallgësh më kthehen
për ezofagët që veç nxjerrin britma kërcënuese.

C'gjë njerëzore i ka mbetur trupit tim gjysmë të vdekur,
tani që i lodhur ndihem, i shkatërruar, i pafuqishëm?
Në qetësinë e rrudhave të thella jeta më është mbledhur.
Mbledhur janë aty dhe imazhet e ëngjëjve fluturues,
që qiejve hedhin kaltërsinë e syve të tyre të mahnitshëm.

Sakaq me ballin e rrudhosur të poetit të përthinjur.
Diku në një cep kthine të pastër kërkoj të çlodhem.
Aty, me shpirtin tim të pamposhtur dua të pres vdekjen.
Mes zbardhëllimit të dëborës rrëzuar prej shpatmalesh.
Gjithë opti i vargjeve të mia në aromë lulësh le të kthehet.

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Ernesto Guevara.

With your picture in the bay,
of love and longing tight,
hurry through your bloody ways.
Roads where your foot standing strong.
Staring from the wild fire and hunger of the people.
Hurry after your warm wind,
thoughts and push towards another world.
Your view of freedom want to touch Guevara.
Freedom, which lifted the madhërishmen pillar.
Ernesto, to stay alive in millions of hearts.
Millions of hearts in white lily
today are turning to you.
On that October day Vallegrandes
rain mourners threw around the world.
In a forgotten grave,
the parealizuarën, your hope
with the gray mud of wounds, covered.
But from wounds received in the breasts
Your dreams took flight.
Hasta La Victoria Siempre!
Hasta La Victoria Siempre!
My Guevara,
please
stay awake for me a second! '

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Bregu S'Do Te Kishte Shpetimtar

Bregu s'do të kishte shpëtimtar..

Mbushur me helm është sot zemra ime.
Po ashtu dhe buza e rrudhura parakohe.
Më mirë një i çmëtur i detërave të isha.
Sesa vetmitar të rroj, kështu pa dashnore.

Një të dashur që pata më braktisi një natë.
Mbi jetën time ajo derdhi gjithë helmimin.
Fole merimangash, o mik, më derdhi në shtrat.
Si shpirtit tim dhe yjeve ua morri vezullimin.

E desha marrëzisht dhe përsëri do ta dua.
Si qelq të thyhet bota në miljona thërrime.
Mbi shkumbimin e saj do të ngrihen gjithkund.
Vdekja dhe flakët përvëluese të dashurisë sime.

Dikur m'i puthte buzët gjer në dhimbje.
Dhe shpirtin m'a coptonte me syrin ziliqar.
Se dija se thellë detit anija jonë do të mbytej.
E bregu në buzembrëmje s'do të kishte shpëtimtar.

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Bukuri E Pikelluar

Bukuri e pikëlluar...

si një pulëbardhë e përzishme
që mbi kreshta valësh vërtitet,
endesh trishtimit tim të thellë.

Limazhdës së bardhë më tërheq
për t'më kthyer në një copë akulli të ftohtë.

Ulur në ishullin tim të vetmisë,
mbedhur mendimesh të papërcaktura,
kurmi yt më thërret për t'më zhytur
oqeanëve të pafundeme të çmëndurisë.

Një mijë vjetë me ty kam jetur
dhe njëmijë vjete do t'më duhen
që me ty të vdes.

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Ecja Jote Ee Perjetshme

Ecja jote e përjetshëme.....

- Mirmbrëngjes mik! - të përshëndes.

I gaxhahutur sytë mi ngul me një shikim të shqetësuar
e përshëndetjen më kthen me frymimin e një të vdekuri.

- Tungjatjeta burrë! - thua. Nuk ndal.

Me ritëmin e përjetshëm të hapit, pa e ngadalësuar
shkon drejtë një mëngjesi të amullt me zabullimë.

me zemrën të thërrmuar në gjoks prej dëshpërimit.

Supit të takëllojnë takëmet e përditshëme si armët e luftimit.

Thellësive vajtimtare të shpirtit të shpërthen dhimbja vetmitare.

Shpërthen rënkimi yt i gjatë,

si mallkim për fatet e helmuara Hamletjane.

E në këtë ecje viganësh,

ti pas tërheq pegasin e mbijetesës tënde elegjiake.

Ti, burrë i ashpër si mallet ku u rrite,

si njeri që këtyre viseve u fryve që prej kohërave biblike.

Ecën e shikimin tej horizontit të mënxyrt e ngul,

si shpresë për ripërtëritjen tënde të pashmangshëme.

Kumtin e zi të vajtimit të thellë e të thatë

lëshon në mesin e kësaj boteje mjerane

dhe pse s'je skudëra e perëndimit, por mëtuesi i tij,

morfema që pas perëndish lidhi nyjet populusjane.

Me një të paralizuar në ferrin e ngrirë më përngjan.

Ndërsa unë hija jote e përjetshëme të ndjek pa zë.

Përara syve të shfaqen imezhe të paimagjinuara.

Me vete ca fjalë shqipton, rrëz një mali të rrëzuar.

E megjithatë ti ecën.

Në duar bastardësh ecën i vetvlarë,

me ritëmin e përjetshëm të hapit, pa e ngadalësuar.

E në këtë ecje të përjetshëme,

duke përshkuar misterin e plogësht të pyjeve e fushave gërnjare,

ti sikur ravijëzonë konturet e kafshuara të atdheut

me mpiksjen e ngrohtë të gjakut ndër damare.

E di që ti nuk je hija e vetvetes, as zemra e lotit,

që bie mbi lagështirën e vegimeve të një lisi të tharë.
Prej paaftësive të tua, ti nuk je viktimë e viktimizuar.
Nuk je ëngjëlli ideal i lirisë ëmbëlake pagëzuar në altar.
As peng i të panjohurave të ashpëra i një zemre të lënduar.
I grryer mendimesh prej padrejtësish gjithëkohore,
me qytën e dashakeqësive shpesh të kanë qëlluar.
Ty shteg i syrit asnjë çast nuk tu drodh.
Muzgut me krisma të thekshëme ngarkuar.
kurrë s't'u përkul qepalla e rënduar.
Udhës tënde të pështjell prej mjegullës së errët ece.
Ece vetmitarë kryelartë përmes dhëmbësh i kafshuar.
Një hap më tepër duke bërë, një fjalë më pak duke thënë,
kohën për të fituar.

Ti je një copë mish prej mishit të tokës tënde të përgjakur.
Frymëmarrje për mushkритë e saj të coptuara je.
Je zemra në gurin e pathërrmueshëm të malit vajtimtar.
Ashta e pathyeshme e trupit në ball të kohërave gdhëndur.

Tash ca kohë të ka mbetur veç e gjata pritje e pashpresë.
I djegur prej tërë vështirësive të një përvëlimi tërësor.
Djallëzitë e përditshëme shkallmon mes britmave dhe heshtjes.
Me shtatë lëkurë të përcëlluara, zbukuron sytë e së vërtetës.
Sytë e viteve, muajëve, orëve, që zvarriten të përtuara.
Rropatur e lodhur prej zhgënjimesh e kohësh të mohuara.

E lodhshëme dhe e rëndë është ecja jote shekullore.
Ecja jote prej druvari, minatori, ecja prej baçevani.
Nëpër zymtësinë e kohës pash më pash i bie errësirës.
Si teli përçues i fatkeqësive nën ashpërtsinë e kalbësirës.
Si detonatori i zëmërimit nën burgun e nënshtrimit.
Si dhëmbi i urisë, që përtej telave i hakërrehet skëterrës.
Si etja e pashuar e gjarpërit, që nxjerrë dhe sytë e humnerës.

Shpesh të braktisur shpirtin ke ndjer të kredhur nën helmim.
Prej mallkimit i mbërthyer mes tërë dënësive njerëzore.
Por në trikëndëshin satanik të ardhmen kurrë se vare.
Me plagët e shikimit nxiton përtej portave të harruara qiellore.
Ngarkuar ecën me lot e dhimbje demoni yt i arsyes.
Shpesh herë penguar prej pamëshirshmërisë së shfrytëzimit.
Prangosur në dinjitet brënda një kafazi të shqyer.
Përmes përpjekjesh të vetmohuara, duke pështyrë e urryer.

Mbi ç'shtrat të papërkundur lindi kjo djall liria jote?
Ky mendimi yt i çmëndur prej paprekshmërie virgjirjane.
Mes përpjekjesh mbijeton i mbyllur në shtatë palë varre.
Në këtë truall të martirizuar, produkt i një pjelljeje makabre.
Mbi llumërat erëqelbura e mbi dëshira të flamosura.
Nervi yt i arsyes, vilar i përgjakur në vlefshmëri gozhduar.
Ndaj gjer në vdekje i mbete jetës një rebel i pashtruar.

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Eja Sonte, Eja!

Eja sonte, eja!

E vdekur ëndërrës sime të trisht iu shfaqe,
tej një vëndi të çuditshëm mes gjethe mullagash.
Gjysmë e varrosur në rrënjët e një qiparisi të plakur.
Unë erdha dhe shpirt prej shpirtit tim të dhash.
E ti mostra ime mu riktheve e bukur, e ringjallur.

- Eja sonte të thashë.

O e bukura e përrallave të moçëme!
kësaj mbrëmje të vakët vjeshte mistike.
Digjëma prrushin e fundit të këtij zjarri përvëlues.
Në shtatë portat e qiellit të hapur,
zemrën time të përgjëruar për ty, ngjite!

Eja sonte, ti zanë me parfumin e luleve të bjeshkës.
Arratise erën e rëndë të dashuris sime të vdekur.
Uljonja ime e adhuruar, Shëmbëllimiim i përgjumur.
Shpirtin mizor çpoma, me duatë e tua si trandafilat e egër.

Eja, të ngatërrohem flokëve të tu të mëndafshtë.
Gjitë harresat ti thith në honin e buzëve të shkrumbuara.
Duke u dridhur vritëm në mjerimin tim të dhimbshëm.
Me forcën e magnetizimit të epshit,
në një të vetëmë bashkoi zemrat tona të binjakëzuara.

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Gjithçka Eshte Një Hiç Dhe..

Gjithçka eshte nje hiç dhe hiçi është gjithçka.

Mendime të grryera gëlltit moçalishtja e papjekurisë.
Rëndomë shpresën e vetvetes vret momenti i nxituar.
Një grusht mendimesh shoh ngjitur altarit të maturisë.
Përreth tyre të errëtat mjegullzeza dhëmbë shtrënguar.
Nëpër të vetmin shteg të pamundësisë ringjitem.
Rrëzohem përmes zhurit të përbaltur, ndotur shirash.
Vetëdijshëm përpiqem t'i anashkaloj honit të konfliktit.
Me mund i përzgjatëm një rrezeje që përthyer rrëpirash.
Mëkot rrekem të kapem pas fijesh të padukshëme të hiçit.
Aty ku gjëndet një e vetme fjalë kohën për të helmuar.
Ku një jusrifikim i pabazë gjëndet për të vrrarë mirësinë.
Gjëndet atje dhe një mjet ndërgegjen për të shkatërruar.
Dhe ca helm "of demagogy" për të çoroditur njerëzimin.

Më kanë mësuar se bota asgjë nuk mbart me tepri.
Se lufta për të vërtetën nuk është aspak një sakrifikim.
Se në tërë universin gjithçka merr kuptimin e mirëfillt të tij.
Kur arsyeja arrij të vetzbuloj domethënien e çdo materializimi.
Kur shpatë e Demokleut thyhet përpara çdo pakti.
Atje ku del një tym, nën të ndezur është një zjarr.
Atje ku gjëmon një këmbanë, është një besimtar.
Kotësia humbet kuptimin kur shmang mashtrimin.
Politika si kurizane krihet kur se lëvrojnë ustallarë.
Gjithçka eshte nje hiç dhe hiçi është gjithçka.
Ky është më i hidhuri realitet e lumi ai.....
përsëri them: e lumi ai që materien në sy e ka.

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Koha Per Te Vdekur Eshte Koha Per Te Rilindur

Koha për të vdekur është koha për të rilindur.

Kohë pendese derdhur permes currilit të plakjes.

Kohë e pakët mes dy jetësh thinjur dhe rinuar.

Një kohë refleksionesh të mëdha, përsiatjesh.

Kalërim i dashuris përtej dëshirës dhe vdekjes.

Kohë pritjesh për tu përqasur me një botë tjetër.

Me prehjen shpirtërore dhe butësin apostolike.

Kohë ikjesh për në vëndin vakant të vetmimit.

Përtej piskamave pohuese grirore të fatit.

Prej njërës rrëshqitje në tjetrën kreshpërohet shpirti.

Zbutur prej zjarrit lëbyrës të hithrës nën dobinë e mëkatit.

Atje ku zjarret digjen pa tymëra dhe zhurmë.

Eshtë koha mbi veten të sundosh i grryer nga uria.

Të mos largohesh si një mbret i mundur nga zia.

Ditët e shkuara dhe ditët në rrugëtim.

Në kohën për të vdekur thërrasin këmbanën madhore.

Përulen si dallgë të poshtëruara prej vetvetes

dhimbjet zhbiruese të fluturimit në amshim.

Gjethet e thata gërvisin tulin e frutave të papjekura,

dhe turpin e gjithçkaje larë prej njollave të nderit,

mbetur të përlotura udhëve të pashfrytëzuara.

Më e pangushëlluara ziliqare zgjuar fundit të pafundëm.

Si ndërgjegjësimi i tretur përmes buçimave të sirenës

përpara fytyrës me përtëritjen e përhershëme, madhështore.

Koha për të vdekur, kohë e ndërmjetme në paqëtim.

Prekni aty frymimin e pluhurit të zbardhëdhyer!

Mësoni aty njehsimin e gjuhës së të vdekurve me

atë të të gjallëve me plagë trupi pashërim.!

Koha për të vdekur është koha për të rilindur.

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Kur Thyhej Vjeshta....

Kur thyhej vjeshta....

Kur thyhej vjeshta,
nën një përzierje vaji dhe tingujsh,
mes pikëzave të fundit të shiut humbiste portreti yt.

Lot të dhimbshëm i pikonin qiellit zëmërak.

Si një pupëlz imcake mes dëborës së parë,
që kishte nisur të binte mi përvidheshe syve,
mes pyjeve gjetherënë duke shkuar larg e më larg.

Në dhomën time heshtjekallur,
një çirmë e dobët ngatërrohej mes librave.
Ngatërrohej mes rreshtave.
Ngatërrohej mes fletëve gjysmë të shkruara të poezive,
ashtu siç hynin e dilnim prej qënies sime,
tingujt e trishtuar e të zverdhur të vjeshtave.

Rrethuar prej unazash korale të diellit.
Tehut të mbrëmjes i vërtitej hija jote e bardhë.
Me ngurrime rresh të varura mbi pishnajë më ngjaje.
Më ngjaje me puhizën e gjelbër rrugëve të rrëgjjuara.
Më ngjaje me fytyrën time që përpara vegimit tën u ringjall.

Në sfoundin e diçkaje të papërcaktuar
kridheshin sytë e mi dhe kërkonin të gjenin.
Vallë ku ishe e ku fshiheshe ti?
Ende nuk mund të kuptoj se si heshtja pandalshëm
lëviz drejtë këtyre grykëvarreve të errëta.
Se ç'raport enigmatik ka me jetën, vdekja.
Di vetëm të them e dashur se për aq kohë,
ti ishe për mua madhështia dhe vet jeta

S'di pse të kujtova tani që po thyehet vjeshta.....

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Në Muzeun Arkeologjik

NE MUZEUN ARKEOLOGJIK.

Një mendim më risjell ngaherë tek këta portikë.

Tek këto statuja të bardha që me gjuhën e heshtjes
flesin qëprej lashtësisë.

Shikimin të mbërthyer mbaj vragës së të shkuarës
Përhumbur qëndroj pa mundur të trokas në portën e magjisë.

Në imagjinatën time rrënimi i një epoke të herëshme,
rrjedh si shtrat i grryer i një lumi të nëndheshëm.

Pranë një sargofagu të vjetër eshtrash mbledhur,
mundohem të rizgjoj të humburat e asaj kohe të largët,
të pafundemet intriga e dashuriçka mbretereshash.
Përleshje gladiatorësh e luftëra të përgjakshme rromakësh.

Në të largtën kohë, shekujsh të përgjumur
jetën riorganizoj, të artin vezullim të qytetit.

Stepur në pamundësinë e botekuptimit
kërkoj dhe një herë të rikthej sërish në krahtë e saj të mbyllur,
ndëgjegjen time të vvarë.

Pertej kufijeve të përgjigjes, një pyetje më shqetëson.

Pezull më qëndron, në padukshmërinë e ndërgjegjes,
si ajëri i vakët në maj ngritur prej parajsës së vdekur,
emërtuar me një emër ende të gjallë

- O Ju eter të lashtë,
demokracine me c'sy aq bukur e kini pare?

Nën vonesën e së njëjtës dritëpamje të humbur
mugërirës

ku, pas kaq shumë shekujsh ende ndihem i vetmuar,
kam kaq shumë udhë akoma për tu rizgjuar.

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Në Tokën E Lutjeve Të Mia.

Në tokën e lutjeve të mia.

Bjerrur prej zjarrit të zëmrrimit.
Në tokën e lutjeve të mia,
ku agimet e argjënda pas shpatmaleve lindin.
Atje ku fill zë një legjendë, e Mujit dhe Halilit.
Atje ku historia ngjizi gurthemelin e shkrimit,
më pështillen ndër mënd përpjekjet e një ati.
Ngritur mbi vlerat dhe vlerësimin e lutjeve,
që pas portikut të famullisë,
dorën eshtake mbi Mesharin e tij,
si drejtë shekujve zgjati.
- Këtu gërma të arta ndaluni! -thirri.

Vitet që ikën dhe vitet që vijnë,
në të ardhëmen e largët shohim
të projektohen pambarim.
E tashmja kuptimin e saj do ta kish humbur
pa flakërimën e papërmbajtëshme të atij fillimi.
Ndaj, të falem, ty at Buzuk!
Të falem ty ati im!

Shpesh e paarritshemja i pervidhet horizontit.
Ajo që për ne duhet të jetë e nesërmja
e kopështit të trandafilave,
është fatkeqësisht e sotmja e
zbehur prej varferise se mendimit.
larguar prej botës së pasur të ndjenjave humane,
vidhisur prej plogështis së paepur të shpirtit.

Gurë të palëvizshëm, që asnjëherë
nuk mundëm dot ti thërrmonim.
Shtigje nëpër të cilin kurrë nuk kaluam.
Lartësi të bardha, që kurrë si pushtuam
Porta të pahapura, që për vet shkakun tonë,
kurrë pas tyre nuk depertuam.
Shkak të cilin asnjëherë se mësuam.

Në vitet që kanë shkuar dhe në vitet që do vijnë,

ndergjgjja jone po e coptuar ka per te kaluar.

Unë të falem Ty, at Buzuk!

Të falem Ty ati im, që në tokën e lutjeve të mia
Rrugën me gërmat e magjishme ke shtruar.

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Romance E Perjetshme

Romance e perjetshme

Nëpër kreshta valësh rritem.
E nëpër kreshta valësh vdes.
Pas sharmit tënd unë çmëndem.
E i çmëndur prap të pres.
Mes ëndërrash nëpër gjum rrëzohem.
Ashtu rrëzuar, imazhin tënd unë ndjek.
Prej imazhit që më humb përmëndem.
Përmëndem prej zjarrit që më djeg.
Me lotin luaj buzë mbrëmjesh.
Buzëmbremjesh ti luan me sytë e mi.
Nuk e di sa e largët më është vdekja,
por që do të vdes me ty në sy, e di.

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Kthim I Mërgimtarit

KTHIM I MËRGIMTARIT

Në një çantë të hedhur i mblodha eshtrat e mia.
Eshtrat e holluara, të çikërrisura punëve të zeza.
Tokës iu ktheva për t'i rrëmber një grusht dheu,
nga dheun i varrit tim ku përjetësisht do të prehem.

Në kokrrizat e tij ngjitur janë gjurmët e tiranëve,
të dishepujve të degraduar me shpirtin e grykësisë,
gjurmët që shkelin mbi gjakun e mijëra martirëve,
gjurmë manjakërishtë që pagëzojnë demonët e mizorisë.

Në gijotinën e djallit kam parë gjymtyrët e mia të prera,
dëshmimtar i një tjetër torture në udhët me kufoma.
Shpirtin bakallinave e humba si qiramarrës i vetëvrrarë,
me po të njëjtin stërmundim biblik ditë-netët i përcolla.

I vetëdënuar, gremisur honeve të asaj çmendurie të marrë,
të njëjtën artisje kam ndier, të fundosur nën përpjekjen,
i përgjakur shtegtova në funeralin e kohërave të zymta.
Unë engjëlli, që në djepin e dhimbjes përkunda vdekjen.

Braktisa ujqërit e mëdhenj, të kthehem përgjithmonë,
në tempullin tim të përzishëm, shtypur nën gërmadha.
Kokën të mbështes në shtratin e gërryer të një lumi,
portretin e ditëve të ardhme për ta thurur me kallëza.

Nën cicërima zogjsh dua të bëjë gjumin tim të vrazhdë,
me shokët e mi në një bar të dehem veç një herë me raki.
Prej malti gjer në palcë jam përvëlur për gurët e sokakëve,
se shpirti i zhuritur më ka mbetur për të bukurën dashuri.

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Asgjë Nuk Do Të Humbas Prej Syve Të Tu

I thinjuri plak e i hequri gjer në eshtra,
si të tokës tënde të ngrën e grryer prej stuhish.
Sytë e tu, përtej kohërave shikimin përcillnin.
dhe etja për liri, prej buzëve të thara të pikon
si rrëshira e qelibartë e trungut të pishës së zezë.

Prej zjarrit përcëllues, lindi fjala jote e urtë.
Lindi mushti i ardhur i mendimi tënd të ndritshëm,
që ti gjer tek unë i dërgove përmes klithmës së lirisë.

Si një tufë karafilësh të kuq letrash të çmueshme,
Më solle me to dhe një kupë me vesë prej Dardanisë.
Vitet e mohuara më solle si dëshmi që kohërat moderne
qëllimshëm me dheun tënd të djegur
Mbështjell e kishin me harresën e mjegullës së rrufjanëve.

Plak i urt.
Zëri yt më sjell aromën ledhatuese të manushaqes.
Mjaltin e e gështenjës së butë të livadheve.
Dhimbjen që me timen takohet si trupëzat qiellore.

Ti shkoje përmes vrundujve të fuqishme të erërave të 81-shit,
që me tërbim udhëve të Prishtinës shkundënin baltën e ngjeshur,
reckurinat e grisura,
rreckurinat e pisura të përbindëshit.

Ti ishe mes britmave të fuqishme të dallandysheve të tua,
që fluturimin kishin marrë të vetëdijshme për çlirim
Atëherë fjala jote mbi zemrat e tyre binte
si copëzat e perlave mëngjesore.

Urrejtja që portat e njerëzve të munduar thyen,
përmes ëndërrash të squllura të shpërtheu.
Dhe zëri yt kumboi mureve të heshtura të qytetërimeve,
për mizorit e pashëmbullta shnëdrruarr në acide bazike.

Gjithçka jotja e dashur kthyer ish në shkreti djerrinash.

Në gjëmbaç të tharë e trungje të djegura bashtinash.
Me ty gjer në kështjellën e Burbonëve erdhi drithi i bukës së bardhë.
Për të parën herë ajo njohu legjendën e Mujit dhe lotin e Ajkunës

Pas teje erdhi atje kripa,
zjarri i oxhakut, drita dhe vetëtima.
Erdhën me ty muzat dhe mushti i ardhur i fshikëllimës.

Atyre ditëve në dritaren e zemrës tënde hyri fladi
i ngrohtë i erërave të reja që tokës tënde do të frynin.
Hyri zjarri përvëlues i Trepçes dhe flakërima e lumit të Ibrit.

Dikush do të dëshironte të harroheshe plak i urtë.
Dikush do të dëshironte parakohe
të varroseshe mes trandafilat e tu.
Po kush mund ta lëkundëte lisin që në acare dimërore
prej rrufesh s'u dogj e gjunjësh kurrë s'u rrëzu?

E si mundet të humbas fara e përzgjedhur e drithërave,
që harlisen lartësive në tokën që kurban u bëhet perëndive?
Si mundet të humbas prej syve të tu makabra e varreve masive.?
Si mundet të humbas syrit tënd miti i pavdekshëm i Adem Jasharit.?
Ti me syrin e djegur në mendimet e Miteve të zhveshura,
eshtrat e të parëve prej thellësive të ftohta të varrit.i ngrite

Vargmaleve të ashpër ku ti u ngjite
Ne do të shkojm së bashku duke kënduar
'Hymnin Kombëtar' me zërin tonë të djegur prej gjëmimeve.
Do të shkojmë atje ku përherë do të çelin zymbylat e lëndinave

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Durrah Varri Im I Madh

DYRRAH - VARRI IM I MADH

Qyteti im - bir i Melisës dhe hyut të detit,
në tre mijë vjet me frymën tënde jam rritur,
jam rritur në furinë e vazhdueshme të rrëmetit.
Në tre mijë vjet kam pirë lotët e tu të kripur,
buzë detit duke vështruar sytë e tu të vdekur.

Sa herë prej vendit ke lëvizur, qyteti im,
prej tërmetesh të llahtarshëm i rrënuar.
Po këtu ku më ke lindur, më ke gjetur,
me shpirtin tënd prej Taulantësh të mëkuar.

Mijëra vjet, qyteti im, të kam pyetur.
Ti veç ke heshtur me heshtjen tënde
prej dheu të kripur e bregu të përcëlluar.
Klithmës sime të çmendur s'i je përgjigjur,
por krahët e përgjakur katërsh m'i ke hapur
e supit më ke mbështetur ballin e përhumbur.

Në rrahun prej algash ma shtrove shtratin prej guri.
Shtratin shekullor që Epidami thellësive kish ngulur,
mbi shkumëzimet e shndritshme
e të vetmuara të detit të tërbuar.
Netëve të kthjellta aty kam fjetur,
duke ëndërruar futurimin mbi krahët e trandafiltë,
të jetës tënde të pagjunjësuar.

O varri im i madh!
O varr gjysmë i mbuluar!
Në tre mijë vjet,
gjithë mendinet e mia për ty kam kryqëzuar.

Gjymtyrëve të tua të djegura kam vrapuar i përvëluar,
duke iu frikur përherë fuqisë tënde të zemërimit.
Prej fashitjes së menjëhershme të një ëndërre jam zgjuar,
ty të kam përqaftuar nën tejdukshmërinë e perëndimit.

Një herë e një kohë ka qënë shkëlqimi yt,

më i tejdashëm e më i thellë se flakërimi i dallgëve,
fytyra jote prej mermeri të kuq,
më e freskët se gjoksi i bëshëm e qumështor i një vashe.
Madhështia jote, qytetërime ka lënë të mahnitur.
Gjymtyrët e lëmuara të luanin shpesh me valët
e dielli ngazëllehej me fytyrën tënde
prej perëndeshe të skalitur.

Tani rreth murit, prej zjarrit të rreshjeve gërryer,
bari yt i blertë prej kohe është zverdhur e zhuritur.
Por deti përsëri mes vështrimesh të rënduara,
me baticat dhe zbaticat e tij të buta,
të përkëdhel e të puth si me gjuhë valësh i uritur.
Kujdesshëm të mjekon plagët e pashëruara,
që ti kurrë të mos vdesësh, qyteti im,
por të mbetesh si i gjallë mes të gjallësh.

Dorën një herë të vetme s'ma ke zgjatur.
S'më ke përkëdhelur kurrë si fëmijën tënd të uritur,
dhe kur me zë të lartë, për gurët e tu kam kënduar,
kur kam kënduar për hirin e perëndive pellazgjike.
Kur mbi shkrimet e sargofagëve të mbyllur
sytë më janë verbuar, përsëri po aty janë ripërtëritur.

O varri im i madh!
O varr gjysmë i mbuluar!
Në tre mijë vjet.
Gjithë mendimet e mia për ty kam kryqëzuar.

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Eja, Merrmë, O Det!

EJA, MERRMË, O DET!

Kaq vite me një cigare buzëve kam mbetur,
me shkrimet e mia shpesh herë i zemëruar.
Përse nuk deshe të më bëje dhe mua shok,
por brigjeve të egra më lë kështu, të vetmuar?

Ngaherë shpërfillës me dallgën tënde që gjëmon,
ia merr ti një kënge të hershme prej piratësh.
O det i honeve të jetës sime, përse ti më tundon?
Dallgëve shqetësimin s'ma merr të ma përplasësh!

Në një copë shkëmb një ditë dhe ti do të ngurosesh,
me të rëndin petk të kaltërt hedhur përmbi krah.
Fatet e këtij shkëmb ku rrënjët kemi mpleskur,
le t'i lajmë ne, o det, me shkulma dallgësh të mëdha.

Trazuar prej një ndjenje të natyrshme njerëzore,
me psherëtime të argasim pulëbardhat lart në qiell.
Eja të ecim, deti im, nëpër shi e mjegull, a gurore.
Veç të brishtat mure t'i ngrohim me pak diell.

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Hyu Im Ilir ...

HYU IM ILIR ...

I mbarë paskësh qenë, Hyu im Ilir,
kur mbi dy rrahe trupin e shtriu gjërë e gjatë.
Nimfat e detit këndonin këngët e përjetësisë,
mirëseardhjen bekonin tok me korifejtë e lashtë.

Dhe lindja ime rastësi s'paskësh qenë.
I ardhur nuk jam nga ishulli sirenave,
ku vdekja vdekjes i nanuriste nat' për natë,
Poseidoni, i zemëruar, detit i ngrinte dallgë.

Lindur jam unë prej brinjve pellazgjike.
Nga deti i përgjakur, i dhimbjes së tij
që dallgët Epidamusit ia futi thellë në shtat,
dhe gjaku i ngrohtë shpejt iu bë rrasht.

Me lotët e diellit tharë nëpër trupin e copëtuar,
me Hyun Ilir, shekujt me mund kam sjellë gjer këtu.
Sot, nuk di përse, Hyut tim i rëndon një qepallë,
dhe trupit ndien të mardhur, shndërruar në një dru.

Unë dhe Hyu për ty, Dyrrah, jemi krenar,
dhe pse na dhimbsesh, kur të shohim kështu.

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Më Gjeti Deti ...

MË GJETI DETI ...

Më gjeti deti mbanë një ane
me kokë mbi gur e të përgjumur.
Në çantë pak ndrresa kisha marrë,
e botës rrotull, si eremit,
i bija cep me cep duke u lutur ...

U lodha unë, por nuk u dhashë.
Eh, mor mik, sa shumë kam vuajtur,
lypsar për punën e përditshme.
Thellë, gjer në kockë më thau era,
e dielli verës më përzhiti.

Por prap me shpirt, k'të qene jetë,
e mbajta fort, e desha shumë.
Paçka se fati i keq me shpirt prej djalli,
si gjeth të vyshkur më vërtiti.

Kështu e paska jeta! - thonë.
- Të mos i qesh buza fukarasë.
Me vdekjen të përfytet, dhëmbë e thonj.
E një pakicë, o miku im,
të bredhë mbi malin e parasë.

Shkojnë...Shkojnë e vijnë kohërat memece,
me ajër deti qesh e rroj.
Ja marr një kënge deri vonë,
më pas mbi gur kokën qetoj.

Kështu rroj unë me gas dhe shpresë
e një mal me halle nën lëkurë.
Rroj. Rroj vëlla. Unë rroj me djersë.
Mes dhimbjesh rroj, me nder të vdes ...

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Më E Çmuar Se Vet Jeta..

Më e çmuar se vet jeta..

Më të çmuar se vet jetën të kam patur.

Shpirtin detyruar shpesh kam bërë të hesht.

Në një pjesë të së panjohures tënde kam jetuar.

Pa e ditur as vet nëse jetoja në të vërtetë.

Në një mesazh dërguar prej erës më thoshte.

Se ti si e marrë ngado më ke kërkuar.

Ndaj sot të kam ardhur me nxitimin e shiut.

Që beharit humbet tokës së përvëluar.

Braktisur prej vetes ku jetuar ty të kisha lënë.

Ncrringur tek sofati i shtëpisë së rrënuar të gjeta.

E ngrysur qënia jote si një vjeshtë e tretë.

Aty ku frymë njeriu s'më përshëndeti "tunjatjeta".

Një llampë vajguri digjëte flakë të mekura.

Përhumbur qetësia jote mbi një libër të zhubrosur.

Pahnike kishe mbetur siç të lash dikur.

Të shkuarën në tri hapa përjetësisht varrosur.

Një tufë pëllumbash flatëruan prej një dhome

Prej kaq vitesh me ta kishe bërë dashuri

Ngallitur pas tyre, asnjë çast pa më harruar.

Si shenjti besuar perëndisë së tij.

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Melodi Te Pergjakura Kengesh

Melodi te pergjakura kengesh.....

Të paharruarit, mikut tim

Adem Gjurgjeviku

Në heshtje errësirës, i vetëmuar shkoj ngadalë.
Përbrënda trupit tim të ndrydhur hapur një tjetër varr.
Me shpirtin e përthyer gjer larg dëgjoj një këngë.
Dhe thonjët e gjishtërinjëve kafshoj fortë me dhëmb...
Gjithë qënien time, vajit lëshuar dua t'ia lë.
I krrusur prej kësaj dite, nën një melodi të trishtme.
Deri në rrënjë flokësh dhimbja më përshkon.
O melodi e pergjakshme pse shpirtim ma kafshon?
Përzier nën lot malli shikimi mi i tretur.
Buzëve që më dridhen, e ëmbëla fjala jote mbetur.
Më gjëmojnë mendimet prej k'tij lajmi më të zi.
O melodi, e pergjakur, që ditës ia çave zemrën.
Përtej vdekjes tërhiqu, lërmë një cast të lir.
Nën përplotjen time të puth k'të burrë të mirë.
Se sot e nëpër vite do t'më mungojë një zë i ngrohtë.
Do t'më mungoj një burrë, një At, një Zot.
Melodi të pergjakur më ndjekin...
më ndjekin e s'më lënë të ec.
Oh ... gjer larg në Rahovec...

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Pas Enderres Se Minerves

Ish dora e zotit që shkroi paragrafet e mëkatit:

Ti e divorcuar...

Unë i mallkuar prej fatit...

Minervën se kisha parë kurrë të përlotur.

Nëpër sy i rridhnin të freskëtat rryma të jetës.

Prej luftërash të vjetra ish tkurrur e ngurosur.

Tani llahtari i një ëndërre befas e kish zgjuar.

Makthi dhe trishtimi i diteve tona të mundimshëme,

me kohë trubullirash dhe përmbyrjesh të mëdha,

me kohë dhimbjesh, ku fjala kthehet në gërmadhë,

ku heshtja prej heshtjesh bëhet më e rëndë se vdekja

dhe thashethemnajat kthehen në grykësira të përbindëshme

Më shëmbëllen statuja me ëndërrat e mia të frikshëme.

Se tregim i shkurtër ish pasqyra e thyer e viteve të mia.

Si gongola me mbingarkesen e parajsës tënde të humbur.

Ne lidhur prej fatit shkonim bashk e dashur gjer atje,

ku rrinte duke pritur vdekjen, vdekja ime, e vdekura.

Atje ku psikozat e lashta mes tabuve të helmëta ishin tretur

dhe gojët e vrerosura jargoseshin nën kalbëzime të hekurta.

A s'ish gjithë jeta jote një keqardhje e pangushëlluar?

A se dije ti se nën rrogoze të lagësht flinite e poshtëra?

Prej jetës e lënduar, nën paprekshmërin e karakterit.

Ty e divorcuara, ty e mbetura më e përgojosura,

ende zemra të rreh nën përpëlitjet e mallkimit.

Ty shënjtëri, që asnjë grimë dheu, prej dheut nuk je

një shënjtëri nën shkrumbëzimet e padenja të dënimit.

Minervën se kisha parë kurrë të përlotur.

Ndaj të prita, të shkonim bashk deri tek të imtat lulevjollce.

Si ngjashmëria që të pangjashmen pret e përcjell nëpër terr.

Shkelur djerrinave të skllafvërisë, ku prehet e liga, e ndyra.

Nën këmbët të ndjejm rënkimet e fateve tona të vidhisura.

Dhimbjet e shkrumbëruara dhe përvëlmin e puthjeve në ete

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Prej Madheshtise Tende

PREJ MADHESHTISE TENDE

Ngaherë diçka forcërisht më rrëmben drejt teje.
Dhe magjishëm më thith horizonteve të pafundëme.
Harbon zemra ime, prej valëve, kafshuar nëpër terre.
Mbi paranoja bredharake, hapsirave të zhurmëshme.

Përtej madhështis tënde, që shpirtit m'a gulçon.
Nën netët e mbushura me gjëmime shkepëtimash.
Ti deti im, me çfarë magjije kaq rënd më përvëlon
Dhe mbi dallgët më përplas me zëmërim vetëtimash.?

Dhe unë nuk di, përse klithmat e tua dua t'i dëgjoj.
Të rend pas psherëtimës së fundit të vajit të koraleve.
Atje ku mes heshtjes ulërasin misteret e ngatërruara.
Thellessive kërënuese dua, të çvarros udhët e fateve.

Tempull i hyjnive të mija, prej algash e perlash ndërtuar.
I magjepsur si një femijë, përpara këmbeve të tua falem.
Për të marrë prej teje gjithçka që ditës më ka mungur.
Prej afshit tënd, në udhën e përditëshme të mos ndalem.

Herë në një copë shkëmb më shndërrove mes tallazesh.
Si Anteu më ngrite, prej diellit përbindshëm zëmëruar.
Herë si një zgalem, më mbajte mes dallgëve të ashpëra.
Ti deti im, prej fuqisë së tokës, asnjëhere s'më ke lëshuar.

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Qerpikeve Te Tu Te Ulem...

QERPIKEVE TE TU TE ULEM...

Udhëve të botës ngado ku u enda,
shkumën e duarve të tua të kaltra
dhe imazhin e valëve të muzgjeve të vona,
me lot mërgimtari, prej mallit tënd, i njoma.

Vij sot të puth sytë prej lotësh të përkripur,
si një trëndalif i lagur, të prek buzëve të tua
që zjarrmojnë në përvëlim.
Të puth ujërave flakëruese, koralet e zvetënuara
e mbi qerpikët e tu prej shkume të ulem,
të thith dritën e një ylli të heshtur, pa shkëlqim.

E ndjeva zërin tënd, o det i brigjeve të mia!
Këtë psherëtimë të zemëruar, të trishtuar e ndieva,
siç ndien nëna rënkimin e birit të saj në djep.
Petalet e bregut dhe stërkalat me të cilat kam kënduar
' Përjetësisht të dua, o i magjishmi, o i mi det! '

Me veshje të vjetra emigranti të rropatur,
t'u ktheva i lodhur prej mallit që më ka marrë.
Një mal me të fshehta të përvuajtura ngarkuar,
të solla dhuratë kësaj nate transparente, të bardhë.

Të jam kthyer djalosh i heshtur, i menduar,
për të gjetur përsëri gjithçka që kam të shtrenjtë.
Përkëdhelitë e tua që shumë më kanë munguar,
dhe thellësitë e kristalta ku ngula thellë rrënjët.

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Qyteti Im

QYTETI IM

Në përflakjen e perëndimit të vonë mbi kodrinë,
kur pulëbardhat vajtueshëm mbi valë krakëllisin,
ti, Durrësi im, si një dhëndërr i urtë, si një nuse e mirë,
qëndron i heshtur me shikimin e ngrirë.

Tri herë i vidhisur, tri herë i ringjallur,
shfaqur si sfinks me fytyrë madhështore.
Nën bedenat pellazgjike, rrënjët thellë ke shtrirë.
Rrënjët e mpleksura, rrënjët mijëra shekullore.

Në arena të përgjakura gladiatorësh,
lotë të kristaltë ke derdhur me pikëllim.
Mbi pellgje gjaku dhe male rrënojash
me eshtrat e të rënëve ke shkruar lavdinë.

Hyjnitë e mermerta, si korale të bardha,
të kanë mbetur ndër vite si kurorë e lulëzuar.
Me dallgët e zhurmshme, me dallgët e paqta.
të kalburit damarë, nga trupi ke shkallmuar.

Vërshuar kanë mbi ty kohërat tragjike.
Përjetësisht mes erërave ke mbetur i rrethuar.
S't'u drodh asnjëherë ajo zemër e mirë.
S'të krisi asnjëherë balli përcëlluar.

I çmendur pas teje gjithë jetën do të mbetem,
pas bukuroshes tënde dhe erosit mbi kalë,
pas mureve të lashtë dhe torrës Ilire,
pas detit të magjishëm dhe të brishtave valë.

Një mijë herë prej teje në u largofsha, Durrësi im!
Një mijë herë nga larg do të puth e përshëndes me mall.

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - U Gënjam, Apo ...?

U gënjam, apo ...?

Koha apo vetveten gënjam, nuk e di.
Tani shndërruar jemi në dy trupa të huaj.
Ti në njërin pol, atë të jugut, e unë, në veri
mes akujsh që dashuria në vijë të pambarimt uji
i ktheu për të gjetur udhën për tek ty.
Ngandonjëherë bëhemi erëra që hapsirash
vërtitemi, humbasim, s'dim ku vemi.
Gur lumi bëhemi, të ekspozuar ndaj qiellit.
Lëndë lisi, ushqim për ata që s'na deshën.
Gjëmbaç të kaltër që askush të mos na preki.
Nuk di si u shndërruam në dy kongjinj të shuar,
Kur dikur na kish patur zili dhe vet dielli.

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Vajzë E Këtij Qytetit Të Harruar

E vetmuara vajzë e këtij qyteti të harruar.
që shkon e vjen përmes ditëve të vdekura,
me ca imazhe mbetur udhëve të ngatërruara.
Me ca murmurima blu buzëve të djegura.

Sonte eje e fli në gjumin e ëndërrave të mia.
që brënda gjumit tënd të trazuar zë dremit.
Prej meje mos u trëmb që syrin e mbaj zgjuar.
E grindem me lugatin që dhëmbët të skërmit.

Se unë s'jam idioti i mëngjezeve të mallkuara.
As i përçarturi që pandalur flet me gjuhë despotësh.
Jam i zakonshëmi që përvesh llërët e munduara.
Orfeu që këndon për zëmëra yjesh dhe botësh.

Unë vij prej nga ku deti frymëmerr
me ëndërrimin e qiejve të përjëtshëm.
Prej nga ku ujëra të mëndafshëta rridhnin
përmes kristalit të ëndërrimit ton të pavdekshëm..

E largëta udha ime aty tek ty, le të prehet..
E lodhur të zgjohet prej tingujsh të coptuar.
Mëngjesi yt i bardh lehtësisht le te derdhet
përmes një shëmbëllimi të trisht, të vjetëruar.

Askush s'do të trokas në gjumin ton e dashur,
Mbi gjurmët tona s'do Pështyj e s'do shkel njeri.
S'do na trembin ulërimat e pështira të qytetit marrak
Nëpër muzgje do rilindim e do qeshim unë e ti.

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Varrmihes I Vetvetes

Të përjetshmen rilexoj në pëlhurën e art të qiellit.
Atë, që pak kush arrinë ta deshifroj mirësisht.
Me dhëmbët shtrënguar, pa nxjerr një fije zëri.
Prej dëshpërimit drejtëvizor i mbytur vazhdimisht.

Më i fortifikuari front ka qënë e mbetet ndërgjegjja.
Ajo, që s'u muarr pa shkarje ujërash të pist nën të.
Mes përpjekjesh satanike shënjtërova anti vlerat.
Që nën çroditjen e përjetshëme njerëzimin të lë.

Më i çuditshëmi varrtar jam i mjedisit ku jetoj.
Ndaj ti ndërgjegjeja ime shpesh më ke dërrmuar.
Kur i tëri më është dashur veveten të shkatërroj.
Forcërisht me të vërtetat e tua më ke përballuar.

Entuziazmin kam shuar e tretur prej makutërisë.
Kur të rëndën këmbë, fortë gjoksit ma ke shtën.
Sa herë me përgjërime t'u luta, t'u fala me gulçime.
Udhëve të frikshëme, si lepurin në lak më ke zënë.

Jam lutja e pëkulur mbi fotonet e valëve të mjerimit.
Mbi vraga plagësh eci, pa mundur të ngjall shpresën.
Në fletët shumngjyrëshe të librit tragjik, të njerëzimit.
Paktin e pakthyesëm kam nënshkruar me dënësën.

Lakuriqësia e së vërtetës jam, që krimin demaskoj.
Më irriton injoranca kur flet me gjuhën e justifikimit.
Jam vetëtima e përflakur, që shikimin qiellit lartësoj.
Për imazhet e shëmtuara jam flakërima e përvëlimit.

Jam më i pabesi gjarpër i shkretëtirës që helmoj.
Më konservatori tiger ndaj bitmave të mekura.
Jam më i panënshtuari luan i savanës që kafshoj.
Shqipja e Andeve, që varret i grryej me kthetra.

Jetë e dyerve të shqyera, që në grusht të kam mbledhur.
Pushtuar më ke, me ethet e tua të pushtetit demonial.

Që me lindjen e pronës, varrmihës i vetvetes kam mbetur.
Më i paskrupullti egoist, për të sunduar kudo si Sovran.

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Zhelani Im I Vogel

Zhelani im i vogel

Nuk di ku e kalove këtë natë dimri.
Jashtë bënte ftohtë.
Jashtë binte shi.
Cila strehez zhelani im i vogel, t'u bë jastëk? ,
Cila rrugicë e ngurosur, t'u bë çati?
Fërshëllima jote ëmbël, trupin m'a ka tkurrur.
E kapelja Gavroshjane, syrin m'a ka çarë. Kur
kanaçe mblihdje me duartë vocërrake,
me turravrapin tëndë si ketrushi mbi arrë.
Këmbëzbathuri im zhelan i vogël,
Barkun s'ta pash një herë të ngopur,
e grryer prej uris ish buza jote.
Fytyra njomëzake, e mbetur e palarë.
Në çdo kanaçe pikonte një pikë loti.
Në çdo kanaçe një thërrime bukë për shtëpinë.
Pse s'ti pash sot sytë e bukur?
Dhe thesin shpinës nuk t'a pash.
Më thanë se jetës ti ju ktheve si një flutur.
Shpirti vogël tu ngrit mbi galaktikë, larg.
Ka mbetur aty një bluze hollë.
Atje ka mbet kapela jote,
si kryq i vogël përmbi varr.
Të lutem zhelani im i vogël,
më fërshëlle dhe një herë si mik.
Ma plas edhe mua zemrën,
më pas, në përjetësinë tënde,
fluturo e ik...

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Zhgënjim Fatal...

Zhgënjim fatal...

Nën sytë e përlotur, që hapsirash enden, prej kohe të shpërfillur.
Zhgënjim i vazhdueshëm, thellë tyre mbetur i mbërthyer.
Shkaktuar prej barbarësh të së njëjtës skëterrë, sërishmi të rilindur
Pinjoll bastardësh konvertual, prej të vetëmit qëllimi të ushqyer.
Gozhduar prej erës kuterbuese të mëkateve të tyre.
Grahmat e kohës, që ka herë ka humbur.
Ethshëm përtypin të varrosurat mistere të jetës.
Nën trysni të papara dhunimesh, për të përlijtur egzistencën.
Mbi dallgëzime përpjekjesh, çdo ditë notojnë dhe ulërasin.
Zërat e mekura të miljonave, nervozuar prej nevojës jetike.
Të përfytyruarat imazhe të së ardhëmes me grushte godasin.
Karvanët e endacakëve, të eksodeve të dhimbëshme biblike.
Si gjurmë të humbura stepash, zëri i së drejtës përgënjeshtuar.
Dhimbjen tërësore përcjell drejtë pavdekësis së shoqëris njerëzore.
Drejtësi e përgojosur në altaret e nderit, robinjë e nënshtrimit.
E kërcënuar mbetur çdo ditë prej krimin dhe makinacioneve djallëzore.
Mes së humburës pafundësi besimi, thellë zemrës që rënkon.
Ushtritë e të papunëve rropatur përtej kufijëve të skamjes.
Nëpër zhurmime udhësh, ndriçuar prej rrufesh qiellor.
Kryqet e vetëdijes ndizen prej rënkimesh, dhe përgjakjes.
Zhgënjimi fatal ardhur prej deformimit të pushteteve.
Prej djallit me shëmbëlltyrën më të paskrupullt të mitmarrjes.
Provokon permanentshëm në ndjenjat e brishta të popujve.
Dukurin e shpërthimit të demonit, prej zjarrit të hakmarrjes.

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im - Zhgenjim Fatal

Zhgënjim fatal...

Nën sytë e përlotur, që hapsirash enden, prej kohe të shpërfillur.
Zhgënjim i vazhdueshëm, thellë tyre mbetur i mbërthyer.
Shkaktuar prej barbarësh të së njëjtës skëterrë, sërishmi të rilindur
Pinjoll bastardësh konvertual, prej të vetëmit qëllimi të ushqyer.
Gozhduar prej erës kuterbuese të mëkateve të tyre.
Grahmat e kohës, që ka herë ka humbur.
Ethshëm përtypin të varrosurat mistere të jetës.
Nën trysni të papara dhunimesh, për të përlijtur egzistencën.
Mbi dallgëzime përpjekjesh, çdo ditë notojnë dhe ulërasin.
Zërat e mekura të miljonave, nervozuar prej nevojës jetike.
Të përfytyruarat imazhe të së ardhëmes me grushte godasin.
Karvanët e endacakëve, të eksodeve të dhimbëshme biblike.
Si gjurmë të humbura stepash, zëri i së drejtës përgënjeshtuar.
Dhimbjen tërësore përcjell drejtë pavdekësis së shoqëris njerëzore.
Drejtësi e përgojosur në altaret e nderit, robinjë e nënshtrimit.
E kërcënuar mbetur çdo ditë prej krimit dhe makinacioneve djallëzore.
Mes së humburës pafundësi besimi, thellë zemrës që rënkon.
Ushtritë e të papunëve rropatur përtej kufijëve të skamjes.
Nëpër zhurmime udhësh, ndriçuar prej rrufesh qiellor.
Kryqet e vetëdijes ndizen prej rënkimesh, dhe përgjakjes.
Zhgënjimi fatal ardhur prej deformimit të pushteteve.
Prej djallit me shëmbëlltyrën më të paskrupullt të mitmarrjes.
Provokon permanentshëm në ndjenjat e brishta të popujve.
Dukurin e shpërthimit të demonit, prej zjarrit të hakmarrjes

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im -Sa Here Vij Prane Teje...

SA HERE VIJ PRANE TEJE...

Sa herë që vij pranë teje, deti im,
e përkëdhelem lehtas me valën qumështore,
në mall e dhimbje, thellë shpirtin ma ngacmon.
Më rreh e më tund si era degëzën mbi bregore.

Me të vrrarat duar të pëkëdhel i etshëm.
Mbi krah të hidhem, aty ku lindi pavdeksia.
Puth buzën ku shpërthen një trëndafil i përjetshëm,
ku shkrep e udhën e pakthyeshme merr dashuria.

Madhështori, i pakrahasueshmi deti im!
Shplarja m'u bëre për fatkeqësitë e përhershme,
drita e udhëve marramendese, shumëdredhore.
M'u bëre dielli i energjive të mia të pashtershme.

Ti je vullkan i shpërthimeve të brumit njerëzor!
Je jeta dhe e pashmangshmja vdekja ime e përditshme,
je dhimbja e moçme e një populli të rënë theror,
je fytyra engjëlllore e të gjitha ditëve të pakthyeshme.

Ti dallgë pas dallge vjen e më rrëmben.
Larg më çon, mes thellësive të tua të kaltra.
Ti je orteku vezullues i netëve të ftohta,
je shpërthimi i mijëra agimeve të bardha.

Plakur me vdekjen time përherë udhëtove
e prej vdekjes sime çdo ditë u brejte ti.
M'u bëre një copëz bukë për bukën e pëditshme,
këputur si petalja e tulipanit prej ngricës dimërore.

skender iljaz braka

Nga Libri Qyteti Im- Vendit Tim

Vendit tim.....

Tutje pas malesh dhe detit të trazuar
Ku mbrëmjeve vala buzëqesh me shkëlqim.
Atje ku syri i nënës më pret përherë zgjuar.
Kam varret e etërve dhe gjysëmën e trupit tim.

Atje më është toka e rrudhur gjer në palcë.
Flokëthinjura ime, me hire e bukuri.
Atje ku dehesh nga era e manxurasë.
Është vëndi im i vogël, është nëna Shqipëri.

S'ma lebyrin syrin ndërtesat shumëkatëshe.
Ura e gjate s'më ngjall kërshëri.
Atje, unë kam Bosforin tim të vogël.
Të kaltërin det, që i falem si një perëndi.

Kam lënë atje një mall, një shok fëmiriye.
Një vajzë që padurimin për mua po tret.
Mbi tavolinë kam lënë dy strofa poezie.
Një dhimbje toke, që do çastë më thërret.

.....Stamboll 1995....

skender iljaz braka

Nga Malli Per Ty

Nga malli per ty

Nga malli dhe prej mallit për ty u dogja.
Prej dallgës tënde të dashuris,
thellësive të detit u mbyta.
Marramëndshëm labirintheve të pafundëm
të ndjenjave,
si pënda e parë e artë e lejeku, i tëri humba.
Prej teje për asnjë çast nuk desha
të largohesha..
Vetveten në dashurinë tënde
më mirë se kudo e njoha.
Ndaj tretëm nëpër këndet
e reflekseve të kaltër të syve të tu gjallues
dhe, si zogun e dëborës mbyllëm
në kafazin e shpirtit tënd përvëlues.

skender iljaz braka

Nisja

Nisja...

Nuk jemi më shumë se një grusht,
që presim për tu nisur.
Një grusht i hallakatur njerëzish.
A thua se drejt asgjës do të nisemi.
Dhe udha nga prej kemi ardhur
ka kaluar nga hiçi.
Pë nisjen e shumpritur presim,
pa e ditur se do të mbrrim një ditë.

Eshtë frika në fytyrë, gjithë ç'na ka mbetur.
Eshtë një psherëtim e fikur buzeve që ka ngrirë.
Vetëm ca pika djerse mbulojnë ballin e gjërë.
Dhe një vështrim i trëmbur, si vetëtimë.

Të gjithë presim orën e nisjes...
si atleti startimin në pistën e tij.
Nisja jonë paska qënë një infinit...

skender iljaz braka

Një Sekondë, Të Përulem.

I rikthehem ngahere nje kohe apatike.
Nje kohe te ploget, pa nerv,
mbushur dogmash oqeanike.
Por s'mundem te hesht
per kete te sotme poshteruese
dhe te mos mbetem skeptik
per nje te ardhme mashtruese.
Nese ne te shkuaren me ka munguar
ngahere nje pikenisje,
sot nuk e di nese do te kem nje here te veteme
ndonje pikembrritje.
E ndersa mend
jen vras mbeshtetur
ne tavoline e pune sime.
Nje ze qiellor vjen e me thote:
- Mbushe zemren me durim.
Une serish do te kthehem nje dite,
pasi ju te gjithë jeni pjella ime.
Dhe kjo eshte shpresa e pafundeme.
Nje sekonde, te perulem.
- Amen! Lutja ishte e dliirë.
Lutja ishte e gjithshpirteshme.
E vetme dhe aspakak e veshtire.

skender iljaz braka

Një Mbrëmje E Kuptova

Kokën ule e diç murmurite nëpër buzë.
Jetoje me mendimin se unë të tradhëtoja.
Ndër mënd se kisha shkuar kurrë e dashur.
Se pa dashurin time më tepër do të doja.

Një mbrëmje kur muzgu befi përmbi det.
I vetëm shkoja përgjat bregut këngëtar.
Pa ty gjithë bota më dukej aq e shkretë.
Dhe vetja më dukej si kërkushi, mëkatar.

Atij çasti e kuptova seç ish në thelb vetmia.
Se humbja të shkaktoka një hon kaq të errët..
S'u shkërrmoqka si yjet nëpër duar mërzitia.
Mes dilemash dhe vet jeta tu bëka më e pjerr't.

Se ky breg ku ne u puthëm s'është i kot.
Atje ku vdesin dhe rilindin të gjitha dashurit.
Jetën duke thithur përmes etjesh dhe nën lot.
Se u dashka ca vullnet për të thyer marrëzit.

skender iljaz braka

Nje Mbremje..

Mbi fletën e pashkruar një mesnatë m'u ule.
Krahtë ledhatushëm m'i hodhe rreth në qafë.

Me vlagën përcelluese

shpërthyer nëpër buzë.
Petale lulesh mbi trup me shkunde.
Nuk di sa shumë më folën sytë e tu.
Drthëruar hedh zemra nektar dashurie.
I harruar asaj mesnate mbetur i përgjumur.
Mbi fletë të shkruar lash dy rreshta poezie.
Cmenduria ime drejtë teje fluturonte.
O Kleopartë e bukur, sy kaltër si deti.

Si munde ti ndjenjat e mija

t'i sundoje.?

Si munde t'ia rrëmeje ti zemrën një poeti.?

skender iljaz braka

Një Metër Katrore Toke

Një metër katrore toke, ju lutem më jepni
për të luajtur vallen e vjetër të shqipeve!
Dhe do të shihni se si ajo do të ndizet
prej ritmit dhe prej gjëmimeve.
Një hark ylberi profilesh, tiparesh, karakteresh
ka për ta rrethuar duke pikuar djersë dhe gjak.

Do t'u tregoj më pas kur të mblidhemi rreth zjarrit
si mbeti mbi shkëmb një zëmër nëne e coptuar prej mallit.
Si një vajzë u hodh prej shkëmbit,
si dy burra majëgishtat e tyre prenë
për t'i dhënë njëritjetrit fjalën dhe shpirtin e vllamit.

Një metër katrorë tokë më lini
prej tokës sime të zezë dhe të djegur!
Do tu tregoj për harmoninë e gurit të bardhë të malit.
Për besnikërinë naivë në legjendën e Rozafës
dhe fisnikërinë që derdhet përtej grykës së etur të livadhit.

Do t't tregoj si arratisen buzëmbremjet
me profilin e Bjeshkëve të Nëmura.
Si bie e ngrihet prej varresh të harruara
përgëdhelimat e djegura dhe të ashpëra të flladit.
Si përcëllohen dashurit mes erërave të thata dimërore
Si jeta gëlon dhe vdes mes shpresash të vakëta,
të mbushura plot këngë të thjeshta baritore.

Një metër kub ajër më lini për të kënduar
këngët e gjyshërve të mi mjekërrbardhë!
Dhe do të shihni se si korbi do të drithërohet majë kuvlisë
Se si në akujt e shkretëtirës do të shuhen
sytë e paturpshëm të banditit dhe të kusarit.

skender iljaz braka

Një Portret Dashurie Kam Mbetur

Skajeve të pluhurosura të një kornize të vjetëruar
Një portret dashurie prej kohësh kam mbetur.
Përtej errësirës, britma e shurdhër, e mohuar
dhe zhurma e pazëshme që rrënqeth qetësinë.

Si një kujtim i trandafilt më shfaqet ikja jote.
Celuloidit të fushës së djegur të një malli përvëlur.
Përpara meje dhimbja, të hutuarin zëmërim çukit.
Të humburin realitet të dashuris, duke imagjinuar.

Mëshira në një degë peme të përthyer ka ngrirë.
Aty ku buzëqeshja jote, zjarret e shpirtit të përgjumur
ditë pas dite kërkonte të ndizte në etje dhe dëshirë
dhe të prekte puthjet e mykyra prej kujtimesh kërkonte

Një portret dashurie kam mbetur, përgëdhelur.
I rrahur prej valësh që këndojnë për histori tragjike.
Fshikëlluar prej erërave të natës së malit shpirt ndezur.
Me sy të tejmbushur plot ankthe padurimi dhe pritjeje.

Një portret dashurie kam mbetur,
duke u djegur nën flakët e vetmis...

skender iljaz braka

Një Portret Dashurie Kam Mbetur.

Skajeve të pluhurosura të një kornize të vjetëruar
Një portret dashurie prej kohësh kam mbetur.
Përtej errësirës, britma e shurdhër, e mohuar
dhe zhurma e pazëshme që rrënqeth qetësinë.

Si një kujtim i trandafilt më shfaqet ikja jote.
Celuloidit të fushës së djegur të një malli përvëlur.
Përpara meje dhimbja, të hutuarin zëmërim çukit.
Të humburin realitet të dashuris, duke imagjinuar.

Mëshira në një degë peme të përthyer ka ngrirë.
Aty ku buzëqeshja jote, zjarret e shpirtit të përgjumur
ditë pas dite kërkonte të ndizte në etje dhe dëshirë
dhe të prekte puthjet e mykyra prej kujtimesh kërkonte

Një portret dashurie kam mbetur, përgëdhelur.
I rrahur prej valësh që këndojnë për histori tragjike.
Fshikëlluar prej erërave të natës së malit shpirt ndezur.
Me sy të tejmbushur plot ankthe padurimi dhe pritjeje.

Një portret dashurie kam mbetur,
duke u djegur nën flakët e vetmis...

skender iljaz braka

Nje Portret Dashurie Kam Mbetur...

Një portret dashurie kam mbetur.
Skajeve të pluhurosura të një kornize të vjetëruar
Një portret dashurie prej kohësh kam mbetur.
Përtej errësirës, britma e shurdhuar,
mohuar dhe prej zhurmës së pazëshme
që rrënqeth qetësinë.

Si një kujtim i trandafilt më shfaqet ikja jote.
Celuloidit të fushës së djegur të një malli përvëlur.
Përpara meje dhimbja, të hutuarin zëmërim çukit.
Të humburin realitet të dashurisë, duke imagjinuar

Mëshira në një degë peme të përthyer ka ngrirë.
Aty ku buzëqeshja jote nën etje,
zjarret e shpirtit të përgjumur
ditë pas dite kërkonte të ndizte,
dhe dëshirën e tërbuar për të prekur puthjet e mykyra.

Një portret dashurie kam mbetur, i pa përgëdhelur.
I rrahur prej valësh që këndojnë për histori tragjike.
Fshikëlluar prej erërave të natës së malit shpirt ndezur.
Me sy të tejmbushur plot ankthe padurimi dhe pritjeje.

Një portret dashurie kam mbetur,
duke u djegur nën flakët e vetmisë...
Ti, kaq shumë larg meje mbete
rrezja e pashuar e dashurisë.

skender iljaz braka

Një Shekull Me Muzikën Tënde

Një shekull muzikën tënde kam sjell nëpër mënd.
Një shekull epsheet e saj të shfrenuara
kam mundur të dëgjoj i vetmuar.
Që prej ditës kur frymëmarrja
mu kthye në kristale të ngurtësuar.
E terrinën e heshtur trotuarit të vrazhdë,
kumbim i mprehtë i tyre në dysh e ndau.
Ti takimit s' si erdhe asaj nate,
kur qytetit të përgjumur një vetëtimë iu thye.
Në cilat kordinata i humbe lumturisë sime?
Pas cilës pamje afsh i dashurisë tënde shkriu?
Brënda teje agonia mëkatin kryqëzoi.
Ndërsa djalli i zi të kërkonte mëshirë.
Pluhurin e trishtimit shkundëte muzugu përthinjur,
mbi hekurat e flokëve të mi dhe buzën e dridhur.
Nuk ishte ti, kur qerpikët e hollë,
si degëzime të rënduara palmash më ranë.
Ti nuk ishte, kur përdhëmbshëm çapita
gjer tek një fund udhe si i marrë.
Kripësinë e lotit - mall kam gëlltitur,
gjer ditës kur e pamëshirshmëja ikje,
kapriçioze do na vinte ball për ball,
prej zinxhirësh të të njëjtit fat, lidhur.
Unë mbi një kreshtë të përmbysur vale.
Ti në tjetrën anë, si pulëbardhë për toke platitur.
Një shekull me muzikën tënde kam jetuar.
Këtë botë të qelbur milona here duke mallkuar.

skender iljaz braka

Nje Te Shtune Vjeshte

Një të shtunë vjeshte...

Mbi xhamin e lagur të dritares,
fytyra jote e venitur me dy sytë pa dritë,
mu shfaqën nën përgëdhelinë tunduese
të pikave të shiut, që bimin pikë, pikë.
Oh, e paharruara ime e përmallur,
vegimi i një dritëhieje të marrosur.
Të përgjumurat kujtime rrëke më derdhen
përzier me atë fanitje imazhesh,
përsëri rindërtuan shtrat lumin e asaj
dashurie të çngjyrosur.
E shtunë vjeshte ishte dhe atëherë...
Kur mbi fjalëkryqin e të larguarit,
unë përpiqesha të mbyllja çdo katror,
si boshllëk i një imagjinate mpirë prej ngërçjes.
Përse vallë e ndërmore atë akt madhor fatal
e ngrite kryevepërn më cinike të vdekjes?
E shtunë vjeshte ishte dhe atëherë...
dhe shiu binte mbi xhamin e dritares.

skender iljaz braka

Një Të Shtunë Vjeshte...

Një të shtunë vjeshte...

Mbi xhamin e lagur të dritares,
fytyra jote e venitur me dy sytë pa dritë,
mu shfaqën nën përgëdhelinë tunduese
të pikave të shiut, që bimin pikë, pikë.
Oh, e paharruara ime e përmallur,
vegimi i një dritëhieje të marrosur.
Të përgjumurat kujtime rrëke më derdhen
përzier me atë fanitje imazhesh,
përsëri rindërtuan shtrat lumin e asaj
dashurie të çngjyrosur.
E shtunë vjeshte ishte dhe atëherë...
Kur mbi fjalëkryqin e të larguarit,
unë përpiqesha të mbyllja çdo katror,
si boshllëk i një imagjinate mpirë prej ngërçjes.
Përse vallë e ndërmore atë akt madhor fatal
e ngrite kryevepërn më cinike të vdekjes?
E shtunë vjeshte ishte dhe atëherë...
dhe shiu binte mbi xhamin e dritares.

skender iljaz braka

Nuk Bëra Kurrë Kompromis Me Të Keqen.

Me angulla vdekjesh nxitove drejt meje.
Duartë e përgjakura për të më mbytur zgjate.
Unë nuk t'u stepa, s'tu frika, nuk t'u trëmba.
Ishe ti që ndiheshe mbërthyer prej paniku.

Ti e dije që jetës nuk i eca kurrë i përgjumur.
Se dëshirë kam patur të këndoja buzëmbremjesh.
Që gjithçka të trishtuar ta digjëja mes flakësh.
E fushave të xhveshura të përvëlohesha prej etjesh.

Po ç'faj të kisha, magjistrice me mantel të ndotur.
Që horizontet të digjeshin prej shpirtit të coptuar.
Që sytë të shkëlenin me një shnëdritje të kobshme.
Që përpara meje të dridheshin këmbë e duar.

Unë kompromis me të keqen s'bëra kurrë në jetë.
E ndëgjegjen se krodha kurrë në pafundësira çnderimi.
Di që të vërtetën pikturova veç në të njëjtin portret.
Si piktor i mëkateve hyjnore, që prej syrit i lind shkëlqimi

skender iljaz braka

Nuk Di Ku Më Humbe

Nuk di ku më humbe

Nuk di ku më humbi hija jote.
Në ç'metro a udhëkryq nuk e di,
Mjegull e padukshme që lumit i tretet.
Mes njerëzve që shpenguar shkonin udhëve të qytetit,
Ti si hije nate m'u zhduke, mu vodhe.
Ike, siç lind e zhduket papritmas misteri magjisë.
Një grusht pluhuri syve të mi të lagur u hodhe.
Gjithçkaje duke i dhënë trajtën e dhimbshëme të vetmisë.
Shpirti, si një varkëtar i lodhur prej meje tu largua.
Kokën time të prerë buzë një udhe le
të ngulur mbi një qysqi.
Asaj buzëmbremjeje të trisht,
si tingujt e obosë më kumbonte zëri yt.
Me jehonë grykash të errëta binte mbi mua.
Parfumi yt i freskët s'di se si më shponte.
ndërsa kujtimi i plakur thellë trupit më brente,
më gryente, më lëndonte.
Në fund humnerash, qofshë në parajsë a ferr.
Për mua të vdekurin ka pak rëndësi.
Unë si Orfeu i gjor, Euridikën do të kërkoj.
Për të nxjerr në dritën e ëmbël të dheut.
E me ty do të bëjë përsëri dashuri.
Nuk di ku më humbe.....
Nuk e di...

skender iljaz braka

Nuk Di Ku Te Humba

Nuk di si të humba.

Buzëdetit, duke shëtitur deri vonë,
a ndoshta me një valë, muzgut të ngatërrova,
diku harruar pas një degë pishë,
bregut shkëmbor rrëzuar, ku ndriçonte hënë e plotë.

Me frymën e erës mbi detin e trazuar,
mesazhe pambarim më përcillje.
Më shkruaje duke ecur skajeve të muzgut.
Ndalesa për të gjetur m'u bë streha mes tokës dhe qiellit.
Shkëlqimin e vdekjes së dëshpëruar,
me qumështin e tij, më njomte fiku gjëmbaç i detit,

Mbi kurorët e pishave fluturonte qeshja jote.
Thirrja pikëlluese.
Më gjej! Më gjej nëse më do! - jehonte buzëdetit
Zëri yt shndërruar në një ëngjëll mirësie.
Ndërsa unë në tokën e zezë këtu poshtë
këngën tënde dëgjoja përhumbshtëm nëpër re
të veshur me tantella të bardha nusërie.

Zogjtë, qiellit të mrvenjtur në tufa fluturuan.
Ti ndoqe udhën e tyre e dashur.
Ndoqe metodën e hijeshive.
Atë çka murgeshat na mësuat.
Të verbër për ti mbetur, përjetësisht dashurive.

skender iljaz braka

Nxitioni O Ju Hapa Te Penguara

Nxitioni, o ju hapa te penguara...

Nuk di përse ngjasoj me nje varke mes detit,
humbur natës së ftohtë, larg, tej bregut,
thithur prej dallgeve te terbimit,
ku frika prej frikes fshihet dhe tej i bënë pritë shtegut.
Në horizontin e largët te sakrificave te mija,
për të ecur udheve te panjohura te rrezimit.
Në ditet e marsit te vonuar nxitoj.
Nxitoj përmes akujve ende të pashkrirë të dimërit.
Mes dëborës ngjitem nëpër nje shpat mali,
me nevojen për të arritur diku mes ndjenjë së kohës,
përpir prej flakëve të përvëlimit.
As vet nuk di se çfarë kërkoj prej vetes,
se çfarë më pare ti rizgjoj kujtesës.
Ndoshta për të gjetur një shteg mes reve,
ku varrosur jane shifrimet e zemerplasjes
dhe te humburat kode shekullore te beses.
Ndoshta përtej vargmaleve dua të qendroj.
Të shtrohem kambëkryq kullave te ngujimit.
Atje ku brenga të dhimbëshme thekshëm rënkojnë,
të fshehura prej kaq vitesh, nën pikëzën e vesës.
Ngjitem nëpër të padukëshmen e tretur horizontit,
të pëpirë prej rrezes së pare të agimit.
Atje ku mitet dhe legjendat e qëmoteshme,
lengojnë si të fundit tinguj grykësornën përgjumjen e harrimit.
Ndoshta më duhet më parë te përzgje
dhe kendin me te pershtateshem te shikimit.
Drejtë portës së larget të diellit të kërkoj,
melhemin për të mbyllur plagët e shkatërrimit.

skender iljaz braka

O Dashuri

Trandafil i bukur jetëdhënës,
për shpirtërat e gjakosur, mbetur tërë plagë.
Si pulëbardhë e bukur ti ulesh
mbi sytë dhe zemrat e lënduara.
Perëndimet, me lot dhimbjesh i përflakë.
Magjia jote - puthja, loti, dhimbja.
Sinfoni e heshtur, që shekuj ke jehuar,
përmes drithërimash dhe fuqish coptuar.
O dashuri!
Më ngre fladi yt qiejve të kaltër.
Kufijët e gjithë botës m'i shkrin në një të vetme.
Me ty, trishtimin tres
për të mbeturi kaq i paqtëm.
Mbi barin e gjelbër të jetë,
një pikë vesë e pathar.

skender iljaz braka

O Mushke Xanxare...

O mushke xanxare...

O mushke xanxare.....
Pervjedhur mendimesh ty te ndiqja
buzembremjes mbi trotuarin tim gri.
me kengen e bulkthit tretej hija ime
Kur rrekja te kerkoja, po s'di ku te kerkoja poezi
Ah, mushke xanxare, e frikshmjia madheshtore.
Me bere te kuturisem perhumbshem
shtegut te harrimit
Endur te mbetem si mergimtari
udheve te pakthimit.
Muzgut me pluhur sperkatur
te ndjej zvarritet e fantazmave
nga zemra e braktisura,
nga zemrat e pergjakura.
Me çmendurin time me bere te grindem, poezi,
per t'u djegur prej diellit te perflakur.
O mushke xanxare,
sa here nga vithet e tua te pashtuara
pertime me hodhe?
Dhe sa here kur ty te gjeta.
Ti si një e marre me dashurove.

skender iljaz braka

O Supet E Mia

O supet e mia.....

O supet e mia mal rënduara,
mal grryera, mal thërrmuara.
Prej mishi, eshtrash dhe gjaku të pampiksur.
Gjithë jetën më mbetët si hirushja plot hire.
Kështjellë me bedena të pathyeshme,
po aq madhështore sa mburojat dhe përkrenaret ilire.
Rrufepritëse për qiej shkrepetimash.
Dallgëthyese për dete tërbimesh.
Hekurkthyese për konflikte përplasjesh.
Zhëzhitur prej flakësh.
Tkurrur prej ra prej mallelesh.
O supet e mija që kokën kurrë s'ma ulët.
Me forcë titanike, e gjallë mystësia jote.
Myzavat e tua pluguar prej djersës,
udhët e mija u bënë për të sotshëmen
dhe dritët e së nesërmes.

skender iljaz braka

O Supet E Mia.....

O supet e mia.....

O supet e mia mal rënduara,
mal grryera, mal thërrmuara.
Prej mishi, eshtrash dhe gjaku të pampiksur.
Gjithë jetën më mbetët si hirushja plot hire.
Kështjellë me bedena të pathyeshme,
po aq madhështore sa mburojat dhe përkrenaret ilire.
Rrufepritëse për qiej shkrepetimash.
Dallgëthyese për dete tërbimesh.
Hekurkthyese për konflikte përplasjesh.
Zhëzhitur prej flakësh.
Tkurrur prej ra prej mallelesh.
O supet e mija që kokën kurrë s'ma ulët.
Me forcë titanike, e gjallë mystësia jote.
Myzavat e tua pluguar prej djersës,
udhët e mija u bënë për të sotshëmen
dhe dritët e së nesërmes.

skender iljaz braka

O Vajze E Rinis Sime Te Hershme

O vajzë e rinis sime të herëshme....

O vajzë, e ditëve të rinisë sime të hershëme.
C'mi afrove sot kaq pranë, të panjohurat e tua të akullta?
Të vdekurat vegime pa varre të buzëmbremjeve.
Dhe ngjyrimet e humbura errësirës, ditë-netëve të amullta.

C'mu afrua e jotja brishtësi, që aq shumë ta kam dashur.
Të harruarat udhë të shtegut, për tek shpella ku jetuam.
Ato mijëra imazhe të çrregullt nën përthyeshmëri të dritës.
Kryqet e krahëve të mështeknës ku dashurin kurorëzuan.

Lërmë syve të tu të ulem, si zog i gjumit të trazuar.
Pak çaste të hesht mbi heshtjen tënde të shndritëshme.
Mbi qetësinë e syve të tu, më të qetë se vet qetësia.
Të rri më i heshtur se vet heshtja e përjetëshme e yjeve.

O vajzë, e ditëve të rinisë sime të hershëme.
Ti ende jeton në brëndësi të paqes sime të butë.
Të mbledhura brënda teje janë dënesat, shpërthimet.
Të fundit psherëtima të humbura nëpër muzg.

Oh shqisa ëngjëllore, burime të puthurash.
Oh vezakja e përskuqur buzë e kafshuar.
Gjithmonë e më pranë ma sollët etjen time mizore.
Dhe të besuarit se me ty, vet vdekja është harruar.

skender iljaz braka

Pabesia Ime E Tradhëtuar

Shtigjeve të një pylli të egër
vazhdoj të bredh fillikat.
Me pamjen dhe mëdyshjen e një të verbëri të harruar.
Gënjyer prej gjeometrisë së një jete të pakuptimt..
Vetëm të puth dua. Kam mall.
Të puth kupën e qiellit në netët e dimërit
Sytë dhe buzët e thara të detit të trazuar.
Majë shkëmbit prej nga jam rrëzuar
të ringjitem me këmbët e mija dalëngadalë.

Fryma e erës mbi krelat e një vale të vetmuar.
Tani po u rrëfen etheve të qytetit tim në muzg,
Mbi poshtërsitë dhe pabesinë time të dukshme,
si një pasqyrë të kobshme të një kujtimi të shkuar.
Ç'djall poet i pashpirtë paskam qënë,
që vetëm prej klithmës së një fëmije të rrebeluar,
mbeta i tradhëtuar, një mëngjesi të bukur në agim..

Oh sa shumë frikë kisha të të prekja!
Sa shumë frikë kam patur të thosha veç një fjalë.
Vetëm në egzstencën e frymëmarrjes së ujit kam besur.
dhe në bregun shkëmbor
prej hënës së plot që ndriçon mbi këtë djall moçal.

Gjithë lumenjtë që rrjedhin,
i ndrojnë papushim ngjyrimet e tyre
Dhe ishujt e vegjël të ëndrrave treten vazhdimisht.
Me një ngathtësi mizore tërë papesitë e mia gremisen,
siç rrëzohen petalet e trandafilave të trisht.

Shtigjeve të një pylli
vazhdoj të bredh fillikat..
Prej pabesisë time i tradhëtuar.....

skender iljaz braka

Pafytyrësia E Paftyresis...

Pafytyrësia e paftyresis...

Po kërkoha të gjeja pafytyrësin e pafytyrësis.
Ku nuk shkova e me kë nuk u fjalosa.
Të gjithë më thanë të njëjtën gjë.
- Poet, mos u lodh të endesh si ermit nëpër botë.
Ti vet po vjen prej vëndit ku sundon
e mbretëron pushteti i pafytyrësisë
dhe s'mundesh ta vrasësh dot.

skender iljaz braka

Paqja Fillon Tek Unë

Paqja tek unë i ka rrënjët.

Në buzëqeshjen time kur ngrihem në mëngjes.

Kur njeriut i them ëmbësisht; Tungjatjeta!

Dhe diellin me shikim përgëdhel, e përshëndes.

Paqja tek unë fillon

kur përdore fëmijët i marrë për në shkollë.

Kur gjithkujt i flas me të njëjtin zë në botë.

Kur ndriçimit të dobët në ngjyrën e jargavanit.

I zgjas pa u dridhur, dorën time të ngrrohtë.

Paqja vjen prej përzëmërsisë tënde bujare.

Përtej një shikimi tinzar e të dyshimtë.

Dhe tolerant kur arrin të tregohen

ndaj një administratori prepotent e të pashpirt.

Paqja fillon gjimonë nga unë

Nga ti,

Nga ne.

Gjithkush prej nesh duhet ta ketë në shpirt.

Paqja nga themelet e forta të shtëipsë tonë fillon...

Prej saj vet globi arrinë të marrë

Veçse dritë.

skender iljaz braka

Pas Vdekjes

Pas vdekjes...

Një vajzë, mollëzat e gishtërinjëve bren
Me dhëmbët e saj prej kokërrizash të imta fildishi.
Flokët shkul dhe nduk një grua aty pranë
si të jenë mustaqe të gjata e të njelmëta misëri..
Ndërsa një djalë, me thëmbërën e këmbës tokën grryen
Asgjëje të ndodhur si beson,
thujse prej vargjeve të tua
përbrëndshëmi i vjen ngushëllimi.

Kështu të përcjellin ty në botën e përjetshme.
Brëndësis së dheut të lutjeve dhe rënkimeve tona.
Në hirin e ftohtë ku shpirtat e kreshpëruar
lulëzojnë në të njëjtin livadh me luledelet dhe vjolat.

Më pas do të këndohen për ty shumë këngë.
Do të tregohen si legjendat mitike ca të tuat bëma.
Por pas kësaj s'do të rrinë pa u gjalluar dhe gojë të liga,
që kafenesh e skutash të errëta do të thurrin intriga,
ende pa u tharë eshtërat e tua të njoma.

Do të kujtojnë si bujkun e plagosur që me thonjë
pastronte plagët e maisura të tokës.
Lumturinë tënde therëse për artin e shërimit të shpirtit.
Do të kujtojnë metrikën e çrregullt të hiteve
Ku ti të hapur na le deriçkën e ndryshkur të enigmave,
Tok me çelsin e çkyçjes së diagramës së jemit
dhe ngurosjes së sifilizit.

Në vajin tonë të përjetshëm do të kthehet kënga jote.
fshehur lëpiskave të argjëndëta dhe aheve të korijes.
Sepse ti në këmbë doje të vdisje,
si djemt e rrahur përpara altarit të Artemisës së Orties.

skender iljaz braka

Pas Shumë Vitesh...

Pas shumë vitesh....

Rastësisht një ditë buzë detit u takuam.
Sa shumë e ndyra kohë neve na kishte vrarë.
Për sytë e ty unë vija disi më i burrëruar.
E ti për mua, diçka më serioze ngasa më parë.
Sa shpejtë na shkuan vitet, fare pa kuptuar.
Si vetëtimia që i shfaqet një qielli të përhimt.
Thellë sytë e tu të bukur, flakëronin ende zjarr.
E prej lëngimit shpirti im ishte djegur, ishte tharë.
Këto pika shiu...

Ah këto pika shiu vjeshtor rëndë më ç'mishërojnë...
Kthyer në akuza që më shtyp me peshën e trishtimit.
Vetmuar në dhomën time burg, shpirtin m'a lëndojn.
Më ngren e më përplasin fuqishëm kulmit të lëndimit.

I mbështjellë kësaj nate po ndihem prej harresës së dëborës.
Ndaj sytë me ngulm natës i kërkoj për të parë tej errësirën.
Përtej botës së të panjohurave shtegëtova gjithçka timen.
I ndriçuar për të mbetur prej pëshpërimës së vetëtimës.

Këto pika shiu më duken fashikuj lexuar prej fantazmash.
Rrugina të harruara, të shkretuara shtegëtimi më duken.
Në botë grabitqare vetëm ti më shfaq një ngjashmëri vizionesh.
Vetëm ti m'i largon këto pamje jonjerëzore të shpërfytyruara.

skender iljaz braka

Pas Teje Vrapoja

Veç shpirti im e dinte se për ku po e thyeja
misterin e asaj vetmije, sa tmerrake e të ngjeshur,
si në një gufallë hapur, të pafundëme, zjarmëtare.
Me gjoksin e bardhë prej Tadeni fluturoja si zog mali,
prej psherëtimës së një fluture, fort të trembur.
Lirishtes së blertë, krrusur prej peshës së rënd të mëkatit.
Turravrap i përvidhesha me nxitim të nagtërruar.
Shqetësuar prej një mëndjeje të turbullt e të çartisur.
I hutuar prej dëshirës, duke përfytyruar në pafundësi
shëmbëlltyrën tënde përtej ca akujve të krisur.
Ti më ndillje dhe tërhiqje, si bregu valët e kristalta.
E unë rrekja të të prekja...
Brigjeve të ishujve të tu, do të doja që të ndalja
e të prehesha asaj mbrëmje çmëndurake.
Me një rënkim të thell, si prej bishe të plagosur,
mes shtullungave të fundit të mjegullës, të thërrisja.
Zëri im i ethshëm ngrihej drejt një vëndi,
ku tjetër gjë veç teje nuk vëreja
dhe të humburit monopati, diku tutje të përflakur.
Nuk di, nëse do të mundja të arrija...
A të rrokja, arratisjen tënde marramënthore,
prej kësaj qorrollisjeje të çmëndur, të pamundur,
për të ndjer pëkëdhelinë, ëmbëlake të një dore.
Ti më shfaqeshe si një yll, që prej qielli bie këputur,
që humbet nuk'di se ku, nëpër ca hapsira boshe.
S'doje vetëm të qëndroje, ashtu siç ishe e vuvosur,
të rrëshqisje përtej bregut, as vet pa ditur të qëndroje.
Përmbi krifën e gjethinave, shëmbëlltyra jote frenoi të prehet,
ndërsa kurmi yt, përsëri për diku larg, rrek e shkonte.
Në atë copëz vend, ku vetëm dashuria di të shkoj.
Në atë copëz vend, ku vetëm dashuria s'di të kthehet.

skender iljaz braka

Pavdekési

Pavdekési...

Krahët i 'a prene meshtekes ne pyllnaj.
Levozhgen e bardhe i'a xhveshen gjer ne palce.
Gjethezemerat ne toke pike-pike
zune te pikonin gjak.
Nga plazamt e tij tokës buiti bari njomë,
toka e ftohte mori vlage.
U drodh dhe gjethezemrat ne yjesi i njiti.
Pavdekési, pavdekési mermeriti.
Tej pyllit te gjymtuar,
mbi tela lahute dridhet një këngë e këputur.
Kënga e malsorit që me hënën
veç një natë ishte puthur.
Si ne kohet e nëmura,
vdekja njëmije here e rrezuar.
Balladen e deshperimit ne heshtje
percjell mal me mal,
per meshteknen e blangosur
dhe malsorit, qe lahuten kish ba rrasht.

skender iljaz braka

Pendimi....

M'a fal ti gabimin!
Dikur e dashur rënd të lëndova.
Të solla makthin si dhuratë të pakëndëshme
dhe netëve pa dashur t'a shtova pagjumesinë.
Si pikë e ujit shkëmbin, zemren t'a coptova.
Në mijëra kristale t'a thërrmova dashurinë.

Ma fal ti gabimin!
E dashur, ti më fal!
Unë jam fytyrë, që skuqem në gabime.
Unë jam syri, që dridhet si një tingull.
Unë jam zemra, që gjunjëzohet nën përgjërime.
Unë jam shpirti, që tretet nëpër mjegull.

Ma fal gabimin! ,
E dashur ti, me fal!
Me ujë burimi mëkatet do t'i laj.
Buzet do t'i ngroh me dëborën në mal
Në thellësi oqeanesh pafundesisht do të zhytem.
Tek ty për tu rikthyer dhe një herë si kristal

skender iljaz braka

Për Kalorsin E Kaltër Të Ferrit.

Ti puthje sytë e netëve të ftohta.
Buzët e netëve të trishta.
Gjinjët e tharë të netëve të hidhura.
Dhe ferrit tënd i thurrje këngë melankolike.
Me zë koke i këndoje mbështetur pravazit të dritares,
nën dritën qiellore të hënës qumështore.

Llagëmeve të lagështa të ferrit.
Mes kodeve të dashurisë tënde të humbur,
ngatërroreshin jehonat konfuze.
Ti bridhje përhumbshëm si të ishe një gjysmë trup,
si të ishe njëgjysmë perëndi,
heshtuar prej një kalorësi të ndyrë.

Kalorësi i kaltër i ferrit,
melodis tëde të trisht
i vishte vargjet e vjedhura të poetit.
Me ferrëtaret e ferrit të tij bënte orgji.

Oh, rënkim i dhimbshëm i zëmrës tënde të pashpresë!
Që skajeve të horizontit bredh me melodinë e pavdekësis.
Mbushja kësaj nate grushtet
me mushtin e ardhur të dashurisë
Dhe lërë të humburin e të humburve,
të humbas nëpër errësirën e ferrit të tij.

skender iljaz braka

Për Sa Kohë Që Ishim Të Dashuruar

Për sa kohë që ishim të dashuruar
Për sa kohë që ishim të dashuruar
çdo ditë, diçka tek ne ndryshonte veç për mirë.
Sjellja ndaj njerëve na bëhej më e lakuar.
Më të qetë se qetësia e natyrës bëheshim,
Më të përmbajhtur, më të duruar.
Mbushur ishim për jetën me pasion dhe dëshirë.

Për sa kohë që ishim të dashuruar
na shkundeshin dobësit si gjethe pemësh në rrëzim.
Fytyrat na merrnin ngjyrimet e pranverës
Në fije bari ktheheshim mbushur me blerim.

Për sa kohë që ishim të dashuruar
Në zogj të egër mali u shndërruam.
Cicërima shumëngjyrshe përhapnim
mbi lëndinat e djegura të yjësive.
Për detin e kaltër në pulëbardha u kthyem.
Na pëlqente të luanim mbi valët gazmore
dhe si peshq të humbisnim thellësive.

Për sa kohë që ishim të dashuruar
qiellit iu bëm dy re pupëlore
që enden e puthen buzëbrëmjesh
oh...deri në agim.
Veten nuk them e dashur se e gënjyem.
Sepse ne muarrëm dhe dham gjithçka për dashurinë

skender iljaz braka

Për Të Njëqindin Vit Radhazi

Për Të Njëqindin Vit Radhazi

Hazreti Ismail, Tungjat'jeta!
Për të njëqindin vit radhazi këtij sheshi i vijmë.
I mblidhemi si zogjtë e qyqes së lënduar.
Kokëulur vijmë.
Hijerënd si kreshtat e maleve tona
me dëborën e përjetshme supeve të ngrirë.

Uratat të të sjellim prej të gjitha trevave.
Rreth teje të mblidhemi na i paskërka ënda.
Dhe pse përsëri zbresim me gjysmë fytyre të hequr,
me gjysmë zëmre të thyer, me gjysmë trupi të djegur,
me gjysmë..... gjysëm..... gjysëm.....gjysëm.....
Rreth flamurit tënd Hazreti mjekërrbardhë,
Nën shtrëngime duarësh lëkurë rrjepura
të përshëndetena e të thurrim të tjera ëndërra.....

Vijmë këtu si vargëmalet flakë derdhura.
Tek prrushi i zëmrës së tokës sonë të vdekur.
Kokëmënjane, prej një shekulli keqpërdoruar.
Zbresim këtu ku fshihet e rënkon emëri yt,
zbukuruar prej lulesh që kurrë nuk u thanë.

Zbresim si fëmija i uritur pas një nate pangrën,
që duke qar buzët e palaritura prej të ftohtit lëpin.
.Zbresim si ujërat e nxira e të pashkumëzuar të maleve,
mbërthyer prej makthit të vetpërrjashtimit.
Trëmbur prej fatit të gozhduar bregut të shkëmbenjtë.
Tkurrur prej ndjenjës së fajësis së vetëdënimit.

Pas nesh paturpësisht zbresin ishët e të sotmit pushtetar.
Vratarë e varrmihës të lirisë që për të çirren e ulërasin.
Mashtrues e të paskrupulltit mafiozë me fytyra të dyshimta.
Në sfondin e mënxirtë të varfërisë së popullit,
rrëzëllejnë të fliqurat pasuri dhe bëmat e tyre të ndyra.

Hazreti Ismail

dhe këtë vjeshtë na mungon ky qiell lirie.
Dhe këtë vjeshtë pesë degë trungun e rënd thërrasin.
Përsëri dhe këtë vjeshtë në kokën e Meduzës
gëlojnë gjarpërinj të ethshëm për pushtet.
Sundimtarë absolutë të kamufluar pas gjakut të martirëve,
që në emër të tokës e popullit, liritë e vetvetes godasin e përgjakin.

Dhe këtë vjeshtë Hazreti Ismail
e përlotur është frymëmarrja e lirisë,
prej derrash të privilegjuar,
që ndihen rehat në llumin e skllavërisë.

Hazreti Ismail, ne vijmë e zbresim sot
tek shamizeza e zë shurdhërta, Vlora jonë.
Tek lokja xhokegrisur me fytyrë të përhumbur.
Tek Ija këmbëzbathur, prej motit të keq fshikëllues.
Tek dada fytyrë tretur si shkumësi zbardhëllues.
Nënokja lëkurë regjur e sy ngrirë prej mijëra lotësh.
Nëna, buzpërvëluar, që në gjoksin e rrashtëtka
mbledhur mirësitë dhe gjithë dashuritë e botës.

Zbresim ne sot në sheshin tënd të madh...
Aty ku dorën shtrim dhe bëm një betim.
- Mëmëdheu është i yni. - thamë
Jashtë të shporrim robërinë.
Ja të vdesim, ja të rrojmë për Shqipërinë!

Në "Sheshin e Flamurit", në të vetëmen gjë heroike.
Zbresim sot ne të ngriturit prej zëmërës së errësirës.
Ne që në emër të lirisë u derdhëm përmes flakëve.
Ne që ramë e u shkrumbuam në zëmër të zjarreve.

Për të njëqindin vit radhazi ne vijmë këtu me shpirtin e djegur.
Kordhëtar me imazhe të zhgënjyera jete mbledhur nëpër sy.
Mbetur në krenenarinë këforte të mos nënshtrimit si ndër shekuj.
Nën përgjumjet e ndotura prej fantazmash, mbetur të përndjekur.

Kështu vijmë me ty për tek Vlora jonë e djepit të gurit.
Si vargëmalet flakë derdhur zbresim gjithëkahanë.
Hazreti Ismail nga haxhillëku kthehet me hazinetë e burrit.
Ballin rrudh dhe tek qoshku i sheshit përshëndet hijerënd.

skender braka

skender iljaz braka

Për Tek Ty Po Vrapoj.

Për tek ty po vrapoj.

Me një rrahje të lehtë flatrash
ndonse rruga më duket e pambarimt,
për tek ty po vrapoj.
Në sy kam flakëritjen e yllit të mëngjezit.
Në buzë puthjet dhe përgëdhelitë e imagjinuara.
Si asnjëherë prej së largu
ndjej afshin e kurmit tënd të zjarrtë.
Ndjej tingujt e zërit të lehtë e të trisht.
Ballinën e shpirtit, që çdo sekonde më thotë;
- Të dua, të dua, të dua, të dua....
Nxitoj dhe mendimet më ngatërrohen në kokë.
I mbytur rënkimesh, shpresat e errëta thërrojnë
si thërrmimi prej pikëzës së shiut i gurishtes.
Nuk di përse më përngjan me një objekt të panjohur,
të paprekshëm e të tejdukshëm gjer në kockë.
E përhumbur përmes avujve të freskët të detit.
Mbytem nëpër valëhijet që tërheq e mpleks pas
vetmia ime e thellë.
Ti larg më je..larg.....
Oh! sa larg mbi gjithë të tjerat më je ti,
këmbanore mjegullash,
flakërima e diellit,
lëndina bleronjëse,
Venusi shumëgjyrësh i syve të mi.
Eshtë gjithçka e jotja sot,
që më bënë të vrapoj për tek ty.

skender iljaz braka

Per Ty Palestine

PËR TY, PALESTINË ...

Në një ngrehinë të çuditshme prej balte,
me dhimbje tretur kallamishteve,
atje ku prej tmerrit kreshpërohet goja e shqyer e vdekjes.
Tej, në atë tokë të djegur të Palestinës,
Çdo ditë nën tmerrin e predhave dhe raketave
kam jetuar rëndom edhe unë.

Kam varrosur atje një pjesë të klithjeve të mia,
një mijë herë prej ndjenjave të trazuara,
një mijë herë prej vargjeve të poshtëruara,
mbytur në borxhe të pashlyera,
arratisur prej damkosjes së turpit,
mos shikimit dhe rënkimeve të padëgjuara.

Atje ku duar fëmijësh krasiten si degëza hardhie
dhe vajzëria sterilizohet për shterpësinë e turpshme,
kam mbjellë poezitë e mia të pashkruara.
Nga kujtesa, si ujvarë, loti i gjakut më rrjedh pikëllim
që humbet në zbrazëtirën e athët.
Palestinë mortore e rrebelimit të gjallë,
mbedhur si musht i ardhur ke zemërimin,
nën qerpikët e tharë.

Mbytur në aromë gjaku
dhe mbeturina gëzhojash shndërruar
lulet e tua të porsaçelura, që bëjnë apel,
gjakun e martirtëve mbi petale kanë pikuar.

Jeruzalm, o bukuri e pikëlluar!
Kryeqytet i trishtuar, si trëndafili i pluhurosuar
prej tymit të zjarreve të luftës!
Të rikthehem sot, borxhin për të paguar
dhe thellësive të tokës tënde të purpurt,
poezitë e shpirtit për të shkruar.
Për ty, Palestinë e martirizuar...

skender iljaz braka

Përditë Me Vetën Grindem...

Përditë me veten grindem...

Përditë e përditë me veten grindem.
Torturohem prej këtij drej vargu, që s'më bindet.
Lidhur si cima të çelikut anijesh më ngjan.
Që si baticat e detit lëshohet e tërhiqet.

Përditë e përditë fjalët më ngatërrohen.
Më vijnë si shkëmbenjtë të thikëta, të ashpëra.
Letrat zë e gris, me vargjet rrebelohem.
Mbi qepalla më rëndojnë netëve të gjata.

Buron e më rrjedh vargu me kolorit autokton.
Sintezë që rrjedh e derdhet brënda mikrobotëve.
Më i rënd më bëhet e shpirtin më sundon.
Kur më shtyp me britmën dhe këngën e rapsodëve.

Përditë e përditë më kthehet fjala në një gur.
Më çon tek bujku në arë e në thellësi minierash.
Përgjumjen më shkund e më thotë: bëhu burr!
Se veç burri di të dashuroj e të mbjell farën e jetës.

Më lodh ky djall vargu, më lodh e më cfilit.

skender iljaz braka

Perheree Nen Kujtimet E Tua

Përherë nën kujtimet e tua

Përherë nën kujtimet e tua i rrëmbyer.
Prej buçimës së kujtesës, ti më del përball.
Të humburin realitet të dashurisë imagjinuar.
Vështroj shikimin tënd, derdhur diku mënjat.
Qepallat e njomura prej vesës në ag.
Imazh i një trupi të pajetë pa një vend çvarrimi
Përse vallë më dukesh kaq e huaj! ?
Përse vallë të urrej e të ndjej kaq larg! ?
Të urrej se s'pata kurrë forcë për të harruar.
Se dhe në harrim ndjenja bëhet më e gjallë,
dhe urrejtja gjithashtu, më e përvëlur.
Si asnjëherë i rënduar mungesën tënde përjetoj.
O brerore e zjarrtë përmallimi e diellit tim të afshët.
Në zemrën e mpirë prej hidhërimit, pritja m'u ajohua.
Mes lotësh të bardhë timbër i zërit m'u shua.
Me një devotshmëri skllavëruese të isha përkushtuar.
Dhe përsëri të dua si në ditën e fillimit.
Dhimbjen për nofullash shtrëngo
si i dënuari i pashpresë përpara ekzekutimit.

skender iljaz braka

Përpara Portës Së Vjetër

Përpara portës së vjetër

Ka diçka që më nguros përpara kësaj porte të vjetër.
Por s'më trëmb misteri frikshëm që fshihet pas saj.
Pa ditur seç kërkuj kështu kësaj udhe të djegur.
Llogaris faturën që do të paguaj me çmimin e jetës.
Me atë të shpirtit, që jeton botës së perëndive në hyjnajë.
Kreditet që përgjatë viteve mblodha për të kuptuar
ndritshmëritë e padukshëme të fjalëve të gjalla.
Ku u degëdisën e humbën vallë këta breza njerëzish,
për të cilët u ngritën mitet e u thurrën mijëra gojëdhëna.

Hallehedhur pas shpinës shkoj buzëmbremjes në bregdet.
Të hirtën e tokës vështroj që tretet nën ngjyrimet universale.
Dëgjoj sonetën e muzgjeve, ultratingujt e lakuriqëve të natës.
Dhe të mallëngjyeshmen këngë zë drithëruese të valëve.

Shoh një kalimtar në udhë të drobitur prej plagëve.
që fërshëllen me bindjen se jetonë të vërtetën.
Në shtëpi nëna çdo ditë me motrën grindet,
që veç makiashit s'di të bëjë asgjë tjetër.
I urrti m ungj dhe sot harroi të lexoj gazetën.

Një zhgjëndërr e çuditshme kanë qënë vitet e mia.
Si një ëndërr grimore brënda një ëndërreje të thellë.
Në mjekrrat e gjyshërve kurrë si kam kuptuar ato thinja.
Të damkosurit prej mretërisht dhe sirenash të shpifura.

Përse vallë vargjet e mia të para në mënd më risillen?
Ato fragmente dashurie, që në copëza letrash
shkrova e i grisa një nga një.
Atëherë unë vdekjen as që mund ta merrja me mënd.
Më dukej se me kafshimin e saj të ngadaltë bëja dashuri.
Pas asaj porteje të vjetër trokas i heshtur,
Me mendimin se jetës pak e nga pak jam duke i vdekur,

skender iljaz braka

Përpara Syve Të Dantes...

Në takimin e parë me Danten,
lëkurën time të zvetnuar prej trupit xhvesha
dhe e hodha përdhe
mbi një grumbull gjethesh të mykura.
Syri s'ma kish njohur kurrë pendimin.
C'vlerë do të kishte ti dëgoja
pëshpërime e fundit natës,
kur ende nuk dija nëse zoti do më shpallte
të pavdekshëm apo jo.
Vdekja përgjumur u ul përpara këmbëve të mia,
si një kone e përgëdhelur, e zbutur.
Nuk ma thoshte dot mirseardhjen.
Përpara syve të Dantes unë falenderoja:
gjarpërin e syve dhe një tufë shkrimesh,
që kam lënë për të mos u harruar.

skender iljaz braka

Përse Kaq Larg..?

Më mungon ti...

Shikimi yt, tingujt e buzeqeshjes,
ngrohtësia jote më mungojnë.

Vetëm kujtimi i asaj dashurie më ka mbetur.

Cdo qelizë timen si ndryshku hekurin duke brejtur.

Tani larg më je...

Por jo prej mendimeve të mia.

Unë sytë mbërthyer mbaj tek asgjëja.

Si për të thënë se më e bukura ëndërr

paska qënë për mua dashuria.

Rrotull një zemre të bërë copë,

më i pamatshmi perimetër.

Sa minuta, orë, ditë, ti larg je prej meje?

C'të afron dhe ç'të largon nuk e di.

Padukshëm, si baticat dhe zbaticat

tërhiqemi e shtyhemi.

Hon i pakpërcyeshëm na u kthye kjo largësi.

Gjysma jote brënda mbeje të ka mbetur.

Gjysma ime, si proteinë,

plazmës së gjakut tënd e tretur.

Përse kaq larg e dashur.

Kësaj bote ç'dreqin kemi për ti ndar?

skender iljaz braka

Përse Më Fshihesh..?

Unë të gjej kur dua të të gjej,
ndërsa ti më fshihesh
dhe kur pranë më ke.
Mbase të jam thinjur...
Mbase të jam plakur...
Po ç'dreqin të kam bërë,
që më shkon si hije?
Kaq shpejt pse më ngatërron
me një gjeth, parakohe flakur...?
Por prap unë s'të mërzitem.
Përdhëmbshëm s'të qortoj.
Veç rrallë ma ço një fjalë,
qoftë dhe një shikim.
Që s'linda çupkë e bukur,
e s'dita të bëj ledhka,
s'është mëkati im...
Unë të gjej, kur dua të të gjej.
Ti pse më fshihesh
si gjarpëri nën shkëmbenj?

skender iljaz braka

Përtej Së Përtejshmes.

Përtej së përtejshmes.

Ti ishe atje, si më e bukura shëmbëlltyrë e Xhakonës.
Mes fosforeshencës së detit nën flakërim të perëndimit.
Tej më humbisje, përmes lakuriqësis hënore.
Si engjëll i arratisur nën zjarrin e etheve të përvëlimit.
I ndjekur prej klithmave të zogjeve, të natës së bronct.
Pas teje vrapoja, përhumbur shkretëtirës së vetmisë.
Platitur prej tërbimit të erës, duke rrekur të të prekja.
Me mollëzat e gishtërinjëve, dridhëruar prej dashurisë.
Prej një shqetësimi të arratisur, që rënd më mundon.
Cmëndurisht të thërrisaj me timbrin e erës së trazuar.
Mbi dallgëzime valësh mesnatës së shëndritëshme.
Humbur buzëdetit, prej gjyrmëve të mija ngatërruar.
E hej...E hej...Ku je? Tretur nëpër mjegullë për ku shkon?
Si valë e lëshuar prej një varke të mbytyr më përplasesh.
Mbi luspat hënore të një peshku me vete më rrëmbe!
Përtej së përtejshmes, mbi pavdekësin e detit të jetojmë.

skender iljaz braka

Poeti....

Poeti....

Nxiton poeti udhëve pa mbarim.
Kënga e tij, fuqi jete shpërthen nga gjoksi.

Prej çdo qelize, muza e tij lind veçse poezi.

Në sytë e të gjithëve tretet
me energji të pashtërshme.
Mbi qerpikët e gjelbër të globit
frymëzim i tij rreh stuhi.
Në maja shkëmbenjësh qëllon që bie,
coptohet,
ngrihet
dhe përsëri me vrike udhëve lëshohet.
Poetit vrapin kërkush dot s'ia ndal.
Me copëzat e sëmurura të jetës vargu i tij,
përdhëmbet, lufton, kurrë nuk vdes.
Vargu i poetit atje merrë fuqi.
Mes njerëve të thjeshtë bëhet i gjallë.
Vargu i poetit, Univeres.

skender iljaz braka

Poker Ne Shekuj

Poker në shekuj...

Pokeri luhet në salla të mëdha lluksoze.
Salla që gojë hapur më kanë lënë nga habia.
Goja ime peshkut të paujë i përngjante
dhe hunda përngjashmërinë me sqepin e fajkoit.
Tiparet e mia të ashpëra përherë i kanë
çuditur lojtarët e mëdhenj të pokerit.
Të çuditur prej meje janë që prej kohës së Cezarit.
Unë poker nuk kam luajtur asnjëherë mbi fatet e popujve
dhe kokën se kam vënë kurrë në peshoren e pazarit.
Vërtetë une nuk di të luaj poker,
se njëhësuar e kam patur atë me kumarin.
Kumarxhiu në dej ka gjakun e vrastarit.

Letrat me shenja mban në duar Lloyd George.
Sytë e tij dinak vërtiten mbi trungun tim degë sharruar.
prerë prej së njëjtës shpatë të përgjakur,
kryqëzuar nëpër të njëjtën rrugë të shkrumbuar.
- Sharromi edhe ti një herë Mister Lord George!
Unë vijë nga alpet e jugut, përsëri kam për të mbijetuar,
se për aleat kam mallet, detin, lumenjtë dhe pushkën.
E di që ti je mjeshtër në hilerë, më më keq se një Bismak.
ndaj hidhi ato lerat e tua në plehra e mos më hy në hak!

Ju luani poker zotërinjë në sallat e mbushura me kufoma.
Mes zërave çjerrës pretendoni shënjtërinë e vendimarrjes
dhe thellë në shpirtin tim zë vënd çngjyrojsa e popujve,
domethënia e vuajtjeve të tyre përtej skajeve të imagjinatës.

Loja e pokerit kërkon sy me vështrim të përhumbur
si shikimi i gjarperit i etur për të thithur gjak.
Unë shikimin nuk e kam më pak se të shqiponjës.
Në tryezat e pokerit asnjëherë s'jam afruar.
As në bankete nuk jam ftuar.
Pokeri thonë është lojë për miliardier.
Për sojllinj me kollare, borsalinë dhe frak.
S'është e përshtatshme veshja ime me

fustanellë, xhubletë e tallagane gjithë shajak.

Curçilli si binjaku i grekut Odise me puron
në gojë lunate pokerin e shekullullit në Jaltë.
Pokeri i tij një lojë e përdhosur në duar të degraduara,
si diplomacia që është quajtu putana më e toksifikuara.
Loja që djalli në shtatë qiej nuk arrin ta rrëzoj.
Loja e mbetur gjithëherë nën vizione të përdhunuara.
Mbi trupa të vegjëlish gjysëm të vdekur
lojtarët hijerënd të pokerit hedhin procesverbale
vetëm për t'i nënshtruar e dërrmuar.

Gjuhën e nderit kam mësuar që prej kohës së pellazgëve.
Me këtë gjuhë u flas juve Pokerista që s'kini lexuar
asnjë rresht dokumenti për thyerjet e Rromakëve,
për terheqjen e tyrpëshme të osmanëve
e deri tek largimi fatal i Gjermanëve.
Juve qe se njohni historinë time të përgjakur.
Unë si kali i bardhë i Gjergjit ndër shekuj
pas vetes kam tërhequr të ardhëmen e përflakur.

Lertat e flilqura të Pokerit ka hedhur dhe një marshall,
kur Stalini mustaqet e ashpëra përdridhte
ndërsa llulla e gjatë lëshonte tymin si oxhak.

skender iljaz braka

Porta E Fshehur..

Porta e fshehur..

Diku tutje rri strukur vetmia ime,
e heshtur, fytyrëvrenjtur, lëngimtare.
Qepallët përpëlt pas një porte të fshehur.
Braktisur si simotra e saj e përzishme e ishujve.
Si vetmia e zezë dhe e akullt e trotuareve.

Përgjumjen shkund në një kaçubore dëllinje.
Atje ku ne hapëm të parat varreza të puthjeve.
Nën degët e xhveshura mbuluar me dëborë.
Ku trupat prej të nxehtit u ndërthurrën si det i kreshpëruar
dhe vonë - vonë, të heshtur ikëm pas portës së fshehu.
Ndjekur prej vetmisë bredharake, ikëm të dëshpëruar.

Tashti prej teje e dashur,
më vijnë vetëm ca tingëllima zëri të largët,
që më thonë se dimri sërish copëza akujsh do të ngrij
dhe se vetmia ime tek porta e fshehur ndotet nga jarget.i

Se plaga brënda gjoksit tim do të zmadhohet vazhdimisht.
Se të përthinjurit e flokëve dalngadalë më afrojnë pleqërinë,
përmes së cilës shkon gjarpëri i jetës.

Ah këto jehona zëri të thara prej lotit të dënesës,
që asnjëherë nuk më thanë,
se brënda vetes njeriu kurdoherë ka një qelizë.
bërthama e së ciles i shpëton harresës.

skender iljaz braka

Portreti Im.

Unë me detin dhe me qytetin tim ngjaj.
Me bukuroshen e ujit dhe me një eros mbi kal.
Ngjaj me nje fik deti rritur brigjeve të tij.
dhe me ca bedena që flen e çelin çdo maj.

Ndaj më kot mos u lodhni të kërkoni
portretin tim mes të tjerësh poet.
Unë jam një copëz det në miniaturë.
Një copëz anije e vogël jam,
ankoruar në molin e shkret.

Portreti im do tu kujtoj perëndimet e detit,
netët e ndriçuara prej një drite të hollë
dhe të gjitha dhimbjet e qytetit.

Mos më thërrisni për poezinë tu mbaj një leksion.
Kam kohë që me fatin tim të mjerë
së bashku me të larg kam shkuar.
Me anijen time të vogël kam ikur
nëpër dete të pabesa,
nëpër dete të frikshëm piratësh kam ikur,
andej nga ku fryjnë përrherënjë ca erëra të hekurta.
ku me qiejt grinden e përfyten me ca re të çmëndura.

Andej kam ikur nga ku dallgët e përthyera i lëpihen
tokës sime të djegur.

Qysh prej fëmijërisë ua kisha mësuar
huqet dhe gjuhën dallgëve
dhe kur thellësive të errëta më tërhiqnin,
përsëri mbi gjelbërime ujërash të qeta më nxirrnin
dhe më hidhnin si kripën e thatë përmes flakëve.

Mësuar jam me jetën të shahem, të puthem, të kapem,
si me tokën e ashpër gjuhët e briskëta të dallgëve.

Unë kam një portret disi ndryshe prej të tjerëve poet.
Syve të mi do të gjeni një far, një spirancë, një direk.

skender iljaz braka

Prej Degjenerimit Total....

Prej degjenerimit total....

Ndjen një moment trishtimi të thellë njeriu,
kur një buzëqeshje shtazore, lë pas një viktimë.
C'mure të rrënuar mbretërinë e mëkatit rrethojnë?
Zoti e mëshiroftë këtë krijesë të poshtëruar!
Prej së largu a pranë, diçka më vjen si një frymim.

Ca fasha drite i ranë sonte kësaj udhe mortore.
Castit kur sytë e një vajze preka perënduar në agoni.
Më ujë ndjeva të më mbusheshin gropëzat e syve.
E nën këtë ujë të nxëht lotësh, dhimbjen e saj lëpi.
Dorën zgjas dhe trupin e ftohtë ia prek me kërshëri.
Si një bujtinare vonuar që portës vazhdon ti trokas.
Engjëlli i mëshirimit, i qëndron mbi flokët e pakrehur.

Prej vitesh kthinës së varfër i ish afruar e uritur.
Vdekjen duke pritur, çdo ditë me të duke luftuar.
Ashtu si kandërrat që brejn një shpirt të cfilitur.
Ish tretur gjer në palcër, lirin duke kryqëzuar.

Zhveshur e tëra prej moralit, nën degjenerim total.
Syrgjynur prej shpërfilljes, në llumit e paturpësisë.
Nën të njëjtën fliqësi zhytur si një kafshë e molepsur.
Të tjera ulërima të papërmbajtura vajzash dëgjoj të ngrinen,
anë këtyre trotuareve përgjakur e të qelbur.

Në tregun e zi me çmim të lirë shet nderin e mohuar.
Si fare pa kuptuar vret e burgos iluzionet e shpresës.
C'mund të nxjerr veç mallkimit një shpirt i helmuar.
që veç një grim pamvarësie, kurrë paqe s'pat kërkuar

skender iljaz braka

Prej Lindjes Së Një Fëmije

Prej lindjes së një fëmije.

Kurrë ndonjëherë si sot s'jam ndjer i gëzuar.
Si zog i dehur në fluturim, kurrë nuk jam ndjer.
Pasqyrojnë sytë e mi gjithë kopshtet e harlisur
dhe zemrën askush nuk mundet të ma frenoj,
që mbi shkumëzime ujërash të panjohura detesh
zhytet, e përsëri mbi ujëra ngjitet e kthyer në delfin..

O natë, shikom!

Unë ndriçoj më shumë se vet drita jote e argjënd.
Sot më i përqëndruar jam në të tjera largësira qiellore.
Më beson vetëem ai që di të përgëdhel një fëmijë.
Ai që mbi supe di të mbaj përgjegjësira atërore.

Ndjej rishtash të më lindin shpresa të mëdha.
Spirancat më duhet të ngre për në të tjera detëra.
Përgjumshëm të zvarritem nëpër të humburat dhera.
Të përballem me stuhi e tu shpëtoj përmytjeve shkatrrimtare.

Mësojeni se sot kam një arsye më shumë,
që diellin të rrok e ta mbështjell me këto duar.
E qara e një fëmije që netëve mundet të më lërë dhe pa gjum.
Është shqetësimi që gjithkush në heshtje
ka pritur dhe shpresuar.

skender iljaz braka

Prej Luftës Jam Kthyer..

Prej luftës tu ktheva sot e dashur,
E përsëri drej luftrash do të shkoj,
në qytete të tjera të ftohtë, të pështjelluara.
Në qytete që kurrë s'kanë egzistuar.
Zëmëratën si një togë bulonësh të shuaj.
Prej një ëndërre të re të ndihem i rrethuar.

Kam ardhur për pak çaste të çmallem me ty.
Djegur dëshirash jam prej largësive të pafundëme.
Dhe shpirtin mbushur e kam me etjen për kripën,
për gruroret dhe barin që buit fushave të murrme.
Për zabelin ku një përroskë puthet me borigën.

E mundimshëme të jetosh në k'të botë të kalbur.
Ku dhe zogu pak ajër të pastër gjen të fluturoj.
Nën vetminë e frikëshme të shkrepave pa diell
dhe muzikën bajate që vjen prej të kazinove.
Shpirti yt dhe i imi, nuk mundet dot të jetoj.

Të gjitha mendimet sot vërtiten tek krizat.
Kudo, ajo që duhet bërë i fshihet qartësisë.
Si qukapiku mbërthyer mështeknës së zezë.
Përthojësh thepisjet e jetës dua të ngjis.

Ndaj mbi duar lërm t'i mbaj shpatullat e brishta.
Dhe zemrat të trazojm në ishujt e shëlgishteve.
Prej luftës jam kthyer e drejtë luftrash do të shkoj.
Mes ngrirjes dhe shrirjes së ngricave të frikshëme

skender iljaz braka

Prej Një Lavdie Falce Dhe Një Urrejtjeje Cfilitëse.

Tashmë që asgjë s'më ka mbetur për të festuar.
Formën e shpresës në tënden fytyrë ravijëzoj
Dhe vdekjen në një hendek kall me këto duar.
Tek shoh të pamundurat
të struken skutave të ërrëta.
ngrihet
Hendeku dhe krahët shpërngulur nëpër të ftohtë
Kërkoj ta kthej në një gur monumental.
Në gjunjë të përulem Evropë.
Idhëtar i përpjekjeve të tua titanike.
Aty ku thithë mushtin e përgjakur të sakrifikimit.
Ngritur mbi paqen e brishtë Për paqen e dëshiruar të njerëzimit mendoj,
për një shoqëri të përsosur,
ku para së gjithash e mbi të gjitha krimi të mos egzistoj.
të mos egzistoj shtypja persekutimi, korrupsioni.
Oh sa e kam dashur qe popujt prej memorjes
ta zhdukin epilepsinë e kohës
dhe një tjetër kohe ti besojnë...
të reapektoj mutacionet e rregullta
ti shjkeputemi njehere e mire kësaj errësireje të plotë
te mos ketë ndasira ne tonën Evropë

skender iljaz braka

Prej Njerëzores Dua Të Digjem

Prej njerëzores dua të digjem

Më çmëndën këto dekrete presidenciale
Këto farsa mashtruese që askujt si shërbejnë,
Nuk mundem më dot ti duroj.
Vazhdojnë jetët tona ende të mbeten të dhunuara.
Prej një shëmtimi që vetëm përçudnime pjell e pagëzon.

Vuajtjet e të shkuarës dhe një herë më janë rikthyer.
Gjithë ç'kam hequr ndjej t'më rizgohet më me forcë.
Dhe këtë herë mbeta i përvuajturi që dhunuesit
S'iu përula e s'ia shtriva kurrë njërën dorë.
Para dhëmbëve të flliqura të kapitalit
zë dhe ulëras me gjithë sinqeritet.
Këtë shëmtim nga themelet dua t'a ndryshoj.

Me vëmëndje kam dëgjuar rënkimet e një shpirti fatkeq,
Që mes erërash të ftohta sillet si poezi e pikëllimit botëror.
Në lakuriqësinë e urisë njerëzore
unë dhimbjen gjer në palcë kam ndjer.
Prej vdekjes së pashmangshme të fshihet
dhe të dridhet një tutor.

E vështirë është rruga ime, e mundimshme.
Më çon ajo drejtë majash ku me diellin të puthem.
Njerin e vërtetë kam dashur dhe respektuar
mbi gjithçka në botë.
Prej njerëzores dhe dashurisë së tij
dua të vdes dhe të digjem.

skender iljaz braka

Prill I Thyer.

Prill i thyer.

Ne rrinim mbeshtetur në pravaz të ballkonit.
Të tjerë pas xhamave fshihnin fytyrat e vrenjtura.
Mbasditja e mbërthyer nën ethet e trishtimit.
Përcillte mes pluhurit të horizontit
fatkeqesitë e tmerrëshme.
Ne mbeterine e xhungles.
prilli kishte thyer njërin krah.
Të gjitha anijet ishin fundosur në radë,
vetëm rimokiatori lëshon zhurmë e tij të mbytur
Lufta kishte ulur armët e saj.
Në ditarin tim vetëm diçka kisha lënë të pashkruar.
Diçka, që kurrë nuk kisha për ta mësuar.

skender iljaz braka

Pulëbardhë E Bukur..

Pulëbardhë e bukur..

Veç një çast të lutem pulwbardhw,

Ti qiellin e kaltwr braktise për mua.

Supeve tw mi tw rwnduar

shkundëmi përbaltjet e pathara të ujërave.

Rrëmbema ti zemrën prej dëshpërimit coptuar.

Dhe tw pwr gjakur hidhëma mbi kreshtat e dallgëve.

Nëse deti prej saj, i tëri, s'do tw përskuqet.

Me të dhe lëkura hënore e delfinit të rrallë.

Atëherë tw drejtw do t'jap për sa më ke mallkuar.

Dhe për të pakëtën dashuri prej teje që kam marrë.

skender iljaz braka

Puthëm Si Dikur..

Lodhur prej vetmisë nën një brengë mallëngjimi
dhe një herë të thërras, prej dhimbjesh i fashitur.
Gjithë mallin t'a përcjell me një jehonë pikëllimi.
Nën përvëlim i mbetur, thellë shpirtit i zhuritur.
Ndaj shkallmoje forcërisht koracën e ngurimit
dhe merre ti vrapin, fluturimithi për tek unë.
Gjatë të kam pritur, dërrmuar prej ngashërimit.
Prej vitesh të kam pritur, i heshtur si një murg.
Eja të takohemi atje, atje ku rrinim deri vonë.
Në atë vënd ku lulëkuqet çelin përmbi gurë.
E dashur ti kthehu si një puhizë e ngrohtë.
Me zjarrin tënd pëkëdhelëm dhe puthëm si dikur!

skender iljaz braka

'Qielli Me Yje Mbi Mua, Ligji Moral Në Mua"

Shpesh i përhumbur udhëve mëkatore të natës.
Imponuar prej kësi tranzicioni të gjatë, paradoksal.
Këtij epitafit mbi gur-varrin e Kantit shpesh i referohem.
Vetvetes kurrë pa i kërkuar, pendimin tim verbal.

Dhe mes imazhezh shpërfytyruese, që syve më ngrijnë.
Teksa i rikthehem si hija ngrehinës sime të shkatërruar.
Po këtij epitafi i falem, për udhët nga kam ecur.
Për gjithë ç'kam bërë, i ngritur dhe rrëzuar.

Unë jam për ju Neptuni përmes dallgëzimeve të kripura.
Anima Mundi, që nga varret ngriti shpirtin e besimit.
I irrituari prej poshtërsisë së një kanoniku mjeran.
Për boshllëqet e të së përditëshmes, i natës zjarr përvëlimi.

Jam heshtja e zezë e shpellave të largëta.
Taipani helmues, armik i betuar i mëshirës,
Përbuzja e urryer, përçmuese e Guimpenit.
Shpirti, që përpëlitet prej kafshimit të cmirës.

Kështu mbeta unë, një zë, një këngë dëshpërimi.
I përditëshmi kuant i juaj, që brendësore emeton.
Për ulërimat e erës së vjetër, i papërmbajturi, rrebelimi.
Kur ndodh që në emër të popullit, i pandershmi triumfon.

Qielli me yje mbi mua, ligji moral në mua.

skender iljaz braka

Qyteti Im

QYTETI IM

Në përflakjen e perëndimit të vonë mbi kodrinë,
kur pulëbardhat vajtueshëm mbi valë krakëllisin,
ti, Durrësi im, si një dhëndërr i urtë, si një nuse e mirë,
qëndron i heshtur me shikimin e ngrirë.

Tri herë i vidhisur, tri herë i ringjallur,
shfaqur si sfinks me fytyrë madhështore.
Nën bedenat pellazgjike, rrënjët thellë ke shtrirë.
Rrënjët e mpleksura, rrënjët mijëra shekullore.

Në arena të përgjakura gladiatorësh,
lotë të kristaltë ke derdhur me pikëllim.
Mbi pellgje gjaku dhe male rrënojash
me eshtrat e të rënëve ke shkruar lavdinë.

Hyjnitë e mermerta, si korale të bardha,
të kanë mbetur ndër vite si kurorë e lulëzuar.
Me dallgët e zhurmshme, me dallgët e paqta.
të kalburit damarë, nga trupi ke shkallmuar.

Vërshuar kanë mbi ty kohërat tragjike.
Përjetësisht mes erërave ke mbetur i rrethuar.
S't'u drodh asnjëherë ajo zemër e mirë.
S'të krisi asnjëherë balli përcëlluar.

I çmendur pas teje gjithë jetën do të mbetem,
pas bukuroshes tënde dhe erosit mbi kalë,
pas mureve të lashtë dhe torrës Ilire,
pas detit të magjishëm dhe të brishtave valë.

Një mijë herë prej teje në u largofsha, Durrësi im!
Një mijë herë nga larg do të puth e përshëndes me mall.

skender iljaz braka

Qyteti Im Me Fytyrë Perëndie....

Qyteti im me fytyrë perëndie....

Prej kripës grryer janë muret e tu të uritur.
Poreve të tua të mbushura plotë alga dhe likene
pikëllueshëm të pikon mushti i ardhur i shekujve.
Xhveshur pankartash e banderolash të shqyera,
je sot bukuroshja e rilindur
me fytyre prej rrezesh perëndimi praruar.
Durrësi im i përthinjur,
diafragma e atdheut tim gjak mpiksur.
Kënga e fundit që Euridikës i këndoi Orfeu.
Durrësi im - prej valësh fytyrlarë,
me gjakun e koraleve dhe perlave të detit tënd.
Thyer trishtim nga lulëzimi që dhe vet diellin vret.
Prej gurit tën të Sizifit, që ndali rrokullimën
e në dysh u nda në fundin e shekullit te njëzetë.

skender iljaz braka

Qytetit Tim

Pushtuar i tëri je sot
prej fashosh të trasha resh grirore.
Ngaherë humbasin mes të kaltrës së detit të sert.
Si ujërat e turbullta,
si ujërat e vrenjtura
përpara fillimit të bunacës vjeshtore.
E kaltëra e detit shpesh prej harqe ylberi mbërthehet,
si për të mbuluar gjurmët e dhunës së egër,
që prej vitesh si vraga plagësh të kanë mbetur,
shkaktuar prej gjëmimeve të frikshme të luftës.
Këmisha e purpurt, qëndisur me alga të gjelbërta,
ditët t'i kthen në një det të gjërë pa këngë.
Supet e përgjakur t'i krrus si një peshkatar i vjetër.
Si një peshkatar i përgjumuar,
që me mushamanë e vjetëruar të shiut
gjuan koca dhe levrek
në motin e trazuar.
Qyteti im i heshtur,
o tokë e zezë, e gjakut dhe e varrit.
Një grusht pulëbardhash qiellit i ke hedhur...

skender iljaz braka

Retrospektive

Largësive të mjegullta vështrimin hedh larg.
Mbi rrënoja ngrehinash, skaje skutash të errëta.
Befas e ndjej të më shfaqen kujtime të largëta,
Copëza vegimesh e imazhesh me ndodhira të djegura.
Si bujku me plorin e tij tw hekurt e rqmoj kujteswn.
Fragmente ngjarjesh vëndin e njëra tjetrës zënë,
Si tabllot e një filmi metrazh shkurtër, bardh e zi.
Përmes heshtjes dhe lotëve, fytyra të përvuajturish.
Të dashurit e mi që shkuan e humbën Qerbelasë.
Varre për kryqëtar që tokën e egër ma kthyen në hi.
Të përndjekurit prej monarkut halldup e matrapaz.
Më shfaqen hije minaresh e këmbanash zë shuara.
Lot nënash shamizeza dhe deri tek kwngwt e ndalura
Ndjej ngerçin që gjymtyrët t'më shtrëngoijnw forcërisht
Kur hyjnitë e luftërave shikoj parakëmbëve të gjunjëzuar.
Të tjerë që shkretëtirave mbetën prej dhunimit totalitar.
Prej dogmatikëve mjeranë e idhëtar të ksenofobijës.
Të ekzekutuarit pa gjygje prej të bindurve ushtar
Më tëhu në kohë, të pacipët zvarranik të Muavijes.
Ja, e vjetra kasollja ime ku u linda mes përbaltjes.
Të errëtat shtigje ku kam shkuar i etur, zëmërvrar.
Më shfaqet imazhi i të dashurës buzës greminws.
E lehura e një koneje që gjurmët lë tej mbi ugarë.

...

skender iljaz braka

Rilindje

Rilindje

Ia shtriva dorën e zbardhur valëkaltërës.
e prej syve të saj mu njomën mollzat.
Si luhatja e përjetëshme e erës nëpër muzg,
më erdhi rënkimi i degës së tharë të palmës.
Vragave të kohës kishte rrjedhur pjalmi,
bashk me pickimin e bletës, që në jetë më solli.
Bova e largët lëkundej e përzhytyr,
për anijen e zhdukur viteve të shkuara
thellë thellësive të paaritëshme të detit,
që bregut më nxorri me frymën e tij të kripur.

skender iljaz braka

Ringjallur Pas Ndëshkimesh

Në të përpjeta të pashkelshme, kudo ku kam ecur.
Buzë honesh e rrëpisha, shkoja larg e më larg,
pa ditur se ç'më priste atje,
në atë ishull të mallkuar e gojë mekur
ku përbaltja dita ditës na njolloste në çdo kënd,
ku s'kish hënë e s'kishte drite,
për asnjë, nuk kish një vënd.

Të vështirë e pata patur të harroja seç kam qënë.
Por veç Ligjit, për gjithë mëkatet do t'i lutem t'më dënoj.
Nën rrethana poshtëruese ndjej të qënurit fajtor.
Se kam një varrë për tu varrosur, gjithnjë shpresoj.
Se dhe në ferr më thonë, do të kem një kënd, për vizitor.

Tani i vdekur i rishfaqem, qytetit tim të harruar.
Vij i mbytur nga hidhërimi, pas ndëshkimesh i ringjallur.
Prej ca traumash shkatërruese, tërësisht i vetdënuar.
Porsi shpirtëra të arratisur, një nga një gjithë perënditë,
brënda qënies sime plak, seç i ndjej t'më jenë larguar.

Oh, ti barku i mallkuar,
mbartës i së keqes kaq të madhe e vrastare.
Sytë më vezullojnë mbi plazmën tënde të çngjyruar.
Shihmi! Shihmi këto këmbë e këto duar që më dridhen!
që kërkojnë të çapiten e të prekin mijëra varre.

Të avitem përsëri, kështu siç jam i verbuar,
me këtë pamje të mërzitshme, shpërfytyrore.
Të përulëm para këmbëve i helmuar, shpresë grryer.
Se uriya për moral edhe sjellje djallëzore, s'do t'ia dij.
Se një zëmër e lënduar s'është gjë tjetër veç tragjedia,
më e dhimbshmja e një jete të përdhosur nën poshtërsi.

I ringjallur pas ndëshkimit,
prej të njëjtit mallkim ngaherë i shtrëngar.
mes të vdekurish, si i vdekur i rishfaqem
rrugicave të përbaltura që përpëliten në agoni.
Këtu rrekem të nderoj gjithçka të humbur
që askush se ka nderuar.

Nuk dua të hakmerrem, as ndaj atij gjarpëri
që dhëmbin e vdekjes trupit tim ia nguliti.
Kurrë s'kam dashur të ndëshkoj as atë,
që dikur rëndë më pat ndëshkuar.
Iluzion i ngashëryer në harresë më mbeti shpirti.

Nën një lutje të pashpresë, vetndëshkuese,
si i kryqëzuari në kryqin e tij i gozhduar.
Atij që gjer më dje prej frikës i jam nënshtruar,
sot nën të njëjtin rënkim i afroj rrugën time,
nëpër të cilën shpirti im ndihet vetëm i lartësuar.

Ringjallur prej ndëshkimesh, rikthehem...

skender iljaz braka

Rizgjim Ndergjegjesh.....

Rizgjim ndergjegjesh.....

Tek nje varrezë e vetmuar stepem nën pendim.
Me shikimin e diellit zhbiroj thellë nën k'të varr.
Mes ulërimash të tmerruara, që vetveten kanosin.
Kam ardhur të çvarros kufomen e ndergjegjes së vvarë.
Në një shesh publik, ndër më të madhin t'a vendos.
Përpara syrit të të gjithëve, diçka për t'rikujtuar.
Se dikur bashkjetonim e më së miri përpjestoheshim.
Sot prej mungesës së saj, miljona dëme shkaktuar.
Ne te perditeshmen udhë, te shkelur prej mundimit
Nën dallgëzime jehonash prej minareve shurdhuese.
Pëpara kryqeve te përthyer prej efektit të mos pendimit.
Dishepujt predikojne genin e forces së arsyes verbuese.
Perhitur si gumë deti qëndron shpirt robëruar.
Rikthyer prej ferrit, përmes qindëra poshtëtimeve.
Për të vërtetat e çnderuar më rrëfen si e ngratë.
Rrënqethur prej plagësh në një trup të sakatuar.
E ringjalla ndërgegjen, shtyrë prej motivesh jetike.
Prej besimit të kercenuar nën dinakërinë e mashtrimit
Ropatur në kohe mes se padukeshmes se përditëshme.
Brejtjet e ndërgegjes, të zhdukura mbetur prej trishtimit.
Në kët'botë shtazarake, mbërthyer nën darët e krizës.
Ku të jashtëzakonshmet shndërrohen në ngjarje ditore.
Nën mungesën e vazhdueshme të respektit për jetën.
Njerëzimi vet jetën ka shndërruar në godinë piramidash djallëzore.
Kurajoz gjatë jetës ngaherë siç kam qënë.
Të vërtetat drejtë syve kam parë përtej mëshirës.
Në apel ndërgegjen time kam thirrur shpesh here.
Për gjykime të rrepta, nën përvijim të arsyes.

skender iljaz braka

Rrënimi Vjen Prej Etjes Për Pushtet

Mu kujtua vajza që vinte mbasditeve në bibliotekë.
Unë qëndroj në tavolinën e fundit nga krahu i dritares.
Ditët e mia të trishtuara përtypja në heshtje.
Jashtë, era gjethe të rëna shtynte rrëzë trotuareve.
Mendimet më shkonin në qytetin e saj të lindjes
ndërsa bëja sikur lexoja Lermontovin në origjinal.
Në vend të farave të lulediellit, përtypja mendimet.
Të ngatërruara më dyndeshin si retë mbi shpat mal.
Mbrëm në televizor pash Helenën e Trojës.
Në kujtesë doja ta alkimoja urrejtjen e saj për Menelaun.
dhe gjykimin e palëkundur për vetërrënimin e qytetit.
Bukuria, thosha me vete, nuk është e përjetshme.
As perandoritë më të fuqishme të përjetshme s'janë.
Qytetet dhe njerëzit lëvizin si ujërat e nëndheshme.
Mbetet vetëm shikimi im mbi atë vajzë bjonde,
që fosilet e lashtësisë prekte atje në tavolinën e parë.
Atë të shkuar prej kujtimeve doja ta shprangosja.
Por vajza me një gaz të çuditshëm në shpirt më thërret.
Të lidhur me të më mban i verdhi flok I gjatë
dhe imazhi i shkërrmoqur i të gjithë perandorëve,
që rrënimim mbollën prej etjes për pushtet.

skender iljaz braka

Rrëpirave Të Thepisingura Të Hënës

Rrëpirave të thepisingura të hënës
rrëshqet mendueshëm hija ime.
Në varrin tim të ftohtë, flokët që më rriten,
sytë m'i mbrojnë prej gjarpërit çukitës
dhe vetëm një xixëllonjë i bënë dritë
emrit tim, që si një shelg vajtues,
kalimtarët e përzishëm pret e përcjell,
me ca vargje të shkëputura prej poezisë së ditës.

skender iljaz braka

Rreth Zjarrit

Rreth zjarrit

Rreth zjarrit tone te bukur bubulak
vertitet e vertitet nje qen i zi
rojtarit i tij pas pylli pergjon
here here e ndersen qe te haj nje njeri.

Te shkretit qen, si mendja nuk i shkon
se me nje dru zjarri une e shkrumboj
dhe rojtarit qe pas peme si hije pergjon,
ndoshta dhe atij gropen e qenit i tregoj.

pas qenit te zi fshihen dhjetera langonj.
qe sillen verdall rreth zjarrit tone te bukur bubulak.
te mjeret langonj sa here qe qenin nderrojne.
te zinje i zgjedhin nga thonjet, koka e gjer ne bark.

skender iljaz braka

Rropatur Per Qiellit..

Rropatur per qiellit..

Rropatem diteve te vetmise se pergjakur.
Cigaret ndez e fike mbi nje tavull te bardhe.
Djall i mallkuar qe enderrat me ke perflakur.
Nje cope dallge me ke lene ne kete oqean shkatrimtar
Mbytur anija ime pa shprese shpetimi.
Kapedani kokekrisur ne drejtim te pakontrolluar.
Shtrenguar mes dhimbjesh prej syrit te perçmimit.
Dhimbshem shoh hyjnite e lufterave gjumnjezuar.
Diku tej mbi dallget e bardha, thithur prej nates.
Shenjterimi perfaqsuar mes luftera intrigash.
Lotet e popujve fshin si djerset e vapes
dhe zeshem mallkon kete gjyete te pambarimt shtrigash.
Nje ze me shume, nje klithje e gjate.
Ethshem gjemojne nen britmat e urise.
Mbi terrin e mbjell plantacioneve te mendimit.
Rrebelohet per qiellit zheline e coptuar e lirise.

skender iljaz braka

Rrugeve Te Mehalles Sime

Nëpër të ndoturat rrugë të mëhallës sime,
mes atyre shtëpive të rrënuara, të varfëra,
lëngun e tmerrit të skamjes kam pirë..

Nëpër shtratin e varfërisë, të zhytur në mjerim,
si minatori thellësive të galerisë kam zbritur.

Atje, urinë grryese,
si acidin bazik të kohës që jetojmë,
në miljona herë shumëfishuar,
kam parë tendosjen e zorrëve të pangopura,
zorrëve të holluara dhe indeve të squllura.

Mëhallës sime, mes shtëpive të varfëra,
frikën dhe pasigurinë e së nesërme,
kam ndjer të më mbaj mberthyer në darën
e pamëshirshme të ngerdheshjes.

Në buzqëshjen e mundimëshme të skamjes
kam prekur atë pak shpirt të brishtë të lumturisë.
Muskujt që mezi kanë pritur rritjen,
si kallëzat e fashitura të grurit të arës,
që prej erës marramandëse
tokës së ftohtë duaj duaj i bien.

Rrugëve të mëhallës sime shihet
apatia e ndjenjës së pafuqisë...
njerez të prirur për të ndershmen,
përrjetojnë përjashtimin dhe stagnimin.

Nga afër i kam parë këta njerëz të rreckosur
Tek punonin në ndërtimin e një muri,
tek përzhiteshin prej zhegut të vapës përvëluese
në hapjen dhe shtrimin e një rruge.

Këta njerëz të thjeshtë.
Këta njerëz të urtë...
Cdo ditë din të çajnë veç me verbësinë e tyre.
Miëra herë janë ndjerë të pënguar në udhën e tyre

e po mijëra herë janë ngritur mbi vuajtjet e përbindëshme.

Duke rrapellitur neper rruget e mehalles
sime te varfer kam pare se si nevoja
lind domosdoshmerisht nje ide.

Askush nuk ka arritur ta kuptoj shpirtin e tyre
As kur i shohin trupat e tyre të përlodhur si dergjen
në pluhurin e ngjinjur me djersë dhe gjak.

Duke rrapellitur neper rruget e mehalles
sime te varfer kam pare se si nevoja
lind domosdoshmerisht nje ide.

Mos u tremeni nga idet e ketyre, njerez!
Dhe nëse ato të vihen në veprim një ditë,
mos u trëmbëni.
Mëhallës sime të varfër do të lindin gjenit.

skender iljaz braka

Rrugica Ime E Fëmijërisë

Rrugicë e fëmijërisë, të erdha përsëri,
unë, djali çapkën që luaja serenata.
Me vete kam marrë një trastë me poezi
dhe brengën e thyer të udhëve të gjata.

Shëtitur kam qënë mërgimtar nëpër botë,
përvuajtur si rrezja në muzgun e thatë.
Në një gotë kristali kam derdhur shumë lotë,
ditët kam përcjellë me rënkime malli.

Të erdha, rrugicë, të të prek i ngazëllyer.
Diku larg i lashë këngët shurdhmemece.
Afromi të t'i puth sytë e gjelbëruar,
mallin të shuaj e t'i heq këto ngërçe.

Të dhimbshmet fragmente të jetës endacake,
në detin e kaltër i mbyta thellësive.
Erdha të flasim me gjuhën e ngjyrimeve,
serenata për ty këndojmë si dikur dashurive.

Erdha të rrimë tok nën kurorën e rrapit shekullor.
Një vajze t'i shkel syrin, tek del e luan në dritare.
T'i mërmëris ca fjalë, një puthje t'i jap me dorë.
T'i këndoj të mrekulleshmen ' O moj korçare..'

skender iljaz braka

Sa Here Me Ke Lënduar Ti Ndergjegja Ime.

Sa herë më ke lënduar ti ndërgjegja ime,
kur i tëri më është dashur të jepem pas së mirës.
Sa herë me të vërtetat e tua të papërkulshme
më ke pushtuar e mes krahësh më ke mbledhur,
Me këmbën tënde të sigurt e të padridhur,
mes gjoksit të gozhduar më ke shkelur.

Shpesh me përgjërime tw jam lutur, tw jam falur.
- Mos më vrit! - të kam thwnë.- Mos më vrit!
Por ti pamëshirshëm nwn vete më ke përmbysur.
E duart si Pilati ke larë në shpirtin tim të përgjakur.

Mes skërfitjesh të vajtueshme për pak dritë
mundimshëm si dreri i plagosur të jam zvarritur.
Dhe me mendimin tim prej poeti rrebel,
mes lotësh të përmotshëm të jam përpëlitur.

Sa herë kam shkuar përtej gjërave të pamundshëme.
Ti ditëve më sundoje me artin e pwrbotshwm tw ...
Ndwsa netëve më lije të kuvendoja me vetveten.

Mbi tehun e mprehtë të kufirit të tingujve.
Shumë herë më lëshove, se vëtrtetë përherë,
si para një dite, më deshe diçka më shumë.

Mbi tërbimet e ethshme të shfarosjes,
me ty përsëri kam fituar.
E prej ëndërash të frikshëme, të kobshme,
po me ty jam zgjuar dhe kam vrapuar.

skender iljaz braka

Sa Pak I Paskam Dhënë Kësaj Jete.

Sa pak i paskam dhënë kësaj jete.

Kam shkruar poezi që pak kush m'i ka lexuar...
Për rininë, deri vonë, një dashurie Platonike i kam kënduar.
Gjithçka kam mundur të ndaj me të varfërit, me të munduarit.
Cdo natë kam hedhur fragmente dhe copëza nga e përditshmja,
si çasteve kur i jam ngjitur një tëpërpjete,
ashtu edhe kur jam rrëzuar.

Kam qarë dhe kam qeshur me lotin e një fëmije të padjallëzuar.
Me durimin e shenjtit, kam përtytur të panumërta përcmime.
Prej njërës dorë jam goditur, nga tjetra, përgëdhelur i dërrmuar.
Nën breshëri të poshtërimeve drejtë së vërtetave kam ecur.
Por në një domethënie të vetme vendimtare kam ngecur.

Në të llahtarshmen skenë të kohës
kam luajtur edhe unë pjesën e dramës sime të papërsëritshme.
Njollat e lotëve kam pastruar në hirin e ngrohtë të shpirtërave.
Me urtësinë e Solomonit u jam shmangur mësymjes së tigrave.

Më jan shfaqur shpesh ca kostume modern përbrënda të arnuar.
Nuk kam dashur kurrë që mbi to të njolloset sytë e mi të paverbuar.
Në thatësinë paralizuese të jetës, të vazhdueshmen etje kam shuar.
Ditëve të akullta nën damkosjen e mendimeve,
portat e vetdënimit kam shqelmuar.

Ngaherë pamje nga më mjeranet më kanë bërë të flas me vete.
Tash e ca kohë them në heshtje,
sa pak i paskam marrë e i paskam dhënë kësaj jete...

skender iljaz braka

Sa Shumë Të Desha

Sa shumë të desha

Ti je më e bukura
se të gjitha bukurit
dhe më bënë të lumtur,
më shumë seç do t'më bënin,
të gjithë lumturitë.

Ndaj sa shumë të desha,
jo s'mundem dot ta them.
Dashurinë në botë s'ka masë, që e peshon.
Njeriu me të një mal të tërë rrëzon.
Janë pak miljona male, për një që dashuron.

Përtej një tjetër bote,
unë të desha dhe më shumë.
Të dhash gjithçka nga vetja,
mbi të gjitha dashurit.
Ti më quajte mbret,
ndaj të thirra: - E imja Mbretëresha.
Me po këtë skepter për hir të dashurisë,
do t'më përcjellin perënditë.

skender iljaz braka

Se Ngopa Dot Shpirtin

Shpirtin s'e ngopa kurrë me dashuri.
Se për dashurinë dhe me dashurinë
gjithë jetën kam luftuar dhe jetuar.
Jetova me atë që të tjerët ma vranë.
Dhe vdiqa prej një tjetër dashurie,
si çdo të vdiste çdo njeri i mirë,
me dashurin përjetësisht i dashuruar.

skender iljaz braka

Sfide E Perjetshme

Sfide e perjeteshme

E kishe paramenduar ikjen tende,
ndaj e le aq rremujshem
dhomen tone te varfer.
Dhe pse mizor ishe sjell me mua.
Çuditerisht ne percjelljen tende te bujshme,
nuk di perse i derdha lotet.
Mbase nga qe isha mesuar
t'i respektoja te vdekurit.
Mbase sinfonia e lasht e
trishtimit
ma trazonte shpirtin.
Te nesermen perjetesisht
e sfidova shpirtin tend.
I vendosur u ngrita te te le ne honin e harrimit.

skender iljaz braka

Shekuj U Dogjem Neper Zjarret E Lufterave

Shekuj u dogjëm nëpër zjarret e luftërave.

Shekuj u dogjën nëpër zjarret e luftërave
Të ardhmen mes suferinash pagëzuar me gjak.
Hirit të tyre, me forcën e shpirtit i mbijetuar.
Përmes varreve të etërve gjithkund të riahpara,
gjer këtu kemi mbërritur krenar e kryelartë.

Por nga liria të pashpresë papritmas u rrëzuar.
Nën terror duke rënë të prangosur, dëshpëruar.
Të rëndën kohë të lirive të kufizuara përjetuar.
Për së gjalli të varrosur, si qenie e përçëmuar.

Por më e rënd ish brejtja, ndrydhja, izolimi.
Me pak bukë nën sjetull, si eremit shtrënguam.
Si robërit pas lufte, në rresht shkonim drejt
frontit të ekzekutimit.
Dekadat njëra pas tjetrës para sysh na rrokulliseshin,
nën mizorinë autoritare të keqdrejtimit.

Në emër të diktaturës së proletariatit.
Për shënjtërimin e kauzës së sovranit.
Si metastraza të pashërueshme, gjer në
qelizat embrionale të kombit na i shtrinë,
të egrën, diskreminuesen, luftë të klasave.

Përpëlitur nën ngashërimet e shpirtit të gjakosur.
Nën klithmat drithëruese të lutjeve të pafundëme.
Kthyer në ca krijesa të pavullnetshme, vet trullosur.
Vetveten kafshonin në mënyrën më të etëshme.
Kufomat e përgjakura për kurban që nuk mjaftonin.
Kurbanatka nën tërbimin demonial kish nguros.

Nën pritshmërin e pashëmbull e me durimin e shenjtit,
Gjakftohtë e verbërisht me grushtin lart betoheshim.
Kur ëndërr na dukej dera e përflakur e perëndimit.
Kur ndaj çdo lirie themelore të përjashtuar ndiheshim.
E liritë na përgjakeshin nën shënjëzimet e diskriminimit.

Gjurmë gjaku pikonin koridoret e qelbura të ministrive.
Aty ku vet tharmi i doktrinës komuniste ish thartuar.
Jeta e një kombit të përndjekur pa frymëmarrje kish mbetur.
Tiranët në këmbë mbaheshin ngaherë të pa ndëshkuar.

Erdh koha kur në paqyrën e madhe të kohës komunizmi.
Shpërfytyrimin e fytyrës së tij të poshtëruar vështronte.
Kur Gorbi nga maja e perandorisë së shëmbur të Kremlinit.
Fundin e "Luftes së Ftohtë" nënshkruante do të nënshkruante.
Barrierat e pakapërcyeshme, guximshëm do të shkallmonte.

Te eturit sytë tanë për dritshmërinë e yjeve.
Horizontesh të reja piketuam ngjitjet e mundimshme.
Larg çdo brutaliteti kërcënues, larg çdo përdhosjeje.

skender iljaz braka

Shkoj Mendueshëm Buzëdetit.

Shkoj mendueshëm buzëdetit.

Mendueshëm shkoj mbi rërën rrezatuese të bregut.
Me trishtim shkel mbi pirgje algash dhe leshteriku.
dhe ndjej sikur prek pluhurin e përhimtë të qytetit,
Si të vdekurin prej sëmundjes së egër të lezbikut.

Përgjatë brigjesh të ngrëna prej dhëmbëve të natës,
bredhoj me dashurinë e frekët të hënës së vetmuar.
Nuk jam pelegrin i huaj me paimet ngarkuar shpinës.
As endacak i lodhur, që një bujtine i qasem për tu qetuar.

Unë vij nga varfëria e thellë e periferisë së qytetit.
Atje ku njerëzit të ashpër bëhen çdo ditë e më shumë.
Ku nëpër fytyra u ka zbritur frikshmëria e rrëmetit.
Aryeja dhe durimi humbasin e tjetërsohen në dhunë.

Vij prej lagjes ku flitet zhargoni më i rëndomtë i jetës.
Prej deltinës kripore me aromën e krekëzave të zhukës.
Andej ku perënditë qorrollepsen çdo ditë drejtë vdekjes.
Dhe dashuritë e brishta pëlcastin si fluckëzat e shkumës.

Këtë ngarkese të rënduar supesh mbi ty dua ta hedh.
Mbi natën prej peshkatarësh e dokerësh të cfilitur.
Helmin e shpirtit mbi shrtatin tënd të yjësuar të derdh.
Dhe me përgjërime të lutem me shpirtin tim të zalisur.

Me dorën tënde prej kristali jepma këtë degëz buzëdeti!
Prej njerës vale në tjetrën lëm të fluturoj një ditë të vetëme.
Si shpend furtunash dua të ngjitem hapsirave të qiellit.
Në folezën e shiut të sterilizoj gjithë fatalitetin e njerëzve.

O det, që thellësive ruan kallirin ëmbëlak të shpresës.
Jepëm një perëndim prej pranverë së bukur të majit.
Një grusht plot me yje jepëm dhe një muzg të pruar,
për t'i vënë si gjerdan orkidesh mbi kristalet e tua.!

Do të shohësh se si duart e mia prej punësh të forcuara.

Si një trandafil i hapur do të fluturojnë përtej pafundësis.
Jepëm një fllad Veriu ta vendos mbi shtatoren e qytetit.
Ndezur të mbaj farin e përjetshëm të paqes dhe mirësisë.

skender iljaz braka

Shkozeti Ynë

Shkozeti Ynë

Çuditërisht, tek një kornizë e vjetër
u ngulitën këtë mëngjes sytë e mi të vegjël.
Me zemër të zalisur ndjeva shtangjen e nemitur.
Je ti aty, copëza e vogël e mëhallës sime,
që orbitës së kujtimeve të largëta i vërtitesh
edhe me heshtjen e përjetshme,
më madhështore më rikthehesh pas kaq vitesh.

E imja mëhallë e humbur.
Përmes zjarrit të largët më shfaqesh,
atje ku i vjetri 'Orrel' digjej në përjetësi.
Ti strehëza jonë e akullt, mbushur e tëra plot helm e vrerë.
Trazuar klithmash më rishfaqesh, nën një tragjedi.
E goditur për vdekje, më parë e shtypur me egërsi.

Shkozeti ynë, i rrethuar prej reflkse algash, ndyrësish.
Porta e parë nga hynin lajmet më të çuditshmet e botës.
Mes baltovinës së kënetës më shfaqesh i fundosur.
Ndonse i poshtëruar, ti na rrite drejtë një bote plot rreziqe.
Bren gat thyer një nga një, përmes ditëve rraskapitëse

Përmes kohës, thjeshtësisht ti fluturoje.
Larg, përtej thellësive të detit tënd rënkimtarë,
Shpirt tronditur shtyje të përgjumurën vetmi cilitëse
dhe kotësitë e atij metabolizmi të çrregullt e vrastar.

Shkozeti ynë, streha dhe bujtina e të varfërve,
ngopur me ëndërrat e detit dhe të dritës.
Ti shkulma e përgjakshme e të gjitha sytheve.
Me fytyrën e bonifikimit të zhurmshëm më kujtohesh.
Më kujtohesh me aromën djegëse të plastikës.

Nën një masë të zezë resh fshehur pishave të përzhitura.
Fëmijëve e tu që trokisnin derë më derë duke qarë,
Gjithë të trëmbur prej vrazhdësisë së natës së marrosur
me një copëz hëne varur gjymtyrëve të drobitura.

Shkozeti ynë me kopshte të heshtura tërë plogështi.
Fantazmat hijerënda të mesnatës përzure forcërisht
Dhe më thoshe i përlotur, buzëdridhur si fëmijë:
se përtej së përtejshes do të gjesh ngaherë një kohë.
që do të jetë edhe koha jote më e mirë se e shekullit.
Veç këtu ku je rrëgjuar, ku t'u than ca pikëza loti
dhe një këngë e pakënduar..
ke boll një vend të mjaltëm biri im,
me hyjnitë e detit dhe me të vdekurit për tu dashuruar.

skender iljaz braka

Shkujdesur Ecja Rrugeve Te Qytetit

Shkujdesur ecja rrugeve te qytetit
Hapat ngaterroheshin
Ne kuadrate trotuaresh ne forme, pa forme
Capitesha, si nje hije ne nje ishull te humbur
Ndjeja nevojen te isha larg
Pertej kufijve te Tokes
Larg dhimbjes, frikes nga e panjohura
Larg konturit te vizatuar
Ne sfond Ligji abstrakt
Ne hapesiren e qiellit, qe me mbulonte
Struktura jote me shfaqet gjymntuar
Zeri yt, qe tingull bosh me ngjante
Diten ma kishte erresuar
Ndjesi te ngaterruara me trazonin shpirtin
Ne kryqezim semaforesh zemra ka ndalur rrahjet
Lodhja ka filuar te me ngaterroj kembet
...apo hija jote me ndjek torturueshem?
Filloj hapat te numeroj
Si jehone prej qiellit oshetinte
Betimi I zemrave ne nje ze
Pikturuar ne nje veshtrim
Mes ofshames se shpirtit
Shkrepetima te frikshme qiellit vjeshtor
Me kane pushtuar
Teksa ecja pa ditur bregut te liqenit
Rraskapitja gjoksin ma ngushton...apo?
Ulur heshtjes se nje stoli
Dhe liqeni ngjyren gri kish veshur
Rrezet e fundit te diellit me turbullojne pamjen
Fytyra njerezish pushtojne hapesiren time
Mundohem te shkeput nje copez te botes se tyre
Diku atje tej tymi ne disa peme te djegura
Behej nje me ngjyren gri te reve
Edhe rrezet e fundit u fundosen
Pas kraheve te shpateve
Duke lene pas nje shpirt te vetmuar
Cigaren vendos ne buzet e thara
Duke e mbajtur gjate ashtu pa ndezur
Perhumbur veshtrimi ndesh syte e nje vogelushi

Qe hapat ngaterron nxituar te kap nje pellumb
Buze trotuarit qendronte per te pushuar
Buzeqesh lehtas nen buze
Pellumbin I vendos qetesisht femijes nder duar
Duke I ngritur lehte te ty nder krahe
Buzeqesh femija
Krahët rreh pellumbi ne fluturim
Mbi liqen
Nje rreze kishte harruar te puthte valen

skender iljaz braka

Shpesh Në Ëndërr Më Shfaqen Katër Varre....

Shpesh në ëndërr më shfaqen katër varre....

Shpesh në ëndërr më shfaqen katër varre.
Më ngjasojnë me katër meteor
që digjen e kurrë nuk do të treten.
Mbi një kodrinë të jeshiltë rrethuar
prej lulësh dhe egjërash,
që mermerit të kuq s'ua ktheni kokën dot.

- Këta që shtrirë janë këtu, - më tha dikush,
s'demonstruan për të pushtuar institucione.
Instikucionet shteti yn i ka të kalbëzuera, të degraduara.
Më parë se të binin këtu, i kish njohur pak kush.
Ata në protestë u ngritën për drejtësi,
hajdutërisë dhe një bande njerëzish të korruptuar.
Prej të njëjtit shkak i vranë dhe i akuzuan.

Të fundit fjalë të tyre ishin si një murmurimë,
që dilte prej grykësh të jo forte mirë të ushqyera.
Të acartat erëra të janarit me vete i muarën.
I shnëdrruan në murana të përjetësuar
Shpesh në ëndërr më shfaqen katër varre....

skender iljaz braka

Shpirt Gruaje

Shpirt Gruaje. Livadh i pafund, mbjell me dashuri.
Kështjellë vuajtjesh e rrethuar plisash të zinj.
I qelqëti zëri yt, mbush hapsirat e kthjellta.
E gatshme për të notuar mbi pirgje kalbëzimesh.
Përmytje kënetash, dhe intigash thurrur kuvlive të errëta.
Shpirt je gjëmim dhe varr pabesish.
Pabesia ime, në qiell të plumbtë tu shndërrua.
Por ti me shpirtin vajtonjës të natës bëre paqe.
U ngrite mbi ngashërimet e tua të thella, të gjata.
Viktimë nuk re e ditës së zeza, të trish si nata.
Si toka e zbrujtur shirash,
trupit, sythet e dimrit ndjeve të të çelnin.
Me ofshamë dhimbjesh tej e tej mbushur vrapove,
duke gëlltitur copëzat e bukës së hidhur,
rrugëvë të pashtruara, kaldrëmeve të përbaltura.
Krahtë e ndrojtur ia ndere vegimit të një porte
Pa iu shmangur cakut të një rrugëtimi të vështirë,
duke përshkuar pafundësi të thella haresh të trishta.
Kokën se ktheve kurrë prapa.
Sikur doje të harroje emrin tim të njelmët,
emrin tim të ndyrë.
O Shpirt, i vërtetë gruaje, me mbretëri magjepsëse.
Si kamë më ngule gjoksit vajin e thekshëm të Ajkunës.
Mbërthyer mes hekura të ndryshkur kangjellash.
Isha unë që doja të rrëzoja, prej poltronit të princeshës.
Madhështia jote m'u bë freri i egos, kapriçios dhe dhunës.
Tani shkatërruar prej pabesisë së paskrupullt zvarritem.
Ndaj largoma shkëlqimin e vdekjes së dëshpëruar!
Ngritur mbi pabesinë time të marrë,
vërtitëma brishtësinë tënde me valëzime të kaltëra.
Shpirt i papërkulur gruaje.
Jepëm një grusht shërim, të lutem!

skender iljaz braka

Shpirtin S'Ma Nenshtroni

Shpirtin s'ma nënshtroni....

Urremëni e më mallkomëni sa të doni.
Ju të nëmurit prej arsyes e vetëdijes njerëzore.
Shpirtin kurrësesi s'do të mund t'ma nënshtroni.
Varrosur e kam mes gjakut e bindjes popullore.

Unë jam një copëz det prej detit tim të kripur.
Përherë i mbërthyer prej dallgësh të çelikut.
Jam shpendi i furtunës, një valë e pabindur.
Rritur prej frymemarrjes së tij, teheve të thikëta.

Jam zog i lindur shkëmbit ku lulëzojnë murrizat.
Guri i urrejtjes dhe prita për lumenjt e turbullt.
Jam më e mprehta kosë për barishtet e drizat.
Jam shpirti i këngës prej perëndimeve të mugët.

skender iljaz braka

Shpit Kreshpëruar

Shpit kreshpëruar

Vjeshta gjethe shtronte mbi rrasat e errëta të çative.
Ndërsa tutje mbi thepinat e shpatmaleve,
Jehona e këmbanës zëshuar të famullisë
Zërit drithërues të vajtojçave i përngjante.

Ty prej kohe nga trupi të kish ikur lumturia,
por veten të mundur nuk e ndjeve kurrë
as si një copëz dru të përzhitur flakëve
apo gurë të plasaritur nga rrebeshi e stuhia.

Fragmente të dhimbshme prrushi kullës i rrëmbeje,
e shtegut flisje veç me gjuhën e të vrarëve.
'Ti je perëndia ime ' me vete murmurisje...
teksa mendimet të shkonin tek fëmija,
tek pengu i pengut të të gjallëve.
Tek ca statuja të vendosur nëpër vënde të gabuara.
Tek ca kode të ngatërruara të gjakmarrjes.
Tek i vetmi varr, atje mes qindëra varreve.

S'të kish shkuar ndër mënd se kaq papritmas
do ta këpusnin degëzën e farës.
Ndaj loti t'a çante parmëndën e drunjtë të arës.
Ndër mënd s'të kish shkuar baca i Nikollajve
që e mesmërja jote do të ishte një fletëz e rënë.
Frëngjija e mbyllur e një kënge të djegur,
mishërimi më i trishtuar i Skeptërit kanunor.
Fabula e presuar faqeve të pahapura të një libri.
Ku shpirti vet kreshpërohet prej zëmërimit.

Me lahutë do të doje të këndoje buzëmbremjesh
Një këngë kreshnikësh rrethuar prej fëmijësh.
Një këngë të ardhur prej bardhësisë së maleve
me të gjëlbertën e tij nën të, përherë të çelur.

Ish vjeshtë e ftohtë brënda dimrave të përjetshëm,
kur ti baca i Nikollajve shkoje përtej malit dhe vdekjes.
Mendueshëm prej tokave të harruara niseshe i vetëm

Me një pìrg mendimesh të shprishura në kokë,
Për të gjetur udhën ku dielli është më i shëndetshëm.

skender iljaz braka

Si Nje Lis I Djegur

Në detin e ngrirë të mendimeve të mia.
Prej vitesh vazhdon t'më endet hija e trishtimit.
Shpirtit më mblidhen si një grumbull hedhurinash.
Të panumërtat dilema, të çorientuara ekuilibrit.
Nën përgjërime e lutje nënash humbas i helmuar.
Si trumbcaku i grunajës, i pashmanguri i fluturimit.
Në hapsira vuajtjesh rënkoj,
e përgjithmonë rrugëtoj duke medituar.
Kështu i mbeta viteve të mia,
si më i binduri ushtar i skalionit të pare të sakrifilimit.
Cdo ditë duke jetuar anormalitetin brënda anormales.
U bëra përçues i ideve, që varrosen e përçmohen.
Me bindjen për të arritur atje ku asnjëher nuk arrihet.
Por që vetëm padrejtësisht prej padrejtësë ndëshkohen.
Mes kërcënimesh kam vrapuar si dallgë shpërthyese.
Shkretëtirës së vizionit pa iu përulur nënshtrimit.
Si lis i djegur kam mbetur mbi ca rreshta poezie.
Më i palodhuri luftërar i luftës për lirinë e mendimit.

skender iljaz braka

Si Nje Pikez Vese

Si një pikë vese.

Sot një pikë vese dua të jem.
Qetësisht të bie mbi të mbjella.
Mbi gjethina lulishtesh të këputem.
Njeriut të mirë ti tregoj shpresat.
Errësirat të çpoj e pafundësisht
të hap horizontet.
Trupin të shtri skajeve të blerta.
Në një shtëpi përdhese dua të bie,
ku një fëmijë i uritur,
prej gjumit ende nuk është ngritur.

Sot një pikë vese dua të jem.
Të shkëlqej siç shkëlqen syri i bukur i një vajze.
Mik të bëhem me rrezet e praruara.
Mbi stacione e metro dua të tretem.
Të vezulloj në sheshe e parqe të dashuruara.

skender iljaz braka

Skllavëri Bindjesh

Ditë-netë të mbushura me dihatje, përcjell.
Dekada të mbarsura me sllogane në vazhdimësi.
Ca joshje çmëndurake mes djallëzish plot helm.
Planete trupash të infektuar, që s'njohin karantinë.

Skllavëri bindjesh të sëmura,
kapur pas tufa leshrash të nxira.
Këmba këmbës ndjekin njerëz me mëndje të mpira.
Mes lutjesh të padëgjuaara priftërinjshë,
që pagëzojnë në fshehtësi kurvërimin.
Bastard, fodull që njollosin njerëzimin.
Parreshtur predikojnë hajdutërinë, nënshtrimin.

Shpirtëra të degraduar të droguarish,
që nën plogështi amorge shtyjnë përtej kohën.
Ca injorat në fshehtësi ndajn pazartet,
plagëve ua lënduar maisjen, gërvishtur koren.
Me mëndësi të varrosura, ndër vepra të mallkuara.
Nën përdëllimet e satanit të tjerë kusar, nxitojnë të tërbuara.

Sharlatan ekranesh që zhurmojnë, llomotisin.
Analist partiak që për një cope lëmosh
dhe bythën e grisin.
Nën këtë perandori poshtërsish veç martirët kryqëzohen.
Kriminel, burgaxhinjë, kontributor fushatash, gradohen.
Skllavër bindjesh qurrepsen, përloten.
Vlerat me antivlera përditë zëvëndësohen.

skender iljaz braka

Sonte Shpirtin Kujt T'Ia Fal?

Diku frenuar prej kujtimesh qëndroj si i mpirë.
Përulur në gjunjë trupin ndjej t' më marrë zjarr.
Ky vënd ku ne kemi mëkatuar tashmë më urren.
Shpirtin këtu kam burgos në mijëa copa të çarë.

O perëndi! kësaj udhe mbrapash s'mund ti kthehem.
Prapakthimet gjithnjë i kam mallkuar dhe urryer.
Prej një hijeje të larguar, përngjas me një të vrarë,
që tokës i zvarritet prej ngashërimesh i mbërthyer.

Ah ky qiell, që më damkos të përgjakur herezisht.
Pas një çasti mbase për toke rend do t'më përplas.
C'faj të pata moj e dashur që të desha marrëzisht?
C'magji më bëre që sot e kësaj dite të thërras.?

I përgjakur do të ulem mbi lëvozhgën e një guri.
Prej një brenga kaq tragjike tërësisht i dërrmuar.
Veç kur nata përmbi mua do të hedh vello pluhuri
Do të ngrihem i përlotur sa i gjall, aq i mbaruar.

Sonte vallë unë shpirtin tim kujt mund t'ia fal?
Pyes veten i përlotur nën tortura i ringjallur.
Përmes akujsh do të ngjitem ty një ditë veç për të kapur.
Se i vetëm poshtë në ferr do të digjem i përmallur

skender iljaz braka

Sot Dua Te Uleras

Sot dua të ulëras

Shpesh here kam qarë, mijëra lot duke gëlltitur.
Thellë shpirtit i ndezur prej padrejtësh në k'të botë.
Në kthimin e Jezusit në heshtje kam pritur.
Siç ka pritur me vite Uliksin, e mira Penelop.
Sot dua t'ia heq kryqit gozhdët e ndryshkura,
të më mallkojnë kryqtarët prej mllefit e trishtimit.
Jezusit unë dua që këmbët t'ia zbres në tokë.
Që përjetësisht të mos mbes rob i mashtrimit.
Ndaj sot leshoj të gjatën klithmën time.
Si oshëtima e malit kur fryn e gjëmon.
Nuk mundem kurrësei në heshtje të qëndroj.
Kur mashtrimi më mbyt dhe shpirtin m'a copton.
Fshehur si me të padukëshmet këmbë të gjarperit.
Në olimpin e kapitaleve ngrihen maskaradat.
Mbi eren e gjakut dhe të djersës që gulçon.
Paturpësisht trumpetohen arritje dhe lëvdatat.

skender iljaz braka

Sot Ndjesë Ju Kërkoj.....

Sot ndjesë ju kërkoj.....

Sot ndjesë u kërkoj për të pakëtat fjalë.
Për sytë që më marrin ngjyrimin e perëndimit.
Për vrazhdesinë e ballit tim të rrudhosur,
rrahur prej erërave të forta të poshtëritimit.

Sot ndjesë ju kërkoj për ikjen e rrënuar.
Braktisjen e shpirtit që e shpërndava në eter.
Për këngët e përhapura hapsirave të vetmisë
dhe zvarritjen e tendosur rënë nëpër humnerë.

Sot ndjes ju kërkoj për fuqinë e përplasjes.
Për zërin që më nguroset buzëve të thara.
Për ujin e paster që mundimshëm ia mora lumit,
për të shkripëzuar të vjetërat toka të mia, të çara.

Sot ndjesë u kërkojë dhe për valët e detit.
Për klithmat që rërës më mbetën porsì duna..
Për vdekjen ëndërruar duarve të ashpëra të jetës
dhe për diegien e vet hirit, që këmbëve m'u shkrumbua.

skender iljaz braka

Sot...dhe Vetem Sot

Sot...dhe vetem sot

Në harresë i lash të gjitha harrimet.
Trishtimin me gjashtë porta të rënda hekuri,
e mbylla me trishtimin tim.
Në dyzet fije merimange vara ndjesitë naëve.
Në të shtatin sokak tek shkoja
u mbusha me besim.

Në nëntë maja malesh ndeza zjarre.
Me dymbëdhjetë lumenj përmyta vetmin.
Si krishti kam qëndruar
mbi pesqinde e pesedhjetë varre.
Për të puthur veç një here dashurinë.

Sot.. dhe vetëm sot...

skender braka

skender iljaz braka

Syrgjynosja Ime E Lënduar

Syrgjynosja ime e lënduar

Të papërmbajtshëmin mllef çliron frymë e përvuajtur.
Mushkритë e vrerosura shfryjnë metastraza kanceroze.
Mbi malomat që shpërthejnë lëkurës sime të çngjyrosur.
Si mbi një turë drush digjen ëndërrat e pavarrosura.

Sot nuk mundem të vallzoj nën këtë muzikë funebër.
Nën errësirën ku gënjeshtër gëlon dhe në dritë të diellit.
Harrimit s'mund ti rezistoj qofsha i gjallë apo i vdekur.
Kur më i ndotur se vet ndotja, shkëlqimi i vidhiset qiellit.

Ngaherë brënda meje agonia haptazi kryqëzon shpresën.
Si fytyrë e deformuar që pasqyrës konkave i hakërrehet.
Nën ironime të pazëshme vet djalli pagëzon të pandershmen.
Sfungjer i moralit prej ujërash të qelbura fryfjet e ngjeshet.
Si asnjëherë i stresuar vrapoj pas një tjetër jete.
Përndjekur prej viktime foshnjesh dergjura prej skamjes.
Nën egërsinë e pashëbullt të natës përpëlitet humbja.
Mbi kufoma të uriturish ngrihet botë e pafundme e vdekjes.
Cilën jetë ju patrice e plebenjë më afroni të jetoj?
Në ç'pistë pa dritë e pa ritëm më ftoni për vallzim?
Ekuacionet e jetës nuk mundem ti zgjidh kësisoj.
Të vërtetën ta ngjis në altar, kur s'është veç mashtrim.
Askush nuk është më i lumtur sesa unë që vuaj.
Mes gjakut të pampiksur të kokës sime të prerë.
Pas vetes arratin e mospëlqimit tërheq i pafriksuar.
Se një ditë mund të vdes si njeri krejt i pa vlerë.

skender iljaz braka

Sytë E Tu Të Bukur

Sytë e ty të bukur

Sytë e tu, dy liqenj të kulluar janë
dy oqeane të pafundëm kaltërsie.
Me dy konstelacione yjësie seç më ngjajn,
Të mbushur plot ëndërra dhe
me miljona grimca pafajësie.

Në sytë e tu shoh reflekse jete.
tek ta rrethuar me ngjyrimë
shoh brënda tyre veten time.

Në sytë e tu veç një orë dua të rroj.
Paçka se ti një shekull rron
thellë ...
thellë e më thellë zemrës sime.

skender braka

skender iljaz braka

Takim Miqesh...

U mblodhem nje dite ashtu krejt papritur.
Me vetedijen e thjeshte si miq te papare..
Te kembenim ne pak caste veç disa mendime.
Kujtimin mbreselenes me vete per te marre.

Me shume se gjithkush folen syte e qeshur.
Per te munguarit e larget ngritem nje dolli.
Si nje nuse e bukur ajo dite ish veshur.
Si dhenderri i turpshem ne vallen e tij.

Harrur n'ato caste gjithë brengat e diteve
I lam mbi ca vargje te pashkruara poezie.
Nje hop i dhame jetes pertej kufirit te viteve.
Per tu ngritur mbi vetveten me ndjesi fisnikerie.

Nje dite shumfishuar do vijme perseri.
Per te pathenat tona do flasim me zjarr.
Dikush do jete plakur nga e fismja pleqeri.
Dikush nje femije prej dore duke marre.

Dhe atehere do kemi me shume c'te tregojme.
Dhurate me te bukur se libri nuk do kete.
Roberuar prej kesaj ndjenje, qe s'mund t'a frenojm
Si kolla kronike qe te ndjek vazhdimisht, perjete.

skender iljaz braka

Tani Nuk Di Seç Me Ka Mbetur

Tani nuk di se ç'më ka mbetur

Nuk di ç'më ka mbetur prej gjithçkaje që kam patur.
Një pjesë më janë larguar, të tjerë sakaq kanë vdekur.
Netëve të lagështa, pasqyrës më thyhet buzëqeshja.
Gjithë qënien ma drithëron, i zhurituri malltretur.

Nuk di se prej ç'flakësh toka më është djegur.
Dhe uji i pusit në oborr, natyrisht është thar.
Gjithë muret e shtëpisë si prej mole janë brejtur.
Helmues e brejtës gjallojn nëpër hambar.

Të ngratës sime mëje, fshesa në dorë i ka mbetur.
dhe e zeza shami, që me droje fsheh ca flokë të bardhë.
Im at duhanin, gëzh-gëzh me biçak, gri çdo natë.
Dhe shtullunga tymi i dridhen fytyrës së vvarë.

Nuk them " S'ka ç'më duhet, e, le të shëmbet çdo gjë".
Për mua aty dhe çdo fije bari është i shtrenjt.
Hakmarrja ime, qarja metalike e një foshnjeje do të jetë.
Dhe kënga e gjelit pas stuhis mbi të gjelbërtin shelg.

Një ditë fëmijët do t'i mbledh përball dritares.
Do tu tregoj për xhepaxhinjë, makutër, injorant.
Prej zërit tim do të dridhen të gjitha marrëzit.
Kur ngrehinën ta ringe mbi pirgje gurësh e mbi baltë.

skender iljaz braka

Tani Që Pranë S'të Kam

Tani që pranë s'të kam
Ke kohë që larg ke ikur
E zemra thellë prap më ther.
Si një kamë e përgjakur, hija që le pas ka mbetur,
boshkllëkun që askush nuk mundi të ta zër.
Lëndimi më bëhet mal, e dashur.
më bëhet litar,
Murmurima në dhimbje më kthehet
Psherëtima më shnderrohet në një lutje të gjatë
dhe lutja në një rrëfim lirik,
me subjekt qënien tënde që mes qënies time,
rrjedh si një ujvarë.
Që mungesën time ndjen, i bindur jam.
Siç ndjeje dikur pas çdo ndarjeje
Se dikçka kisha për të thënë.
Tani që pranë s'të kam
E çuditshme më duket që ike,
si era zëmërake kaq papritur
Këmbëngulja, si hije panjohur tu bë natë.
Dhe nata në një dallgë të pambajtur.
Nuk di për ç'arsye të dua dhe më shumë
Ndoshta ngaqë përherë çdo gjë me ty më ngjan,
Më tërheq e më duket si dikur fëminore.
Mbase në nevojë të brendshme të ndjej edhe unë.
A prej urrejtjes që më këputet përnjëherësh
si petalja e tulipanit prej një ngrice dimërore.
Si zë i largët, gjer tek unë arrijnë të thirrurat.
"Ty të dua! " "Ty të dua përjetësisht."
Nxitoj hapat, të të prek me tinguj këngësh.
Hija ime derdhet udhës
si ujvarë e këputur dhimbjesh.

skender iljaz braka

Të Dielën E Shkuar

Shpura e makutëve erdhi dhe iku të djelën e shkuar.
Ca britma histerike për një fitore të mundshme la pas,
parfumin e makinave të tyre luksozedhe përtokë,
rënkimin e mekur me shurdhimin e ca flamujëve.

E djela e shkuar s'kish buzmbëmje të llakuar në kompleksin e duralit.
As moli plak që pret e pëecjell anije të vjetra kërkund nuk u duk.
Veç vërsëllitja e erëes kish një thërrmim të dhimbshëm, të thatë.
Nën ballin e yllit të mbrëmjes vraga e plagës së pambyllur kullonte ende gjak.

Shpura e makutëve erdhi dhe iku të djelën e shkuar.
Forca e lavdisë ish thërrmuar damarëve të ujit të mbetur.
Fjalët vinin në lëvizje gjërat prej një firmë të detyruar.
Ngoja me lugën e zbratur mes dhëmbësh ish tretur.

Mballomat e dukshme të natës dimërore.
Format e një fytyre të përçudnuar ritregonin.
Riciklimi i të mashtruarit që prej detit thithe ozonin.
Nuk kish asgjë më tepër se vdekja tragjike e një zoti.

Të djelën e shkuar erdhën dhe ikën makutërit.
Bastërdimi i reales i zhytur mbeti përsëri nën vakuum.
Përpara ndryshimit të menjëhershëm të mosgjës njerzit qëndronin.
Në kupën e Gralit, përfytyrimi asgjë si kish shtuar ëndrrës së derdhur si lum.

skender iljaz braka

Të Dua E Dashur

Unë të dua e dashur.
Pa ty ditët, më bëhen më të shkurtëra.
Të vegjël më bëhen tragetet, trenat, urbanët.
Më të vogëla më bëhen pistat,
ku ulen e ngrihen për fluturim avjonët.
Pa ty mendimet më fluturojnë
si zogjtë e shtegëtimeve të largëta.
Luginave të gjelbërta më bien si mjadulla,
me përgjumjen e gjetheve të plakura.

Unë të dua e dashur.
Me furinë e stuhive të marrosura
ditëve të akullta të dhjetorit, të dua.
Kur prej mallit në dysh më thyehet urrejtja.
Përsëri të dua, se s'mundem të largoj.
Të dua dhe kur ty të mpihet buzëqeshja.
dhe zëri yt më ngjason me këngët e djegura.
Të dua më shumë se pikëllimi tulipanit
dhe loti i blirit të tharë kur vjeshton,
rrënoqethur gjer në palcë nga dhimbja.

skender iljaz braka

Të Dua Mbretereshe

Lëndinës i mblodha si perla të praruara
dhe varg për ty i bëra të kuqet manaferra.
Rreth gushës së holl t'i vija si gjerdan.
Të më dukeshë ti, më e bukur se pranvera.

Nga shpate i këputa të verdhat gjineshtëra.
Për flokët e gështenj të thurra kuror mali.
Më të bukurin skepter dhuratë të t'a solla.
Të desha mbretëreshë moj vajë me sy kristali

skender iljaz braka

Te Dua Ty.

Të dua ty....

As vdekja prej teje do të mundet të më ndaj.
Në botë s'më josh asgjë më shumë se shpirti yt.
Cdo ditë në thep të syrit shikimn tënd unë mbaj.
Me kthjelltësin e detit, s'do ti ndroja të bukurit sytë.

Të dua ty, furtun e brigjeve të mia të pamata.
Ty musht i gjelbërimit të vreshtit, tim të plakur.
Të dua, o mjalt i hojeve në vlimin e pranverës.
që më e rinuar më përngjan përvjetoreve të përflakur.

Të dua, vesë e këputur e agut të praruar vjeshtor.
Të dua ty, akullnaja e pashkrir e shpellave të errëta.
Ti je siguria e ritmit të hapave të mia, ngado ku shkoj.
Je syth i porsaçelur i mijëra degëzimeve të blerta.

Të dua ty, gjaku i arterieve të mia vullkanore.
Tek më shfaqesh më e bukura se drita e yjësive.
Ti më je flutura e magjishme e ëndërrave shtegëtare.
Je muza ime e pashtershëme e të gjitha poezive.

Të dua ty, me dashurinë e përbotshëme të miljona dashurive.

skender iljaz braka

Të Dy Kaq Shumë Larg.....

Në prëhër të dobësis biem shpesh prej largësisë.
Ndjenjat na përthyhen kur më nuk jemi pranë.
Dhe veten të braktisur e ndjejm nga dashuria.
Kur asnjë dashuri e vdekur s'na bëhet më e gjallë.

Bregut të lotëve, nën një zhurmërim të davaritur.
Ndjejm zemrës t'na rigojnë të ftohtat copëza malli.
Prej një shiu dinak, të qullur si zogjtë krahlidhur.
I thërrasim njëri tjetrit me zën e një të marri.

Në këtë bujtinë të verbër, pashpresë hidhërimi.
Humbur mes avujve të fuqive të pashterura.
Ne u tretëm dhe vdiqëm si ujëra të nëndheshëm,
që mpleksen me forcë përmes rrënjësh të etura.

Gjithë jetës të mbërthyer në detërat e shpirtit.
Të pangopur i mbetëm varrezës së pëgëdhelimit.
Të stuhishmet fjalë s'na zgjojnë kurrfarë ngrohtësie.
Tashmë që kaq larg jemi prej syve dhe harrimit.

Kështu një nga një na u shuan të vjetërat shpresa.
Si varka të braktisura i mbetëm limanit në agim.
Dhe pse sytë na shikojnë miljona qënie të kthjellta.
Për ne veç një bregore mbetet, i vetmi ngushëllim

skender iljaz braka

Të Gjithë Presim..

Nuk jemi më shumë se një grusht,
që presim për tu nisur.
Një grusht i hallakatur,
i papërqëndruar,
i pa mirëorientuar
jo kaviesh por njerëzish.
A thua se drejt asgjës do të nisemi,
me asgjënë për tu bashkuar.
Prej nga kemi ardhur
fortë mirë e dim.
Ah udha jonë që shpesh
nëpërmjet një hiçi na ka shkuar.....
Për nisjen e shumpritur gjatë jemi pikëlluar,
pa e ditur se do të mbrim një ditë
në pikëmbritjen tonë të ëndërruar.
Eshtë frika se prej ç'deqi e kallur në fytyrë,
gjithë ç'na ka mbetur.
Eshtë një psherëtim e fikur
mbi buzët tona të plasaritura.
Mbi cipën e lëkurës sonë
të regjur e të djegur.
Janë ca pika djerse...
Një vështrim i trëmbur si vetëtimë.
Për faj të kujt po presim vallë kaq gjatë?
Të mardhur si zogj dimëror.
Të gjithë presim orën e nisjes...
si atleti startimin në pistën e tij.
Nisja jonë paska qënë një infinit.

skender iljaz braka

Të Lutem Mos Ik..

Mbi duar të të marrë, të shtrërngojë krahërorit.
Dhe pse tanshmë për ne kjo ka kaç pak vlerë.
Mbi gjoksin tënd të bardhë pikon loti ngrohtë.
Ca mërmërima t'u thërrmuan, u ngritën në eter.

Oh, e brishta ime! Fluturake përjetësisë.
Së shpejti hapsirave qiellore ti do fluturosh.
Trupit tim do ti mbetesh, klorofil në çdo qelizë.
Gjer ditës kur në varr me mua të takosh.

Vetmuar tek qëndroj mugetirave të mbrëmjes.
Përlotur çdo sekondë, mbytur prej ngashërimit.
Për ty e shtrenjta ime, me dridhet sot çdo ind.
Më i hidhur se helmi, më duket sot trishtimi.

Me vete mërmëris si burrat që nën zë rënkojnë.
Ti rrekesh të më thuash në heshtje veç dy fjalë.
Të ka ngrirë buzqeshja mbi buzët e kristalta.
Teksa çarçafët e bardhë zënë të ftohen dalngadalë.

Te përgjërohëm mos shko, të vetem mos më lërë.
Si gjinkalla në degë lisi për ty unë do të thahem,
Si tumbcaku në maj mali që dimrit ngrin mbi borë.
Tek varri yt do tkurrem, mbi mermer do çahem.

skender iljaz braka

Të Lutem Mos Më Ik!

Të lutem mos më ik!

Mbi krah të marrë, të shtrëngoje krahërorit.
Dhe pse tani kjo ka shumë pak vlerë
mbi gjoksin tënd dy pika loti pikoj.
mugëtirës së qiellit për t'i hapur një derë

E brishta ime, ti se di,
se së shpejti mbi qiej lartë do fluturosh.
Do ti mbetesh trupit tim në çdo qelizë
dhe ditës kur në varr përsëri t'më takosh.

Mugëtirave të mbrëmjes vetmuar tekqëndroj.
Me lot ngashërimi te qaj në çdo sekondë,
Për ty e shtrenjta ime, më dridhet çdo ind.
Më shumë se sa helmi, i hidhur më duket trishtimi.

Nën zë të qaj si burrat që nuk flasin
Ti rrekesh të më thuash në heshtje veç dy fjalë.
Buzqeshja buzeve të ngriu porsì kristali.
Teksa lotët të t'i ngohin jastekët e bardhë.

Të përgjerohem mos ik.
Të vetem mos më lërë.
Si gjinkalla në degë do thahem, do tretëm.
Do të ngij si tumbcaku malit me dëborë.
Një gurë i thatë gjer në vdekje do të mbetëm.

skender iljaz braka

Të Lutem Sot Mos Fli

Të lutem sot mos fli!
Binjaken tënde, vetëm sonte mos e fik!
Në avujt e xhamit bëjë vetëm dy sy.
Mos u trëmb nëse vonohem, pas tyre jam aty.

Të lutem sot mos fli!
Me një shkop, krrusur prej mallit jam nisur,
mbi trotuaret e përbaltur bëj trak – trak.
Zemrën pas dere mbështet dhe rri.
Me çelsin e zemrës time ta hap.

Të lutem sot mos fli!
Me lot mos i fresko ti faqet e përskuqura.
Si mjegulla do të përvidhem për të ardhur aty.
Gjithë natës do bëj zjarr me të puthura.

skender iljaz braka

Te Vdesesh Se S'Ke Para

Të vdesësh se s'ke para.....

Drejtë spitalit u nise pa ditur çdo të ndodhte.
Kishe dhimbje trupit dhe pak të holla në dorë.
Ti nuk e dije çmimin e lart të shërimit tënd.
Që asnjë binjake me ty nuk do mund ta përballonte.

Nën epikrizë e receta duhet të flinin të hollat.
Përtej heshtja së syve të mjekut, si kafshama e
gjarpërit të shkretëtirës kish vetëm një parajsë,
pargun e së cilës ti s'mund ta kapërcej dot.

Ajo ishte më e zbehtë se e zbehta e ftyrës tënde.
Më e trishtuar se trishtimi i syve të tu të blertë.
Në udhën e gjatë të njeriut, prej ferri në rikthim,
fjalët përherë e humbin kuptimin e tyre të singert.

Një degë shelgu i tundej përhijshtëm dritares tënde.
Dhe mbi gjeth një pikëz vese i përgëdhelej agut.
Ti rrije pa mundur të thithje një grimë kënaqësie.
Trupit të rënduar, ndjeje aromën e kripur të gjakut.

Rrije mbërthyer prej ngërçit të minutave pashpresë.
Përhumbur hapsirave të mjegullta të kujtimeve.
Si gjithmonë duke luftuar me luftën tënde heroike,
me parandjenjën e përcaktimit të fatit prej ndëshkimeve.

Vdekja të vinte si një shtrëngatë e fortë dëbore.
Si zambaku i pranverës që i hapet erës së marrë.
- Kur pikëza e vesës qetësisht ti bjerë tokës, -thoshe.
- Atëherë ti vdekje, po qetësisht ke për t'më tharë.

skender iljaz braka

Tek Endem Mbi Qytet

Prej një copëze akulli përherë duke u vetasgjësuar.
Të marrë prej mes detit ku rreh e gjëmon stuhia.
Mbi qerpik të qytetit tim tmerrësisht rëndojnë.
Mes këtij dimëri të ngurt dhe troku i hapave të mia.

Më trishtojnë perëndimet kur i shoh tek vdesin.
Lënduar si ulkonja e pyllnajës ulëras nëpër natë.
Tmerruar prej ngurtësimit të ditë- orëve të ngrira.
Në kuisje kacafytjesh më kthehen dimrat e acart.

I tëri kthyer në rënkim të prehut që përpëlitet.
Në vetminë e lodhur të muzgut të perëndimit.
Në pafajësinë e gjethit të zverdhur që dridhet.
Pres ndezjen prej një shkrepjeje të beft të agimit.

Tani nuk di se ç'më ka mbetur
Nuk di ç'më ka mbetur prej gjithçkaje që kam patur.
Një pjesë më janë larguar, të tjerë sakaq kanë vdekur.
Netëve të lagështa, pasqyrës më thyhet buzëqeshja.
Gjithë qënien ma drithëron, i zhurituri malltretur.

Nuk di se prej ç'flakësh toka më është djegur.
Dhe uji i pusit në oborr, natyrisht është thar.
Gjithë muret e shtëpisë si prej mole janë brejtur.
Helmues e brejtës gjallojn nëpër hambar.

Të ngratës sime mëje, fshesa në dorë i ka mbetur.
dhe e zeza shami, që me droje fsheh ca flokë të bardhë.
Im at duhanin, gëzh-gëzh me biçak, gri çdo natë.
Dhe shtullunga tymi i dridhen fytyrës së vvarë.

Nuk them ' S'ka ç'më duhet, e, le të shëmbet çdo gjë'.
Për mua aty dhe çdo fije bari është i shtrenjt.
Hakmarrja ime, qarja metalike e një foshnjeje do të jetë.
Dhe kënga e gjelit pas stuhis mbi të gjelbërtin shelg.

Një ditë fëmijët do t'i mbledh përball dritares.
Do tu tregoj për xhepaxhinjë, makutër, injorant.
Prej zërit tim do të dridhen të gjitha marrëzit.

Kur ngrehinën ta ringe mbi pirgje gurësh e mbi baltë.

skender iljaz braka

Tek Nje Bregore E Xhveshur

Tek një bregore e xhveshur.....

Netë me radhë hutueshëm nxitoja pas ikjes tënde.
Me skeletin tim prej lodhjes e drobitjes të cfillitur.
Nuk di se si humbisja përgjatë udhëve nëpër mjangull.
Pas jehonash dhe oshëtima zërash timbër grisur.

Nëpër gurë shkëmbenjësh gjunjët mu përgjakën.
Gjersa fryma më ndali tek bregorja jonë e xhveshur.
Atje prej magazines së kujtimeve tona të vjetra.
I pash përsëri dy sytë e tu, si dy meteor të djegur.

Atje një qeshje gjeta dhe pak fjalë të mbështjella.
Me të ngrohtin hi malli dhe identitet kohëshkuar.
Mes myshqesh aty gjeta më shumë se tri të vërteta.
E më të gjallën atë, që marrëzisht ishim dashuruar.

Në atë bregore, ngurosur kish mbetur zmbropsja jote.
Vajtimi yt, që këngën time në mijëra pjesë kish ndar.
Shtypur prej marrëzis tënde si kokërra të kuqe dëllinje.
Ende nën dënësia përlotej e rënkonde ndjenjë e vrar.

skender iljaz braka

Ti Aty! ? Aty Ti! ?

Mes një perandorie dhimbjesh
ikjen tënde përjetova tepër gjatë.
Përmendore e padukshme,
shkrirë mes akujsh shkretëtire djerrur.
Putje vdekjes, ndezur, flakë.
Një buzëqeshje perënduar gjithë kërshëri,
lëpin plagët e fytyrës së pajetë.
Si mesnatës ëndërrake shpirti yt i përvëluar,
tharë e tretur për pak këngë e dashuri.
Oh e dashur! ,nën mëkat.

Carmatosur u gjënda nën pangjyrësin e qiellit.
Në klithma të pazëshme,
s'di kë pyeta.
S'di se si:
Ti aty! ? Aty ti! ?

E pashmangshmja në kësi çastesh
s'mund të bëhet kurrë e shmangshëme...
(tek e fundit ka një vdekje për të gjithë...
dhe ti e di.)

Korbëzezat fluturojnë perreth kohërave.
Ti në tënden pavdeksinë dizenjove.
Të thepisurën brengë të jetës
dhe pse ike, se mallkove.

Ti aty! ? Aty ti! ?
Vrastaren heshtje prekja prore drithëruar,
tek çapisja pas korteut të përzitur.
Më rëndë peshën asnjëherë s'ta pata ndjer
, kur mes plagësh të acaruar në atë qivur,
për t'fundit herë të pata ngritur.

Nën një hapsirë të tensionuar bash mortore.
Pse mu duke aq e madhe,
e tejdukshëme, madhështore?

Ti aty! ? Aty ti! ?

I përndjekur nën helmim,
më shumë se syri diellit lartë,
nxirrnin lot sytë e mi.
Të pamëshirshëmes s'kisha forcë ti përgjigjesha.
Në të vetmin çast të jetës, seç u ndjeva foshnje jetim.
Në kristale transparente,
mbi savanin tënd të bardhë,
kthyer ishte loti im.

Ti aty! ? Aty Ti! ?
Ah jetë, moj jetë!
Jetë e djegur në përvëlim.....

skender iljaz braka

Ti Deti Im ...

TI DETI IM ...

Sa herë që vij pranë teje, deti im,
e përkëdhelem lehtas me valën qumështore,
në mall e dhimbje, thellë shpirtin ma ngacmon.
Më rreh e më tund si era degëzën mbi bregore.

Me të vrrarat duar të pëkëdhel i etshëm.
Mbi krah të hidhem, aty ku lindi pavdeksia.
Puth buzën ku shpërthen një trëndafil i përjetshëm,
ku shkrep e udhën e pakthyeshme merr dashuria.

Madhështori, i pakrahasueshmi deti im!
Shplarja m'u bëre për fatkeqësitë e përherëshme,
drita e udhëve marramendese, shumëdredhore.
M'u bëre dielli i energjive të mia të pashtershme.

Ti je vullkan i shpërthimeve të brumit njerëzor!
Je jeta dhe e pashmangshmja vdekja ime e përditshme,
je dhimbja e moçme e një populli të rënë theror,
je fytyra engjëjllore e të gjitha ditëve të pakthyeshme.

Ti dallgë pas dallge vjen e më rrëmben.
Larg më çon, mes thellësive të tua të kaltra.
Ti je orteku vezullues i netëve të ftohta,
je shpërthimi i mijëra agimeve të bardha.

Plakur me vdekjen time përherë udhëtove
e prej vdekjes sime çdo ditë u brejte ti.
M'u bëre një copëz bukë për bukën e pëditshme,
këputur si petalja e tulipanit prej ngricës dimërore.

skender iljaz braka

Ti Dhe Unë E Dashur

Ti dhe unë e dashur
Ti dhe unë e dashur,
shndërruar jemi në një trup,
në një frymë, në një jetë.
Kur plazmat e gjakut tonë
për ti mbledhur në këto duar, na është dashur.
Ti fort më ke tërhequr drejt zjarreve të largët,
atje ku kodrinat digjen në përjetësi,
dhe dita e përfshirë prej dëshpërimit
më zgjonte brënda shpirtit dritën e shumpritur.
Fati gjithmonë e dashur diku gjëndet i fshehur.
Ndaj s'të thash të mbeteshim përjetësisht skllavërit e tij.
Ndoshta kapur fort pas rrathëve të ferrit.
Siç na ka rrëzuar, na ka ngritur, ku ta di.
Por ne, që përherë kemi ecur mbi gurët e një jete të djegur.
Nëpër muzgun e përhimtë drejtë një bote të qetë
Parasysh kemi patur vetëm kodin e të fshehtit pakt,
mes dritës dhe territ.
I humbur nën realitetin e pritshmërisë,
përulur në lutje qetësish të kam dëgjuar.
Në një pyll të gjelbër bredhash, ku veç hijet bien.
Ca dyer të reja më hape dhe më binde.
Se ka dhe një tjetër kohë për të qëndruar.
Se ka një kohë për të parë më mirë përtej vetvetes.
Se ka një kohë tjetër për tu ndjer i penduar.
Pastaj për të ikur paqësisht me kënaqësinë e bletës.
Ndoshta shumë gjëra duhet t'i kishim bërë më ndryshe.
Por faj të mos i vëmë shpirtit të tronditur.

skender iljaz braka

Ti Ngazëllehesh

Ti ngazëllehesh kur dëgjon këngën e zogut,
Kur tingujt e mëngjesit me aromë lulesh të pështjellin,
Dhe ndjenjat njëqindë fish të lartësohen.
Kur prej rrezesh të praruar dielli vetë nata zë tërbohet.
Gjithë bota të duket sikur brënda teje rizgjohet

Çdo gjë tek ty bëhet më transparente se vet ajëri.
Kur muzgjet e largët paraqiten si një kthjellim.
Ligësia vetvetiu sa vjen e më shumë plogështohet.
Kur tërë universin e pushton hareja e njeriut të mirë.

Ti ngazëllehesh kur deti lirinë ta zbukuron.
Atë që ti bleve më shtrenjtë se gjithçka.
Me shkëlqimin e forcës së mrekullueshme që vetëtinë,
Mbi dallgë detesh ti ngrihesh, kotësitë e jetës shpërfill.
Me to varros dhe gjithë ndyrësit e mëdha

skender iljaz braka

Ti Vije Si Orfikane

Ti vije si një Orfikane.....

Ashtu siç ishe e hijeshme dhe e vetme.
Siç të mbaja mend dikur të papenguar.
Larguar prej qytetit të zhurmshëm kaotik.
Thepash të natës kishe nisur për t'më kërkuar.

Në një stacion trami ëndrrat kisha lënë.
Që prej ditës kur prej marrëzisë të braktisa
dhe të humba si një copë ashkëlë e thatë.
Marrë e hedhur prej erës, udhëve të pista.

Ti vije të ngjyrosje tavalecin pis të shpirtit tim.
Si një Orfikane e bukur e kronologjive të lashta.
Me një majë të hollë pene, t'i lije një shënim.
Statujës sime të hedhur që prej kohësh të largëta.

skender iljaz braka

Tingujt E Harruar..

Tinguj te harruar...

Tinguj, që vjedhurazi hynë
në dhomën time të zbrazët.

Një cast e uli tonin spikeri në television.

Kanarina e bukur cecërimën ndali.

Tik-taku i orës së murit mbetet në sekond.

Lulja.."Mos më harro" mbi vazon blu,
gjethet vari e trishtuar.

Të mbyllurat plagë diçka zë e m'i ngacmon.

Në dhomën e heshtur, i hutuar.

Mbërthyer dilemash kisha mbetur.

Pas krahëve m'jagulla më mbështjell,
e derdh mbi dhomë të kaltërin tis.

Prej dritës ndezur mbi një raft,
përlotet syri ndjeshmërisë!

'Nuk jam ketu', doja te thosha me një zë

Mohim i mohimit te gjithçkaje isha unë.

Por tingut e largët, të qetë nuk më lënë.

Tingujt nga dhoma nuk munda t'i përzë.

Nuk mundem dot, nuk mundem jo, jo

Të parën dashuri pas dere,
si mundem të ta lë.?

skender iljaz braka

Tregu I Madh I Jetës...

Jeta, treg i pafundëm që përherë na afron oferta të reja.
Të etur zgjasim duart për të rrëmbyer ç'të mundim.
Vjen një ditë që ky treg na largohet e syve na zbehet,
si lulet që vjeshta zverdh e gjethet i rrëzon me trishtim.
Kohë pas kohe prej shumë gjërash tregu na privon.
Ambicjet e çastit vetvetiu na largohen, të rejat lindin
si shpërthimi i gjelbërimit në lëndinë.
Pakupueshëm na rizgjohet forca magjike e çdo fillimi.
Shkëlqimi i ditëve nuk mund të zgjas pafundësisht.
Ndaj në çdo moshë për sfida të reja jetës i përgatitemi.
Të bindur me zemërat e ndezura frontit t'i hidhemi.
Në luftëra të tjera të mësymë me të tjera ndjenja.
Përpjekjeve të ashpëra të mos tërhiqemi apo të thyhemi.

Rob të përherëshëm do t'i mbetemi tregut - jetë.
Gjer çastit kur të dëgjojmë tingëllimën e orës së vdekjes.
Dhe fjala e fundit që do të themi do të jet:
- Lamtumirë ti treg i pafund!
Shtirë nën rrënjët e barit të but ku do të prehemi.

skender iljaz braka

Trishtim I Bukurisë

Flokët i leu me bojë Movidë
Qau e tha se nuk bënte pasqyra.
Pasqyra ishte e poshtër dhe xheloze.

Era lëvizëte e qetë mbi lule.
Ngjyrimet argjendi përplaste në mure.
Asaj një luftë e heshtur me zjarr shafrani
i derdhej qerpikëve të hollë dhe buzëve.

- Të liga qënkan dhe lulet, - tha.
Kjo larmi ngjyrash kaq shumë më tmerron.
Bukurin time ma kanë grabitur
e paturpësisht ma hedhin mbi kokë.
Tutje përse më largojnë?

Sa shumë të kam urryer ty shkëlqim
i bukurisë mashtruese.
Ty vetpëlqim i etur për madhështi firari.
Unë kështu do të mbetem përgjithnjë,
duke shkelur mbi copëza të heshtura qelibari.

Kjo fanitje ngjyrimesh derdhur si prrush.
I kujtoi petalet në një degëz të lagur, në muzg.

skender iljaz braka

Trokit E Dashur.

Trokit e dashur.

Në portën e zemrës sime, e dashur ti trokit.
Kur e ftohta natë udhëkryqeve në të zënt.
Në hi të zjarrit tim, ti eja edhe ngrohu.
Se kam në këtë shpirt ngaher për ty një vënd.

Ngashërryer lotësh, e vetme ti mos rri.
Pa ngurrim në strehzën time, eja bëj fole.
Kurajoze siç të njoh, thuaj shpirtit, dashurohu!
Prej zjarrezh përvëlur trupin mos e lë.

Në portën e zemrës e dashur ti trokit.
Kur muzgu endrrat me vel të t'i mbuloj.
Do të gjesh tek unë të munguarën dritë.
Dhe ëndrrat me shkendijs shpirti t'i ndriçoj.

Nuk jam Hyjni në altar i shënjtëruar.
Buzëqeshjen unë ul mbi pirgje pikëllimi.
Frymëmarrjen e nxitoj të etur nëpër botë.
Si dritën lozanjare, që maleve hedh agimi.

skender iljaz braka

Trungu Im I Hershem

Trungu im i hershëm
I hershëmi trungu im, shkon deri në lashtësi.
Me jehonë lahute rrënjët ka vaditur.
Dhe vallja e shpatave shtatit i dha forcë.
Mbi shkëmb e gurë flamurin mbajti ngritur.
I hershëmi trungu im, binjak me historinë.
Supet e rënduar përlyer ka me gjak.
Me legjenda kreshnikesh e ngriti lavdinë,
Shekujsh i përzhitur nëpër tym dhe flakë.
I hershemi trungu im, aureolë e madhëstisë.
Me sytë e dhimbjes kohërat ka zhbiruar.
Muzgjeve ka ecur krenar drejtë lirisë.
Me jetën dhe diellin përjetësish i dashuruar.

skender iljaz braka

T'U Ktheva, O Det ...

Udhëve të botës ngado ku u enda,
shkumën e duarve të tua të kaltra
dhe imazhin e valëve të muzgjeve të vona,
me lot mërgimtari, prej mallit tënd, i njoma.

Vij sot të puth sytë prej lotësh të përkripur,
si një trëndalif i lagur, të prek buzëve të tua
që zjarrmojnë në përvëlim.
Të puth ujërave flakëruese, koralet e zvetënuara
e mbi qerpikët e tu prej shkume të ulem,
të thith dritën e një ylli të heshtur, pa shkëlqim.

E ndjeva zërin tënd, o det i brigjeve të mia!
Këtë psherëtimë të zemëruar, të trishtuar e ndieva,
siç ndien nëna rënkimin e birit të saj në djep.
Petalet e bregut dhe stërkalat me të cilat kam kënduar
" Përjetësisht të dua, o i magjishmi, o i mi det! "

Me veshje të vjetra emigranti të rropatur,
t'u ktheva i lodhur prej mallit që më ka marrë.
Një mal me të fshehta të përvuajtura ngarkuar,
të solla dhuratë kësaj nate transparente, të bardhë.

Të jam kthyer djalosh i heshtur, i menduar,
për të gjetur përsëri gjithçka që kam të shtrenjtë.
Përkëdhelitë e tua që shumë më kanë munguar,
dhe thellësitë e kristalta ku ngula thellë rrënjët.

skender iljaz braka

Tu Ktheva, O Det

TU KTHEVA, O DET.....

Udhëve të botës ngado ku u enda.
Shkumën e duarve të tua të kaltëra
dhe imazhin e valëve muzgjeve të vona,
me lot mergimi prej mallit tënd i njoma.

Vij për të fjetur në shtratin e gurëve të tu.
Në buzët e djegura që zjarrmojnë në përvëlim,
pranë koraleve të zvetënuara dhe rërën e njomë.
Me mall të vij, o det, si ylli i heshtur pa shkeqim.

E ndjeva zërin tënd, psherëtimë të trishtuar,
si nëna që ndjen rënkimin e birit në djep.
Petalet e bregut dhe rërën ku kam shkruar.
" Përjetësish të dua, o i shtrnjti, deti im."

Me veshje të vjetra emigrant të rropatur.
T'u ktheva i lodhur prej mallit të marrë.
Një mal me të fshehta të përvuajtura ngarkuar.
Të solla dhuratë kësaj nate të bardhë.

Jam kthyer djalosh, i heshtur, i menduar.
Të gjej perseri gjithçka që kam të shtrenjt.
Perkedhelit e tua, që shumë më kanë munguar
Dhe thellesitë e kristalta ku ngula rrënjët thellë.

skender iljaz braka

Tu Ktheva, O Det.

T'u ktheva, o det.....

Udhëve të botës ngado ku u enda.
Shkumën e duarve të tua të kaltëra
dhe imazhin e valëve muzgjeve të vona,
me lot mergimi prej mallit tend i njoma.

Vij sot në shtratin tënd të fjetur.
Në buzët e tua që zjarrmojnë në përvëlím,
në koralet e zvetënuara dhe rërë e njomë.
Të vij, o det, si ylli i heshtur pa shkeqim.

E ndjeva zerin tënd, psherëtimë të trishtuar,
si nena që ndjen rënkimin e birit në djep.
Petalet e bregut dhe rërën ku kam shkruar.
" Perjetesish te dua, o i imi det."

Me veshje të vjetra emigrant të rropatur.
T'u ktheva i lodhur prej mallit të marrë.
Një mal me të fshehta të përvuajtura ngarkuar.
Të solla dhuratë kësaj nate të bardhë.

Jam kthyer djalosh, i heshtur, i menduar.
Të gjej perseri gjithçka që kam të shtrenjt.
Perkedhelit e tua, që shumë më kanë munguar
Dhe thellesitë e kristalta ku ngula rrënjët thellë.

skender iljaz braka

Unë Bir I Detit Dhe I Durrsit Tim...

Unë bir i detit dhe i Durrsit tim...

Thellësve të detit fle i lashti Durrës.
Qyteti rilindur, kurorë mbi qerpikët e tij.
Sarkofagëve të gurtë rënkojnë eshtrat e thyera.
Varret, amfora dhe stoli e bukuroshes,
që ende dremmit nën ujë.
Aty ku të gjithë jemi pagëzuar
papërrjashtim me gjak Ilir.
Pulbardha kemi qënë në qiellin ton gri.
Me krikëllima qiellit i kemi bërtitur
dhe Hyut ton njëmijë herë i kemi thurrur lavdi.
Nga varri edhe unë me to jam ngritur.
Me madheshti rilindjen dhe unë kam përjetuar.
Por qiellit si Jezusi unë nuk i jam ngjitur.
Unë qiellin forte e kam mbështjell me keto duar.
Më është dashur parajsës të takoj etërit e lashtë.
Në ferr të ndjej ende erën e temjanit.
si në ritualin e përshpirtjeve të mëngjesit.
Më ka ndodhur që dhe detit t'ia shkul rrapullit.
Damarët e thellësive t'i përshkoj pash më pash
kur më është dashur të qëmtoj mitin pellazgjik
per te lidhur magjite e mallkuara te Universit.
Bir i detit dhe i Durrsi jam.
Askend nuk lejoj te hyj ne labirinthe e te shkaures time.
Laguna tek une askush s'ka per te hapur kurre.
I këtij qyteti unë jam një copëz det i ngut.
Një pëmë e tij e lulëzuar jam, që rritet nëpër muzg.
Une bir i detit dhe i Durrsit tim, jam.

skender iljaz braka

Unë Zogu I Dimrit...

Unë zogu i dimrit...

Mehalleve te botes përherë i humbur...
Pllakosur prej dhimbjesh dhe trishtimit
Skajeve të jetës çdo ditë duke shtegëtuar,
si zogu i vogel i muzgut të dimerit.

Udhkryqeve endur prej errësirës mbërthyer
Pa ditur se ku mund ta gjejë vetmin time.
dhe pse shpesh herë i gjëndur krahëthyer,
fluturimin për tek ty kam marrë e dashura strehëza ima,

skender iljaz braka

Vajza E Bibliotekës.

Mu kujtua vajza që vinte mbasditeve në bibliotekë.

Unë zija tavolinën e fundit nga krahu i

dritares.

Ditët e mia të trishtuara përtypja në heshtje.

Jashtë, era gjethe të rëna shtynte rrëzë

trotuareve.

Mendimet më shkonin në qytetin e saj të lindjes

ndërsa lexoja Lermontovin në origjinal.

Në vend të fjalëve

tw librit, përtypja mendimet e mia.

Mbrëm në televizor pash Helenën e Trojës.

Në kujtesë doja ta alkimoja

dashurinë e saj për Paridin

dhe gjykimin e palëkundur për vetërrënimin e qytetit.

Bukuria, thosha me vete, nuk është e

përjetshëme.

As perandoritë më të fuqishme të përjetshëme s'janë.

Qytetet dhe njerëzit lëvizin si ujërat e

nëndheshme.

Mbetet vetëm shikimi im mbi atë vajzë bjonde,

që studionte lashtësinë aty në

tavolinën e parë.

Atë të shkuar

prej kujtimeve doja ta shprangosja.

Por vajza me një gaz të çuditshëm në shpirt më thërriste.

Të lidhur më mbante floku i saj i verdhë

dhe imazhi i shkërrmoqur i të gjitha

perandorive.

skender iljaz braka

Vajze E Ketij Qyteti Te Vetmuar

E vetmuara vajzë e këtij qyteti të harruar.
që shkon e vjen përmes ditëve të vdekura,
me ca imazhe mbetur udhëve të ngatërruara.
Me ca murmurima blu buzëve të djegura.

Sonte eje e fli në gjumin e ëndërrave të mia.
që brënda gjumit tënd të trazuar zë dremit.
Prej meje mos u trëmb që syrin e mbaj zgjuar.
E grindem me lugatin që dhëmbët të skërmit.

Se unë s'jam idioti i mëngjezeve të mallkuara.
As i përçarturi që pandalur flet me gjuhë despotësh.
Jam i zakonshëmi që përvesh llërët e munduara.
Orfeu që këndon për zëmëra yjesh dhe botësh.

Unë vij prej nga ku deti frymëmerr
me ëndërrimin e qiejve të përjëtshëm.
Prej nga ku ujëra të mëndafshëta rridhnin
përmes kristalit të ëndërrimit ton të pavdekshëm.

E largëta udha ime aty tek ty, le të prehet..
E lodhur të zgjohet prej tingujsh të coptuar.
Mëngjesi yt i bardh lehtësisht le te derdhet
përmes një shëmbëllimi të trisht, të vjetëruar.

Askush s'do të trokas në gjumin ton e dashur,
Mbi gjurmët tona s'do të shkel njeri.
S'do na trembin psherëtimat e detit marrak
Nëpër muzgjet e përthyer, do ikim unë e ti.

skender iljaz braka

Valës Së Detit

Valës së detit

Ty vale e qetë e detit tim.
Të puth mëngjesit si një prrockë,
që malit zbret me uturimë.
Me dhimbje therse gjer në kockë.

Ti valë e qetë, frymemarrja ime.
Kur m'i përlot k'ta sytë të bukur.

thërrime.
M'i ul qepallat si një flutur.

M'a plas ti zemrën në

Me dallgën-nënë dikur jam grindur.

Ndaj sot prej

syrit më largohet.
Zhurmon e shfryn, nuk ka qetësi.

Me mua vallë përse s'pajtohet?

Ndaj vi të prek, të flas, me ty.
T'më bëhesh dallgë, t'më bëhesh mike.
Mikesh moj valë t'më bëhesh ti.
Dhe dallga -nënë t'na rris orkide.

skender iljaz braka

Vallë Kush Me Flet

Kush më flet prej andej,
ku gjithçka më duket sikur hesht.?
Tani që mbytur jam mes akujve të dimrit.
Me zemër të dridhur qëndroj e mbaj vesh,
shndërruar në një copë gur pa zë,
nëpër kryqëzime të zhumëshme rrugësh,
a në një fillikat të verbërt
që yjeve u kërkon pikat e referimit,
ndërsa kujtesa e vdekur më bredh
mes ndjesive të shpirtit.
Një hije prek me sytë e mi të mbyllur.
Një zanë të brishtë që digjet nëpër dëborë.
Mes zjarresh të tjerë më duket sikur kridhet
Dhe kërkon të më tërheq mes pyllit eshtëror.
Përse dreqin s'më ke njohur gjer më sot?
Mua që ngaherë kam dashur tu vë flatëra,
fjalëve të mia.
Gjithçka të gënjeshtërt ta vidhis,
a ta zhys thellë në tokë.
Që verbërisht kam besuar veçse tek një zë hyjnor.
Tek tingujt e zemrës që meken e dridhen nga dashuria.
Mbase asnjëherë në jetë nuk kam për ta mësuar.
Mbase vet më duhet të kuptoj se janë tinguj zemre
Ato që duan të më mbajnë përherë të zgjuar.
Vallë kush më flet prej andej ku gjithçka po hesht?
Në qofsh ti e përjetshmja dhe e gjalla vërtetësi,
Si kali i bardhë i përrallës do të fluturoj.
për të ardhur gjer tek ty,
Për tu ngjitur gjer në atë lartësi.....

skender iljaz braka

Vargu I Poetit

Nën kumbimin e vargjeve
të mia poetike do të vdes një ditë.
Do të vdes në një shtëpi të thjeshtë.
Një shok fëmijërie tek koka do ta kem.
Më pas të dashurit qivurin e drunjë
me lotë pikëllime nën dhe do ta shtjen.

Dhe përsëri në jetë do të pihet dhe rakia.
Të tjera buzë do dridhen prej dashurisë së parë.
Trishtimi mbi qerpikë përsëri do të zbres.
Këmbana e largët një tjetër do thërras për në varr.

Arratisur do të ngjitem se s'mundem dot të fle.
Si zogu dëborës do endem shteg më shteg.
E përsëri vargje poeti me shpirt do cicëroj.
Të paktën, shpirtërave të gjallë tu jap pak jetë.

skender iljaz braka

Varrosur Nën Gërmadhat E Tua,

Varrosur nën gërmadhat e tua,

Qyteti im i madhërishëm,
nokturn i endërrave të mia gjymtyrë prera,
pa detin asnjëherë s'të kam kuptuar.
S'të kam kuptuar pa amfiteatrin antik
dhe muret e tu prej guri të latuar....

Ditët e tua të mundimëshme
kur me valët mërmërisje ledhatuar,
u bënë klithmat e para të poezisë sime,
që me shpirtin e zemrës t'a kam kënduar.

Varrosur nën gërmadhaat e tua,
mbetur janë psheretimat e mia,
prej dhimbjesh lënguar.
Mbi llerë si foshnje mbajtur të kam patur,
sa herë që trupin tënd kanë lënduar.

Nën bedenat e Torrës Ilire,
përgjumur flenë me heshtjen e shpatave
dhe këngët e dashurive të mohuara.
Ti kurrë nuk do të vdesësh qyteti im.
Në zemër të netëve të tua kam ndezur poezinë
dhe mallin tend të pashuar.

skender iljaz braka

Vdis, O Baba, Vdis!

Akrepat e orës dymbëdhjetë shënuan.
Unë biri yt i vetëm sonte s'mund të fle.
Ti hesht në natën e ftohët diku strukur.
Zhytur në një mjegull të ngjeshur si nën re.

Mbi heshtjen tënde ngrihem e bie i dërrmuar.
Se s'mundem diku të gjej një copëz strehë.
Lëndina ime e vogël prej ca kohe është gardhuar.
Ku e egëra Ulkonjë e pyllit ti qasësh nuk të lë.

Kështu, o ati im na u derdhën këto kohërat modernë.
Si vërshëllima e shkumës së tërbuar që përpin gjithçka.
Se për dikë, i dyti prind i mërzitshëm bëhet, i paduruar.
Dhe dhimbja pa dashur i nënshtrohet dallgëve të mëdha.

S'them se dhimbjes i dhash vënd më tepër nga çduhej.
Se për ty i ngushtova hapsirat e jetës së përditshme.
Por ajo që gjer në plakje ndër mend s'të kishte shkuar.
Kësaj nate mu bë makth e ty diçka e pagëlltitshëme.

Ndaj vdis, o baba, larg syrit e zemrës sime vdis!
Prej kohe askush si afrohet më kaut të ngordhur.
Prej syrit le të shpërthej i hidhërueshmi lot i zisë.
Në të njëjtën pikë mbështetjeje, ne s' mund të ishim ndodhur.

skender iljaz braka

Verbuar Nga Dashuria

M'a solli fati të puqem me një vajzë.
T'i përgedhel asaj flokët dhe duart lehtë- lehtë.
Por mjeri unë i mjeri, që buzët dot s'ia gjeja.
Në vend të tyre natës, puthja sytë e blertë.

Një kupë me verë nga më e vjetëra e haurit.
Më çmendi dhe gjakun m'a ndezi në damar.
Veç dëgjuar e kisha seç ishte dashuria.
Verbuesen hije, që në e ndjeksh, të iken si e marrë.

Me akujt e ferrit mbi rrath le t'me ngijë
Kurora do t'i ve unë murit të saj.
Dy krahë do t'i jap që lartë të fluturojë.
Visaret e mija mbi supe të mbaj.

skender iljaz braka

Vërsëllitëshin Fjalët

vërsëllitëshin fjalet....

Ngritur prej fytyrës tënde si një ishull me dëborë.
Nën syrin pishë të pemës, puthjet në copëza i ndam.
Me etjen e një gjarpëri thëthitës, të thëthita fortë.
Me afshin e flakëve të zjarrit, që ngrihet mbi vullkan.

E thepisura natë, hijet tona të ngatërruara shqyente.
Me hënën buzëkafshuar i thërrmonin pamëshirë.
Binte psherëtima nën shushërima ujërash të ftohta.
Si rrëzim i pandalur në çastet ekstreme e përpirë.

Me ngjyrat e vet gjetheve nën atë heshtje të mugt.
Nën të lehtë erë vjeshte gjithë fjalë vërsëllitëshin.
Nën një buzëqeshje shtirëse të përdredhur yjore.
Dhe gjymtyrët e luleve në livadheve këmbeheshin.

Kështu përcillnim netët e bukura vjeshtërore.
Nën dëndësinë e pemëve në një dritë të verdhëme.
Rrugëtonte dashuria për të mbetur e përjetëshme
Nën fasha të holla drite, mjegulle dhe reflekse.

skender iljaz braka

Veshur I Tëri Në Të Zeza

Tërheqja ndonjëherë është një taktikë e gabuar.
Kur sulmi kacafytet thatsirave paralizuese të shpresës.
Të gjitha shancet një gjeneral i mirë i hedh në planshet.
Një kuptim më të mirë për ti dhënë vetkontrollit, të vërtetës.

Sot asgjë s'mund të përcaktojnë gjeneralët e mendimit.
Ngërçi si orteqet rënë udhës fletës së jetës mbetet i shkruar.
Të pafuqishme hovet, të mbyllura të gjithë shtigjet e zhvillimit.
E vërteta që simbolizon kohën është një fund i papërfunduar.

Endërrat e popujve në ksi lloj ngricash cdo ditë përpihen.
Askush me duar të pastëra kallinjë e misrit nuk zhvesh.
Të humbura në rihumbje nën damkosje të mundimshme digjen.
Pabesueshmëria më e pabesueshme është bërë në çdi sy e vesh.

Popujt nën sëmundje të pashërueshme mbeten t'infektuar.
Nën të njëjtë udhë gjithçaka për të përfunduar.
Epidemit si metastraza përhapen prej fekondimit të pakontrolluar.
Një grusht zotash grindenpër kapitalen si qëntë që natës angullinë.

Skamja ngado mbulon dritën e shikimit.
Gjithkush rri mendon me kokën mbështetur mbi duar.
Fytyra që shprehin pasigurinë nën flakë kandili dridhen.
Nën djersë të ftohta, belbëzimet vinë duke u shuar.

C'mëkat mëkatohet syve të çiltër me ngjyrime pafajësie.
Në ç'përjetësi akullsitë e mbijetesë fshihen e flenë?
Nën këmbë urash të thyera zotat për kapitale grinden e shquhen
Si qëntë e uritur që mesnatës së frikshëme kacafyten e angullinë.

Askush s'mund të thotë se kur do të ulet sipari i kësaj tragjedie

Me bindje shprehem se askujt ndër mënd s'i kish shkuar.
Se endërrat e nëntëdhjetës prej ksi ngricash do përpiheshin.
Me të tjera epidemira sëmundjesh të pashërueshme infektuar.
Të rihumbura në rihumbje nën shënjëzime mundimesh do digjeshin.

Askush s'mund të thotë se kur do të ulet sipari i kësaj tragjedie.

me duar të pastëra sot botën nuk drejton.
Këmbadoras zvarritur në të pamëshirshmen kohë.
Të nesërmen e frikshëme pushtetet veç bekojnë.
Kështu thonë do të ulet sipari i kësaj tragjedia.
Nën forcën e dhunimitkrimi gjithomonë lulëzon.

skender iljaz braka

Vetem Dashuria Mbetet E Perjetshme

Ku shkuam atë ditë?

Më kujtohet vetëm fërshellima e blirit të blertë,
një pellg i ndezur prej ngjyrave,
i mbështjell prej ëndërrash të mëndafshta.
Po.. edhe dy sytë e ty, si sytë hyjnor të
Afërditës, që rrjedhin kristale akulli,
tek pulsonin mbi kënaqësinë e shqisave.

Asaj dite, ti portën e blertë të pranverës
kërkoje të hapje me çelsin shumgjyresh
të luleve ku flinin bletët.
Syri i hënës së mesnatës,
livadhit ndiqte gjurmët tona të arta.
Kashta e përhimtë e reve, ethshëm digjej pyllnajës.

Përmes dënesash, prej flokëve të derdhur,
grushtet mbushja me pikëzat e shiut.
Me to trishtimin shuaja në atë muzg të përflakur.
Aty kishim mbetëm si dy gurë të një kështjelle,
gjersa nata në gulsha dëbore,
yjet e shuar derdhi mbi ne.

Ti s'doje ta besoje se unë kokërra dëllinje
kisha mbjellur për buzët e tua të djegura.

Mëndësisht nuk isha më aty, por diku larg.
Mendoja se s'ka perandori të përjetëshme.
E përjetëshme nuk mund të jetë as toka.
Se vetëm dashuria mbetet e përjetëshme,
ushqyer prej një burimi të përhershëm.

Tutje, gjurmët e skive kishin mbetur
si dy paralele, që humbisnin pafundësis.

Më pas, vetëm ajëri i lagësht i agut
ripërtëriu kujtesën tonë të ngrirë.
Atëherë ti më the se fati im do të ndiqte
këngët, letrat, librat dhe poezit.
Dhe unë që prej asaj kohe,

asgjë nuk kam lëvizur nga fusha ime e betejës.

skender iljaz braka

Vetmuar Buze Detit

Diku buzedetit, i vetëm do të jem.
Në se aty do vish të më takosh.
Unë qesh e qaj veç me një valë.
Për ty i tharë, i tretur gjer në kockë.

Shnëdruar jam në një sterkalë.
Tek një mollusk i mbyllur do jem fortë.
Në një nimfë të trëmbur do jem nën valë.
I etur për pak jetë të bukur në k'të botë.

skender iljaz braka

Vira, Vira, Vira.....

Të vija re buzëmbremjeve kur nxitimthi më shkoje.
Me atë ecje shpërfillëse siç shkon rëndom një patë.
Belit, një xhokoventë meshini tepër e puthitur.
Dhe kërcinjët mbuluar prej një palë çizmeve me jakë.
Qafën tënde të holl parakohe të rrudhosur.
E qarkonte tej e tej një gjerdan i larë në ar.
Të shpupuriturat flokë gri, iden më krijonin
e të porsa ngriturës prej një gjumi të rend e shkatrrimtar.
Nuk di përse aq shumë më dhimbsuroheshe ti Vira.
Dhe pse tinëzisht vështroje, xhepat e mi të ftohtë.
Herë - herë moskokëçarëse mbrapa ktheje kokën.
Kur djemëria të thërrisnin:
- Vira! Prapanicat, Vira!)
Vira, Vira, Vira....moj virane.
Përse mendon sikur ke pushtuar gjithë botën?
Në fundin e rrugicës u ndeshëm një ditë vjeshte.
Nën çadrën time të mbajta, për sa kohë binte shi.
Sikur ta kisha parashikuar të nesërmen Vira.
Të pamundshëmen do bëja, atë që rrallë bënë çdo njeri.
Më thanë se tek një dhomë moteli të braktisur.
Të shtrirë të kishin lënë me trupin tënd pa jetë.
Shumë gjak të kish rrjedhur mbi një çarçaf të flliqur.
Coptuar gjoksi yt prej një mjeti të mprehtë.
Sa shumë kam qar për ty, o pafajësi mjerane.
Viktimë e viktimizuar e kësaj kohe grabitqare.

Vira. - puntoret e ngarkim shkarkimit e perdorin per..Ngrije.
Vira prapanicat... ngrihi prapanicat...

skender iljaz braka

Vratarja Ime S'Mund Të Bëhesh.

Vratarja ime s'mund të bëhesh.

Prej një zjarrshpirti që s'më shuhet jam përzhitur.
I djegur prej ca syve të ndezur plot butësi.
Vrarë buzëve të tua, ku bota ime gjeti përmytjen
Unë zogu i qelqt, i natës së akullt,
në dritaren e përgjumur të qiellit,
cijatjen time e përvuatshme kam varur.

O dhimbje e pakufijshme e pambarimit.
Dhe çasteve kur prej syve më humbet,
Skajeve të syve të tu do të më gjesh.
Atje ku livadhi i blert shtrin trupin e tij të qëndisur
Dhe pishnaja e manushaqtë, grykash të egëra humbet.

Të përgjërohem ty që vallen hedh mes qiejve.
Ty kënga, ime pa fund e pa fillim, shtat rrëmejësh
Përmes tingujve të tu nxitojnë e rrjedhin mpirjet.
Përplaset e thyhet e ashpëra shkumë lumenjësh.

O ti pasqyrë e mysët dritash mëshiromë!
Se me përçim dhe përqeshje velur i jam jetës.
Më fortë se kjo rreze dielli bëmë të ngazëllehem.
Të vdes brënda teje me buzëqeshjen e ëmbël tëë shpresës.

Kujtimeve të mia ti përjetësisht do të jesh.
Mbi një mal plagëdhimbjesh duke shkelur me qetësi.
Me shkëlqimin e fildisht, puthmi sonte sytë e vrar.
Vratarja ime ti s'mund të behesh kurrësesi.

skender iljaz braka

Xhaketa E Vjeter

Përthyhen deget gri te viteve
dhe token puthin te perlotur.
Diagonale theniesh nderpriten,
perplasen tej muzgut,
gjymtohen,
si gërqeror kristale thyhen,
therrmohen.
Ne nje terren pa perpendikulare
ku luleverdhat kane vite pa çelur
gladiatoret dylufimin makaber
kane nisur per nje shesh te vdekur.
Bulevardet e heshtura
dikur parade mbleserish,
petkun e zis mbi supe kane hedhur,
Tempulli memec i fjales se lire
kryqezohet deshirash te shfrenuara.
Ne piedestralet e mermerte te kancelarive,
kendet pergjysmohen,
ngerdheshen.
Nga dosjet voluminoze,
fijet e letrave shperndahen
pertej oqeanit te ngrir te veriut.
Une ketu kam mbetur...
me jaken e xhaketes ngritur.
Kam mbetur me po ate xhakete te vjeter.

skender iljaz braka

Zbret Një Natë Dikur

Zbret një natë dikur...

pa dëshirën dhe mëndësinë time,
tënden, të atyre, të të gjithëve.

Zbret një natë e lagësh me bimësi lulesh të tejdukshme.

Këmbana e largët thotë se është nata
e një kontinenti të madh, të përgjumur,
ku erëra eshtrash e shpirtërash fryjnë,
pas jehonën dhe avujt e lëngatës duke tërhequr.

Ajo, nga larg vjen deri te streha jonë e dashur,
deri tek kindet e bardha dhe
këmbët e ftohta të shtratit ku bashk ne të dy jemi mbledhur.

Ti fle me sy të lodhur dhe s'më pyet
se ç'forcë më solli deri tek këto brigje të pafuqishme,
deti tek këto fund ëdërrash të magjishme.
Aty ku era tund degën e thatë të lajthisë së murrme.
Deri aty ku si zbatica dhe batica e detit,
kjo thirrje e beft afrohet, tërhiqet dhe tkurret.

Dhe përbetohet si një dritë që ikën përgjatë buzëdetit,
e ndjekur prej hijesh të holla
që sillen e vërtiten për qark ferrit.

Këta tinguj nate të magjishëm të pranverës,
më bëjnë të them kaq shumë gjëra për sytë e tu.
ngulitur fundit të këtyre brigjeve ku një shpend ndjellakeqës guit.
Mbi të, erërimi ynë më i fuqishëm se shfryrja e vullkaneve
ngrihet e davaritet.
Eshtë më i fortë se erëmimi i kalbëzimit në agullimë
të një shekulli të vdekur
që strehë bëri nën ngrohtësinë e lëkurës sonë të regjur.

Gremisen yjet te cepi i një përroi të padukshëm.

Ne shtrënguar në krahtë e njëri-tjetrit,
natën e pazëshme për qeshim.

skender iljaz braka

Zbret Një Natë Dikur...

pa dëshirën dhe mëndësinë time,
tënden, të atyre, të të gjithëve.
Zbret një natë e lagësh me bimësi lulësh të tejdukshme.
Këmbana e largët thotë se është nata
e një kontineti të madh, të përgjumur,
ku erëra eshtrash e shpirtërash fryjnë,
pas jehonën dhe avujt e lëngatës duke tërhequr.
Ajo, nga larg vjen deri te streha jonë e dashur,
deri tek kindet e bardha dhe
këmbët e ftohta të shtratit ku bashk ne të dy jemi mbledhur.

Ti fle me sy të lodhur dhe s'më pyet
se ç'forcë më solli deri tek këto brigje të pafuqishme,
deti tek këto fund ëdërrash të magjishme.
Aty ku era tund degën e thatë të lajthisë së murrme.
Deri aty ku si zbatice dhe baticë e detit,
kjo thirrje e beft afrohet, tërhiqet dhe tkurret.

Dhe përbetohet si një dritë që ikën përgjatë buzëdetit,
e ndjekur prej hijesh të holla
që sillen e vërtiten për qark ferrit.

Këta tinguj nate të magjishëm të pranverës,
më bëjnë të them kaq shumë gjëra për sytë e tu.
ngulitur fundit të këtyre brigjeve ku një shpend ndjellakeqës guit.
Mbi të, erërimi ynë më i fuqishëm se shfryrja e vullkaneve
ngrihet e davaritet.
Eshtë më i fortë se erëmimi i kalbëzimit në agullimë
të një shekulli të vdekur
që strehë bëri nën ngrohtësinë e lëkurës sonë të regjur.

Gremisen yjet te cepi i një përroi të padukshëm.

Ne shtrënguar në krahtë e njëri-tjetrit,
natën e pazëshme për qeshim.

skender iljaz braka

Zhguni I Vjeter

E hoqa nga supet të vjetrin zhgun.
Çdo mëngjes, e mbrëmje mëmbyste
me duhmën e tij.....
Te thith ajerin e paster kam dal ne dritare
dhe ju, o njerez, të mbar globit,
Perzemersisht tu pershendes.
Se di dhe une te them ' tungjatjeta'.
Romane te lexoj e te thurr poezi
Te ndaj qetesisht egjern nga thekrra.
Pa di te beje mire edhe dashuri.
Relike zhgunin ne nje qoshe e lash.
Relike te nje kohe te eger, tragjike.
Guximin mora ne deren tuaj te trokas.
T marr prej jush nje thirrje:
- Eja.! Tungjatjeta!

skender iljaz braka

Zog I Dëborërave Të Pranverës.

Nuk di përse i përngjave
kaq shumë këngës së erës.
Dhe emrin gdhënde mbi qëndisma
copëzash të kaltëra ajrore.
Me puthjen prej drite ethshëm më tërhoqe
gjer në zgrip të humnerës.
Më përplase mes shkëlqimit të bukuris,
Me buzët gjysmë të mbyllura më përplase,
si shpirt i ardhur befas prej largësish.
Përmes piskamaves dhe llahtarës,
shndërruar në një re të mëndafshët pluhurore.
Në një pemë thithëse të burimeve të hidhërimit
Me tharmin e zi të erës së natës më le.
Më le si një gur vetmie,
ku gjuajn rrebeshet e trishtimit.
Ti që kaq papritmas m'u ktheve
në shpirt të shpirtrave të vdekur.
Psherëtimave të skajshme e nise këngën tënde.
Të pakapshëmin fluturimin
që të zgjonte bulëzimin e vesë.
Drithërimën e dhimbshëme ngjite
përtej pyjeve të dendur.
Zog i mardhur i dëborërave të pranverës.

skender iljaz braka